




BASHKIA LEZHË

Plani i Emergjencave Civile

Dhjetor 2020





BASHKIA LEZHË

Plani i Emergjencave Civile

Dhjetor 2020

PËRMBAJTJA

HYRJE	12
1. ADMINISTRIMI I PLANIT	14
1.1. Mirëmbajtja e planit	15
1.2. Regjistrimi i ndryshimeve	17
1.3. Lista e shpërndarjes	18
2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I PLANIT	20
2.1. Synimi dhe objektivat	21
2.2. Qëllimi	22
2.3. Autoriteti për planin	24
2.4. Planet respektive dhe dokumentet	25
2.5. Aktivizimi i planit	26
2.6. Identifikimi i grupeve më të cënueshme/vulnerabël	27
2.7. Trajnimet dhe ndërgjegjësimi publik	30
2.8. Menaxhimi i vullnetarëve	36
3. STRUKTURAT, ORGANIZIMI, PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT	38
3.1. Strukturat dhe autoritetet në nivel qendror	39
3.2. Strukturat dhe autoritetet në nivel qarku	40
3.2.1. Detyrat e Prefektit të qarkut	40
3.2.2. Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel qarku	40
3.2.3. Drejtuesi i Operacionit në Qark (DOQ)	41
3.3. Strukturat dhe autoritetet në nivel bashkie	41
3.3.1. Përgjegjësitë e Komisionit të Mbrojtjes Civile në bashki	43
3.3.2. Detyrat e Drejtuesit të operacionit në bashki	43
3.3.3. Strukturat bazë operationale në bashki	44
4. PËRGJIGJA NDAJ EMERGJENCAVE	46
4.1. Nevojat për bashkërendimin e operacioneve për përballimin e fatkeqësive dhe mekanizmat e realizimit midis organizatave të ndryshme	47
4.2. Funkcionet dhe menaxhimi i qendrës operationale të emergjencës (QOE) në bashki	49
4.3. Menaxhimi i emergjencës. Modeli i ndërhyrjes	54

5. RREZIQET, RISQET DHE CENUESHMËRITË.....	55
5.1. Përshkrim i rreziqeve, risqeve dhe cenueshmërive.....	56
5.2. Skenarët.....	57
6. FUNKSIONET MBËSHTETËSE EMERGJENTE DHE RIMËKËMBJA.....	58
6.1. Funkcionet e mbështetjes emergjente.....	59
6.1.1. Organizimi dhe drejtimi, koordinimi qendror / i përgjithshëm i përballimit të emergjencës.....	59
6.1.2. Mobilizimi dhe aktivizimi i burimeve	59
6.1.3. Kërkim shpëtimi	60
6.1.4. Evakuimi i popullsisë civile (shpërngulja).....	61
6.1.5. Strehimi (i përkohshëm)/akomodimi i përkohshëm gjatë emergjencës batanije, tenda, shtrroje plastike, rroba).....	63
6.1.6. Paralajmërimet të hershme dhe informacione publike për emergjencat, këshillimi i publikut ..	65
6.1.7. Kujdesi mjekësor/ndihma e parë gjatë emergjencës (triazimi/klasifikimi).....	65
6.1.8. Shëndeti publik (shërbimi shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor), higjena.....	66
6.1.9. Vlerësimi fillestar dhe ai i specializuar i dëmeve dhe nevojave ujë, shëndetësi, bujqësi etj. në zonat e prekura dhe mbledhja e centralizuar e informacionit	66
6.1.10. Ofrimi i ndihmës së parë ushqimore dhe asistencës tjetër gjatë emergjencës (ruajtja, magazinimi, mensat etj.).....	67
6.1.11. Zbatimi i ligjit, masat e sigurisë dhe masat për ruajtjen e rendit publik, siguria dhe kontrolli i trafikut	67
6.1.12. Komunikimi, shkëmbimi i informacionit dhe procedurat e raportimit	68
6.1.13. Shërbimet e Ndihmës Sociale, mbështetja psikosociale / zvogëlimi i panikut.....	71
6.1.14. Bashkimet familjare.....	72
6.1.15. Qendrat Operacionale të emergjencës	72
6.1.16. Sigurimi dhe rivendosja në funksion e infrastrukturës publike dhe kritike (ujë, rrugë, energji elektrike, kanalizime, qendra publike, shkolla etj.)	73
6.1.17. Informimi i publikut për situatën/edukimin shëndetësor (marrëdhëniet me publikun dhe mediat)	74
6.1.18. Logjistika (transporti dhe magazinimi etj.).....	74
6.1.19. Menaxhimi i të dëmtuarve/viktimave në masë.....	76
6.1.20. Mbrojtja dhe shpëtimi i bimëve dhe produkteve bimore	77
6.1.21. Mbrojtja dhe shpëtimi i kafshëve dhe ushqimit të tyre	78
6.1.22. Menaxhimi i asistencës ndërkombëtare (procedurat e Mbështetjes së Vendit Pritës/HNS)	79
6.2. Rimëkëmbja.....	79
7. PARALAJMËRIMI I HERSHËM, MONITORIMI DHE ALARMI.....	82
7.1. Indikatorët e kontekstit. Buletini ditor i IGJEUM.....	83

7.2.	Indikatorët e statusit. Veprimtaritë e monitorimit në kohë reale	85
7.3.	Etapat e fazës së përgjigjes. lidhja me indikatorët e kontekstit dhe statusit	86
8. ETAPAT NË PËRGJIGJEN NDAJ EMERGJENCEVE CIVILE NË BASHKI. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË OPERACIONALE		90
8.1.	Etapa I. Alarmi për rritjen e gatishmërisë	92
8.2.	Etapa II , “Vendosja e Gjendjes së Gatishmërisë”	92
8.3.	Etapa III, “Aktivizimi”	93
8.4.	Etapa IV “Dalja nga Situata”	94
9. SHTOJCAT		96
9.1.	Referencat dokumentare dhe ligjore	96
9.2.	Inventari institucional dhe i burimeve njerëzore	100
9.3.	Burimet financiare	134
9.4.	Zonat e emergjencës	136
9.5.	Matrica e përgjithshme e bashkërendimit të aktiviteteve/funksioneve në përgjigje të emergjencave. Bashkia Lezhë, Prefektura dhe Këshilli i Qarkut	140
9.6.	Matrica e përgjithshme e bashkërendimit të aktiviteteve në përgjigje të emergjencave. Degët territoriale dhe aktorët e tjerë joqeveritarë	143
9.7.	Funksionet Mbështetëse Emergjente dhe aktorët përgjegjës për to	146
9.8.	Lista me pikat e kontaktit	149
9.8.1.	<i>Institucionet qendrore dhe vendore</i>	149
9.8.2.	<i>Kontaktet e Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave tek Prefekti i Qarkut Lezhë</i>	153
9.8.3.	<i>Kontaktet e Komisionit të Mbrojtjes Civile në bashkinë Lezhë</i>	154
9.8.4.	<i>Kontaktet e institucionit të Prefektit të qarkut Lezhë</i>	156
9.9.	Raportimi i detajuar për dëmet e fatkeqësive tek Prefekti dhe QKOEK	157
9.10.	Skenari i përmblytes në bashkinë Lezhë	158
9.11.	Skenari i zjarrit në pyll në malin e Shëngjinit, bashkia Lezhë	178
9.12.	Histori fatkeqësish natyrore dhe fatkeqësish të tjera në territorin e bashkisë Lezhë	190
9.12.1.	<i>Tërmetet (Gjeorreziket)</i>	190
9.12.2.	<i>Stuhi bore, erë e fortë, breshër etj (meteorologjike)</i>	193
9.12.3.	<i>Përmblyte, përmblyte të shpejta dhe valë e madhe deti (hidrologjike)</i>	196
9.12.4.	<i>Zjarret</i>	203
9.12.5.	<i>Biologjike</i>	204
9.12.6.	<i>Teknologjike, shpërthim zjarri</i>	206
9.13.	Urdhri i Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e Komisionit të Mbrojtjes Civile” dhe Rregullorja	207

LISTA E FIGURAVE

FIG 1	Cikli i planifikimit të emergjencave dhe rishikimit të planit	15
FIG 2	Planimetria e bashkisë Lezhë	23
FIG 3	Skema e përgjithshme organizative KNEC-DQO-DOQ-DOB	39
FIG 4	Skema organizative Ministri-Prefekt-bashki	40
FIG 5	Strukturat e mbrojtjes civile në nivel qarku	41
FIG 6	Strukturat e mbrojtjes civile në bashki	42
FIG 7	Skema e menaxhimit të fatkeqësive në tre nivelet. Parimi i subsidiaritetit	54
FIG 8	Hartat përmbledhëse të vlerësimit të risqeve në bashkinë Lezhë	56
FIG 9	Mënyrat e ndryshme të grumbullimit të informacionit në bashki	70
FIG 10	Komunikimi operacional në nivelin vendor	70
FIG 11	Indikatorët e kontekstit, të statusit dhe etapat e përgjigjes	87
FIG 12	Ilustrimet e indikatorëve të statusit. Thellësia e ujit në karrexhiatë	88
FIG 13	Gjendja e karrexhiatës	88
FIG 14	Gjendja e prurjeve në shtretërit e lumenjve dhe nënkalime	89
FIG 15	Gjendja e prurjeve në lumenjtë e mbuluar	89
FIG 16	Etapat e fazës së përgjigjes	91
FIG 17	Katër rastet e kalimit tek Etapa IV "Dalja nga situata"	95
FIG 18	Varianti A i një fushe kampingu. 6 module x 8 tenda me përmasa 6x4 m. Sipërfaqe kampingu 65x110 m. Kapaciteti 192-240 persona	139
FIG 19	Varianti B i një fushe kampingu. 4 module x 8 tenda me përmasa 7.8x5.1 m. Sipërfaqe kampingu 65x110 m. Kapaciteti 128-160 persona	139
FIG 20	Skema e aktorëve qeveritarë dhe joqeveritarë të angazhuar në përballimin e emergjencës sipas skenarit të përmbytjes në territorin e bashkisë Lezhë	158
FIG 21	Sipërfaqet e përmbytura sipas skenarit (google earth)	175
FIG 22	Sipërfaqet e përmbytura historikisht (ArcMap)	175
FIG 23	Sipërfaqet e rrezikuara nga shkatërrimi i digës së rezervuarit Kallmet (google earth)	176
FIG 24	Sipërfaqet e rrezikuara nga shkatërrimi i digës së rezervuarit Kallmet (ArcMap)	176
FIG 25	Foto nga zjarret në Shëngjin në verën e vitit 2016	178
FIG 26	Skema e aktorëve qeveritarë dhe joqeveritarë të angazhuar në përballimin e emergjencës sipas skenarit të zjarrit në Shëngjin	179
FIG 27	Sipërfaqja e zjarrit Shëngjin sipas skenarit (google earth)	189
FIG 28	Pamje nga puna për eliminimin e pasojave të tërmetit të 15 Prillit 1979	191
FIG 29	Shembje në bregun e lumit Mat	192

FIG 30	Guri i rënë, që shkaktoi humbjen e jetëve njerëzore në Torovicë (majtas), Gurë në rrezik rënie në shpatin e malit të Torovicës (djathtas, burimi Nj.A. Balldren).....	193
FIG 31	Borë në qytetin e Lezhës, 2.09.2009 (Foto J. Gjini).....	194
FIG 32	Era e fuqishme e 5 Shtatorit 2010,.....	195
FIG 33	Aksidente nga erërat e fuqishme të datës 23.02.2019 në aksin Lezhë-Milot. (Foto J.Gjini) ..	195
FIG 34	Dalje e ujërave të lumit Drin nga shtrati në zonën e Balldrenit.....	199
FIG 35	Pamje nga përmbytjet në fshatin Barbullojë të Nj.A. Kolsh.....	199
FIG 36	Përmbytje nga deti në zonën e Hidrovorit të Tales.....	202
FIG 37	Pasoja të stuhive detare në bregdetin e Kunës.....	202
FIG 38	Pamje nga aksidenti i ndodhur (majtas) dhe zona e djegur dhe e ndotur e Knallës (në të djathtë).....	206

LISTA E TABELAVE

Tabela 1	Regjistrimi i ndryshimeve	17
Tabela 2	Lista e shpërndarjes	18
Tabela 3	Emergjencat dhe drejtuesit e operacioneve	44
Tabela 4	Qëllimet e përgjigjes.....	47
Tabela 5	Fazat e rimëkëmbjes dhe karakteristikat.....	80
Tabela 6	Parashikimi i reziqeve hidrometeorologjike, buletini ditor i IGJEUM	83
Tabela 7	Parashikimi i rrezikut të zjarreve, buletini ditor i IGJEUM.....	84
Tabela 8.	Indikatorët e kontekstit.....	84
Tabela 9.	Tabela e indikatorëve të statusit	85
Tabela 10.	Etapat e përgjigjes referuar vetëm buletinit ditor të IGJEUM	86
Tabela 11.	Aktivitetet e bashkisë, faza “Alarm për rritjen e gjendjes së gatishmërisë”	92
Tabela 12.	Aktivitetet e bashkisë, faza “Vendosja e gjendjes së gatishmërisë”	92
Tabela 13.	Aktivitetet e bashkisë, faza “Aktivizimi”	94
Tabela 14.	Aktivitetet e bashkisë, faza “Dalja nga situata”	95
Tabela 15.	Inventari i kapaciteteve të degëve territoriale, Prefektit, Këshillit të Qarkut, arsimit, shëndetësisë.....	102
Tabela 16.	Inventari i kapaciteteve të strukturave të bashkisë Lezhë	113
Tabela 17.	Tabela e kapaciteteve të subjekteve private që mund të angazhohen në parandalimin dhe përgjigjen ndaj fatkeqësive	119
Tabela 18.	Kapacitetet hoteliere bashkia Lezhë.....	131

Tabela 19. Buxheti i bashkisë Lezhë për MZSH dhe emergjencat civile për vitin 2019, 2020 dhe parashikimi për vitin 2021	135
Tabela 20. Zona e grumbullimit/zona e pritjes/zona e strehimit.....	138
Tabela 21. Funkcionet mbështetëse emergjente sipas institucioneve të Prefektit të qarkut, Këshillit të qarkut dhe bashkisë	140
Tabela 22. Funkcionet mbështetëse emergjente sipas degëve territoriale dhe aktorëve të tjerë joqeveritarë	143
Tabela 23. Funkcionet mbështetëse emergjente, institucionet dhe subjektet qeveritarë dhe joqeveritarë kontribues në to.....	146
Tabela 24. Tabela e kontakteve të institucioneve qendrore dhe vendore	149
Tabela 25. Tabela e kontakteve të Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave tek Prefekti i Qarkut Lezhë.....	153
Tabela 26. Tabela e kontakteve të Komisionit të Mbrojtjes Civile në bashkinë Lezhë.....	154
Tabela 27. Tabela e kontakteve të institucionit të Prefektit të qarkut Lezhë.....	156
Tabela 28. Institucionet e angazhuara dhe kapacitetet e vëna në dispozicion.....	181
Tabela 29. Të dhëna nga mbështetja e dhënë familjeve në nevojë	192

SHKURTESAT

AAR	After Action Report (<i>Raporti pas Veprimit</i>)
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
ARM	Agjencia Rajonale e Mjedisit
ARRSH	Autoriteti Rrugor Shqiptar
ASIG	Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinor
BE	Bashkimi Evropian
DesInventar	Sistemi i Inventarit të Fatkeqësive (<i>Sistema de Inventario de Desastres</i>)
DQO	Drejtuesi Qendror i Operacionit
DOB	Drejtuesi i Operacionit në bashki
DRAP	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
DOQ	Drejtuesi i Operacionit në Qark
DPRMSH	Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit
EC	Emergjencat Civile
EKB	Enti Kombëtar i Banesave
FA	Forcat e Armatosura
FNSH	Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë
FO	Forcat Operacionale
GIS	Geographic Information System (<i>Sistemi i Informacionit Gjeohapësinor</i>)
IGJEUM	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
IKMT	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
KKSH	Kryqi i Kuq Shqiptar
KM	Këshilli i Ministrave
KNEC	Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile
KMC	Komisioni i Mbrojtjes Civile
KTK	Komisioni Teknik Këshillimor
KUZ	Kanalizimet e Ujërave të Zeza
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MC	Mbrojtja Civile
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MK	Ministria e Kulturës
MM	Ministria e Mbrojtjes

MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MZSH	Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi
Nj.A	Njësia Administrative
Nj.V.K.SH	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor
OJF	Organizata Jofitimprurëse
OJQ	Organizata Joqeveritare
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
OSHEE	Operatori Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PAK	Persona me aftësi të kufizuara
PKEC	Plani Kombëtar i Emergjencave Civile
PRONEWS	Projekti “Përmirësimi i Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm dhe Parandalimit të Përmbytjeve” i financuar nga BE
PSH	Policia e Shtetit
QBO	Qendra e Bashkuar Operacionale në Ministrinë e Mbrojtjes
QKOEK	Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile në AKMC
QKUM	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore
QOE	Qendra Operacionale e Emergjencave
QOEQ	Qendra Operacionale e Emergjencave Civile në Qark
ZRF	Zvogëlimi i Riskut të Fatkeqësive
SAR/SHKSH	Shërbimi i Kërkim Shpëtimit
SFDRR	Sendai Framework for Disaster Risk Reduction (<i>Kuadri Sendai për Reduktimin e Riskut të Fatkeqësive</i>)
SHGJSH	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
SHMU	Shërbimi Meteorologjik Ushtarak
SITREP	Situation Report (<i>Raporti Situacional</i>)
SHU	Shërbimi i Urgjencës
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SRL	Spitali Rajonal Lezhë
UNDRR	United Nation Disaster Risk Reduction (<i>Zvogëlimi i Riskut të Fatkeqësive të Kombeve të Bashkuara</i>)
ZVAP	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

HYRJE

Plani i emergjencave civile të Bashkisë Lezhë është dokumenti kryesor i Institucionit të bashkisë për menaxhimin e emergjencave civile në territorin e saj.

Qëllimi i Planit të Emergjencave është të përshkruajë strukturën dhe organizimin e nevojshëm për të koordinuar në mënyrë efektive gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen ndaj emergjencave nën juridiksionin e bashkisë Lezhë. Ky plan nuk ofron udhëzime operacionale për raste emergjente të cilat koordinohen në vend nga organizatat përkatëse të përgjigjes emergjente.

Plani u përgatit në kuadër të Programit të ndërtimit të kapaciteteve të menaxhimit të riskut të fatkeqësive në nivelin lokal, projekti pilot Lezhë. Ky ishte projekti i parë në nivelin vendor që pasoi miratimin e ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile” (këtëj e tutje ligji 45/2019) por edhe një sërë fatkeqësish natyrore të shkallës së lartë siç ishin tërmetet e datave 21.09.2019 dhe 26.11.2019 si edhe situata e pandemisë që filloi në fillimin e muajit mars 2020 e në vazhdim.

Plani u hartua në një kohë kur pritshmëritë pas miratimit të ligjit 45/2019 ishin maksimale për një transformim thelbësor të sistemit të mbrojtjes civile në të gjitha nivelet, me një theks të veçantë në nivelin vendor. Parimi i subsidiaritetit i sanksionuar më parë në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” është sanksionuar sërish në ligjin 45/2019, i cili i kategorizon emergjencat civile në vendore, rajonale dhe kombëtare, me një kontribut të vetëm të bashkisë në të parën, të përbashkët me bashkitë ose qarqet e tjera në të dytën dhe angazhim të bashkisë krahas angazhimit të gjithë shtetit në të tretën.

Për përmbushjen e detyrave të specifikuara qartë në menaxhimin e risqeve të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile, ligji 45/2019 ka sanksionuar për bashkitë detyrime të qarta, siç janë parashikimi i buxhetit vjetor jo më të vogël se 4%, hartimi i vlerësimit të riskut të fatkeqësive, planit vendor të emergjencave civile, strategjisë së zvogëlimit të riskut të fatkeqësive etj. Rritjes së kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të bashkisë për reduktimin e riskut të fatkeqësive (ZRF) dhe mbrojtjen civile (MC) po u kushtohet një rëndësi e veçantë që prej miratimit të ligjit 45/2019.

Referuar VKM nr.965, datë 2.12.2015, për bashkitë qendër qarku, duhet të ekzistojë struktura e emergjencave civile në nivel drejtorie e cila në rastin e bashkisë Lezhë u plotësua gjatë periudhës së implementimit të projektit pilot. VKM nr.965, datë 2.12.2015 u shfuqizua nga VKM nr. 923, datë 25.11.2020 “Për funksionimin e organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe

bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile”, sipas pikës 16 të së cilës, në bashki duhet të ngrihen struktura të përhershme të planifikimit e të mbrojtjes civile.

Ngritja e Komisionit të Mbrojtjes Civile (KMC) në bashki është një detyrim tjetër që buron prej ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, sipas të cilit “përbërja, funksionimi dhe detyrat e komisionit, miratohet me urdhër të kryetarit të bashkisë”. Për këtë arsye, në përputhje me programin e implementimit të projektit, u hartua që në fillimin e tij Urdhri i Kryetarit të bashkisë “Për ngritjen e Komisionit të Mbrojtjes Civile” me qëllim krijimin e forumit përkatës për menaxhimin e risqeve të fatkeqësive në bashki dhe që do të shërbente njëkohësisht edhe për diskutimin dhe miratimin e të gjitha produkteve të projektit pilot. Sipas Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë, KMC kishte, ndër të tjera, përgjegjësi hartimin e planit vendor për emergjencat civile në territorin e bashkisë Lezhë, vlerësimin e risqeve nga fatkeqësitë dhe strategjinë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.

Procesi i hartimit të planit vendor të emergjencave civile u udhëhoq nga ekspertët e PNUD-it me mbështetjen edhe të ekspertëve të Co-Plan.


Përveç bashkisë, u përfshinë në procesin e përgatitjes së planit edhe të gjithë aktorët e tjerë qeveritarë dhe jo qeveritarë në nivelin e bashkisë dhe qarkut, në veçanti institucioni i Prefektit të qarkut Lezhë dhe degët territoriale në qark.

Për përgatitjen e planit u shfrytëzuan të gjitha dokumentet ekzistuese dhe përvojat e ekspertëve dhe grupeve të tjera të interesit. Nënvizojmë faktin se plani u bazua edhe në gjetjet sikurse është në koherencë me dokumentin e vlerësimit të riskut të fatkeqësive dhe me strategjinë vendore të ZRF dhe MC, çka përbën edhe rastin më të mirë për përgatitjen siç duhet të një dokumenti të tillë.

Theksojmë faktin se për hartimin e planit u morën parasysh plani i emergjencave civile dhe menaxhimit të krizave i bashkisë Lezhë i vitit 2018, plani i emergjencave civile të Qarkut Lezhë të përditësuar në vitin 2018 dhe plane të tjera, raporte dhe dokumente, listën e të cilave do ta gjeni në vijim.

Ky plan është pronë e bashkisë Lezhë. Ai përmbledh informacione dhe tregon rolet e drejtuesve të përfshirë në të gjitha fazat operacionale të menaxhimit të situatave emergjente, bazuar edhe në përvojën e menaxhimit të disa llojeve të fatkeqësive të ndodhura në territorin e bashkisë Lezhë ndër vite.


ADMINISTRIMI I PLANIT



1.1. MIRËMBAJTJA E PLANIT

Vlerësimi, shqyrtimi dhe rishikimi

FIGURA 1 Cikli i planifikimit të emergjencave dhe rishikimit të planit



Plani i emergjencave civile hartohet bazuar në strategjitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, dokumentet e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, kapacitetet e mbrojtjes civile, gjetjet e reja të ekspertëve, si edhe përvojat e fituara në menaxhimin e fatkeqësive¹. Struktura përgjegjëse për vlerësimin, shqyrtimin dhe rishikimin e planit të emergjencave në bashki do të jetë Komisioni i Mbrojtjes Civile. Ndërsa struktura fillestare e bashkisë që do ta ketë këtë detyrë në përshkrimin e punës së saj, do të jetë Drejtoria e Emergjencave Civile e cila do të shërbejë edhe si Sekretariat Teknik i KMC. Koordinator i vlerësimit, shqyrtimit dhe rishikimit të planit të emergjencave civile do të jetë Drejtori i Drejtorisë së EC në bashki.

Plani i emergjencave civile nuk ka nevojë që të jetë i madh ose i sofistikuar. Plani mund të rafinohet, zgjerohet dhe përmirësohet me kalimin e kohës përmes proceseve të trajnimit dhe vlerësimit. Asnjëherë dokumenti i planit nuk është një qëllim në vetëvete. Ajo që është e rëndësishme është procesi i planifikimit, i cili duhet të jetë pjesë e kulturës së përditshme të menaxhimit të bashkisë. Përgjegjësitë në plan u referohen pozicioneve apo posteve dhe jo emrave, me qëllim evitimin e rishikimeve vetëm për shkak të ndryshimit të individëve në këto pozicione.

Një plan efektiv emergjence për të gjitha rreziqet nuk është një dokument i shkruar që prodhohet një herë dhe pastaj harrohet. As planifikimi i emergjencës në vetvete nuk është një proces që kryhet një herë; përkundrazi, është një cikël i vazhdueshëm planifikimi, trajnimi, ushtrimi, vlerësimi dhe veprimi korrigjues.

Vlerësimi/testimi i planit

Për tu siguruar që plani do të funksionojë në një emergjencë reale, ai duhet testuar apo “vlerësuar” siç njihet në zhargonin e planifikimit të emergjencave. Për vlerësimin e planit shërbejnë:

- **Konsultimet dhe diskutimet.** Edhe pse këto ishin pjesë e hartimit të planit, ato do të vazhdojnë rregullisht edhe më pas duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me aktorët e tjerë dhe duke u përfshirë në mënyrë reciproke si pjesëmarrës apo vëzhgues në aktivitetet e njëri tjetrit siç janë trajnimet dhe ushtrimet.
- **Ushtrimet dhe informacionet mbi ushtrimet.** Do të jenë metodat kryesore për vlerësimin e planit. Qëllimi është që normalisht të vlerësohen të gjitha aspektet e planit, si të veçuara ashtu

¹ Pika 7 e nenit 14 të Ligjit 45/2019

edhe i gjithë plani, për një cikël ushtrimesh 3-5 vjeçar. Ushtrimet e vlerësimit supozojnë se stafi e ka marrë trajnimin e nevojshëm dhe është në gjendje të kryejë rolet e tij emergjente, në mënyrë që mësimet e nxjerra më pas të lidhen me efektivitetin e përgjigjes së planifikuar dhe jo me aftësitë e vetë stafit. Pasi të jetë kryer debriefing (raportimi dhe diskutimi) i një ushtrimi, duhet të përgatitet një raport dhe të hartohet një plan veprimi për zbatimin e veprimeve të cilat u identifikuan si të nevojshëm. Veprimet mund të përfshijnë ndryshime në planin e përgjigjes, ndryshime në procedurat operative ose shtesa në trajnime. Pas një incidenti ose një situatë të përafërt, diskutimet duhet të mbahen në të njëjtën mënyrë sikurse për ushtrimet. Ky proces është i dobishëm, edhe nëse nuk do të jetë zbatuar plani, pasi mund të ketë mësimet për të nxitur aktivizimin e planit ose përdorimin e planit në rrethana më të gjera se sa ishte parashikuar fillimisht.

- **Kontrolli i përmbajtjes së planit.** Do të kryhet në mënyrë të vazhdueshme. Ai do të përqendrohet në çështjet e detajeve - kontrolli i emrave, aranzhimet e kontaktit dhe vendndodhjet e pikave të takimit etj. Supozimet të cilat janë bërë në fillim të procesit të planifikimit, objektivat e përgjigjes, aktivitetet e përgjigjes dhe mënyra se si do të gjenden burimet, mjedisi në të cilin zhvillohet përgjigja, dhe protokollet e punës ndërmjet institucioneve do të duhet të kontrollohen të gjitha me kujdes për vlefshmërinë.

Shqyrtimi i planit

Konkluzionet përmes vlerësimit të planeve do të japin informacione se sa mirë i përmbush plani objektivat e tij dhe sa efektive janë ato objektiva në sigurimin e përgjigjes që përmbush nevojat e situatës. Ky informacion do të përdoret për të shqyrtuar planin dhe nëse do të jetë e nevojshme për ta përditësuar atë.

Në shqyrtimet e planit duhet të përfshihen të gjithë aktorët ashtu sikurse gjatë procesit fillestar të hartimit. Mund të jetë e dobishme të ri-thirrret KMC si pjesë e procesit të shqyrtimit. Shqyrtimet do të trajtojnë dy aspekte të planit:

- Detaje të tilla si numrat e telefonit, adresat dhe burimet e disponueshme për dislokim;
- Themeloret siç janë objektivat e planit, supozimet e planifikimit dhe aktivitetet themelore të përgjigjes.

Detajet e një plani duhet të rishikohen rregullisht - jo më vonë se një herë në gjashtë muaj, dhe mundësisht në 3 muaj. Shqyrtimet themelore të një plani mund të kryhen në çdo kohë, për shembull pas një emergjence ose një ushtrimi ose si përgjigje ndaj ndryshimeve të mëdha strukturore në bashki. Nëse nuk nevojitet rishikim themelor, atëherë ai duhet të kryhet si çështje rutinë në intervale të rregullta. Këto intervale do të diktohen nga natyra e planit, por normalisht nuk do të jenë më rrallë se një herë në 3-5 vjet.

Çështjet e barazisë gjinore dhe të mbrojtjes së grupeve të cenueshme/vulnerabil në përmbajtjen e planeve gjithashtu duhet të rishikohen në intervale të rregullta.

Rishikimi i planit

Vlerësimi dhe shqyrtimi duhet të pasohen nga rishikimi i planit. Mësimet e nxjerra dhe ndryshimet e identifikuar duhet të përdoren për të bërë ndryshime në plan. Nëse rishikohet vetëm detaji i planit, do jetë e mjaftueshme qarkullimi i rishikimit tek të gjithë marrësit fillestarë të planit. Kjo mund të bëhet duke qarkulluar një listë ndryshimesh, faqe të rishikuara individuale ose një plan të ri të plotë. Kur në plan do të përfshihen ndryshime thelbësore, do të duhet të kryhen konsultime për ndryshimet dhe të fillohet një cikël i ri planifikimi.

Plani duhet të rishikohet veçanërisht:

- Kur ka ndryshime ligjore që shkaktojnë ndikime në politikat e Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive (ZRF) dhe Mbrojtjen Civile (MC) në bashki;
- Sa herë që ndodh një ndryshim në bashki si në aspektin politik edhe në atë territorial;
- Sa herë që ndryshon një anëtar i KMC apo shtohet një funksion mbështetës;
- Pas ose para miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor;
- Nëse elementë të riskut (rreziku, cenueshmëria, ekspozimi dhe kapaciteti përballues) ndryshojnë në mënyrë domethënëse në territorin e bashkisë;
- Nëse ndryshon diçka me rëndësi në nivelin teknik apo shkencor;
- Nëse publikohet një buletin i ri i besueshëm dhe i koduar meteorologjik/sizmik/për zjarret në pyje;
- Nëse zbatohen procedurat e reja për monitorimin e rreziqeve natyrore (stacione të reja hidrometeorologjike, radarë të rinj, të dhëna të reja);
- Hartohen procedurat e reja për komunikimin e riskut;
- Stërviçet, ushtrimet apo emergjencat identifikojnë boshllëqe apo përmirësime në politika dhe procedura;
- Etj..

Një ekspert apo subjekt që dëshiron të propozojë një ndryshim në planin e EC mund ta bëjë duke iu drejtuar bashkisë për këtë qëllim.

Kryetari i Bashkisë, e publikon versionin elektronik të planit të rishikuar të emergjencave në ueb-in e bashkisë, sikurse zgjedh që thjesht të njoftojë, ta dërgojë planin e rishikuar në formë elektronike apo të printuar.

1.2. REGJISTRIMI I NDRYSHIMEVE

Ndryshimet do të dokumentohen në tabelën më poshtë, dhe një plan i përditësuar do të shpërndahet sipas listës së shpërndarjes.

TABELA 1. Regjistrimi i ndryshimeve

Data	Ndryshimet	Faqe nr


1.3. LISTA E SHPËRNDARJES

Njoftimi për planin do u dërgohet të gjitha strukturave në varësi të bashkisë. Institucionet e tjera që njoftohen për rishikimin e planit janë më poshtë:

TABELA 2. Lista e shpërndarjes

Institucioni	Njoftim	I printuar	Elektronik
Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile			
Qendra e Mbrojtjes Civile për qarqet Shkodër, Kukës dhe Lezhë me qendër në Shkodër			
Prefekti i Qarkut Lezhë			
Prefekti i Qarkut Shkodër			
Bashkitë Mirditë, Kurbin dhe Vau i Dejës			
Drejtoria Vendore e Policisë së Shtetit qarku Lezhë dhe Komisariati i Policisë në bashkinë Lezhë			
Degët territoriale në qark në kuptimin e Ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e qarkut” të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e bashkisë Lezhë			
Subjektet private, organizatat jofitimprurëse dhe bizneset e ndryshme, kapacitetet e të cilëve janë marrë në konsideratë në kapacitetet e bashkisë për menaxhimin e emergjencave civile			
Subjektet private, vendase dhe të huaja, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e bashkisë dhe që magazinonjë materiale të rrezikshme, karburante dhe derivate të tyre, gaze energjetike, si dhe kryejnë veprimtari me mjete të rrezikshme (neni 61 i ligjit 45/2019)			
Institucionet publike, strukturat qendrore dhe vendore apo subjektet private që kanë në administrim apo pronësi infrastrukturë kritike (neni 43 i ligjit 45/2019)			
Institucionet shtetërore dhe subjektet private në sektorët e shëndetësisë, të arsimit, mirëqenies sociale, kulturës, mjedisit dhe turizmit (pika 8 e nenit 14 të ligjit 45/2019)			
Institucionet dhe subjekte të tjera private që disponojnë kapacitete për paralajmërimin e hershëm, njoftimin dhe alarmin në territorin e bashkisë (neni 49 i ligjit 45/2019)			

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I PLANIT



2.1. SYNIMI DHE OBJEKTIVAT

Plani vendor i emergjencave civile është dokument i rëndësishëm i hartuar në zbatim të ligjit nr. 45/2019 dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që kanë lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me ZRF dhe MC.

Bashkia Lezhë është mjaft e ekspozuar ndaj fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. Fatkeqësitë natyrore më të shpeshta dhe me pasoja më të rënda janë përmytjet nga lumenjtë dhe ato nga deti; tërmetet; rrëshqitjet masive të tokës dhe rëniet e shkëmbinjve; zjarret në pyje, kullota dhe banesa; reshjet e mëdha të dëborës, stuhitë e dëborës; erërat e forta; thatësira dhe epidemitë.

Për minimizimin e këtyre risqeve kërkohet një vlerësim real i situatave dhe fatkeqësive dhe një pasqyrim sa më i drejtë i menaxhimit të tyre të cilat realizohen dhe pasqyrohen nëpërmjet këtij plani.

Procesi i planifikimit është po aq i rëndësishëm, madje edhe më i rëndësishëm se plani i shkruar. Individët që do t'i përdorin planet e emergjencave duhet të njihen me to dhe t'i pranojnë ato si të ligjshme dhe të përshtatshme.

Është detyrë e drejtuesve vendorë që të parashikojnë dhe të përgatisin plane për emergjencat që mund të ndodhin në territorin e tyre. Planet e shkruara janë vetëm një pjesë e procesit të gjerë të parapërgatitjes, i cili përfshin: planifikimin, masat parandaluese, trajnimin, edukimin publik dhe mobilizimin e burimeve.

Planifikimi për përballimin e fatkeqësive është një proces kompleks vëzhgimi dhe informacioni midis autoriteteve dhe specialistëve teknikë i cili synon rritjen e aftësisë së tyre për të reaguar në përballimin e emergjencave në mënyrë të bashkërenduar dhe të efektshme. Planet e shkruara vijnë si rrjedhojë e këtij procesi kompleks bashkëpunimi e planifikimi.

Plani i emergjencave civile në bashki përshkruan strukturat dhe organizimin e kërkuar për të koordinuar në mënyrë efektive gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen afatshkurtër ndaj emergjencave civile.

Ai shërben për të njohur faktorët që mund të shkaktojnë emergjencë në territorin e bashkisë, kapacitetet vendore dhe operacionale për të parandaluar çdo fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Duke mbledhur së bashku dhe duke qartësuar rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve, strukturave shtetërore dhe subjekteve private, organizatave jofitimprurëse dhe biznesit në territorin e bashkisë, nëpërmjet planit synohet:

- Të parandalohet, të lehtësohet dhe të rimëkëmbet gjendja nga çdo dëmtim për jetën e njerëzve, gjësë së gjallë, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga emergjencat civile;
- Të sigurohen kushtet për institucionet shtetërore, publike dhe private për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës në një situatë emergjente, me humbje sa më të vogla për ruajtjen e rendit për jetën e njerëzve, për gjënë e gjallë, për pronën, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin, ndaj efekteve të një emergjence civile;

- Të garantohet përdorimi i të gjitha burimeve të mundshme në bashki me qëllim sigurimin publik, ruajtjen e vazhdueshme të aktivitetit ekonomik, lokalizimin e zonës së emergjencës dhe lehtësimin e pasojave;
- Të koordinohen dhe bashkërendohen detyrat, me Prefektin e qarkut dhe me institucionet dhe strukturat qendrore e vendore si edhe aktorët joqeveritarë me qëllim rritjen e aftësisë ripërtëritëse nga fatkeqësitë.

Objektivat e matshëm dhe të bazuar në njohuri që përcaktojnë rezultatet specifike që duhet të ndodhin që plani të përmbushë me sukses qëllimin e tij janë:

- Të vendosë një procedurë për një vlerësim, shqyrtim dhe rishikim periodik të planit;
- Të përshkruajë procedurat për zbatimin e planit;
- Të identifikojë procedurat e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm të njoftimit për një fatkeqësi të afërt;
- Të identifikojë se si ofrohet ushqim, veshje, strehim, transport dhe shërbime mjekësore për njerëzit e prekur nga emergjencat;
- Të identifikojë rolet funksionale dhe përgjegjësitë e partnerëve të brendshëm dhe të jashtëm;
- Të identifikojë mbështetjen logjistike dhe kërkesat e burimeve të nevojshme për zbatimin e planit;
- Të identifikojë përparësitë për rivendosjen e shërbimeve thelbësore të ofruara nga autoritetet vendore, qendrore dhe subjektet private;
- Të përshkruajë çdo marrëveshje për ndihmë të ndërsjellë;
- Të përshkruajë një program trajnimi dhe ushtrimesh për stafin të cilit i janë caktuar përgjegjësi në plan.

2.2. QËLLIMI

Plani i emergjencave civile në nivel bashkie ka si qëllim kryesor organizimin në kohë të veprimtarive bashkërenduese të autoriteteve shtetërore, të strukturave të qeverisjes vendore, të subjekteve private dhe të OJQ-ve të cilat veprojnë në territorin e bashkisë, për parandalimin dhe për përballimin e çdo situatë emergjente të shkaktuar nga fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera të cilat kërcënojnë apo dëmtojnë jetën e njerëzve, pronën, gjënë e gjallë, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin. Ato do të përcaktojnë përgjegjësitë e aktorëve pjesëmarrës për parandalimin dhe përballimin e emergjencave si dhe detyrat e gjithsecilit në këtë kuadër.

Plani do të përcaktojë procedurat dhe rregullat për bashkërendimin gjithëpërfshirës të aktorëve në situatë emergjente si dhe veprimtari të veçanta të parashikuara për parandalimin dhe lehtësimin, përgatitjen dhe mbrojtjen, për përballimin e çdo situatë emergjente të shkaktuar nga fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera të cilat kërcënojnë apo dëmtojnë jetën e njerëzve, pronën, gjënë e gjallë, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, ashtu edhe për rikthimin në gjendjen normale dhe zhvillimin në territorin e prekur dhe më gjerë.

Plani i emergjencave civile është i vlefshëm për gjithë territorin e bashkisë Lezhë.

FIGURA 2. Planimetria e bashkisë Lezhë



Burimi: Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020)

Plani trajton fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në kuptimin e nenit 3 të ligjit 45/2019.

Do të konsiderohen:

Brenda fushëveprimit të planit:

- Fatkeqësitë natyrore të cilat ndodhin brenda juridiksionit të bashkisë si: përmytjet nga lumenjtë dhe ato nga deti; tërmetet; rrëshqitjet masive të tokës dhe rëniet e shkëmbinjeve; zjarret në pyje, kullota dhe banesa; reshjet e mëdha të dëborës, stuhitë e dëborës; erërat e forta; thatësira dhe epidemitë;
- Fatkeqësitë e tjera, në kuptimin e nenit 3 të ligjit 45/2019.

Jashtë fushëveprimit të planit:

- Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera të cilat ndodhin jashtë juridiksionit të bashkisë;
- Përgjigje rutinë ose e përditshme ndaj incidenteve nga zjarri, ato të PSH apo SHU.

Parametra dhe supozime

Për këtë plan ekzistojnë supozime që krijojnë kontekstin e planifikimit të përgjithshëm duke përshkruar konsideratat e planifikimit që supozohet të jenë të vërteta. KMC në bashki mund të ketë nevojë t'i vërtetojë ose konfirmojë këto supozime gjatë gjithë procesit të planifikimit. Për të siguruar vlefshmërinë e planit, supozimet e planifikimit duhet të kenë një pritshmëri të arsyeshme për të qenë të sakta.

- 80% e burimeve dhe personelit të reagimit të identifikuar aktualisht në komunitet do të jenë në dispozicion për t'u përgjigjur gjatë një emergjence civile kombëtare;
- Burimet e identifikuar për t'u siguruar përmes marrëveshjeve të ndihmës reciproke do të jenë të disponueshme gjatë emergjencës;
- Në një kohë të caktuar do të ndodhë vetëm një fatkeqësi;
- Të gjithë personat në pozicione që pritet të përgjigjen do të jenë trajnuar kur të aktivizohet plani.

2.3. AUTORITETI PËR PLANIN

Nëpërmjet planit vendor të emergjencave civile sigurohet një hap i rëndësishëm i masave të kërkuara për rritjen e aftësisë ripërtëritëse në nivelin vendor çka është edhe kërkesë e implementimit të Kuadrit Sendai. Në veçanti, zhvillimi i planeve të emergjencave civile është në përputhje me parimin e fuqizimit të autoriteteve dhe komuniteteve vendore përmes burimeve, stimujve dhe përgjegjësisë së vendim-marrjes sipas rastit.

Rritja e kapaciteteve vendore në ZRF dhe MC është e lidhur ngushtë dhe ndikon pozitivisht edhe për plotësimin e detyrimeve të tjera ndërsektoriale që burojnë nga Agjenda për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, Marrëveshja e Parisit mbi ndryshimin e klimës dhe Agjenda e Re Urbane.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim/SKZHI 2015-2020 miratuar me VKM Nr. 348, datë 11.5.2016.

SKZHI i cili është dokumenti kryesor strategjik në RSH ka aktualisht kapitullin 8.5 të tij "Forcimi i rendit publik dhe përgatitjes për emergjencat civile" të dedikuar pjesërisht për emergjencat civile/mbrojtjen civile. SKZHI identifikon sfidat dhe objektivat strategjike në lidhje me ZRF dhe menaxhimin e MC në të cilat përfshihen edhe forcimi i kapaciteteve të menaxhimit të emergjencave civile në nivelin vendor. Në periudhën e përgatitjes së planit, SKZHI ishte në proces rishikimi.

Ligji 45/2019, datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen civile". Sipas pikës 2 të nenit 14 të ligjit: *Planet për emergjencat civile miratohen në nivel qendror, në nivel qarku dhe në nivel vendor dhe rishikohen jo më pak se një herë në çdo tre vjet.* Gjithashtu sipas shkronjës "ç" të nenit 30 të ligjit: *Bashkitë hartojnë, miratojnë dhe përditësojnë planin vendor për emergjencat civile dhe ia dërgojnë AKMC-së dhe prefektit të qarkut, për qëllime analizimi dhe planifikimi;*

Ligji 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Sipas nenit 29; *Bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e këtyre funksioneve:*

- 1. Mbrojtjen civile, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;*
- 2. Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.*

PKEC i miratuar me VKM nr.835, datë 3.12.2004, është dokumenti kryesor i politikave të shtetit shqiptar në fushën e emergjencave civile i hartuar me asistencën e PNUD në vitin 2004. Sipas seksionit 1.4 të tij: *"Lidhja me planet e tjera": PKEC-ja është dokument harmonizues, gjithëpërfshirës, i cili mbledh së bashku të gjitha institucionet dhe strukturat kombëtare dhe ndërkombëtare në përgjigjen ndaj emergjencave civile. Ministritë, drejtoritë, strukturat lokale dhe institucionet e ndryshme kanë hartuar dhe do të hartojnë planet e tyre të emergjencave civile. Planet specifike sektoriale kanë vlerë të veçantë dhe PKEC-ja nuk i zëvendëson ato, por i harmonizon dhe i sjell ato së bashku në një frymë bashkërendimi.*

Sipas seksionit 2.3 të PKEC: *Bashkitë kanë përgjegjësi për parapërgatitjen, planifikimin dhe operacionet e përgjigjes ndaj situatave emergjente që ndodhin në territorin e tyre. Menaxhimi i emergjencave civile në bashki, njësitë bashkiake në Bashkinë e Tiranës bëhet në përputhje me planet e emergjencave ose planet e gatishmërisë që ato përgatitin dhe freskojnë periodikisht.*

Ligji 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", neni 68: *Organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore, në bashkëpunim me strukturat dhe organet e qeverisjes vendore, janë përgjegjëse për parandalimin, përballimin dhe për rehabilitimin e gjendjes së shkaktuar.*

VKM nr.147, datë 18.3.2004 "Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave". Pika 5 e nenit 4: *Bashkitë ndjekin hartimin e planit të alarmit, të evakuimit dhe të ndihmës për mbrojtjen e popullatës dhe të vlerave materiale në rastet e jashtëzakonshme, si rrjedhim i prishjes së digave/ dambave, sipas udhëzimit nr.248, datë 28.1.2000 të gjashtë ministrive, nga shfrytëzuesi i objektit në bashkëpunim dhe me strukturat e pushtetit vendor.*

Udhëzimi i përbashkët i gjashtë ministrive nr. 248, datë 28.01.2000 "Për hartimin e planit të alarmit, evakuimit dhe ndihmës për mbrojtjen e popullatës dhe vlerave materiale në rastet e jashtëzakonshme si pasojë e prishjes së digave dhe dambave" ngarkon bashkinë që të hartojë planin e alarmit, evakuimit dhe ndihmës për mbrojtjen e popullatës dhe vlerave materiale.

2.4. PLANET RESPEKTIVE DHE DOKUMENTET

Plani i emergjencave civile është mbështetur në ligjin 45/2019 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, PKEC sikurse edhe aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit të mëparshëm nr.8756, datë 26.03.2001 "Për emergjencat civile", të ndryshuar, që zbatohen për aq kohë sa nuk bien në kundërshtim me ligjin 45/2019 dhe do të shfuqizohen përkatësisht me nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të tij.

Në kohën që u përgatit ky plan, dokumenti i Vlerësimit të Riskut të Fatkeqësive në nivel kombëtar ishte ende ai i vitit 2003 dhe nuk ekzistonte vlerësimi i risku as në nivelin e qarkut Lezhë. Gjithashtu nuk ekzistonte një dokument i miratuar i Strategjisë Kombëtare të ZRF dhe as një strategji e mëparshme e ZRF në nivelin vendor.

Metodologjia për hartimin e planeve për emergjencat civile² nuk ishte përgatitur deri në momentin e përfundimit të projektit pilot. Në këto kushte, në mungesë të këtij dokumenti, për hartimin e planit u desh që t'i referoheshim përvojës dhe dokumenteve ekzistuese që janë:

- Plani i emergjencave civile dhe menaxhimit të krizave të vitit 2018 të bashkisë Lezhë;
- Plani i emergjencave civile të Qarkut Lezhë i hartuar nga institucioni i Prefektit Lezhë;
- Plani rajonal i emergjencave për reagim ndaj ndotjeve detare (shkalla 2), qarku Lezhë;
- Plani i masave të Prefektit të Qarkut Lezhë për planifikimin dhe përballimin e mbrojtjes civile në kushtet dimërore 2019-2020;
- Dokumenti "Prioritetet mbi evidentimin, parandalimin dhe përballimin e situatave emergjente në qarkun Lezhë për vitin 2020";
- Raporti i Prefektit të Qarkut Lezhë "Mbi marrjen e masave në përballimin e situatave emergjente", drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes me shkresën nr. 1269/3 prot. datë 15.10.2018;
- Informacioni i Prefektit të Qarkut Lezhë "Mbi marrjen e masave për përballimin e emergjencave civile verore" dërguar në Ministrinë e Mbrojtjes me shkresën nr.684/1 prot., datë 5.06.2019;
- Plani i emergjencave civile të Qarkut Shkodër i hartuar nga institucioni i Prefektit Shkodër;
- Manuali "Planifikimi i emergjencave civile" i hartuar nga PNUD në vitin 2003;
- Manuali "Konceptet bazë dhe planifikimi i emergjencave civile" i hartuar nga PNUD në vitin 2005;
- Udhëzuesi për Planifikimin e Emergjencave në nivel Prefekturë në kuadër të nënkomponentit "B2", "Rritja e kapaciteteve të planifikimit të menaxhimit të emergjencave" të Projektit PRONEWS të financuar nga BE;

² Referuar shkronjës "dh" të pikës 6 të nenit 23 të ligjit 45/2019, për krijimin dhe zbatimin e metodologjisë është përgjegjëse AKMC

- Udhëzime të tjera të planeve të emergjencave/mbrojtjes civile të vendeve të tjera si Itali, Mbretëria e Bashkuar, Kanada dhe Shtetet e Bashkuara;
- Plani i emergjencave të Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Lezhë;
- Plani i masave për planifikim dhe përbalimin e mbrojtjes civile në kushtet dimërore. Sektori i Ekstensionit Bujqësor Lezhë;
- Plani i veprimit të emergjencës për Spitalin Rajonal Lezhë;
- Plani i masave të Drejtorisë së Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve “Për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota, si dhe për krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve për vitin 2020”;
- Plane të tjera të degëve territoriale dhe institucioneve të tjera shtetërore, OJQ dhe subjekteve private.

2.5. AKTIVIZIMI I PLANIT

Termi “aktivizim” i referohet aktit të fillimit të planit të emergjencës dhe niveleve të ndryshme të mbështetjes. Bashkia identifikon shkaqet e aktivizimit dhe krijon praktika dhe procedura për njoftimin e personelit të përgjigjes si për ngjarjet emergjente të papritura ashtu edhe për ato me zhvillim të ngadaltë. Përcaktimi i kritereve për aktivizimin e planit të emergjencave është një element kryesor i tij, pasi një nga problemet më të mëdha me përgjigjen ndaj një emergjence është të binden drejtuesit që të aktivizojnë planet. Përvoja shqiptare por edhe ajo ndërkombëtare ka treguar raste kur, edhe pse janë disponuar planet e emergjencave civile, përgjigjet ndaj emergjencave kanë qenë të improvizuara.

Referuar përvojës kombëtare dhe asaj vendore, sugjerohet që aktivizimi i planit në nivel bashkie nuk duhet lidhur detyrimisht dhe as nuk kërkon si parakusht shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në bashki apo në një territor më të gjerë. Plani mund të aktivizohet, në tërësi ose pjesërisht, nëse ka ndodhur një emergjencë ose një e tillë duket e afërt, dhe e cila mund të kërkojë veprim dhe koordinim përtej procedurave normale të funksionimit të bashkisë.

Plani mund të aktivizohet gjithashtu për qëllime parandalimi të emergjencave, për të ndihmuar në planifikimin dhe koordinimin e masave parandaluese ndaj tyre³.

Aktivizimi dhe ekzekutimi i planit dhe procedurave të emergjencës mund të përfshijnë një ose më shumë nga sa vijon:

- Monitorimi dhe vëzhgimi i situatës (p.sh., nga specialistë teknikë)
- Dislokimi i burimeve të nivelit operacional në vend (p.sh., MZSH, SHU, PSH ose personeli i operacioneve të agjencisë përgjegjëse në vendin e një aksidenti ose incidenti)
- Dislokimi i elementeve të mbështetjes në vend (p.sh., aktivizimi i një QOE ose një QOE mobile)

Aktivizimi i planit nuk do të thotë detyrimisht që do të aktivizohet QOE në Bashki.

Vendimi për aktivizimin e planit të emergjencave merret nga Kryetari i Bashkisë në konsultim me Sekretarin e Përgjithshëm në bashki dhe Drejtorin e Emergjencave Civile. Varësisht shkallës së kompleksitetit të situatës, Kryetari i bashkisë mund të kërkojë për këtë edhe mendimin e KMC-së në bashki.

³ Neni 174 i Kushtetutës së RSH

2.6. IDENTIFIKIMI I GRUPEVE MË TË CËNUESHME/VULNERABËL

Një rëndësie e veçantë në dokumentin e planit merr trajtimi i çështjes së grupeve vulnerabil në të cilat kanë kontribut si aktorët qeveritarë ashtu edhe ata joqeveritarë si KKSH, Caritas, Wold Vision, Kleri etj. Për të dhënat për grupet vulnerabil duhet të shfrytëzohet edhe dokumenti i vlerësimit të riskut të fatkeqësive në bashki.

Në tekstin e planit, fjala “komunitet” është përdorur në një kuptim të gjerë duke reflektuar konceptin e gjithëpranuar se të gjithë personat kanë të drejtën për ndihmë. Me “komunitet” duhet të kuptohen gratë, burrat, djemtë dhe vajzat, pavarësisht nga mosha e tyre, paaftësia, kombësia, raca, përkatësia etnike, statusi shëndetësor, përkatësia politike, orientimi seksual, identiteti gjinor ose ndonjë karakteristikë tjetër që ata mund të përdorin për të përcaktuar vetveten.

Jo të gjithë njerëzit kanë kontroll të barabartë të fuqisë dhe burimeve. Individët dhe grupet brenda një komuniteti kanë kapacitete, nevoja dhe cenueshmëri të ndryshme, të cilat ndryshojnë me kalimin e kohës. Faktorë individualë si mosha, seksi, aftësia e kufizuar dhe statusi ligjor ose shëndetësor mund të kufizojnë mundësinë e ndihmës. Këta dhe faktorë të tjerë mund të jenë gjithashtu baza e diskriminimit të qëllimshëm. Dialogu sistematik me gra, burra, vajza dhe djem të të gjitha moshave dhe prejardhjeve - si ndaras ashtu edhe në grupe të përziera - është thelbësor për një planifikim të mirë. Të jesh i ri apo i moshuar, një grua ose vajzë, një person me një aftësi të kufizuar ose i një etnie pakice në vetvete nuk e bën një individ universalisht të prekshëm. Përkundrazi, është bashkëveprimi i faktorëve në një kontekst të caktuar që mund të forcojë kapacitetet, të ndërtojë aftësinë ripërtëritëse ose e kundërta - të dëmtojë mundësinë e ndihmës për cilindo individ apo grup.

Në shumë kontekste, bashkësi dhe grupe të tëra mund të jenë gjithashtu të cenueshëm për shkak se ata jetojnë në zona të largëta, të pasigurta ose të paarritshme, ose sepse janë shpërndarë gjeografikisht dhe me akses të kufizuar ndaj ndihmës dhe mbrojtjes.

Grupet mund të mos shërbehen dhe të diskriminohen për shkak të kombësisë, etnisë, gjuhës ose përkatësisë fetare ose politike, gjë që kërkon vëmendje të veçantë për të pasqyruar parimin e paanësisë.

Kur në hartimin e planit, përfshihen grupe të ndryshme, përgjigjet emergjente janë më gjithëpërfshirëse, përfshirëse dhe mund të kenë rezultate më të qëndrueshme.

Në shumë situata, të dhënat mbi popullsisë janë të vështira për t'u gjetur ose përcaktuar. Sidoqoftë, të dhënat e ndara/zbërthyera do të tregojnë nevojat e veçanta dhe ndikimin e veprimeve ndaj grupeve të ndryshme. Të dhënat e ndara mund të ndihmojnë në identifikimin e njerëzve më në risk, të tregojnë nëse ata janë në gjendje të kenë akses dhe ta përdorin ndihmën humanitare, dhe ku ka nevojë për tu bërë më shumë për t'i arritur ato. Zbërthejini të dhënat sa të mundeni dhe me kategori të përshtatshme për kontekstin për të kuptuar ndryshimet në bazë të seksit ose gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar, gjeografisë, etnisë, fesë ose çfarëdo faktori tjetër që mund të kufizojë aksesin ndaj ndihmës.

Fëmijët

Fëmijët përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të çdo popullsie të prekur nga fatkeqësitë, por shpesh janë më pak të dukshëm. Kapacitetet dhe nevojat e fëmijëve ndryshojnë në varësi të moshës së tyre biologjike dhe fazës së zhvillimit. Duhet të merren masa të veçanta për të siguruar që fëmijët të jenë të mbrojtur nga dëmtimi dhe të kenë akses të barabartë ndaj shërbimeve themelore.

Gjatë emergjencave, fëmijët mund të përballen me rreziqe specifike kërcënuese për jetën, përfshirë kequshqyerjen, ndarjen nga familjet e tyre, trafikimin, dhunën fizike ose seksuale dhe abuzimin, të cilat, të gjitha sëbashku kërkojnë veprime të menjëhershme.

Fëmijët me aftësi të kufizuara ka më shumë gjasa që të braktisen ose të lihen pas dore. Vajzat me aftësi të kufizuara kërkojnë vëmendje të veçantë sepse ato përballen me risk më të madh të dhunës seksuale, shfrytëzimit seksual dhe kequshqyerjes.

Kërkoni në mënyrë aktive pikëpamjet e vajzave dhe djemve të të gjitha moshave dhe prejardhjeve, në mënyrë që ata të mund të ndikojnë në mënyrën e ofrimit, monitorimit dhe vlerësimit të ndihmës.

Të moshuarit

Të moshuarit janë një pjesë në rritje e popullsisë në shumicën e vendeve, por herë pas here të lënë pas dore në përgjigjet ndaj emergjencave.

Të moshuarit sjellin njohuri dhe përvojë në përballimin e emergjencave, shpesh mishërojnë traditat dhe historinë dhe veprojnë si pika referimi kulturore. Izolimi, dobësia fizike, prishja e strukturave familjare dhe komunitare, sëmundjet kronike, vështirësitë funksionale dhe aftësitë mendore në rënie mund të rrisin cenueshmërinë e njerëzve të moshuar në situata emergjente. Sigurohuni që të moshuarit të konsultohen dhe të përfshihen në secilën fazë të përgjigjes emergjente.

Konsideroni shërbime, ambiente të përshtatshme për moshën dhe të arritshme sikurse edhe informacion, dhe përdorni të dhëna të ndara sipas moshës për monitorimin dhe menaxhimin.

Gjinia

“Gjinia” i referohet dallimeve të ndërtuara shoqërisht midis grave dhe burrave gjatë gjithë ciklit të tyre të jetës. Kjo mund të ndryshojë me kalimin e kohës, brenda dhe nëpër kultura dhe kontekst. Gjinia shpesh përcakton rolet, përgjegjësitë, fuqinë dhe aksesin e ndryshëm në burime të grave, vajzave, djemve dhe burrave. Kuptimi i këtyre ndryshimeve dhe mënyra se si ato kanë ndryshuar gjatë emergjencës është thelbësore për planifikimin efektiv të emergjencës dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut. Emergjencat mund të jenë një mundësi për të adresuar pabarazitë gjinore dhe për të fuqizuar gratë, vajzat, djemtë dhe burrat.

Gjinia nuk është e njëjtë me seksin, që i referohet attributeve biologjike të një personi.

“Gjinia” nuk do të thotë “vetëm gratë”. Ndërsa gratë dhe vajzat më shpesh përballen me kufizime brenda roleve gjinore, burrat dhe djemtë gjithashtu ndikohen nga pritjet e rrepta të burrërisë.

Programimi i barazisë gjinore kërkon përfshirjen e tyre për zhvillimin e marrëdhënieve më të drejta dhe pjesëmarrjen e barabartë të grave, vajzave, burrave dhe djemve.

Dhuna me bazë gjinore

“Dhuna me bazë gjinore” është ajo bazuar në ndryshimet gjinore midis meshkujve dhe femrave. Ajo nënvizon se si pabarazia midis meshkujve dhe femrave është themeli i formave më të shumta të dhunës të kryera ndaj grave dhe vajzave. Emergjencat mund të intensifikojnë shumë forma të dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën e partnerit intim, martesën e fëmijëve, dhunën seksuale dhe trafikimin.

Aktorët qeveritarë të mbështetur edhe nga ata joqeveritarë duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të parandaluar shfrytëzimin seksual dhe abuzimin e njerëzve të prekur nga fatkeqësitë, përfshirë edhe në aktivitetet e tyre.

Kur pretendimet për sjellje të pahijshme konstatohen të vërteta, është e rëndësishme që autoritetet kompetente të sigurojnë që përgjegjës për kryerjen e veprës të përgjigjet sipas ligjit dhe çështjet të trajtohen në një mënyrë transparente.

Personat me aftësi të kufizuara

Rreth 15 për qind e popullsisë së botës jeton me një formë të aftësisë së kufizuar. Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë ata që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose shqisore, të cilat, në ndërveprim me pengesa të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri mbi një bazë të barabartë me të tjerët.

Në kontekste humanitare, personat me aftësi të kufizuara kanë më shumë të ngjarë të përballen me barriera dhe pengesa kundrejt mjedisit fizik, transportit, informacionit dhe komunikimit, dhe objekteve ose shërbimeve.

Planifikimi i përgjigjes dhe gatishmërisë duhet të marrë parasysh kapacitetet dhe nevojat e të gjithë personave me aftësi të kufizuara dhe të bëjë përpjekje të qëllimshme për të hequr pengesat fizike, të komunikimit dhe të qëndrimit për aksesin dhe pjesëmarrjen e tyre. Risqet për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara mund të komplikohen nga pabarazia gjinore dhe diskriminimi.

Personat LGBTQI

Njerëzit që identifikohen si lezbikë, homoseksualë, biseksualë, transgjinnorë ose ndër-seksualë (LGBTQI) shpesh janë në risk të rritur ndaj diskriminimit, stigmës dhe dhunës seksuale dhe fizike. Ata mund të përballen me pengesa në qasjen ndaj kujdesit shëndetësor, strehimit, arsimit, punësimit, informacionit dhe strukturave humanitare.

Për shembull, personat LGBTQI shpesh përballen me diskriminim në programe ndihme që bazohen në njësi familjare "konvencionale", të tilla si për akomodimin emergjent ose shpërndarjen e ushqimit.

Pengesa të tilla ndikojnë në shëndetin dhe mbijetesën e tyre dhe mund të kenë pasoja më afatgjata në integritet. Përfshini përgjigje specifike, të sigurt dhe gjithëpërfshirëse të mbrojtjes në gatishmëri dhe në planifikim. Siguroni konsultime kuptimplota me individë dhe organizata LGBTQI në secilën fazë të përgjigjes emergjente.

Shëndeti mendor dhe mbështetja psikosociale

Njerëzit reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj stresit të një emergjence. Disa kanë më shumë gjasa të pushtohen nga shqetësimet, veçanërisht nëse janë zhvendosur me forcë, janë ndarë nga anëtarët e familjes, i kanë mbijetuar dhunës ose kanë përjetuar kushte të mëparshme të shëndetit mendor. Sigurimi i shërbimeve themelore dhe i sigurisë në një mënyrë të përshtatshme shoqërore dhe kulturore është thelbësore për të parandaluar shqetësimet midis popullatave të prekura dhe adresimin e diskriminimit. Forcimi i mbështetjes psikosociale të komunitetit dhe vetë-ndihma krijon një mjedis mbrojtës, duke lejuar që të prekurit të ndihmojnë secilin të tjera drejt rimëkëmbjes sociale dhe emocionale.

2.7. TRAJNIMET DHE NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK

Bazuar në pikën “d” të nenit 30 të ligjit 45/2019: *“bashkitë organizojnë veprimtari trajnuese në fushën e mbrojtjes civile për punonjësit dhe banorët në territorin e tyre”;*

Njëkohësisht sipas pikës “ë” të nenit 23 të këtij ligji: *“AKMC nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Trajnimeve për Mbrojtjen Civile, kryen trajnimet e strukturave shtetërore, të subjekteve private e vullnetare”.*

Edhe sipas pikës 1 të nenit 63 të ligjit 45/2019: *AKMC kryen trajnime për mbrojtjen civile për strukturat shtetërore, subjektet private dhe vullnetarët, sipas programit dhe moduleve të miratuara më parë nga ministri për këtë qëllim.* Pra, bazuar ligjit 45/2019, pritet që trajnimet e stafit të bashkive të kryhen si nga ana e AKMC-së, nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Trajnimeve ashtu edhe nga vetë bashkia. Trajnimet e stafëve të prefekturave dhe bashkive në fushën e ZRF dhe MC kanë qenë të pakta dhe të paharmonizuara ndër vite, dhe për më tepër stafi i Drejtorisë së Emergjencave Civile të bashkisë është i ri dhe si rrjedhim ka nevojë të ngutshme për trajnime duke filluar nga ato më baziket.

Edhe pse, referuar germës “f” të pikës 6 të nenit 23 të ligjit 45/2019; *“AKMC përgatit programin e trajnimit të strukturave të mbrojtjes civile, në nivel qendror dhe vendor”*, pritshmëria është që AKMC të udhëheqë politikat e trajnimeve në vend, autorët e planit e shohin të udhës të japin disa konsiderata dhe orientime si më poshtë:

Qëllimi i trajnimit

Trajnimi ndihmon për tu siguruar që individët dhe grupet që luajnë një rol në zbatimin e planit të emergjencës të jenë të gatshëm për të përmbushur përgjegjësitë e tyre.

Për këtë arsye, kurrikula e trajnimit lidhet me dokumentet e planifikimit, mbështet qëllimet e planit emergjent dhe vlerëson planin.

Vlerësime

Trajnim i zyrtarizuar

Një program zyrtar trajnimi, duke përfshirë afatet kohore të synuara, nënvizon angazhimin e bashkisë ndaj planit të emergjencës dhe mbështetjen e tij për personelin në përgatitjen për rolet e tyre. Për këtë arsye, kurrikula e trajnimit lidhet me dokumentet e planifikimit, mbështet qëllimet e planit emergjent dhe vlerëson planin.

Zhvillimi i një matrice/programi trajnimi

Puna që përfshihet në grupet e trajnimit të personelit për një sërë detyrash mund të lehtësohet përmes zhvillimit të një matrice trajnimi. Matrica rendit secilin rol të identifikuar dhe trajnimin e kërkuar për të. Porsa të jetë krijuar matrica, mund të planifikohen dhe zhvillohen kurset individuale. Një matricë trajnimi i siguron personelit një udhërrëfyes për t'u përgatitur për përgjegjësitë e tyre të menaxhimit të emergjencës.

Rishikimi i programeve të trajnimit

Për t'u siguruar që programet e trajnimit vazhdojnë të mbulojnë njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë e nevojshme, kërkohet reagim nga pjesëmarrësit në vazhdim për faktin nëse përmbushen nevojat e tyre për trajnim.

Vlerësimi i rregullt i programit është thelbësor për të siguruar një program trajnimi gjithëpërfshirës dhe efektiv. Duhet të merren reagimet/përshtypjet prej të gjithë pjesëmarrësve për të përcaktuar efektivitetin e trajnimit dhe të instruktorit, si dhe njohuritë ose përvetësimi i aftësive. Analizimi i këtij reagimi mund të identifikojë dobësitë në programin e trajnimit dhe të ndihmojë në plotësimin e boshllëqeve kritike të të nxënit që përndryshe mund të kompromentojë operacionet efektive të reagimit emergjent.

Llojet e trajnimit

- Workshope individuale ose në grup për personelin;
- Brifingje ose prezantime të nivelit ekzekutiv;
- Trajnim specifik për funksionin apo aktivitetin për stafin dhe vullnetarët;
- Trajnim ndërstaf për stafin dhe vullnetarët për të ndihmuar në rritjen e kapaciteteve;
- Trajnim shumë-agjencish për aktorët/palët kryesore të interesit për qëllime të shkëmbimit të informacionit dhe për të forcuar koordinimin dhe bashkëpunimin;
- Përmbledhje e planit të emergjencës për zyrtarët publikë për të sqaruar përgjegjësitë e tyre gjatë një emergjence / fatkeqësie të madhe;

Ndërsa trajnimi on-line për konceptet themelore mund të jetë i lehtë për t'u dhënë për ata, roli kryesor i të cilëve nuk është gatishmëria ose reagimi ndaj emergjencave, trajnimi personal i shoqëruar me aktivitetet gjatë tij është më kuptimplotë për pjesëmarrësit dhe absorbohet më lehtë. Gjithsesi pasja e një larmie metodash trajnimi është e rëndësishme për të siguruar kuptimin e plotë të materialit.

Ushtrimet

Ka një numër arsyesh të mira për organizimin e ushtrimeve:

- Ato vlerësojnë planet, ose elementët e planeve;
- Ato rrisin gjasat që bashkia përveç se të mbijetojë në rast emergjence edhe të vazhdojë të jetë në gjendje t'u shërbejë banorëve të saj;
- Ato e ekspozojnë stafin ndaj presionit që do të ushtrohej ndaj tyre në rast emergjence;
- Ato u japin mundësi reaguesve të emergjencave, të cilët normalisht nuk do të punonin së bashku, për ta bërë këtë në një mjedis të rehatshëm ku mund të njihen me njëri-tjetrin dhe të krijojnë besim;
- Ata i tregojnë komunitetit, institucioneve dhe palëve të interesit, që bashkia e merr seriozisht planifikimin e saj të emergjencës;
- Ato lejojnë testimin në kushte të sigurta të ideve dhe teknikave të reja.

Megjithatë ushtrimet mund edhe të kenë të meta siç janë:

- Si planifikimi, ashtu edhe ekzekutimi i ushtrimeve, harxhojnë kohën e stafit dhe i largojnë njerëzit nga detyrat e tyre kryesore;
- Disa (por jo të gjitha) ushtrime mund të kushtojnë shumë për tu organizuar;
- Ushtrime të dizajnuara dobët, ose ushtrime ku nuk përmbushen objektivat, mund të reflektojnë keq në një organizatë;
- Ushtrimet mund të inkurajojnë një ndjenjë false të sigurisë pasi kushtet e ushtrimit nuk mund të përsërisin kurrë saktësisht ato të cilat hasen në një situatë reale.

Qëllimi

Planet e emergjencës ushtrohen për tu siguruar që ato janë të zbatueshme dhe për të identifikuar - para se të ndodhë një emergjencë / fatkeqësi - çdo çështje zbatimi që duhet të zgjidhet. Ata gjithashtu ofrojnë mundësinë për të angazhuar dhe trajnuar më tej personelin, vullnetarët dhe palët e interesit. Një program ushtrimesh do të rrisë gatishmërinë operacionale duke:

- Vlerësuar objektivat e planit të emergjencës;
- Testuar sistemet, procedurat dhe pajisjet;
- Identifikuar boshllëqet e burimeve dhe dobësitë në ekzekutim;
- Sqaruar rolet dhe përgjegjësitë;
- Përmirësuar koordinimin dhe komunikimin ndër-agjenci.
- Vlerësuar njohuritë dhe aftësitë e pjesëmarrësve dhe gatishmëritë e tyre për të kryer detyrat e tyre në përgjigje të emergjencave/fatkeqësive.

Llojet e ushtrimeve

Programet e ushtrimeve zakonisht përfshijnë ushtrime me madhësi dhe kompleksitet të ndryshëm të realizuar sipas një programi. Në përgjithësi, ushtrimet hyjnë në njërin nga dy kategoritë:

Bazuar në diskutime

Diskutimet e mundësuar lejojnë pjesëmarrësit të familjarizohen me planet dhe procedurat dhe të eksplorojnë zbatimin e tyre në skenarë specifikë të emergjencës. Shembujt përfshijnë seminare, workshope dhe ushtrime në tavolinë.

Bazuar në operacione

Këto ushtrime vlerësojnë trajnimet, planet dhe procedurat përmes dislokimit të personelit, pajisjeve dhe burimeve të tjera. Shembujt përfshijnë stërvitje, ushtrime funksionale dhe ushtrime në shkallë të plotë.

Ushtrimet ndahen në:

Seminare

Këto janë ushtrime ku një audiencë dëgjon një folës ose panel folësish duke folur për një plan reagimi ndaj emergjencave ose një problem të veçantë me reagimin ndaj emergjencës dhe ka mundësi për të bërë pyetje, për të kontribuar me ide dhe për të diskutuar mënyrën se si mund të kryhet përgjigja. Ky lloj ushtrimi zakonisht përdoret për qëllime trajnimit, për të informuar njerëzit për rolin e tyre në një plan emergjence, ose për të eksploruar zgjidhjet e mundshme të problemeve në një përgjigje emergjente. Seminari është veçanërisht i dobishëm kur përgatitet një plan i ri ose ku ka pasiguri për mënyrën më të mirë për t'u përgjigjur. Seminarët mund të përfshijnë një numër të madh njerëzish, nëse është e nevojshme, me kosto minimale dhe me kohë të kufizuar përgatitjeje.

Ushtrime në tavolinë

Ushtrimi në tavolinë është i thjeshtë dhe kërkon përgatitje minimale. Është mjet i shkëlqyer për të trajnuar/kualifikuar personelin planifikues dhe reagues si dhe vendimmarrësit e tjerë kryesorë në fushat e përzgjedhura, si p.sh.: bashkërendimi, ndarja e përgjegjësisë, përparësitë e lehtësimit të pasojave pas ngjarjes dhe çështje të tilla të ngjashme.

Këto janë ushtrime në të cilat reaguesit e emergjencave formojnë grupe sindikale ose ulen rreth një tavoline dhe përshkruajnë veprimet që ata do të ndërmarrin për t'iu përgjigjur një emergjence. Në përgjithësi, skenari u jepet atyre pak nga pak, me pjesëmarrësit që u kërkohet t'i përgjigjen secilës situatë kur paraqitet. Vizualizimi i incidentit të ushtrimit mund të ndihmohet nga harta dhe modele të cilat mund të zhvendosen ose përditësohen ndërkohë që ushtrimi përparon. Një ushtrim në tavolinë zakonisht mbahet me individë ose grupe që u është dhënë kohë për të vendosur se cila do të jetë përgjigjja e tyre në një fazë të veçantë të emergjencës dhe më pas do të merret koha për të diskutuar vendimet e marra dhe pasojat e këtyre për reaguesit e tjerë dhe viktimat. Sidoqoftë është e mundur të zhvillohet një ushtrim në tavolinë në kohë reale me pjesëmarrësit e detyruar të merren me një situatë në zhvillim me një ritëm i cili pasqyron se si do të zhvillohej një emergjencë e vërtetë. Kjo i lejon pjesëmarrësit të përjetojnë llojin e presionit që do të kërkonte një situatë reale, por kufizon mundësinë për reflektim dhe diskutim. Ushtrimet në tavolinë mund të ndryshojnë nga ushtrimet e drejtpërdrejta të një aspekti të veçantë të një përgjigjeje tek ushtrimet shumë komplekse që përfshijnë shumë probleme të njëkohshme dhe shumë lojtarë.

Ushtrime të drejtpërdrejt/në shkallë të plotë/stërvitje fushore

Ushtrimi i drejtpërdrejt/në shkallë të plotë është niveli më i lartë i stërvitjeve dhe kulmi i një programi të gjerë stërvitor. Ai kërkon pjesën më të madhe të planifikimit, të burimeve dhe të kohës së menaxhuesve të emergjencave. Ky ushtrim përfshin testimin e pjesës më të madhe të një plani të miratuar të përgjigjes ndaj emergjencave dhe të elementëve të sistemit dhe të organizatave në një mjedis të vërtetë, të karakterizuar nga një stres i madh. Në të kërkohet mobilizimi dhe lëvizja faktike e personelit dhe e burimeve të duhura, për të demonstruar aftësitë për funksionet e bashkërendimit, aktivitetet e përgjigjes dhe të rikthimit në normalitet.

Këto janë lloji klasik i ushtrimeve që zakonisht përfshijnë shumë automjete të shërbimit të emergjencës që kthehen në skenën e një "incidenti" i cili është përcaktuar artificialisht nga grupi i planifikimit të ushtrimeve. Një ushtrim i drejtpërdrejt mund të variojë nga një incident relativisht i drejtpërdrejt, siç është një anije pasagjerësh në vështirësi, në një vend kompleks që përfshin automjete të përplasura, ndotje kimike dhe viktimat të shumta. Të gjithë lojtarët e ushtrimeve kryejnë detyrat që do t'u kërkohen atyre në një incident të vërtetë me ritmin që do të kërkonte një incident i vërtetë. Vullnetarët luajnë rolet e viktimave, vëzhguesve, mediave dhe të evakuuarve. Lojtarët marrin një ndjesi se si do të ishte puna në një emergjencë të vërtetë, por ka pak kohë për diskutimin e opsioneve ose rishikimin e vendimeve. Padyshim që ushtrimet e drejtpërdrejta janë më të përshtatshme për disa skenarë krahasuar me të tjerët. Është e vështirë të organizosh një ushtrim të drejtpërdrejtë të përgjigjes ndaj përmbajtjeve të mëdha ose reshjeve të mëdha të borës.

Ushtrime të kombinuara

Është e mundur të kombinohen lloje të ndryshme ushtrimesh. Për shembull një sesion i stilit seminar ku njerëzit informohen rreth situatës së emergjencës dhe pjesës së tyre të përballjes me të, mund të vijojë menjëherë me një ushtrim në tavolinë për të kontrolluar nëse pjesëmarrësit kanë kuptuar problemet dhe rolet e tyre. Një ushtrim i drejtpërdrejtë i një pjese të një përgjigjeje mund të zhvillohet së bashku me një ushtrim në tavolinë të një pjese tjetër të së njëjtës përgjigjeje.

Në përgjithësi, seminari është më i thjeshtë dhe më pak i kushtueshëm për t'u organizuar ndërsa ushtrimi në shkallë të plotë është më i vështirë dhe i shtrenjtë, por kjo nuk do të thotë që një ushtrim i plotë është në thelb superior ndaj një seminari ose një ushtrimi në tavolinë. Çdo lloj ushtrimi përmbush një funksion pak më të ndryshëm dhe lejon përmbushjen e objektivave të ndryshëm. Shpesh, ushtrime në shkallë modeste, të planifikuara dhe ndjekura siç duhet

dhe të përsëritura sipas nevojës, janë më efektive sesa ushtrimet shumë të mëdha ku burimet përqendrohen në ngjarje dhe mendohet pak për përgatitjet ose vlerësimin pas ushtrimeve. Edhe pse një ushtrim i plotë mund të duket tërheqës dhe mbresëlënës ka gjasa që të jetë pa vlerë për organizatat pjesëmarrëse përveç, ndoshta, ekspozimit pozitiv publik. Në disa raste, një angazhimi i tillë i dukshëm për sigurinë publike mund të jetë një qëllim legjitim në vetvete, por duke qenë të shtrenjta, bashkia duhet të shqyrtojë me kujdes leverdinë e organizimit të ushtrimeve në shkallë të plotë.

Përdorimi i Raportit Pas Veprimit (After Action Report/AAR)

Në përfundim të çdo projekti/eventi, rekomandohet të kapen mësimet e marra duke reflektuar faktin se sa mirë ishte planifikuar dhe zbatuar iniciativa. Një AAR është një diskutim profesional i një eventit që përqendrohet në standardet e performancës dhe u mundëson atyre që janë të përfshirë në event të rishikojnë atë që ka ndodhur dhe pse, dhe të diskutojnë se si të ruajnë pikat e forta të identifikuara dhe adresimin e dobësive të identifikuara.

Një AAR kap mësimin dhe e zbaton atë sa më shpejt të jetë e mundur përsëri në veprim. Rezultatet e procesit të rishikimit janë të dokumentuara në një raport AAR i cili ndahet me të gjithë të stafin e përfshirë.

AAR-të mund të zhvillohen zyrtarisht ose jozyrtarisht dhe mund të përfshijnë aktivitete të ndryshme që quhen “debrifime”, “mësime të nxjerra” ose “rishikim i të mësuarit”.

Pavarësisht nga terminologjia e përdorur, të gjitha qasjet ndjekin një format të ngjashëm dhe adresojnë pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë funksionoi mirë?
- Çfarë mund të kishte shkuar më mirë?
- Çfarë mund të bëhet ndryshe herën tjetër?

Një AAR efektive:

- Përqendrohet në një numër të vogël çështjesh kryesore;
- Zhvillohet në një mjedis jo gjykues dhe të sigurt;
- Përdor një proces gjithëpërfshirës;
- Ndërton një mirëkuptim të përbashkët;
- Kryhet sa më afër një veprimi që të jetë e mundur;
- Lejon që të mësuarit të ushqejë drejtpërdrejt veprimin;
- Përdor një proces të strukturuar dhe të lehtësuar;

Ndërgjegjësimi i publikut/palëve të interesit

Qëllimi

Përpyekjet për ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut / palëve të interesit kanë për qëllim të fuqizojnë anëtarët e një komuniteti ose organizate për të kuptuar risqet dhe rreziqet, ti përgatisin ata për një emergjencë / fatkeqësi, të marrin pjesë konkretisht në iniciativat e menaxhimit të emergjencave dhe të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të zbutur riskun e tyre personal.

Metodat

Fuqizimi mund të arrihet duke rritur ndërgjegjësimin e publikut/palëve të interesit dhe duke kuptuar rreziqet dhe risqet me të cilat përballen dhe rëndësinë e të qenit personalisht i përgatitur për raste emergjente/fatkeqësish, dhe duke u ofruar atyre njohuri të kërkuara për vendime të informuara dhe sjellje të sigurt.

Këtu janë disa shembuj të programeve/shërbimeve të ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut/palëve të interesit:

- Fushata informuese të drejtuara për publikun, të cilat zhvillohen përmes:
- Televizionit dhe mediave të tjera transmetuese;
- Internetit dhe mediave sociale;
- Publikimeve, të tilla si broshura dhe postera;
- Stendave të informacionit;
- Fushatave të informacionit të bazuara në internet;
- Programeve arsimore të synuara për audiencë specifike, siç janë lagjet, nxënësit e shkollave, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, pronarët dhe punonjësit e biznesit dhe pronarët e kafshëve;
- Fushata të specializuara ndërgjegjësimi dhe edukimi, siç janë:
- 13 tetori - Dita ndërkombëtare e Reduktimit të Riskut të Fatkeqësive;
- 4 maji - Dita ndërkombëtare e zjarrfikësve;
- Evente për diskutim të publikut/palëve të interesit, të tilla si anketime, intervista, workshope, dhe forume publike;
- Ushtrime që përfshijnë plotësisht komunitetin ose organizatën (p.sh. stërvitje)

Programet e emergjencës gjithashtu mund të konsiderojnë lidhjen me programe të tjera, të tilla si ruajtja e ujit, ndërgjegjësimi dhe edukimi mjedisor dhe programet për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Edukimi i publikut/palëve të interesit do të mund të mbështetet në dokumentin e hartuar në kuadër të Projektit PRO NEWS në vitin 2018 “Platforma Strategjike e Komunikimit dhe Rritjes së Ndërgjegjësimit Publik në Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë Natyrore (Risku nga Përmbytjet)”. Nënvizojmë faktin se në 21.05.2013 në Gjenevë, Zvicër, në ditën e hapjes së Platformës Globale për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, Lezha i është bashkuar Fushatës së UNISDR-it 2010-2015 “Ti bëjmë Qytetet të Qëndrueshëm: Qyteti im po përgatitet”, duke nënshkruar Certifikatën e Fushatës.

Fushata e UNISDR-it “Ti bëjmë qytetet të qëndrueshëm: qyteti im po përgatitet” filloi në maj 2010 për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm urban duke promovuar aktivitete të aftësisë ripërtëritëse dhe duke rritur kuptimin e nivelit lokal të riskut.

4360 qytete i janë bashkuar Fushatës⁴ dhe janë angazhuar për ti udhëhequr aktivitetet e tyre për zvogëlimin e riskut bazuar në Dhjetë Thelbësoret/Esencialet për “Bërjen e Qyteteve të Qëndrueshme” (Making cities resilient/MCR).

10 Esencialet paraqiten në një manual më operacional, adaptues dhe të zbatueshëm që inkurajon qytetet të ndër marrin veprime të ZRF dhe ndërtimit të aftësisë ripërtëritëse.

4 Informacioni është i datës 13.12.2020. Numri i qyteteve rritet vazhdimisht dhe për ta marrë atë të përditësuar duhet vizituar <https://www.unisdr.org/campaign/resilientcities/>

10 elementët esenciale në të cilat mbështetet kjo fushatë janë:

1. Organizoni për aftësinë ripërtëritëse ndaj fatkeqësisë;
2. Identifikoni, kuptoni dhe përdorni skenarët aktualë dhe të ardhshëm të riskut;
3. Forconi kapacitetin financiar për aftësi ripërtëritëse;
4. Ndiqni zhvillimin dhe projektimin e qëndrueshëm urban;
5. Ruani mbulesat natyrore për të përmirësuar funksionet mbrojtëse të ofruara nga ekosistemet natyrore;
6. Forconi kapacitetet institucionale për aftësinë ripërtëritëse;
7. Kuptoni dhe forconi aftësinë shoqërore për aftësi ripërtëritëse;
8. Rritni aftësinë ripërtëritëse të infrastrukturës;
9. Siguroni gatishmëri efektive dhe reagim ndaj fatkeqësive;
10. Përshejtoni rimëkëmbjen dhe rindërtoni më mirë.

Rezultati i vlerësimit siguron një seri vlerësimesh që lejojnë qeveritë lokale të vlerësojnë aftësinë e tyre ndaj fatkeqësisë, duke u strukturuar rreth Dhjetë Esencialeve të UNDRR për të bërë qytetet të qëndrueshëm. Ndiqmon gjithashtu për të monitoruar dhe rishikuar progresin dhe sfidat në zbatimin e Kuadrit Sendai dhe mbështet analizën bazë për përgatitjen e strategjive të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe aftësisë ripërtëritëse.

2.8. MENAXHIMI I VULLNETARËVE

Ashtu si me të gjitha fazat e tjera të menaxhimit të emergjencave, gatishmëria është një përgjegjësi e përbashkët, dhe për këtë arsye duhet të bëhen përpjekje për të angazhuar individë dhe grupe në të gjitha nivelet. Vullnetarët (d.m.th., njerëzit që ofrojnë shërbimet e tyre pa pritur kompensim financiar) janë një komponent kritik i procesit të menaxhimit të emergjencave.

Qëllimi i menaxhimit vullnetar gjatë fazës së gatishmërisë është i dyfishtë:

- Së pari, bashkia duhet të përcaktojë rolet për vullnetarët në mbështetjen e aktiviteteve të menaxhimit të emergjencave. Përvoja ka treguar se vullnetarët kanë role në funksione të ndryshme mbështetëse emergjente dhe kjo pasqyrohet specifikisht në këtë plan.
- Së dyti, duke qenë se ekziston një rol i tillë për vullnetarët, duhet të hartohen plane të menaxhimit të vullnetarëve për të siguruar menaxhim efektiv të vullnetarëve të regjistruar si dhe vullnetarëve emergjentë. (Këta të fundit janë grupe njerëzish që bashkohen si rezultat i emergjencës për të ofruar ndihmë në një zonë të caktuar ose për një detyrë të veçantë dhe të cilët nuk janë ende zyrtarisht të lidhur me një organizatë)

Një përgjegjësi dhe rol të veçantë në shërbimin vullnetar të MZSH-së ka Drejtoria e MZSH në bashki⁵. Sipas nenit 13 të ligjit 152/2015: *“Në bashki krijohet shërbimi vullnetar për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, në përputhje me këtë ligj, dhe ai bëhet pjesë e shërbimit të MZSH-së në nivel vendor.”*

5 Sipas paragrafit “e” të nenit 11 të ligjit 152/2015: Drejtoria e MZSH drejton dhe përgjigjet për rritjen e aftësive profesionale të personelit të MZSH-së, të shërbimit vullnetar, për zbatimin e programit të përgatitjes së tyre profesionale, dhe zhvillon mësimet treguese për dhënien e njohurive të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

Edhe ligji 45/2019 i ka dhënë një rol të rëndësishëm shërbimit vullnetar duke e kategorizuar atë ndër forcat operacionale. Ndërkohë, pritet miratimi i VKM-së përkatëse për angazhimin dhe trajtimin e vullnetarëve në emergjencë⁶ çka do t'i japë një shtysë tjetër zhvillimit të vullnetarizmit.

Burime të mundshme të vullnetarëve në bashki janë organizatat:

- KKSH, Dega Rajonale Lezhë;
- World Vision;
- Caritas;
- Bizneset private;
- OJF të ndryshme.
- Vullnetarë të tjerë në grupe apo persona të veçantë janë paraqitur në emergjencat e kaluara por edhe në emergjencën e COVID 19 që vazhdon ende.


Për të gjithë personat dhe subjektet e ndryshme me rol në shërbimin vullnetar, bashkia duhet të disponojë bazën përkatëse të të dhënave⁷.

Roli i vullnetarëve duhet të mbahet parasysh edhe në fazat e tjera të menaxhimit emergjent, përkatësisht parandalimit, gatishmërisë dhe rimëkëmbjes.

6 Referuar pikës 3 të nenit 38 të ligjit 45/2019: "Trajtimi i vullnetarëve për angazhimin e tyre në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit dhe të përballimit të fatkeqësive miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

7 Sipas paragrafit "e" të nenit 30 të ligjit 45/2019, bashkitë sigurojnë, administrojnë dhe përditësojnë të dhënat e nevojshme për shtetasit dhe për subjektet private, të mundshme për t'u planifikuar dhe angazhuar në parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive

STRUKTURAT, ORGANIZIMI, PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT



3.1. STRUKTURAT DHE AUTORITETET NË NIVEL QENDROR

Sipas nenit 15 të ligjit 45/2019, sistemi i mbrojtjes civile është sistemi që kryen funksionin e mbrojtjes civile dhe përfshin aftësitë dhe aktivitetet që synojnë mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, nga dëmtimi ose rreziku i dëmtimit, si pasojë e fatkeqësive, dhe përbëhet nga:

- institucione dhe struktura qendrore të mbrojtjes civile;
- institucione dhe struktura vendore të mbrojtjes civile;
- struktura operacionale të mbrojtjes civile.

FIGURA 3. Skema e përgjithshme organizative KNEC-DQO-DOQ-DOB





FIGURA 4. Skema organizative Ministri-Prefekt-bashki



3.2. STRUKTURAT DHE AUTORITETET NË NIVEL QARKU

Institucionet dhe strukturat vendore të mbrojtjes civile janë:

- Prefekti i qarkut;
- komisioni i mbrojtjes civile në nivel qarku dhe bashkie;
- bashkitë;
- strukturat e decentralizuara të institucioneve dhe të strukturave qendrore të mbrojtjes civile.

3.2.1. Detyrat e Prefektit të qarkut

Prefekti i qarkut është institucioni përgjegjës për ZRF dhe MC në qark. Sipas seksionit 2.2.1 të PKEC-së, Prefekti i qarkut:

- Monitoron dhe menaxhon situatën emergjente nëpërmjet koordinimit të strukturave qendrore të pranishme në këtë nivel, të cilat janë përfshirë në planet e emergjencave në nivel qarku;
- Thërret komisionin e mbrojtjes civile në qark;
- Kërkon ndihmë kur situatat e emergjencës civile janë përtej mundësive apo kapaciteteve të qarkut, duke kërkuar të shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore në një pjesë ose në të gjithë territorin e qarkut;
- Mban kontakte të vazhdueshme dhe bashkërendon veprimet me Ministrinë e Mbrojtjes, AKMC-në, me KMC-në dhe KNEC-në si dhe me DQO-në, në varësi të situatës, edhe me kryeministrin;
- Koordinon forcat operationale në nivel qarku në rastet e fatkeqësive dhe cakton drejtuesin e operacionit për përballimin e emergjencës civile brenda qarkut (DOQ).
- Prefekti i qarkut ka detyra të tjera të lidhura me të gjithë ciklin e menaxhimit të emergjencave civile, të cilat përcaktohen në nenin 28 të ligjit 45/2019.

3.2.2. Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel qarku⁸

Sipas seksionit 2.2.2 të PKEC, KMC:

- Bashkërendon veprimet institucionale të nevojshme në të gjitha etapat e përgjigjes ndaj

⁸ Komisioni i mëparshëm i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në Qark, sipas nenit 27 të ligjit 45/2019, emërtohet tashmë Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel qarku. Sipas nenit 29, "përbërja, funksionimi dhe detyrat e komisionit, miratohet me urdhër të prefektit".

emergjencave civile;


- Bashkërendon veprimet e strukturave qendrore të pranishme në nivel rajonal me veprimet dhe aktivitete e strukturave lokale, të KKSH, të vullnetarëve dhe donatorëve të ndryshëm;
- Vlerëson nevojat materiale dhe financiare, dëmtimet e shkaktuara, kostot e rehabilitimit të rajonit të prekur nga fatkeqësitë dhe kërkon mbështetjen e strukturave të tjera qendrore në nivel rajonal;
- Bashkërendon forcat operationale të përfshira dhe grupet e ndihmës dhe ato vullnetare të cilat veprojnë në rajon me organet e pushtetit vendor;

3.2.3. Drejtuesi i Operacionit në Qark (DOQ)

Në situatën e fatkeqësisë natyrore, burimet materiale dhe njerëzore të listuara në planet e emergjencave të qarkut vendosen nën autoritetin e drejtuesit të operacionit në qark (DOQ) që bëhet përgjegjës për menaxhimin e situatës së emergjencave civile në qark. Sipas VKM Nr.531, datë 1.8.2003 "Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit të emergjencave civile", DOQ kryen këto detyra:

- Menaxhon situatën nëpërmjet drejtimit të strukturave operationale të shërbimit të emergjencave civile, në zbatim të planeve të hartuara më parë për përballimin e emergjencave civile në nivel qarku;
- Vepron sipas udhëzimeve që merr nga KMC në qark dhe raporton përpara këtij Komisioni, rast pas rasti ose sa herë që e gjykon të nevojshme ky komision;
- Vendos lidhje të drejtpërdrejta me DQO pranë KNEC, me Drejtorin e Përgjithshëm të AKMC-së dhe dërgon raporte periodike e përmbledhëse për situatën;
- Bashkëpunon me drejtuesit operationalë dhe me strukturat e shërbimit të emergjencave civile në bashki;
- Bashkëpunon me grupe të shërbimit vullnetar të emergjencave civile dhe me organizma e institucione të huaja, të specializuara në përballimin e emergjencave civile, që ofrojnë ndihmë në territorin e bashkisë.

FIGURA 5. Strukturat e mbrojtjes civile në nivel qarku



3.3. STRUKTURAT DHE AUTORITETET NË NIVEL BASHKIE


Përgjegjësitë e Bashkisë janë Zvogëlimi i Riskut të Fatkeqësive dhe Mbrojtja Civile në juridiksionin e saj të përcaktuara në nenin 30 të ligjit 45/2019. Sipas seksionit 2.3 të PKEC-së, bashkia është përgjegjëse për parapërgatitjen, planifikimin dhe operacionet e përgjigjes ndaj situatave emergjente që ndodhin në territorin e saj. Menaxhimi i emergjencave civile në bashki kryhet në përputhje me planin e emergjencave ose planin e gatishmërisë që ajo përgatit dhe rishikon periodikisht.

Bashkia krijon dhe mban një sistem të:

- Njoftimit të hershëm dhe informimit të strukturave kyç;
- Alarmit dhe evakuimit të popullsisë;
- Skuadrave, grupeve dhe strukturave të tjera aktive të përgatitura për të parandaluar, për të lehtësuar dhe për t'u përgjigjur në raste të emergjencave civile;
- Ndërmarrjes dhe administrimit të aktiviteteve të rehabilitimit për zonën e prekur nga emergjenca.

Skema organizative e sistemit të menaxhimit të emergjencave civile në bashki, referuar seksionit 3.3 të PKEC-së është si më poshtë.

FIGURA 6. Strukturat e mbrojtjes civile në bashki



PKEC nuk ka ndonjë referencë në sistemin e Komandës së Incidentit (Incident Command System) tek i cili mbështeten vende të tjera dhe që sipas tyre siguron një përgjigje të koordinuar dhe të organizuar ndaj emergjencave dhe fatkeqësive.

Sipas pikës 3 të nenit 33 të ligjit 45/2019, “*gjatë pjesëmarrjes në operacion, efektivat e strukturave operacionale të mbrojtjes civile drejtohen nga eprorët direkt, sipas detyrave që marrin nga drejtuesi i operacioneve kur shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore dhe nga AKMC-ja në rastet e tjera*”

Sipas pikës 22 të VKM nr.531, datë 01.08.2003 “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit të emergjencave civile: *Në rastet kur nuk është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, drejtimin e strukturave të shërbimit të emergjencave civile, deri në caktimin e drejtuesit të operacionit, e merr komandanti i stacionit zjarrfikës më të afërt. Në të gjitha rastet, veprimet operacionale kryhen në zbatim të manualit “Mbrojtja civile”, i cili miratohet nga ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit.*

Ndërsa sipas pikës 23 të VKM më lart:

Kur shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore, për drejtimin e strukturave të shërbimit të emergjencave civile, caktohen drejtuesit e operacioneve në nivelet e mëposhtme:

- a) Drejtuesi qendror i operacionit, i cili emërohet nga Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile.*
- b) Drejtuesi i operacioneve në nivel qarku, i cili emërohet nga prefekti.*
- c) Drejtuesi i operacioneve në nivel bashkie, i cili emërohet nga kryetari i bashkisë.*
- ç) Drejtuesit e forcave vepruese të shërbimit të emergjencave civile në nivel qendror dhe vendor, si dhe qendrat operacionale të tyre.*

3.3.1. Përgjegjësitë e Komisionit të Mbrojtjes Civile në bashki

Komisioni i Mbrojtjes Civile Civile në bashki⁹:

Deri me hyrjen në fuqi të VKM nr.965, datë 2.12.2015 ka qenë Komisioni vendor për emergjencat civile pranë bashkisë, i cili, në mungesë të një strukture permanente të emergjencave civile në bashki, mbulonte të gjitha çështjet e menaxhimit të emergjencave civile. Prandaj edhe referencat e PKEC për detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit kanë qenë gjithëpërfshirëse dhe shteruese për një Komision që do të vepronte në mungesë të një strukture të EC-së në bashki.

Në kushtet kur në Lezhë, në zbatim të VKM nr.965, datë 2.12.2015, është ngritur dhe është plotësuar me stafin përkatës, Drejtoria e Emergjencave Civile, një pjesë e detyrave të PKEC-së do të duhet të kryhen tashmë nga kjo drejtori e cila e ka këtë një detyrë funksionale. Duhet theksuar fakti se sipas ligjit 45/2019, përgjegjësitë e bashkisë në fushën e ZRF dhe MC, janë më të gjera dhe të mirëpërcaktuara, krahasuar me ligjin e mëparshëm 8756, datë 26.03.2001, i ndryshuar. Si rrjedhim, edhe parashikimet respektive në PKEC e rishikuar pritet të ndjekin të njëjtën logjikë të ligjit 45/2019. Sigurisht që edhe praktika e përditshme e punës së Drejtorisë së EC-së në bashki do të vërtetojë saktësinë e parashikimeve të detyrave të mësipërme dhe balancën midis tyre dhe atyre të KMC-së, me qëllim reflektimin siç duhet si në përshkrimin e punës së Drejtorisë ashtu edhe në përmbajtjen e Urdhrit të Komisionit të MC në bashki duke përfshirë edhe rishikimet e mundshme të tyre në të ardhmen.

Edhe pse ekziston Urdhri i Kryetarit të Bashkisë nr. 656, datë 9.09.2020 "Për ngritjen e Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Mbrojtjes Civile dhe Krizave", grupi i ekspertëve hartues të planit sugjeron që në rastin më të parë të rishikimit të merret në konsideratë Urdhri i Kryetarit "Për ngritjen e Komisionit të Mbrojtjes Civile" dhe rregullorja përkatëse të cilat ndodhen në seksionin 9.11 të planit.

3.3.2. Detyrat e Drejtuesit të operacionit në bashki¹⁰:

- Zbaton udhëzimet e kryetarit të bashkisë, mban lidhje të vazhdueshme me Sektorin e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në Prefekturë dhe me QKOEK në MM;
- Raporton dhe ndjek udhëzimet e KMC dhe kërkon mbështetjen e këtij Komisioni;
- Vepron sipas planeve të emergjencave dhe/apo kontigjencave, të hartuara më parë dhe të miratuara në këshillin bashkiak, të cilat janë pjesë e planit të emergjencave të qarkut;
- Në rast se situata përkeqësohet dhe me mundësitë e mjetet që zotëron bashkia, nuk mund ta përballojë situatën e krijuar, i propozon kryetarit të bashkisë të kërkojë mbështetje nga bashkitë fqinje dhe/ose i propozon Prefektit të qarkut të kërkojë mbështetje nga instancat më të larta shtetërore;
- Bashkëvepron me grupe vullnetarësh, të specializuar për përballimin e emergjencave dhe me banorë, që shprehin dëshirën të përfshihen përkohësisht në strukturat e shërbimit të emergjencave civile të bashkisë.

9 Komisioni i mëparshëm Vendor i Emergjencave Civile, sipas nenit 27 të ligjit 45/2019 emërtohet Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel bashkie. Sipas nenit 27 të këtij ligji: "përbërja, funksionimi dhe detyrat e komisionit miratohen me urdhër të kryetarit të bashkisë".

10 Detyrat e DOB i referohen pikës 26 të VKM Nr.531, datë 1.8.2003 "Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit të emergjencave civile"

Drejtues operacioni në nivel bashkie do të jenë:

TABELA 3. Emergjencat dhe drejtuesit e operacioneve

Lloji i fatkeqësisë	Pozicioni i sugjeruar i Drejtuesit të Operacionit në nivel bashkie
1 Tërmet	Drejtori për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin
2 Përmytjet nga lumenjtë dhe ato nga deti	Drejtori për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin
3 Rrëshqitje masive toke dhe rëniet e shkëmbinjve	Drejtori i Emergjencave Civile në Bashki
4 Zjarre në pyje, kullota dhe banesa	Drejtori për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin
5 Era, dëbora dhe stuhitë e dëborës	Drejtori i Emergjencave Civile
6 Thatësira	Drejtori i Emergjencave Civile
7 Epidemi	Drejtori i Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor

3.3.3. Strukturat bazë operacionale në bashki

Në bashki, shërbimi i emergjencave civile në nivel vendor funksionon përmes tre strukturave bazë¹¹ të cilat janë:

- **Strukturat monitoruese dhe njoftuese në bashki**
 - Prefekti i Qarkut Lezhë;
 - Komisariati i Policisë në bashkinë Lezhë;
 - Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor;
 - Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Lezhë;
 - Agjencia Rajonale e Mjedisit;
 - Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
 - Sektori i Ekstensionit Bujqësor, Lezhë;
 - Dega Lezhë e Drejtorisë së OSHEE Shkodër;
 - Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë;
 - Shërbimi Doganor Shëngjin, Dega Doganore Lezhë;
 - Administrata e Zonave të Mbrojtura Qarku Lezhë;
 - Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës;
 - Agjencia Kombëtare e Bregdetit për Rajonin e Lezhës;
 - Baza Ushtarake Detare, Shëngjin;
 - Spitali Rajonal Lezhë;
 - Sektori Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Lezhë;
 - Baza Ushtarake Ajrore, Gjadër;
 - Kapitaneria e Portit, Shëngjin;
 - Porti Shëngjin;
 - Dega Lezhë e Drejtorisë së OST, Shkodër;
 - Inspektorati Kombëtar i Mjedisit dhe Territorit (IKMT);
 - Strukturat me detyra monitoruese dhe njoftuese të bashkisë.

Këto struktura kanë për detyrë të japin të dhëna të vazhdueshme pranë Prefektit të Qarkut dhe bashkisë për parashikimin e fatkeqësive dhe përballimin e tyre në të gjithë territorin e bashkisë Lezhë.

¹¹ Bazuar në pikën 1 të VKM nr.531, datë 01.08.2003 "Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit të emergjencave civile"

Të tjerë faktorë që japin kontribut në njoftimin për emergjencat janë qytetarët, kryetarët e fshatrave, OJF-të e ndryshme, subjektet private.

- **Strukturat Vepruese Aktive në bashki**

- Drejtoria e MZSH në bashki;
- Komisariati i Policisë në bashkinë Lezhë;
- Shërbimet e ambulancës, të urgjencës së Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor;
- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Lezhë, Spitali Rajonal Lezhë dhe të gjitha strukturat e sistemit shëndetësor në territorin e bashkisë;
- Dega Lezhë e Drejtorisë së OSHEE Shkodër;
- Dega Lezhë e Drejtorisë së OST Shkodër;
- Shërbimi i MZSH-së pranë Portit Shëngjin;
- Politicë e institucioneve në territorin e bashkisë dhe ato private;

Këto struktura angazhohen menjëherë në situatat e emergjencave civile dhe vihen në dispozicion të bashkisë dhe të Prefektit të qarkut.

- **Strukturat Vepruese Mbështetëse në bashki**

- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT);
- Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë;
- Autoriteti Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër;
- Shërbimi Doganor Shëngjin, Dega Doganore Lezhë;
- Sektori i Ekstensionit Bujqësor Lezhë;
- Administrata e Zonave të Mbrojtura Qarku Lezhë;
- Telekom;
- Strukturat vepruese mbështetëse të bashkisë (SH.A Ujësjiellës Kanalizime, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Njësia e Mirëmbajtjes së Institucioneve, Drejtoria e Bujqësisë, Njësia e Bujqësisë, Ujit, Kullimit dhe Transportet specifike);
- Donatorë vendas dhe të huaj;
- Kryqi i Kuq Shqiptar dega Lezhë;
- Caritas;
- World Vision;
- OJF të tjera që veprojnë në bashki.


Strukturat vepruese mbështetëse në bashki janë planifikuar për ndërhyrje në situata emergjente në mbështetje të strukturave vepruese aktive. Menaxhimi efektiv i emergjencave në bashki kërkon bashkëpunim midis aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në të gjitha fazat e procesit.

Kështu, programet e menaxhimit të emergjencave kërkojnë të zhvillojnë lidhje të ngushta me aktorët që mund të thirren për mbështetje. Këto partneritete mund të ndërtohen përmes mënyrave të ndryshme, të tilla si:

- Konsultimi me të gjithë aktorët e përfshirë në menaxhimin e riskut, në kuadër të KMC;
- Kryerja e trajnimeve dhe ushtrimeve të përbashkëta për planifikimin, përgjigjen dhe rimëkëmbjen ndaj emergjencave;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve të ndihmës reciproke¹².

¹² Deri në momentin e përfundimit të planit nuk ekzistonte ndonjë memorandum/marrëveshje bashkëpunimi midis bashkisë dhe ndonjë institucioni, strukture, subjekti joqeveritar apo OJF me objekt bashkëpunimin në menaxhimin e emergjencave çka sugjerohet të ndërmerret në të ardhmen.

PËRGJIGJJA NDAJ EMERGJENCAVE



“Përgjigje” është ofrimi i shërbimeve emergjente dhe të asistencës para dhe gjatë një fatkeqësie ose menjëherë pas saj, për mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, për të garantuar sigurinë publike dhe për të përmbushur nevojat themelore për mbijetesë të njerëzve të prekur.

Referuar praktikave më të mira ndërkombëtare, janë tetë qëllime të përgjigjes, të cilat udhëzojnë vendimmarrësit në prioritizimin e aktiviteteve të përgjigjes emergjente. Megjithatë qëllimet renditen më poshtë sipas rendit të përparësisë, personeli merr parasysh të gjitha informacionet e disponueshme gjatë përcaktimit të përparësive specifike për emergjencën.

TABELA 4. Qëllimet e përgjigjes

1	Siguro shëndetin dhe sigurinë e reaguesve	Mirëqenia e reaguesve duhet të adresohet efektivisht ose përndryshe ata mund të mos jenë në gjendje t'u përgjigjen nevojave të atyre që janë në rrezik
2	Shpëto jetë	Rëndësia e jetës njerëzore është parësore mbi të gjitha konsideratat e tjera. Kur jetët njerëzore janë në rrezik, duhet të ndërmerren të gjitha përpjekje e arsyeshme për ta eliminuar atë
3	Zvogëlo vuajtjen	Lëndimi fizik dhe psikologjik mund të shkaktojë ndikim domethënës afatshkurtër dhe afatgjatë te individët, familjet dhe komunitetet. Masat e përgjigjes duhet të marrin parasysh të gjitha masat e arsyeshme për të zvogëluar ose eliminuar vuajtjet njerëzore
4	Mbro shëndetin publik	Për mirëqenien e komuniteteve, duhet të mbahen ose zbatohen masat e domosdoshme të shëndetit publik. Mund të duhet të merren në konsideratë përmirësimi i mbikëqyrjes dhe zbulimit, eliminimi i rreziqeve shëndetësore, minimizimi i ekspozimit dhe zbatimi i programeve të tilla si imunizimi i përhapur
5	Mbro infrastrukturën	Kur është e nevojshme për të mbajtur përpjekjet e përgjigjes, për të mbajtur nevojat themelore të njeriut dhe për të mbështetur rimëkëmbjen efektive, infrastruktura që është thelbësore për jetesën e komunitetit duhet të mbrohet përpara pronave të tjera.
6	Mbro pronën	Prona mund të jetë thelbësore për jetesën e komuniteteve. Gjatë përcaktimit të përparësive, personeli i përgjigjes duhet të vlerësojë rëndësinë e mbrojtjes së pronës private dhe komunitetit.
7	Mbro mjedisin	Mjedi është thelbësor për komunitetet. Gjatë përcaktimit të përparësive, personeli i përgjigjes duhet të vlerësojë rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe të zbatojë strategji mbrojtëse që janë në interesin më të mirë të komunitetit
8	Zvogëlo humbjet ekonomike dhe sociale	Humbja e gjeneratorëve ekonomikë mund të ketë ndikim afatshkurtër dhe afatgjatë në komunitete, përfshirë humbjet sociale që lidhen me humbjen e rrjeteve të mbështetjes së komunitetit dhe uljen e punësimit, investimeve dhe zhvillimit. Mund të jenë të nevojshme masat përgjigjeje për të zvogëluar këto humbje, dhe mund të kërkojnë ndërhyrje psikosociale për personat e prekur nga fatkeqësia.

4.1. NEVOJAT PËR BASHKËRENDIMIN E OPERACIONEVE PËR PËRBALLIMIN E FATKEQËSIVE DHE MEKANIZMAT E REALIZIMIT MIDIS ORGANIZATAVE TË NDRYSHME

Operacionet që ndërmerren në përgjigjen ndaj emergjencave në shkallë të gjerë janë të ndryshme nga ato operacione që ndërmerren në përgjigje të incidenteve të përditshme ose të fatkeqësive të zakonshme në shkallë të vogël. Në përballimin e fatkeqësive shpesh përfshihen burime dhe përgjigje nga shumë individë dhe organizata të ndryshme shtetërore, private, vullnetare sikurse edhe asistencë ndërkombëtare duke kontribuar me mjete financiare, ndihma materiale dhe personel. Në varësi të përmasave të fatkeqësive, përcaktohen më përpara nevojat e operacioneve për përballim, në të cilat u kërkohej institucioneve dhe strukturave të kryejnë detyra nën presion kohor dhe të ndryshme nga ato që ata kryejnë në punën e tyre të përditshme.

Shpesh lindin nevoja që tejkalojnë kapacitetet e institucioneve dhe strukturave të veçanta duke u kërkuar kështu që të bashkërendohen dhe ndahen detyrat me institucione dhe struktura, të cilat përdorin procedura të panjohura për ta. Më tej, gjatë fatkeqësive, institucionet dhe/apo strukturat mund të përballen me përgjegjësi të paqarta dhe që dublojnë njëra-tjetrën si dhe me detyra të reja për të cilat, tradicionalisht, asnjë prej tyre nuk ka pasur përgjegjësi.

Këto kërkesa të veçanta si dhe sfidat e krijuara si pasojë e fatkeqësisë, me të cilat përballen shumë organizata, nxjerrin në pah nevojën për procedura dhe struktura qeveritare të emergjencave, të cilat kanë si qëllim bashkërendimin dhe menaxhimin efektiv të operacioneve të gjithanshme për përballimin e fatkeqësisë. Me bashkërendim ndërstrukturor do të nënkuptohet aftësia për të bërë që të punojnë së bashku individë nga organizata të ndryshme për të arritur qëllimin e përbashkët në mënyrë efektive. Pa procesin e bashkërendimit, nuk do të mund të ndahen ose të shpërndahen burimet sipas nevojave dhe aktivitetet që kanë lidhje me fatkeqësinë mund të zhvillohen në mënyrë të pastrukturuar dhe spontane, pa komunikimin dhe kontrollin e duhur. Kjo mund të sjellë si rezultat dublimin e përpjekjeve, boshllëqe në asistencë, madje edhe aktivitete që nuk i shërbejnë qëllimit.

Bashkërendimi ndërmjet strukturave dhe organizatave nxitet nga mekanizma të ndryshëm. Në fazën para ndodhjes së fatkeqësisë, këta mekanizma përfshijnë: ndërveprimin dhe komunikimin, planifikimin dhe trajnimin e përbashkët, plane për emergjencat dhe legjislacionin për fatkeqësitë dhe/ose marrëveshje ndërmjet organizatave. Në çastin kur ndodh fatkeqësia, bashkërendimi ndërmjet strukturave dhe organizatave mund të lehtësohet në masë të konsiderueshme nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të QOE në bashki. Ky seksion përshkruan shkurtimisht secilin prej këtyre mekanizmave.

Ndërveprimi dhe bashkërendimi para fatkeqësisë

Përvoja dhe studimet tregojnë se bashkërendimi për përballimin e fatkeqësive nxitet kur organizatat kanë bashkëvepruar dhe kanë komunikuar edhe përpara një fatkeqësie. Kontakti dhe komunikimi para fatkeqësisë mund të arrihen nëpërmjet takimeve, planifikimeve dhe trajnimeve të përbashkëta, ndarjes së zakonshme të informacionit dhe raporteve ndërmjet organizatave. Në thelb, çdo aktivitet i zhvilluar në fazën para fatkeqësisë, i cili ndihmon në krijimin e besimit, shoqërisë dhe marrëdhënieve profesionale të punës ndërmjet personelit kryesor përgjegjës për emergjencat, do të mundësojë një përballim më efektiv të fatkeqësisë.

Planifikimi dhe trajnimi i përbashkët

Planifikimi dhe trajnimi i përbashkët bëjnë të mundur që punonjësit e organizatave të ndryshme të njihen dhe të kenë besim tek njëri-tjetri dhe, njëkohësisht, të njihen me funksionet, kapacitetet dhe procedurat e gjithsecilit. Planifikimi i përbashkët i referohet zhvillimit të planeve të emergjencës, të cilat identifikojnë rreziqet dhe risqet e mundshme gjatë emergjencës, përshkruajnë mandatin dhe kapacitetet e organizatave, paraqesin një listë të aktiviteteve për përballimin e fatkeqësisë dhe përgjegjësitë në bazë të strukturave dhe të organizatave për këto aktivitete. Trajnimi i përbashkët u referohet seminareve, stërvitjeve dhe ushtrimeve përgatitore në lidhje me fatkeqësitë, të cilat sjellin më afër organizatat dhe strukturat e ndryshme, që luajnë rol dhe kanë përgjegjësi për përballimin e emergjencave. Trajnimi i përbashkët përdoret, gjithashtu, për të provuar dhe për të përmirësuar planet e emergjencave. Më tepër në lidhje me trajnimin është sqaruar në seksionin 2.6 "Trajnimet dhe edukimi publik".

Bashkërendimi në të gjitha nivelet sipas legjislacionit për ZRF dhe MC

Legjislacioni për ZRF dhe MC përcakton përgjegjësitë ligjore, mandatet organizative dhe procedurat administrative të cilat do të aktivizohen gjatë përballimit të emergjencave. Ndërkohë që ligji 45/2019

është miratuar, pjesa më e madhe e këtyre akteve nënligjore të ligjit nuk janë miratuar ende. Në këto kushte, legjislacioni mbështetës janë ato akte të reja nënligjore në zbatim të ligjit 45/2019 së bashku me aktet në zbatim të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001, "Për emergjencat civile", të ndryshuar, dhe që do të zbatohen për atë kohë sa nuk bien në kundërshtim me ligjin 45/2019. Një përmbledhje e legjislacionit të sipërpërmendur ndodhet në seksionin 9.1 "Referencat dokumentare dhe ligjore".

Marrëveshjet ndërmjet organizatave

Marrëveshjet apo memorandumet ndërmjet organizatave, janë një formë njohjeje nga të dy palët, e burimeve që do të ofrojnë secila organizatë për përballimin e fatkeqësive dhe e aktiviteteve në të cilat do të përfshihet secila prej tyre, si dhe e atyre aktiviteteve për të cilat organizatat do të bashkëpunojnë dhe do të krijojnë mekanizma bashkërendues. Memorandumi i mirëkuptimit mund të paraqesë, gjithashtu, pakte për ndihma të ndërsjella ndërmjet dy organizatave të ndryshme qeveritare ose dy organizatave të juridiksioneve të ndryshme, apo marrëveshje me kontraktorë privatë për ndihmën që ata do të japin në lidhje me transportin dhe logjistikën për përballimin e emergjencave. Do të ishte e udhës që bashkia Lezhë të nënshkruante memorandum mirëkuptimi me Kryqin e Kuq Shqiptar, pasi ky i fundit disponon kapacitete dhe ka funksione të rëndësishme në përballimin e emergjencave. Edhe memorandumet/marrëveshjet me aktorë të tjerë joqeveritarë do të ishin të dobishëm dhe do të lehtësonin menaxhimin e emergjencave në territorin e bashkisë.

4.2.FUNKSIONET DHE MENAXHIMI I QENDRËS OPERACIONALE TË EMERGJENCËS (QOE) NË BASHKI

Një element kritik për menaxhimin e emergjencave është bashkërendimi. Sapo përballemi me fatkeqësinë, ngritja e QOE-së në bashkinë e prekur nga fatkeqësia është mjaft e rëndësishme për të pasur një bashkërendim të suksesshëm.

Qëllimi i QOE-së në bashki

QOE-ja është një strukturë bashkërendimi dhe komunikimi midis drejtuesve kryesorë dhe organizatave të përfshira në përgjigjen ndaj emergjencës, e cila lehtëson shkëmbimin e informacionit midis tyre. Ajo shërben edhe si një sekretari teknike që ndihmon punën për funksionimin e KMC-së dhe Drejtuesit të Operacioneve në nivel bashkie, në varësi të përmasave të emergjencave.

Funksionet e QOE-së

Funksionet kryesore të QOE-së janë:

- Bashkërendimi i punës së strukturave, të agjencive dhe të organizatave të ndryshme;
- Bashkërendimi i centralizuar i operacioneve për përballimin e emergjencës, në mbështetje të KMC në bashki dhe Drejtuesit të Operacionit në bashki;
- Mbledhja dhe ndarja e informacionit dhe raportimi zyrtar;
- Dhënia e informacionit publikut dhe medias.

Përgjegjësitë e QOE-së

- Ushtron efektivisht autoritetin, kur paraqitet nevoja;
- Lehtëson komunikimin në kohë dhe ndarjen e informacionit midis strukturave vendore në territorin e bashkisë;

- Mobilizon efektivisht personelin dhe burimet;
- Komunikon në kohë me publikun;
- Ofron zgjidhje të shpejtë të mosmarrëveshjeve midis aktorëve të ndryshëm që marrin pjesë në përballimin e emergjencës në lidhje me qëllimet, taktikat dhe burimet;
- Lehtëson ndërveprimin efektiv ndërmjet autoriteteve të qeverisë qendrore, Prefektit të qarkut, bashkisë dhe aktorëve të tjerë.

Përgjegjësitë e Drejtuesit/koordinatorit të QOE-së

- Bashkërendon përgjigjen e institucioneve dhe strukturave qeveritare në bashki;
- Siguron lidhjet e komunikimit midis QOE-së dhe qendrave të tjera operacionale dhe bashkërendon përpjekjet e OJQ-ve, OJF-ve, biznesit dhe aktorëve të tjerë;
- Identifikon burimet për të cilat organizatat janë përgjegjëse dhe organizon angazhimin dhe shpërndarjen e tyre;
- U paraqet raporte të rregullta të situatës KMC-së dhe Kryetarit të Bashkisë;
- Përgatit njoftimet për median dhe, pas miratimit nga KMC, ia bën të ditur asaj;
- Drejton punën e specialistëve të personelit të drejtimit të operacioneve dhe atij administrativ.

Përgjegjësitë e specialistit të personelit të operacioneve:

- Mban evidenca, harta dhe tabela me informacion rreth situatës;
- Ndjek progresin e zërave/pikave të ndryshme të veprimit;
- Përgatit raporte për situatën;
- Siguron që mbështetja administrative të jetë funksionale;
- Mbledh informacion vlerësues nga organizatat e tjera qeveritare, KKSH-ja dhe të tjera.

Përgjegjësitë e personelit mbështetës administrativ:

- Ndhmon për radhitjen e materialeve, për futjen e të dhënave dhe për detyrat e tjera që përfshijnë punë kompjuterike të cilat mund t'u caktohen;
- Ndhmon për përgatitjen e raporteve dhe për mbledhjen e të dhënave vlerësuese nga organizata të tjera.

Aktivizimi i QOE

Kur situata e lejon, Kryetari i Bashkisë në konsultim me Sekretarin e Përgjithshëm ose/dhe Nënkryetarin dhe sipas nevojës edhe me Drejtorin e EC, aktivizon QOE-në dhe cakton një koordinator të veprimeve të QOE-së dhe personel me përgjegjësi të përditshme për menaxhimin e kësaj qendre. Elementët mbështetës të QOE-së do të aktivizohen në rast se këtë e kërkon situata e emergjencës. QOE-ja aktivizohet menjëherë në të gjitha rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në një territor që përfshin të paktën një Njësi Administrative të bashkisë.

Në shkaqet për aktivizimin e QOE përfshihen:

- Është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore;
- Numër i konsiderueshëm i personave në risk;
- Shkalla e kërcënimit për njerëzit, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore ose mjedisin;
- Kërkohet mbështetja në vend (aktivizimi afatgjatë, burimet e kufizuara, etj.);
- Koordinimi i burimeve që kërkohet për shkak të burimeve të kufizuara lokale dhe/ose madhësisë dhe shtrirjes së emergjencës/fatkeqësisë;
- Shqetësim i lartë i ngritur nga media ose publiku/palët e interesit.

Përfaqësimi në QOE, personeli dhe bashkërendimi

Organizimi dhe personeli

Personeli i QOE-së do të përbëhet nga:

- Drejtuesi/koordinatori i veprimeve (del nevoja për dy persona, nëse puna do të vazhdojë 24 orë në ditë);
- specialistë përfaqësues të zyrave dhe të strukturave të cilat kanë lidhje me emergjencat dhe të organizatave të cilat i ofrojnë ndihmë personelit të operacioneve;
- personel mbështetës administrativ;
- të tjerë.

Përfaqësues nga të gjitha agjencitë dhe organizatat e përfshira në përgjigje ndaj emergjencës mund të jenë pjesë e personelit ose të marrin pjesë në bashkërendimin dhe takimet e shpërndarjes së informacionit, të organizuara nga QOE-ja. Kryetari i bashkisë, duhet të caktojë një person me ekspertizën dhe autoritetin e duhur për të menaxhuar dhe për të bashkërenduar QOE-në.

Takimet bashkërenduese të QOE-së

Qëllimi, pjesëmarrja dhe shpeshtësia e takimeve bashkërenduese varen nga lloji i fatkeqësisë, nga shkalla dhe nga skenarët e mundshëm që mund të shfaqen. Sidoqoftë, më poshtë po paraqesim objektivat bazë që duhet të arrihen në këto takime:

- Qartësimi dhe delegimi i përgjegjësisë për aktivitete të ndryshme të përballimit të emergjencave;
- Inventarizimi dhe evidentimi i asistencës së ardhur për përballimin e fatkeqësisë;
- Shpërndarja dhe verifikimi i vlerësimit të nevojave dhe informacionit për përballimin e fatkeqësisë;
- Identifikimi i informacionit që duhet t'i shpërndahet publikut. QOE-ja, gjithashtu, përzgjedh personin që do të shërbejë si zëdhënës zyrtar për marrëdhëniet me median;
- Bashkërendimi i transportit dhe shpërndarja e ndihmës së ardhur për përballimin e emergjencës.

Mbledhja e informacionit dhe raportimi

QOE-ja shërben edhe si pika kryesore për mbledhjen, shpërndarjen, raportimin dhe mbajtjen e informacioneve të ndryshme që kanë lidhje me fatkeqësinë. Informacionet që mbërrijnë në QOE dhe që dalin prej saj duhet të menaxhohen me kujdes. Janë 4 lloje informacioni të zakonshme për emergjencat:

- Drejtimi i menaxhimit;
- Raportimi i situatës;
- Kërkesa për burime;
- Informacion i përgjithshëm.

Raportimi i situatës (SITREP)

Raportet e situatës janë një funksion i menaxhuar më së shumti përmes Seksionit të Planifikimit në QOE. I gjithë personeli duhet të përcjellë informacion për situatën e incidentit në Seksionin e Planifikimit. Mbledhja e të dhënave të situatës mund të përfshijë një numër burimesh, përfshirë Seksionin e Operacioneve, Seksionin e Logjistikës dhe Zyrtarin e Informacionit në një farë mase. Informacioni për situatën merret gjithashtu nga nivele më të ulëta dhe nivele më të larta Pas

analizës, funksioni i Planifikimit mbështet vendimet operacionale dhe përmbledh situatën e informacioneve për marrjen e miratimit të drejtorit të QOE. Pasi të miratohet SITREP shpërndahet nga Zyrtari i Informacionit tek Drejtuesi i Operacionit në bashki për miratimin e tij dhe paraqitjen pastaj tek KMC në bashki.

Kërkesat për burime

Normalisht vijnë nga reaguesit e parë tek Seksioni i Operacioneve në QOE ose direkt te drejtori i QOE-së.

Informacion i përgjithshëm

Mund të shkëmbehet midis QOE në bashki me QOE në Institucionin e Prefektit apo me Njësitë Administrative dhe aktorët e tjerë në territorin e bashkisë. Shkëmbimi i informacionit me qëllim verifikimin e tij, midis niveleve të ndryshëm është i dobishëm para se të ndërmerren veprime.

Të dhënat për të gjitha politikat dhe vendimet e drejtimit të QOE-së duhet të jenë të dokumentuara. Kërkesat për burime gjithashtu duhet të regjistrohen dhe gjurmohen për të siguruar që përgjigja e dhënë është regjistruar. Në varësi të shkallës së emergjencës dhe intensitetit të saj, duhet të mbahet një regjistër i përbashkët për secilin seksion të QOE-së gjatë ngjarjeve. Kjo do të ndihmojë në gjurmimin dhe monitorimin e efektivitetit të përgjigjes së bashkisë. Dokumentacioni është gjithashtu i rëndësishëm për gjurmimin e shpenzimeve për llogaritjen e kostove dhe për kërkesat për ndihmë tek Institucioni i Prefektit apo tek bashkitë fqinje.

Vlerësimet e nevojave dhe të dëmeve përdoren për të mbështetur funksionet e tjera të QOE-së dhe për të drejtuar apele për ndihmë tek Prefekti i Qarkut apo tek bashkitë fqinje.

Informacioni publik

QOE-ja duhet t'u shpërndajë në kohë informacionin e duhur publikut të gjerë dhe popullsisë në rrezik. Kjo mund të përfshijë informacionin në lidhje me fatkeqësinë, i cili i ndihmon njerëzit të përcaktojnë nëse janë ose jo në rrezik, dhe me masat e marra, si qendrat e ushqimit ose të strehimit gjatë emergjencës.

Marrëdhëniet me median

Fatkeqësitë paraqesin interes të veçantë për median, si pasojë, QOE-ja duhet të ketë krijuar procedura korrekte për marrëdhëniet me këtë të fundit. Për publikun e gjerë, media masive, në mënyrë të veçantë televizioni dhe radioja, vazhdojnë të jenë ende burime të rëndësishme informacioni për fatkeqësitë. Për të shmangur problemet serioze që mund të lindin nga të dhënat e pasakta ose kontradiktore, QOE-ja duhet të emërojë një punonjës të informacionit publik, i cili do të përfaqësojë bashkinë dhe do të jetë përgjegjës për komunikimin me mediat.

Zyrtari për informim publik gjithashtu adreson pyetje nga media, publiku dhe zyrtarë të zgjedhur; informacion publik emergjent dhe paralajmërimet; monitorimin dhe përgjigjen e thashethemeve; marrëdhëniet me median; dhe funksione të tjera që kërkohen për të mbledhur, verifikuar, koordinuar dhe shpërndarë informacion të saktë, të arritshëm dhe në kohë në lidhje me incidentin. Informacioni mbi shëndetin publik, sigurinë dhe mbrojtjen është i një rëndësie të veçantë. Zyrtarët për Informacionit Publik janë në gjendje të krijojnë mesazhe të koordinuara dhe konsistente duke bashkëpunuar për të:

- Identifikuar informacionin kryesor që duhet t'i komunikohet publikut;
- Përgatitur mesazhe që përcjellin informacione kyçe që janë të qarta dhe lehtësisht të kuptueshme nga të gjithë, përfshirë PAK;
- Përcaktuar përparësitë e mesazheve për të siguruar shpërndarjen në kohë të informacionit pa e mbingarkuar audiencën;
- Verifikuar saktësinë e informacionit përmes kanaleve të përshtatshme;
- Shpërndarë mesazhe duke përdorur mjetet më efektive të disponueshme.

Media do të ketë nevojë për informacion për dëmet në njerëz, për nivelin e dëmtimit të pasurisë, për llojin e aktiviteteve të kryera për ndihmë, për organizatat e përfshira, për rreziqet dhe risqet dytësore si dhe për shkaqet e fatkeqësisë. Ndërkohë që në disa raste, kur paraqet informacione të gabuara, media mund të dëmtojë përpjekjet që bëhen për përballimin e fatkeqësisë, në rastet e tjera, kur paraqet informacion të vlefshëm në lidhje me paralajmërimet, rreziqet dytësore, strehimet si dhe të gjitha përpjekjet që po bëhen për të përmirësuar gjendjen, ajo mund t'u vijë në ndihmë menaxhuesve të fatkeqësisë. Për këtë arsye, në kohën e emergjencës, drejtuesit ose personat e ngarkuar si zëdhënës pranë QOE-së, në mënyrë periodike, duhet të mbajnë konferenca për shtyp dhe të përgatisin e të shpërndajnë njoftime për median.

Kur QOE ngrihet ad hoc në situata emergjence, funksionon si një sekretari, ndërsa kur ka ekzistuar si e tillë më parë, merr si funksion shtesë atë të sekretarisë teknike të KMC-së së bashkisë dhe sekretarisë teknike të Drejtuesit të Operacionit në bashki. Për rolin e medias në emergjencë të shihet edhe seksioni 6.1.17 "Informimi i publikut për situatën/edukimin shëndetësor (marrëdhëniet me publikun dhe mediat)".

Vendndodhja

Si rregull, QOE-ja ngrihet në një vend lehtësisht të arritshëm, mundësisht në qendrën e bashkisë. Ai mund të jetë një ambient që përdoret vetëm për një qëllim - atë të QOE-së ose edhe për një qëllim tjetër. Vendndodhja e QOE-së duhet të identifikohet me kujdes pasi ajo duhet me doemos të ndodhet në një zonë jo të cënueshme/jo me risk nga fatkeqësitë. Si rregull, QOE-ja nuk duhet të ngrihet as pranë strukturave/infrastrukturës/zonave që mund të paraqesin risk për ndërprerjen e funksioneve të tyre. QOE-ja duhet të ngrihet në një godinë që është verifikuar nga ekspertët e ZRF dhe inxhinierët e ndërtimit dhe që u reziston tërmeteve, zjarreve, apo fatkeqësive të tjera natyrore dhe fatkeqësive të tjera, të cilat mund të kufizojnë funksionet e saj koordinuese.

Instalimet dhe pajisjet

QOE-ja duhet të jetë e pajisur, minimalisht, me:

- lidhje interneti;
- burim alternativ energjie elektrike me linjë elektrike dytësore/gjenerator;
- disa kompjuterë me programet bazë dhe të pajisur me ups;
- projektorë;
- telefon;
- radio marrëse dhënëse;
- telefon celular smartfone;
- dy printerë;
- dy pajisje faksi;
- video konferencë;
- material kancelarie zyre dhe për vizatime (p.sh., letër, stilolapsa, lapsa etj.);
- planimetri dhe harta të zonës që tregojnë elementet kryesore të planit të emergjencës (zonat

- në risk, zonat e emergjencës, infrastrukturën kritike dhe publike etj.);
- sipërfaqe muri ose tabela të mëdha të zeza për të krijuar tabela me përmasa të mëdha të situatës dhe të bashkërendimit të përgjigjes;
- aparat fotografik dhe/ose video kamera;
- të gjitha materialet e nevojshme mbështetëse për zbatimin e funksioneve të saj.


Gjatë fatkeqësive në shkallë të gjerë ose fatkeqësive të karakterit specifik (rrëshqitje masive, shpërthim dige etj.) sugjerohet që të jetë në dispozicion një postë komande mobile ose të ngrihet një post komandë e përkohshme në tenda afër vendit të fatkeqësisë për koordinimin shumë-agjencish/organizatash. Post komanda duhet:

- Të jetë vetë-mbështetëse deri në 72 orë;
- Të jetë në gjendje të ofrojë aftësi grumbullimi dhe menaxhimi të informacionit me aftësi të komunikimit të zërit, të dhënave dhe video, duke përfshirë aftësitë për të mbështetur të gjithë komunikimet e dokumentuara;
- Të jetë e aftë të menaxhojë shumë agjenci gjatë reagimit ndaj fatkeqësisë;
- Duhet të jenë krijuar standarde të zhvilluara të kritereve të postit të komandës mobile, të tilla si qëndrueshmëria ndaj mjedisit, aftësitë teknologjike, oraret e mirëmbajtjes, madhësia dhe strukturat e komandës.


4.3. MENAXHIMI I EMERGJENCËS. MODELI I NDËRHYRJES

Informacioni i lidhur me menaxhimin e emergjencës duhet të ndjekë linjën e autoritetit në skemën organizative të menaxhimit të emergjencave civile në nivelet e ndryshme. Skema më poshtë bazohet në përmbajtjen e ligjit 45/2019, veçanërisht në nenin 7 (parimi i subsidiaritetit) dhe nenin 40 të tij.

FIGURA 7. Skema e menaxhimit të fatkeqësive në tre nivelet. Parimi i subsidiaritetit



RREZIQET, RISQET DHE CENUESHMËRITË



5.1. PËRSHKRIM I RREZIQEVE, RISQEVE DHE CENUESHMËRIVE


Bashkia Lezhë përballlet me një shumëllojshmëri risqesh nga fatkeqësitë natyrore të cilat vijnë si rrjedhojë e pozicionit të saj gjeografik. Bashkia Lezhë është e rrezikuar nga përmytjet e lumenjve Drin e Mat dhe njëkohësisht nga përmytjet detare. Po ashtu, përshpejtimi i ndryshimeve klimatike, të manifestuara me një rritje të nivelit detar dhe ndryshim të regjimit të reshjeve, rrit probabilitetin e shtimit të fatkeqësive natyrore në të ardhmen në formën e përmytjeve (Le Tissier, et al., 2013). Tërmeti i nëntorit 2019, edhe pse nuk e ka dëmtuar Lezhën në të njëjtin nivel me bashkitë e qarqeve Durrës e Tiranë, risolli në vëmendje një risk permanent. Ndërkohë, risqe të tjera si rrëshqitja e tokës, rënia e gurëve dhe shkëmbinjve, zjarret apo bllokimi nga dëbora (Bashkia Lezhë, 2018) edhe pse më të vogla në dëme që shkaktojnë janë gjithmonë prezentë në territorin e bashkisë.

Analiza e Rrezikut, Riskut dhe Cenueshmërisë është një vlerësim i burimeve të dëmit të mundshëm, gjasat e tyre për të ndodhur, seriozitetin e impakteve të mundshme të tyre, dhe kush apo çfarë është në mënyrë të veçantë i ekspozuar apo i cenueshëm ndaj këtyre impakteve. Rezultatet nga analiza e sipërcituar janë gurë themeli të procesit të planifikimit dhe do të përdoren për të zhvilluar prioritetet e planifikimit dhe për të ndihmuar komunitetin të bëjë zgjidhje të bazuara në risk për trajtimin e cenueshmërive, për të zbutur rreziqet dhe për të përgatitur për përgjigje dhe rimëkëmbje prej fatkeqësive. Mbështetur në përvojat botërore është mirë që jetë kryer një vlerësim i tillë përpara përgatitjes së planit të emergjencave civile. Krahas komponentit të planit të emergjencave civile, projekti pilot i bashkisë Lezhë kishte komponentët:

- “Vlerësimi i riskut në bashki dhe rekomandimet e hartuara për integrimin e ZRF në planet e zhvillimit”
- “Vlerësimi GIS me shumë rreziqe i bazuar në shkencë”.

Të dy këto komponentë u zhvilluan relativisht më herët se komponenti i planit të emergjencave duke dhënë mundësinë për të shfrytëzuar prej tyre gjithçka që nevojitej në kapitujt respektive të planit dhe në shtojcat e tij. Me një projekt të tillë u siguruan plotësisht përvojat më të përparuara ndërkombëtare ku plani i emergjencave civile në bashki mbështetet mbi një analizë të plotë të rrezikut, riskut dhe cenueshmërisë në territorin e saj. Nga raporti i vlerësimit të fatkeqësive natyrore për zvogëlimin e riskut në Bashkinë e Lezhës të hartuar në 2020 në kuadër të projektit kemi këto përfundime:

FIGURA 8. Hartat përmbledhëse të vlerësimit të risqeve në bashkinë Lezhë



Siç mund të dallohet nga më sipër, cënueshmëria më e lartë nga përmbytjet është në njësitë administrative Shënkoll, Zejmen, Kolsh, Balldren dhe në qytet Lezhë.

Cënueshmëria më e lartë nga rrëshqitjet dhe rrëshqitjet e tokës është në zonën e njërive administrative Kolsh, Zejmen, Lezhë dhe në Shëngjin e Balldren përse i përket rënies së gurëve.

Rreziku më i madh nga zjarret është në njësitë administrative Kallmet e Ungrej. Kjo vjen si rezultat i masiveve të mëdha pyjore dhe duke faktorizuar rritjen e thatësirave e të temperaturave si rezultat i ndryshimeve klimatike.

Cënueshmëria më e madhe nga rreziku i erës gjendet në njësitë administrative Balldren, Shënkoll e Shëngjin, ndërkohë që nga dëborat është në njësinë administrative Ungrej.

Përse i përket rrezikut të pandemisë, cënueshmëria më e madhe është në njësitë administrative Ungrej, Kolsh, Zejmen si rezultat i kombinimit të faktorëve moshë popullore, aksesueshmëri dhe ndihmë ekonomike.

Një përshkrim mbi disa fatkeqësi të ndodhura në vite gjendet në seksionin 9.12 "Histori fatkeqësish natyrore dhe fatkeqësish të tjera në territorin e bashkisë Lezhë"

5.2. SKENARËT

Me qëllim vënien sa më në pah të angazhimit të kapaciteteve të bashkisë, janë zgjedhur dy skenarë të dy fatkeqësive më të shpeshta që prekin territorin e bashkisë dhe konkretisht:


- Përmbytje në territorin e bashkisë
- Zjarr në pyll në malin e Shëngjinit

Struktura e përdorur për secilin skenar përmban seksionet si më poshtë:

- Vlerësimi periodik i realitetit në lidhje me fatkeqësinë në fjalë në bashkinë Lezhë.
- Çfarë e shkaktoi emergjencën?
- Ndikimet e emergjencës mbi njerëzit, pasurinë, infrastrukturën, gjënë e gjallë, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin. Popullsia e prekur, ajo e zhvendosur, karakteristikat e tyre.
- Nevojat humanitare tek popullsia e prekur. Nevojat për përgjigje. Burimet dhe pajisjet që do të nevojiten dhe burimet dhe pajisjet që disponohen aktualisht. Trajtimi i problematikave që dolën.
- Funksionet operacionale për përballimin e emergjencës.
- Institucionet, agjencitë, strukturat dhe organizatat që u përfshinë në përgjigje të emergjencës. Si u përfshinë dhe çfarë angazhuan ato?
- Sfidat ose vështirësitë që mund të sjellë kjo fatkeqësi për Nj.A, bashkinë. Si mund të parapërgatiten ato për përballimin e këtyre sfidave?

Dy skenarët më lart gjenden të trajtuar hollësisht në shtojcat 9.10 dhe 9.11 të planit.

FUNKSIONET MBËSHTETËSE EMERGJENTE DHE RIMËKËMBJA



6.1. FUNKSIONET E MBËSHTETJES EMERGJENTE

6.1.1. Organizimi dhe drejtimi, koordinimi qendror / i përgjithshëm i përballimit të emergjencës

Përballimi i emergjencës varet nga përfshirja dhe bashkërendimi i shumë institucioneve, strukturave të ndryshme dhe aktorëve të tjerë. Struktura zyrtare kryesore në bashki është KMC i kryesuar nga Kryetari i bashkisë i cili merr masat për menaxhimin dhe drejtimin e gjithanshëm të menaxhimit të emergjencave për bashkinë. Në rast situatë emergjente, me kërkesë të kryetarit të bashkisë, prefekti cakton, pranë KMC të bashkisë, një pjesë ose të gjithë stafin e zyrës së emergjencave të administratës së tij¹³. Në rastin e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, për drejtimin e strukturave të shërbimit të emergjencave civile, caktohen drejtuesit e operacioneve në nivelet e mëposhtme:

- Drejtuesi qendror i operacionit, i cili emërohet nga KNEC;
- Drejtuesi i operacioneve në nivel qarku, i cili emërohet nga Prefekti;
- Drejtuesi i operacioneve në nivel bashkie, i cili emërohet nga Kryetari i bashkisë;
- Drejtuesit e forcave vepruese të shërbimit të emergjencave civile në nivel qendror dhe vendor, si dhe qendrat operacionale të tyre.

Një rol të veçantë dhe shumë të rëndësishëm në menaxhimin e emergjencave luan QOE në bashki, e cila specifikohet në seksionin 4.2: *Funksionet dhe Menaxhimi i Qendrës Operacionale të Emergjencës (QOE) në Bashki*.

Në rastet e mosshpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, menaxhimi i emergjencave kryhet nga KMC në bashki dhe KMC në qark. Shkalla e mbështetjes nga niveli qendror do të ndryshojë në varësi të kapaciteteve shtesë që do të nevojiten për përballimin e emergjencës.

6.1.2. Mobilizimi dhe aktivizimi i burimeve

Menaxhimi i burimeve i referohet koordinimit, mbikëqyrjes dhe proceseve të kërkuara për të ofruar burime të përshtatshme në kohën e duhur. Në rast emergjence burimet janë të nevojshme në terren dhe tek mbështetja në terren për të mundësuar bashkinë të marrë masat e duhura. Procedura për të mundësuar sigurimin e burimeve të përshtatshme në kohën e duhur duhet të adresojnë sa vijon:

- Identifikimin e nevojave për burime;
- Menaxhimin e kërkesës për burime;
- Përcaktimin dhe menaxhimin e burimeve kritike;
- Dislokimin e burimeve;
- Demobilizimin e burimeve;
- Pagesat dhe rimbursimet;

Aktivizimi i FO në nivel bashkie, kryhet nga Kryetari i bashkisë i këshilluar nga KMC në bashki ndërsa bashkërendimi i strukturave të PSH, MZSH, FA dhe SHU në nivel qarku dhe i strukturave që vijnë në ndihmë, janë përgjegjësi e Prefektit, i cili këshillohet nga KMC në qark.

Në rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, bashkërendimi për sigurimin, furnizimin, magazinimin dhe shpërndarjen e artikujve të ndihmës, bëhet nga Drejtuesi i Operacionit në Bashki. Shpërndarja e ndihmës kombëtare dhe asaj ndërkombëtare bashkërendohet nga

¹³ Pika 15 e VKM nr.531, datë 1.8.2003 "Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit të emergjencave civile"

DOQ në nivel kombëtar, nga DOQ në nivel qarku. Në nivel bashkie ajo kryhet nga Drejtuesi i Operacionit në Bashki në zbatim të vendimeve të KMC dhe në bashkëpunim të ngushtë mes strukturave të Forcave të Armatosura, Policisë së Shtetit, strukturat e MSHMS (për ndihmën në ilaçe), vullnetarëve të KKSH, shoqatave të tjera dhe bizneseve.

Kapacitetet ekzistuese ndodhen:

- Për institucionet shtetërore në seksionin 9.2 të planit.
- Burimet e tjera njerëzore dhe logjistike që mund të merren nga strukturat e tjera joqeveritare dhe subjektet private gjenden në seksionin 9.2 të planit.

Sasia e kapaciteteve të tjera shtesë që do të nevojiten do të varen nga shkalla e emergjencës. Bashkia do të duhet të bashkëpunojë ngushtë me Prefektin e qarkut për vlerësimin sipas rastit të nevojave për burime shtesë dhe sigurimin e tyre sa më shpejt që të jetë e mundur nga të gjitha subjektet shtetërore dhe joshtetërore.

Bashkia duhet të rrisë kapacitetet e saj teknike dhe financiare në mënyrë që të ngushtojë boshllëkun midis kapaciteteve që disponon dhe atyre që nevojiten në rastet e emergjencave të ndryshme.

Për vendosjen sa më shpejt në dispozicion të emergjencës të burimeve të duhura nga subjektet private dhe OJF-të e ndryshme, bashkia duhet të ketë nënshkruar marrëveshje me to paraprakisht. Demobilizimi është kthimi i rregullt, i sigurt dhe efikas i një burimi të vendosur në përgjigje të emergjencës në vendndodhjen dhe statusin e tij origjinal. Kjo përfshin personelin, vullnetarët, strukturat, pajisjet, furnizimet dhe burimet e tjera. Procesi mund të fillojë në çdo pikë të emergjencës, por për të lehtësuar përgjegjësinë, ai duhet të fillojë sa më shpejt që burimi i identifikuar të mos kërkohet më.

6.1.3. Kërkim shpëtimi

Gjatë emergjencave që kërkojnë një përgjigje të unifikuar të SAR, përgjegjësitë bien mbi institucionet dhe FO që ofrojnë aftësi SAR në kohë dhe të specializuara¹⁴.

Mjedisi operacional i përgjigjes SAR klasifikohet si:

- Kërkimi Shpëtimi Urban i Kolapsit Struktural: përfshin operacione për fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera dhe incidente katastrofike, si dhe operacione të tjera kolapsi struktural që kryesisht kërkojnë angazhimin e kapaciteteve të FA;
- SAR detar/bregdetar/ujor: përfshin operacione për fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera që kryesisht kërkojnë operacione nga ajri, të prerjes, me anije dhe të ekipit të reagimit;
- SAR tokësor (malor, në shpella, në hapësira të ngushta etj.): përfshin operacione që kërkojnë aviacion dhe forca tokësore për të përmbushur objektivat e misionit, përveç operacioneve SAR detar/bregdetar/ujor dhe struktural, siç përshkruhet më lart;

Shërbimet SAR përfshijnë monitorimin e ankthit; komunikimet e incidenteve; gjetjen e personelit në gjendje të vështirë; dhe koordinimin dhe ekzekutimin e operacioneve të shpëtimit, duke përfshirë nxjerrjen dhe/ose evakuimin, si dhe sigurimin e ndihmës mjekësore dhe shërbimeve civile përmes përdorimit të burimeve publike dhe private për të ndihmuar personat dhe pronat në situatë rreziku të mundshëm ose real.

¹⁴ Sipas pikës 2 të nenit 4 të ligjit Nr.10 435, datë 23.6.2011 "Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë": *Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura caktohet Koordinatori Kombëtar i Kërkimit dhe Shpëtimit (KKKSH) në Republikën e Shqipërisë. KKKSH-ja drejton operacionet e kërkim-shpëtimit nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit.*

Menjëherë pas emergjencës, nuk dihet me saktësi vendndodhja dhe gjendja e të dëmtuarve. Qëllimi i kërkim-shpëtimit është të gjendet vendndodhja e të dëmtuarve dhe të shpëtohen ata që janë ende në rrezik.

Grupet kombëtare të Kërkim-Shpëtimit sigurohen nga: FA të MM, MB, strukturat e MZSH në bashki, MIE, grupe vullnetare etj.

Në rastet e emergjencave civile kombëtare, operacionet SAR mbështeten nga grupet kombëtare SAR, MZSH, PSH, SHU, MIE, KKSH sikurse nga grupet ndërkombëtare SAR kur ato thirren në ndihmë.

Grupet SAR në bashki, nëpërmjet mbështetjes së Prefektit të Qarkut, sigurohen nga repartet ushtarake "Delta Forca", nga Drejtoria e Vendore e Policisë, MZSH, FNSH Shkodër, grupe vullnetare etj.

6.1.4. Evakuimi i popullsisë civile (shpërngulja)

Evakuimi është një proces përmes të cilit njerëzit zhvendosen nga një vend ku ekziston rreziku i menjëhershëm ose i parashikuar për në një vend të sigurt, duke u ofruar pajisje të përshtatshme të përkohshme dhe duke i mundësuar të kthehen në aktivitetet e tyre normale ose të marrin rregullimet e duhura alternative kur kërcënimi i sigurisë të jetë zhdukur.

Në raste emergjente duhet të merret vendim i shpejtë por i mirëmenduar nëse është e nevojshme të organizohet evakuimi i një zone. Evakuimi është zakonisht një mundësi e fundit, ku ekziston një rrezik i dukshëm i menjëhershëm ose afatgjatë për njerëzit dhe ku ndërtesat nuk do të siguronin mbrojtjen e duhur. Arsyet më të shpeshta të evakuimeve janë zjarri, stuhitë, përmbytja, ndotja dhe rreziqet eksplozive. Bazuar në dokumentin e vlerësimit të riskut të fatkeqësive por edhe në historikun e fatkeqësive të ndodhura, bashkia duhet të evidentojë të gjitha zonat urbane dhe rurale në të cilat pritet të ndodhë evakuimi i njerëzve.

Evakuimi në vetvete mund të jetë një proces i rrezikshëm. Me më shumë njerëz që lëvizin në mënyrë të menjëhershme, ekziston rreziku i shtypjes ose i aksidenteve të trafikut. Të moshuarit, të vegjlit dhe të sëmurët mund të ndikohen negativisht nga detyrimi për të lëvizur. Duhet pasur kujdes që evakuimi të mos i ekspozojë njerëzit ndaj një rreziku më të madh se sa ai që do t'i shoqëronte nëse do të qëndronin në shtëpi/ambientin ekzistues. Faktorë të tjerë që duhet të merren parasysh në evakuim janë mosekspozimi i stafit operacional ndaj shkallëve të papranueshme të rrezikut por dhe kostoja ekonomike dhe sociale që shoqëron evakuimin.

Ka shumë ndryshore të përfshira në evakuime:

- **Madhësia** - Një evakuim mund të përfshijë gjithçka nga një person deri në qindra, dhe në raste ekstreme, mijëra persona. Ndërsa niveli dhe lloji i përgjigjes do të ndryshojë në varësi të numrit të njerëzve dhe të madhësisë së zonës së evakuuar, parimet e planifikimit dhe reagimit janë të zbatueshme në të gjithë gamën e plotë të evakuimeve;
- **Vendndodhja** - bazuar në dokumentin e vlerësimit të riskut të fatkeqësive, është e mundur të parashikohet se ku mund të ndodhë një emergjencë e cila do të kërkonte evakuim. Evakuimet janë më të zakonshme në zonat urbane pasi ato përmbajnë më shumë risk por ato ndodhin edhe në zonat rurale. Për shkak të dendësisë, evakuimi i një zone urbane përfshin shumë më tepër njerëz se e njëjta zonë rurale.
- **Lloji i pronës** - Evakuimi mund të kërkohet nga çdo lloj prone, duke përfshirë ambientet tregtare

dhe industriale, vendet e argëtimit, parqet dhe hapësirat e hapura dhe banesat. Planifikimi i evakuimit tenton të përqendrohet në banesa, por shërbimet e emergjencës dhe shërbime të tjera, plus pronarët e lokaleve tregtare, pronarët e hapësirave publike dhe organizatorët e eventeve duhet të kenë të gjithë plane fleksibël që lidhen me risqet e identifikuara.

- **Afati kohor** - evakuimet mund të kërkohen në një shumëllojshmëri afatesh kohore:
 - Evakuim i menjëhershëm në përgjigje të një kërcënimi të afërt ose ekzistues;
 - Evakuimi kërkohet shpejt - ndoshta brenda disa orësh - ose në përgjigje të një kërcënimi të afërt ose si një masë paraprake kundër përshkallëzimit të një situatë ekzistuese;
 - Evakuimi është i nevojshëm, por koha është e negociueshme brenda një periudhe ditësh ose javësh;
 - Evakuimi në përgjigje të rreziqeve afatgjata. Mund të ketë një periudhë të gjatë kërkimesh dhe konsultimesh, kohë gjatë së cilës duhet të jetë e mundur të përgatiten plane kontingjencash. Sapo të merret vendimi për evakuim, procesi duhet të jetë në gjendje të vazhdojë me vonesa minimale;
- **Kohëzgjatja** - shumica e evakuimeve zgjasin për disa orë dhe të evakuuarit janë në gjendje të kthehen në pronat e tyre. Sidoqoftë, ekziston mundësia që disa evakuime të zgjasin brenda natës ose më gjatë, për shembull kur moti i rëndë shkakton përmytje të zgjatur të pronave. Në disa raste, shkaku i menjëhershëm i evakuimit mund të kalojë shpejt, por ndërtesat dhe infrastruktura e një zone mund të dëmtohen aq shumë sa që të evakuuarit nuk janë në gjendje të kthehen derisa të bëhet pastrimi dhe/apo riparimi fillestar.

Evakuimi konsiston në:

- Evidentimin e saktë të numrit të personave që do të evakuhet (gjinia, mosha, kategoria);
- Evidentimin e saktë të gjësë së gjallë dhe llojin e tyre;
- Evidentimin e saktë të mjeteve, llojin dhe sasinë e tyre;
- Evidentimin e kapaciteteve të nevojshme njerëzore për kryerjen e evakuimit dhe të vullnetarëve që do të aktivizohen në nivel bashkie/Njësie Administrative;
- Evidentimin e vendeve të përkohshme të strehimit dhe të akomodimit brenda Njesisë Administrative për familjet dhe gjënë e gjallë;
- Kërkesa pranë KMC në bashki për personat dhe gjënë e gjallë që do të akomodohen si edhe për sasinë llojin e mjeteve dhe të forcave që kërkohen.

Evakuimi mund të jetë dy lloje:

- Taktik që rezulton prej një impakti rreziku që kërkon veprim të menjëhershëm dhe lejon për pak alarm dhe përgatitje.
- Strategjik, për të cilin ka kohë për lëshimin e dokumentacionit zyrtar. Kur kryhet evakuim strategjik, inkurajohet të ndiqen tre fazat e procesit të evakuimit; Alarmi i evakuimit, urdhri i evakuimit dhe shfuqizimi i evakuimit.

Në nivel qarku, përgjegjësia për evakuimin është e Prefektit ndërsa në nivel vendor e kryetarit të bashkisë¹⁵. Gjatë situatave të emergjencës, forcat operacionale në terren (FA, PSH, MZSH etj.) mund të vendosin evakuimin e menjëhershëm për territore të kufizuara. Në varësi të situatës, rol të rëndësishëm në evakuimin në territorin e bashkisë, krahas forcave operacionale, strukturave vepruese aktive të MM, MB, MIE, luajnë strukturat e bashkisë, KKSH, Caritas, World Vision sikurse edhe sektori privat.

Evakuimi bëhet në mënyrë të organizuar nga drejtuesit e qeverisjes vendore. Radha e evakuimit do jetë në radhë të parë njerëzit dhe më pas gjëja e gjallë apo orenditë shtëpiake. Kur mundësitë e evakuimit janë të kufizuara, të parët që do transportohen do jenë të miturit, të sëmurët, të

15 Faqe 44, seksioni 6.6 i PKEC

moshuarit dhe gratë shtatzëna. Një rëndësi e veçantë i duhet kushtuar evakuimit të PAK. Për realizimin e evakuimit angazhohen sipas rastit strukturat e bashkisë, PSH, FA, SHU institucionet, bizneset private dhe komuniteti vendas.

Alarmi i evakuimit mund të lejojë që popullata në risk të fillojë një përgatitje të rregullt për të lënë vullnetarisht zonën e prekur, brenda një afati kohor të caktuar. Megjithatë, realiteti i situatës mund të kërkojë veprim të menjëhershëm me njoftim shumë urgjent.

Në mënyrë që të sigurohet që ai është efektiv, procesi i dërgimit të një alarmi evakuimi duhet të studiohet në lidhje me aftësitë njohëse dhe sensoriale të secilit person që duhet të lajmërohet, ose me nevojat e kujdestarëve të tij ose të saj. Personat në regjim shtrati që nuk janë në gjendje të lëvizin vetë duhet të ngrihen, të vishen (nëse është e nevojshme) dhe të transportohen nga kujdestarët ose personat përgjegjës të cilët janë trajnuar se si ta kryejnë këtë lloj pune dhe që do të përdorin procedurat e duhura.

Mesazhi i alarmit duhet të jetë i qartë dhe konciz dhe duhet të përmbajë informacionin “kush, ku dhe kur”, i nevojshëm për t’u mundësuar njerëzve të ndërmarrin veprimet e duhura.

Në fazën e evakuimit, një rëndësi të veçantë merr:

- informimi siç duhet dhe në kohë i komunitetit që do të evakuohet për rrezikun dhe masat që duhen marrë për të lëvizur në zona të sigurta.
- evakuimi i personave vulnerabël.

Popullsia në risk lejohet të kthehet në zonën e evakuuar më parë, vetëm pasi rreziku ka kaluar. Planet e evakuimit duhet të marrin në konsideratë dy grupe të veçanta njerëzish: “popullatën në risk” dhe “popullatën pritëse” e cila do të strehohet të evakuuarit.

Zona e evakuuar është në rrezik, jo vetëm nga efektet e ngjarjes emergjente, por edhe nga hajdutët dhe plaçkitësit. Ky nuk ka gjasa të jetë një problem i madh në territorin e bashkisë Lezhë, por në mënyrë që të garantojë siguri për të evakuuarit, PSH duhet të ndërmarrë veprimet e duhura për të kontrolluar hyrjen në zonën e evakuuar dhe për të monitoruar zonën e evakuimit për çdo aktivitet të paautorizuar. Për ta kryer këtë, PSH mund të ketë nevojë për mbështetjen e Policisë bashkiake, Njësisë Administrative dhe në raste të veçanta edhe të FA.

6.1.5. Strehimi (i përkohshëm)/akomodimi i përkohshëm gjatë emergjencës batanije, tenda, shtroje plastike, rroba)

Menjëherë pas alarmit dhe urdhrit të evakuimit, do të duhet që të evakuuarit të akomodohen në qendrat e pritjes të cilat janë vendet ku, në momentet menjëherë pas ngjarjes, do të garantohet ndihma e parë dhe informacioni i parë për ngjarjen për popullatën, në pritje të përgatitjes së vendeve të strehimit ose kthimit në kushte normale të jetesës.

Sa i përket strehimit, qëllimi i rimëkëmbjes është të sigurojë strehimin e mjaftueshëm urgjent sa më afër zonës së prekur. Mundësia e sigurimit të akomodimit gjatë fazës së rimëkëmbjes varet nga disponueshmëria e burimeve përkatëse (tenda, rulotë, kontejnerë, hotele, rezidenca, kampingje apartamente të lira, etj.).

Në disa raste, gjatë një emergjence del si nevojë strehimi i atyre njerëzve, shtëpitë e të cilëve janë shkatërruar ose nuk janë të sigurta. Kjo do të kërkojë: sigurimin e tendave dhe të gjithë logjistikës tjetër për strehim që do të përfshijë strehimin e personave të shtëpive të dëmtuara ose atyre në rrezik:

- në oborr/ në afërsi të banesës;
- në kampingje;
- tek të afërmit e të evakuuarve;
- në ndërtesa publike si shkolla, palestra, pallate sporti etj.;
- në struktura private si hotele etj.

Përgjegjësi për caktimin e objekteve dhe zonave për sigurimin e vendstrehimeve të përkohshme të sigurta, vlerësimin e nevojave për strehim dhe menaxhimin e tij në territorin e bashkisë është autoriteti i bashkisë i mbështetur nga Prefekti i qarkut dhe AKMC.

Vështirësitë që mund të dalin në strehimet e përkohshme me tenda gjatë periudhës së dimrit do të jenë ato të temperaturave të ulëta. Për këtë, tentat do të duhet të jenë dimërore dhe të pajisura me gjeneratorë të cilët do të sigurohen nga bashkia/DPRMSH. Për tentat gjatë periudhës së verës do të përdoren ato verore sikurse do të sigurohet freskimi siç duhet i tyre.

Edhe për personat që janë strehuar tek të afërmit apo miqtë e tyre do të sigurohet asistencë e nevojshme për të siguruar të paktën kushte të njëjta me ata që janë strehuar në tenda, në ndërtesa publike apo hotele.

Bashkia do të disponojë materiale ndërtimi për punime të ndryshme që do të nevojiten të kryhen si për vendosjen e tendave të veçuara ashtu edhe për ndërtimin e kampingjeve.

Bashkia disponon aktualisht një sasi të kufizuar tendash e cila duhet të rritet. Bashkia gjithashtu duhet të disponojë gjeneratorë për tentat, shtroje plastmase, thasë për fjetje si edhe pajisje dhe mallra të tjera të nevojshme për strehimin.

Përgjegjësia për akomodimin e përkohshëm në rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, do të konsiderohet se do të mbulohet përgjithësisht nga niveli qendror.

Si për rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore ashtu edhe për emergjencat e tjera, bashkia duhet të marrë masat për rialokimin e fondeve deri në 8% të buxhetit të saj vjetor për të mbuluar edhe nevojat e strehimit, duke pasur parasysh detyrimin e pikave 3 dhe 4 të nenin 41 të ligjit 45/2019.

Në këto raste përgjegjësitë për funksionimin e kampingjeve janë si më poshtë:

- Siguria e vendeve të strehimit sigurohet nga PSH e cila në raste të veçanta mund të mbështetet nga Policia bashkiake dhe FA;
- Kujdesi shëndetësor sigurohet Nj.V.K.SH, ISHSH dhe SRL;
- Ushqimi, ngrohja, aktivitetet çlodhëse/rekreative (argëtuese) janë përgjegjësi e bashkisë që mbështetet nga KKSH, Caritas, World Vision, biznesi privat etj.;
- Sigurimi i ujit të pijshëm dhe kanalizimeve është përgjegjësi e bashkisë e mbështetur nga Sh.A Ujësjellës Kanalizime;
- Sigurimi i energjisë elektrike është përgjegjësi e OSHEE dhe bashkisë.

Bashkia duhet të sigurojnë që PAK të mos diskriminohen në planifikimin, hartimin ose caktimin e strehimit të përkohshëm pas fatkeqësisë, i cili duhet të jetë i arritshëm dhe funksional në përputhje me nevojat e tyre. Ata nuk duhet të diskriminohen as në caktimin e strehimeve të përkohshme dhe as banesave të përhershme.

Zonat e grumbullimit të automjeteve dhe reaguesve, zonat e pritjes dhe ambientet e strehimit të përkohshëm evidentohen nga bashkia në bashkëpunim me Prefektin e qarkut.

Shpjegime më të detajuara në lidhje me ambientet që duhet të propozojë Bashkia Lezhë për:

- Zonat e magazinimit (grumbullimit të automjeteve dhe reaguesve);
- Zonat e pritjes së popullsisë së evakuuar;
- Zonat e strehimit të popullsisë së evakuuar, ndodhen në seksionin 9.4 “zonat e emergjencës” së planit.

6.1.6. Paralajmërime të hershme dhe informacione publike për emergjencat, këshillimi i publikut

Raportimi në bashki në lidhje me situatat e emergjencave civile kryhet nëpërmjet burimeve të ndryshme që fillojnë nga qytetarët, institucionet shtetërore qendrore dhe ato vendore, FO, vullnetarë etj. Kjo përgjegjësi përfshin sigurimin e informacionit teknik në lidhje me kushtet dhe situatën hidrologjike, sizmike, meteorologjike dhe të mjedisit. Paralajmërimet për publikun kanë qëllim informimin e tij në lidhje me riskun e fatkeqësive, për t'i dhënë atij udhëzime për masat kryesore të sigurisë që mund të marrë. Paralajmërimet e hershme kritike bazuar në një analizë të plotë janë efektive nëse shpërndahen me shpejtësi tek popullata në risk. Përgjegjësia kryesore për informimin e popullsisë, në varësi të shpejtësisë dhe shkallës së emergjencës, është e Kryetarit të bashkisë dhe Prefektit, si dhe e FO në terren. Përgjegjësia për njoftimin e parë në nivel kombëtar për emergjencat të shkallës së lartë është e MM. Njoftimi, informimi dhe këshillimi i publikut bëhet kryesisht nëpërmjet:

- Radio - Televizionit Publik Shqiptar dhe radio-televizioneve të tjera kombëtare dhe lokale (TV Lezha);
- Mediave private elektronike dhe të shkruara (etj.);
- Njoftimeve zanore të kishave dhe xhamive;
- Thirrjeve telefonike ose mesazheve;
- Vizitave derë më derë dhe/ose shtypjes së citofonëve;
- Udhëtimit në rrugë me një automjet të pajisur me altoparlantë (megafoni lëvizëse);
- Postimit të njoftimeve për shtyp me shkrim në hapësirat bashkiake (bordet e njoftimeve, shkollat, bizneset publike);
- Uebfaqeve bashkiake dhe të tjera;
- Platformave të mediave sociale, duke përfshirë Facebook dhe Twitter;
- Vullnetarëve të KKSH dhe vullnetarëve të tjerë;
- Organizatave të Shoqërisë Civile;
- E-mail-eve si edhe aplikacioneve të ndryshme celulare (për ata që i kanë instaluar);
- Fletëve të printuara me germa të mëdha të shpërndara nëpër ndërtesa;
- Shenja alarmi digjitale në ekranet e smartfonëve për PAK;
- Mjeteve e burimeve të tjera.

Për më tepër informacion shihni gjithashtu seksionin 6.1.12 “Komunikimi , shkëmbimi i informacionit dhe procedurat e raportimit”.

6.1.7. Kujdesi mjekësor/ndihma e parë gjatë emergjencës (triazhimi/klasifikimi)

Spitali Rajonal Lezhë është në gjendje të kryejë triazhimin/klasifikimin e personave të dëmtuar nga fatkeqësia që mund të jenë si popullata e prekur prej fatkeqësisë ashtu edhe FO apo edhe strukturat e tjera të angazhuara në parandalimin apo përbalimin e saj. SRL do të mbështetet nga NJ.V.K.SH sikurse nga KKSH. Këto institucione mbështeten dhe bashkëpunojnë edhe me struktura të tjera shtetërore që veprojnë në qark. E rëndësishme është asistencë që jepet në të tilla raste nga Dega Lezhë e KKSH dhe Caritas të cilat janë të mirëtrajnuara sikurse kanë edhe përvojën nga emergjencat të mëparshme.

6.1.8. Shëndeti publik (shërbimi shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor), higjena

Shërbimi Shëndetësor parësor: Përgjegjëse për Shërbimin Shëndetësor parësor në bashkinë Lezhë është Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor (NJ.V.K.SH). Ajo është përgjegjëse për sigurimin e shërbimit të urgjencës dhe shërbimit shëndetësor parësor nëpërmjet 10 qendrave/klinikave shëndetësore në Lezhë, Shëngjin, Shënkoll, Zejmen, Kolsh, Dajç, Blinisht, Ungrej, Balldren dhe Kallmet, të cilat janë funksionale. Secila prej këtyre qendrave/klinikave shëndetësore ka në varësi rrjetin përkatës të ambulancave duke mbuluar në këtë mënyrë me shërbim shëndetësor dhe ambulator gjithë territorin e bashkisë Lezhë. NJ.V.K.SH dhe Inspektorati Shtetëror Shëndetësor kanë përgjegjësinë për monitorimin e cilësisë të ujit të pijshëm dhe higjienës si dhe për zbatimin e programit të zgjeruar për vaksinimin e popullatës.

Shërbimi Shëndetësor dytësor (spitalor): Në bashkinë Lezhë konsiston në Spitalin Rajonal Lezhë. Shërbimi Shëndetësor dytësor (spitalor) në qarkun Lezhë realizohet nëpërmjet 3 spitaleve, Spitali Rajonal Lezhë, 2 Spitale përkatësisht në rrethet Mirditë e Kurbin, me 30 qendra shëndetësore, 119 ambulanca, 4 laboratorë klinikë të specializuar dhe 1 bankë gjaku.

6.1.9. Vlerësimi fillestar dhe ai i specializuar i dëmeve dhe nevojave ujë, shëndetësi, bujqësi etj. në zonat e prekura dhe mbledhja e centralizuar e informacionit

Vlerësimi i nevojave

Emergjenca civile vendore dhe rajonale

Praktikisht, është e pamundur të organizohen operacione të efektshme për përballimin e fatkeqësive, pa një vlerësim tepër të saktë të situatës së emergjencës dhe një vlerësimi të plotë të nevojave humanitare dhe nevojave të tjera.

Bashkërendimi për vlerësimin e nevojave për emergjenca të shkallës së ulët është nën përgjegjësinë e Kryetarit të Bashkisë i cili mund të mbështetet nga Prefekti i Qarkut, AKMC, dega Rajonale e KKSH, Caritas, degë territoriale ose grupe të përbashkëta pune.

Emergjenca civile kombëtare

Bashkërendimi për vlerësimin e nevojave është nën përgjegjësinë e KNEC, nëpërmjet Grupeve Ndërinstitucionale të Vlerësimit. Këto grupe mbështeten drejtpërsëdrejti nga AKMC dhe përmbajnë specialistë nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjerë të varësisë, duke përfshirë Prefektin, Drejtorinë e EC në bashki, dhe sipas rastit edhe personel nga KKSH, Caritas etj.

Vlerësimi i dëmeve

Vlerësimi i dëmeve, si për rastet e shpalljes dhe mosshpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, i referohet VKM Nr. 329, datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".

Vlerësimi i dëmeve në objektet e banimit dhe infrastrukturë, për emergjencat civile vendore dhe rajonale, kryhet nga bashkia ndërsa për emergjencat civile kombëtare nga Grupet Ndërinstitucionale të Vlerësimit¹⁶.

16 Referuar pikës "gj" të nenit 30 të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile",

Në vlerësimin e dëmeve, bashkia mbështetet nga Prefekti i qarkut i cili koordinon angazhimin e degëve territoriale por dhe nga AKMC. Mbështetja teknike kryesore në nivel qendror sigurohet nga specialistët dhe institucione më të specializuara në lidhje me dëmet, duke përfshirë: Entin Kombëtar të Banesave (EKB), Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARRSH), Institutin e Ndërtimit etj.

Grupet Ndërinstitucionale të Vlerësimit

Grupet Ndërinstitucionale të vlerësimit, drejtohen nga specialistë të institucioneve përkatëse në varësi të natyrës së emergjencës. Specialistët mund të jenë nga Administrata e Prefektit të Qarkut, Këshillit të Qarkut, Bashkisë Lezhë. Strukturat e Shëndetësisë, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Sektori i Ekstensionit Bujqësor Lezhë, Dega Lezhë e Drejtorisë së OSHEE Shkodër, Dega Lezhë e Drejtorisë së OST Shkodër, Inspektorati Kombëtar i Mjedisit dhe Territorit, Drejtoria Vendore e Policisë, Strukturat e FA etj.

6.1.10. Ofrimi i ndihmës së parë ushqimore dhe asistencës tjetër gjatë emergjencës (ruajtja, magazinimi, mensat etj.)

Emergjencat civile vendore dhe rajonale:

Përgjithësisht ofrimi i ndihmës së parë ushqimore dhe asistencës tjetër gjatë emergjencës do të kryhet nga bashkia nëpërmjet mobilizimit të kapaciteteve të saj, bazuar planit të saj të emergjencave civile. Bazuar PKEC bashkia thërret edhe kapacitetet e subjekteve të tjera qeveritare dhe joqeveritare sikurse bizneset. Nëse është e nevojshme, për këtë qëllim ajo kërkon edhe mbështetjen e Prefektit të Qarkut.

Emergjencat civile kombëtare:

Bashkërendimi për sigurimin, furnizimin, magazinimin dhe shpërndarjen e artikujve të ndihmës kombëtare, kryhet nga DQO/AKMC në bashkëpunim me DPRMSH, Prefektin e Qarkut dhe Bashkinë Lezhë. Shpërndarja e ndihmës bashkërendohet nga DQO/AKMC në nivel kombëtar dhe në nivel vendor nga Prefekti i qarkut dhe organet e pushtetit vendor, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e MSHMS (për ndihmën në ilaçe), vullnetarët e KKSH dhe kontraktorë.

Bashkërendimi për sigurimin e furnizimit, magazinimit dhe shpërndarjes së artikujve të ndihmës kryhet nga DPRMSH, duke bashkëpunuar me KMC në qark dhe KMC në bashki. Gjatë gjithë kohës, furnizimi dhe shpërndarja e ndihmave në bashki kryhet nën koordinimin e KMC-së, në bashkëpunim të veçantë me KKSH, Caritas, World Vision, Klerin, OJF, shoqatat e vullnetarëve dhe biznesin privat.

6.1.11. Zbatimi i ligjit, masat e sigurisë dhe masat për ruajtjen e rendit publik, siguria dhe kontrolli i trafikut

Për situata të jashtëzakonshme problemet e sigurisë drejtohen nga Presidenti i Republikës i këshilluar nga Këshilli Kombëtar i Sigurisë dhe mbështeten nga MB (PSH), MM, Shërbimi Informativ Kombëtar dhe Prefekti i qarkut dhe Kryetari i bashkisë.

Në emergjencë kombëtare, përgjegjësia e përgjithshme është e KNEC nëpërmjet strukturave të PSH, FA si dhe autoritetet në nivel qarku dhe bashkie nëpërmjet strukturave të tyre policore. Në nivel Qarku dhe bashkie, masat e sigurisë, ruajtjes së rendit publik dhe kontrolli i trafikut, sigurohen respektivisht nëpërmjet strukturave të Drejtorisë Vendore të Policisë dhe Komisarariatit të Policisë në bashki. Në rast nevoje, në ndihmë të këtyre strukturave vendosen edhe FA.

Në të gjitha rastet e emergjencave, në nivel bashkie, rolin kryesor në masat për zbatimin e ligjit dhe ruajtjen e rendit do të merren nga Komisarjati i Policisë së bashkisë Lezhë i mbështetur nga Policia bashkiake. Në raste të veçanta ato do të mbështeten edhe nga FA.

Nëse ka arsye të supozohet se shkak për emergjencën është bërë një vepër penale, PSH do të fillojë një hetim paralelisht me përgjigjen. Kjo mund të nënkuptojë që vendi ose vendet, e një emergjence të konsiderohen si një skenë krimi dhe që aktivitetet e aktorëve të tjerë të kufizohen në ato thelbësoret për shpëtimin e jetës, në mënyrë që të sigurohet ruajtja e provave.

E rëndësishme në rastet e evakuimeve është si ruajtja e vendbanimeve të braktisura për shkak të emergjencës kundrejt keqbërësve ashtu edhe ruajtja e qendrave të pritjes dhe atyre të strehimit.

6.1.12. Komunikimi, shkëmbimi i informacionit dhe procedurat e raportimit

“Menaxhimi i komunikimit dhe informacionit” i referohet një mekanizmi të organizuar, të integruar dhe të koordinuar për të siguruar shpërndarjen e saktë, të qëndrueshme dhe në kohë të informacionit tek reaguesit në vendin e incidentit, agjencitë ndihmëse dhe bashkëpunuese, personelin e ndihmës në vendin e incidentit, dhe publikun/palët e interesuara.

Përvoja tregon se në situata emergjente strukturat e komunikimit bien nën presion ekstrem dhe mund të dështojnë. Kjo mund të ndodhë për shkak të infrastrukturës së dëmtuar nga emergjenca, për shkak të ngarkesës së trafikut ose për shkak se sistemet nuk janë mirëmbajtur siç duhet (bateritë e rena, lidhjet e vjetruara). Organizatat të cilat varen nga komunikimet e tyre për qëllime komandimi, kontrolli dhe raportimi do të kenë nevojë për mbështetje dhe rezervë. Zgjidhjet e teknologjisë së ulët si përdorimi i vrapuesve dhe korrierëve mund të duhet të merren parasysh. Komunikimet mund të hasin probleme edhe për shkak të vështirësive gjuhësore prandaj mund të nevojiten komunikime specialistësh për njerëzit me probleme dëgjimi apo të foluri sikurse për persona jo shqip folës.

Qartësia, korrektësia dhe shpejtësia e dhënies së informacionit është mjaft e rëndësishme në rastet e emergjencave civile, e cila sigurohet në nivel qendror, qarku dhe vendor respektivisht nëpërmjet njoftimeve periodike të QKOEK-së, QOEQ dhe QOEB (sektorëve përkatës të informacionit), dhe njëkohësisht nga autoritetet e drejtimit të operacioneve në nivele të ndryshme.

Terminologji e zakonshme, gjuhë e thjeshtë

Është kritike që të gjithë aktorët e përfshirë në një emergjencë të dinë dhe të përdorin struktura operative, terminologji, politika dhe procedura të vendosura bashkërisht. Mundësitë për të punuar së bashku, e personelit që merr pjesë në menaxhimin e emergjencave dhe organizatave dhe agjencive të ndryshme, varen shumë nga mundësitë e tyre për të komunikuar me njëri tjetrin. Terminologjia e zakonshme dhe e përbashkët si edhe gjuha e qartë dhe e thjeshtë u mundëson atyre të komunikojnë qartë me njëri-tjetrin dhe t'i koordinojnë aktivitetet me efektivitet, pa marrë parasysh madhësinë, shtrirjen, vendndodhjen apo kompleksitetin e emergjencës. Përdorimi i gjuhës së thjeshtë ose të një teksti të qartë, në vend të kodeve ose shkurtesave, lehtëson koordinimin dhe ndërveprimin midis aktorëve të ndryshëm.

Siguria e informacionit

Protokollet e sigurisë së informacionit janë kritike sepse siguria e pamjaftueshme mund të rezultojë në dhënie të parakohshme, të papërshtatshme ose joefektive të informacionit. Kjo nga ana tjetër rrit mundësinë e keqkuptimit dhe mund të komplikojë situatat e sigurisë publike.

Mjetet e komunikimit mes institucioneve janë telefona celularë, smartfone, telefona fikse, e-mail, faks, radio dhënëse dhe marrëse dhe videokonferencë. Të gjitha këto mënyra do të përdoren për komunikimin mes QOE në bashki dhe Prefektit të qarkut, midis personelit të institucioneve të ndryshme, FO dhe organizatave të tjera.

Komunikimi i besueshëm me radio formon një linjë jetësore thelbësore për reaguesit dhe ofron informacione kritike për personelin e QOE dhe komandantit të incidentit. Radio-sistemet ndërvepruese përmirësojnë ndërgjegjësimin për situatën dhe efikasitetin e përgjigjes dhe mund të parandalojnë dëmtimin e mëtejshëm ose humbjen e jetës. Sistemet e radios për strukturat reaguese duhet të jenë të afta të komunikojnë së bashku në mënyrë që të lejojnë një përgjigje të unifikuar dhe të sigurojnë rrjedhën e efektshme të informacionit midis reaguesve, komandës së incidentit dhe QOE, ashtu siç nevojitet. Aktualisht komunikimi me radio kryhet brenda stafeve të PSH dhe brenda atyre të FA por nuk është i disponueshëm në forcat e MZSH-së dhe stafin e personelin mjekësor. Në momentin që hartohet ky plan nuk është i mundur as komunikimi me radio midis forcave të ndryshme operacionale (MZSH, PSH, SHU dhe FA) apo edhe institucioneve të ndryshme.

Lidhja e rrjetit me bandë të gjerë, duke përfshirë lidhjen me internetin, lejon një komunikim efikas midis strukturave reaguese dhe mbështetëse, komandës së incidenteve dhe QOE. Kjo lejon komunikimin me zë, të dhëna dhe video që përmirëson ndërgjegjësimin mbi situatën, siguron lidhje thelbësore me botën jashtë zonës së prekur nga fatkeqësia dhe mbështet përdorimin e teknologjive të sistemeve GIS, atyre të menaxhimit të incidenteve dhe teknologjive të sistemeve të paralajmërimit të hershëm.

Sipas ligjit 45/2019 por edhe PKEC, është detyra e çdo strukture shtetërore, joshtetërore dhe qytetari në Shqipëri që, në mënyrë të menjëhershme, të informojë tek njësitë e vetëqeverisjes vendore në bashki dhe qark, në administratën e prefektit dhe institucionet e strukturat qendrore të çdo niveli në lidhje me situata reale apo të mundshme për emergjenca civile.

Informacioni për ngjarje reale apo të mundshme emergjente zakonisht vjen nga:

- Strukturat monitoruese dhe njoftuese (vrojtuesit e ndryshëm, laboratorë);
- Pikat e kontaktit në Njësitë Administrative;
- Komisariati i Policisë në bashki;
- Strukturat e ndryshme policore;
- MZSH;
- Strukturat të ndryshme shtetërore në bashki;
- Inspektorati Kombëtar i Mjedisit dhe Territorit dhe inspektoratet e ndryshme;
- Institucione monitoruese;
- Kryetarët e fshatrave;
- OJF, drejtues fetarë, biznese;
- Media tradicionale & sociale;
- Qytetarët e thjeshtë;
- Kryqi i Kuq Shqiptar, Caritas;
- Qendra Kombëtare Operacionale e EC në AKMC;
- Prefekti i Qarkut;
- Etj.

dhe, nëpërmjet tyre, tek autoritetet e vetëqeverisjes vendore dhe ato qendrore. Detajet rreth situatës duhet të shpërndahen për të gjitha autoritetet përkatëse dhe të bëhen të disponueshme

për të gjitha institucionet, strukturat dhe publikun e gjerë në të gjithë territorin e prekur. Për këtë qëllim shfrytëzohen të gjitha mundësitë e komunikimit dhe kapacitetet që ekzistojnë në strukturat shtetërore dhe joshtetërore. Pas marrjes së njoftimit, bashkia duhet të ketë si përparësi përcjelljen e informacionit tek Prefekti i qarkut dhe në raste të veçanta, kur konsiderohet e domosdoshme apo i kërkohet, edhe tek QKOE.

Në rastin kur QKOE-ja e informon bashkinë rreth një fatkeqësie, kjo e fundit informon autoritetet përkatëse në bashki dhe/ose Prefekturë, dhe kërkon prej tyre verifikimin e këtij informacioni.

FIGURA 9. Mënyrat e ndryshme të grumbullimit të informacionit në bashki





FIGURA 10. Komunikimi operacional në nivelin vendor



Informacioni dhe komunikimi për popullsinë

Informimi i publikut është element thelbësor i njoftimit të hershëm, parapërgatitjes dhe këshillimit të komunitetit. Informimi i publikut mund të luajë rol të rëndësishëm në shpëtimin e jetës së njerëzve dhe pasurisë së tyre në raste emergjencash civile. Qartësia, korrektësia dhe shpejtësia e dhënies së informacionit është mjaft e rëndësishme në raste të emergjencave civile, e cila sigurohet në nivel qendror nëpërmjet njoftimeve periodike të QKOEK-së, QOEQ dhe QOEB (sektorëve përkatës të informacionit), dhe njëkohësisht nga autoritetet e drejtimit të operacioneve në nivele të ndryshme.

Në lidhje me komunikimin, informacionin dhe procedurat e raportimit, referojuni gjithashtu seksionit 4.2. “Funksionet dhe Menaxhimi i Qendrës Operacionale të Emergjencës (QOE) në Bashki”, seksionit 6.1.6 “Paralajmërime të hershme dhe informacione publike për emergjencat, këshillimi i publikut” dhe seksionit 6.1.17 “Informimi i publikut për situatën / edukimin shëndetësor (marrëdhëniet me publikun dhe mediat)”.

6.1.13. Shërbimet e Ndhmës Sociale, mbështetja psikosociale / zvogëlimi i panikut

Mbështetja psikosociale është një pjesë integrale e përgjigjes emergjente dhe përbën një nga aspektet shumë të rëndësishme të saj. Ajo ndihmon individët dhe komunitetet të shërojnë plagët psikologjike dhe të rindërtojnë strukturat sociale. Mbështetja psikosociale ka për qëllim si popullatën e prekur nga ngjarja ashtu edhe FO dhe strukturat e tjera të angazhuara në parandalimin apo përballimin e fatkeqësisë.

Aktivitetet e funksionit “Mbështetje psiko-sociale” përfshijnë:

- Zbulimin dhe vlerësimin e nevojave psikologjike dhe sociale të popullatës së prekur;
- Ndhmën e parë psikologjike për njerëzit e përfshirë;
- Zhvillimin dhe organizimin e ndihmave për menaxhimin e aspekteve psikologjike të lidhura me rikuperimin dhe administrimin e kufomave;
- Menaxhimin e shtresave më të dobëta të popullatës, të dëmtuara dhe të vendosura në kampingje;
- Vendosjen, kur është e nevojshme, të strukturave në terren (poste të avancuara psikologjike) për të mbështetur ose zëvendësuar rojet ekzistuese;
- Restaurimin e ndihmës psikologjike themelore dhe të specializuar;
- Monitorimin e stresit dhe niveleve të mirëqenies psikologjike në qendrat e pritjes;
- Promovimin e zgjidhjeve organizative dhe dinamikën e favorshme për ruajtjen e shëndetit mendor kolektiv;
- Promovimin e kushteve fizike (ushqimi, pushimi etj.) që mund të ndikojnë në shëndetin personal dhe kolektiv mendor;
- Aktivizimin e ndërhyrjeve të specializuara në kohë në rastet e krizave akute emocionale;
- Kujdesin në komunikimin e lajmeve të këqija;
- Monitorimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Mbështetja e hershme dhe e duhur psikosociale mund të:

- Parandalojë që shqetësimi dhe vuajtjet të shndërrohen në diçka më të rëndë;
- Ndhmojnë njerëzit të përballen më mirë dhe të ambientohen me jetën e përditshme;
- Ndhmojnë përfituesit e kësaj asistence që të rifillojnë jetën e tyre normale;
- Plotësojnë nevojat e identifikuara nga komuniteti;

Kujdes i veçantë i duhet kushtuar PAK të cilët nuk duhet të vuajnë nga nivele më të larta të riskut pas fatkeqësisë sesa pjesa tjetër e komunitetit të prekur.

Drejtoria e Shërbimit Social në Bashki ka rolin kryesor në këtë funksion, e cila për vlerësimin e këtyre nevojave punon në lidhje të ngushtë me Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor. Në kampingje dhe në shkolla angazhohen psikologët që i vijnë në ndihmë nxënësve në raste emergjente. Shërbimet e Ndhmës Sociale në emergjenca asistohen nga SRL, DRAP, KKSH, Caritas, World Vision dhe OJF të tjera.

6.1.14. Bashkimet familjare

Kur ndodh një fatkeqësi me një numër të madh viktimash ose lëndimesh, individë të panjohur, dëme në infrastrukturën e komunikimit dhe evakuime etj., niveli vendor mund të mbingarkohet shpejt me kërkesa nga të dashurit e interesuar. Në këto raste ndodh shpesh që familjarët apo të afërmit të ndahen e të humbasin lidhjet me njëri tjetrin e si rrjedhim del e nevojshme rivendosja e lidhjeve familjare. Shërbimet e ribashkimit ofrojnë ndihmë për fëmijët e ndarë nga prindi/kujdestari ligjor i tyre, si dhe të rriturit nga familjet e tyre, për shkak të fatkeqësisë si edhe mbështesin përpjekjet e ribashkimit në nivelin vendor apo më gjerë me asistencë teknike.

Shërbimet e ribashkimit përbushin nevojat e ribashkimit afatshkurtër të atyre që preken direkt nga fatkeqësia. Shërbimet përfshijnë sigurimin për individët, të burimeve njerëzore dhe teknologjike për t'u lidhur përsëri duke lehtësuar komunikimin nga brenda zonës së prekur nga fatkeqësia me atë jashtë zonës së prekur. Ndhimja shpesh ofrohet për individët me një nevojë emergjente.

Procedurat e ndjekura gjatë ribashkimit ndjekin parimet e mëposhtme

- Kërkesat për asistencë emergjente dhe kërkesat për bashkim familjar marrin përparësinë më të lartë;
- Ndjekja/gjurmimi ndodh gjithnjë me kërkesat e asistencës emergjente dhe kërkesat e bashkimit familjar;
- Të miturit e pashoqëruar dhe fëmijët e ndarë mbahen të sigurt dhe u sigurohet transferim i shpejtë ose ribashkimi përmes punës me partnerët përkatës;
- Informacioni i klientit mbrohet;
- Informacioni i dhënë duhet të jetë i saktë;

Strukturat e PSH të mbështetura nga bashkia, Prefekti i qarkut dhe KKSH do të luajnë rolin kryesor në këtë funksion mbështetës të emergjencës. Një rol të rëndësishëm në ribashkimet familjare, krahas strukturave të bashkisë do të luajë Spitali Rajonal Lezhë, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, sikurse edhe media.

6.1.15. Qendrat Operacionale të emergjencës

QOE¹⁷ në bashki koordinon, lehtëson dhe menaxhon informacionin, drejtimin e politikave dhe burimet për të mbështetur autoritetet vendore dhe agjencitë e tjera në përgjigjen ndaj një emergjence.

Sipas PKEC-së:

- QKOEÇ përbëhet nga sektorët e informacionit, planifikimit, operacional dhe logjistik;
- QOE në nivel qarku përbëhet nga sektorët e planifikimit, operacional dhe logjistik;
- QOE në bashki përbëhet nga sektorët operacionalë dhe logjistikë¹⁸.

17 Sipas bazës ligjore në zbatim të ligjit 8756, datë 26.03.2001 "Për emergjencat civile, i ndryshuar, QOE-të janë detyrim ligjor në nivel qendror, qarku dhe nivel bashkie. Roli i tyre përcaktohet në dokumentin e PKEC.

18 Nuk ka ndonjë shpjegim në PKEC përse në QOE në bashki nuk ekziston sektori i Planifikimit. Në kushtet e reja kur kompetencat e bashkive janë rritur, një sektor i tillë do të ishte i nevojshëm, veçanërisht në një emergjencë madhore që do të prekte vetëm territorin e bashkisë Lezhë.

Specifikime të mëtejshme për QOE-në në bashki dhe postë komandën mobile gjenden në seksionin 4.2. "Funkcionet dhe menaxhimi i QOE-së në Bashki".

Në territorin e bashkisë mund të ngrihen edhe QOE të forcave operacionale me të cilat QOE-ja duhet të sigurojë komunikim të vazhdueshëm (Policia, SHU).

6.1.16. Sigurimi dhe rivendosja në funksion e infrastrukturës publike dhe kritike (ujë, rrugë, energji elektrike, kanalizime, qendra publike, shkolla etj.)

Fatkeqësitë mund të dëmtojnë ose të shkatërrojnë infrastrukturën publike dhe kritike, p.sh., rrjetin rrugor, ujësjellësit, kanalizimet, rrjetin elektrik, telekomunikacionet etj., gjë që do të ketë efekte negative për funksionimin ekonomik e social të komunitetit.

Aftësia për t'u rimëkëmbur nga një ndërprerje ose humbje e tillë është thelbësore për rimëkëmbjen e përgjithshme, dhe varet nga një përpjekje e koordinuar dhe gjithëpërfshirëse për të vlerësuar ndikimin, priorizuar restaurimin e infrastrukturës dhe fillimin e proceseve të rindërtimit. Në punimet emergjente për riparimin dhe rimëkëmbjen e infrastrukturës publike dhe kritike, në rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, do të zbatohen në mënyrë të veçantë përcaktimet e Ligjit nr. 97/2019 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore".

Bashkia në bashkëpunim me Prefektin e qarkut do të punojë me ofruesit e shërbimeve komunale për të mbrojtur, për të menaxhuar dhe për të riparuar infrastrukturën publike gjatë emergjencave dhe fatkeqësive.

Strukturat kryesore të evidentuara në nivel bashkie me përgjegjësi në fushën e rehabilitimit të infrastrukturës publike dhe asaj kritike si edhe për punime rimëkëmbje të saj janë:

- Drejtoria e Emergjencave Civile;
- Drejtoria e Planifikimit të Territorit;
- Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve;
- Drejtoria e Shërbimeve Publike, Njësia e Mirëmbajtjes së Institucioneve;
- Drejtoria e Bujqësisë, Njësia e Bujqësisë, Ujit, Kullimit dhe Transportet specifike;
- Drejtoria e Bujqësisë, Njësia e Administrimit të Pyjeve;
- Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor;
- Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.

Sipas fushës së infrastrukturës publike dhe kritike, strukturat kryesore përgjegjëse janë përkatësisht:

- Për energjinë elektrike: Dega Lezhë e Drejtorisë së OSHEE Shkodër, Dega Lezhë e Drejtorisë së OST Shkodër;
- Për ujin e pijshëm dhe kanalizimet: Sh.A.Ujësjellës Kanalizime;
- Për shëndetësinë: Spitali Rajonal Lezhë, Drejtoria Vendore e Kujdesit Shëndetësor Lezhë, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Lezhë të mbështetur nga Caritas, World Vision dhe kompani private;
- Për arsimin: Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar/ZVAP dhe Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar/DRAP;
- Për mjedisin: Agjencia Rajonale e Mjedisit dhe Inspektorati Kombëtar i Mjedisit dhe Territorit;
- Për rrjetin rrugor kombëtar: Drejtoria Rajonale e Autoritetit Rrugor shqiptar Shkodër;
- Për shërbimet portuale: Porti Shëngjin dhe Kapitaneria e Portit;
- Për pritat malore, Drejtoria e Bujqësisë, Njësia e Administrimit të Pyjeve, Bashki;

- Për infrastrukturën e Ujitjes: Drejtoria e Bujqësisë, Njësia e Bujqësisë, Ujit, Kullimit dhe Transportet specifike dhe Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë;
- Për kanalet parësorë, argjinaturat dhe hidrovorët - Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë;
- Për rezervuarët, kolektorët, kanalet dytësorë dhe tretësorë është Drejtoria e Bujqësisë, Njësia e Bujqësisë, Ujit, Kullimit dhe Transportet specifike;
- Më hollësisht për kapacitetet dhe përgjegjësitë në sektorin e ujitjes dhe kullimit duhet referuar tek VKM nr.1108, datë 30.12.2015 "Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit" dhe tek VKM Nr.567, datë 14.7.2010 "Për transferimin e rezervuarëve dhe skemave ujitëse përkatëse nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore dhe për një ndryshim në vendimin nr.1157, datë 25.11.2009 të KM "për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të bordeve të kullimit, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit"
- Furnizimi me ujë dhe KUZ janë përgjegjësi e SH.A Ujësjellës Kanalizime në bashkinë Lezhë. Shoqëria disponon të gjitha kapacitetet për furnizimin e vazhdueshëm të popullsisë me ujë. Në rast fatkeqësish të mëdha ajo do të jetë në gjendje që kryesisht me kapacitetet e saj të sigurojë dhe riparimin e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm por edhe funksionimin normal të rrjetit të KUZ. Sigurimi i burimeve alternative me ujë duke përfshirë furnizimin me autobote dhe ujë të ambalazhuar është përgjegjësi e bashkisë dhe SH.A Ujësjellës Kanalizime;
- Riparimet e sistemit të furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe sigurimi i burimeve alternative të energjisë janë përgjegjësi e Degës Lezhë të Drejtorisë së OSHEE Shkodër dhe Degës Lezhë të Drejtorisë së OST Shkodër, të cilat e realizojnë nëpërmjet aktivizimit të grupeve të përgjigjes së menjëhershme për transmetimin e energjisë dhe bashkëpunimin me organet e pushtetit vendor;
- Rrjeti rrugor kombëtar është përgjegjësi e Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Rrugor shqiptar Shkodër;
- Ndërsa për rrjetin rrugor nën administrimin e bashkisë, është përgjegjëse kjo e fundit nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Njësia e Mirëmbajtjes së Institucioneve.

Bashkia duhet të jetë në kontakt të ngushtë me Prefektin e qarkut në lidhje me shkarkimet që vijnë nga Hidrocentrali Shkopet dhe të cilat mund të shkaktojnë përmbajtje nga lumi Mat sikurse për shkarkimet që mund të vijnë nga Hidrocentrali i Vaut të Dejës në një situatë tejet të jashtëzakonshme. Në kapacitetet e përgjithshme që do të mund të përdoren në punimet për rivendosjen në funksion të infrastrukturës publike dhe asaj kritike janë edhe ato të biznesit privat.

6.1.17. Informimi i publikut për situatën/edukimin shëndetësor (marrëdhëniet me publikun dhe mediat)

Koordinimi në dhënien e informacionit

Është në interes të bashkisë të përcaktojë dhe të krijojë udhëzimet e saj në lidhje me marrëdhëniet me median gjatë menaxhimit të emergjencës. Për këtë, bashkia duhet të zhvillojë një plan për menaxhimin e ndërveprimit me median dhe ta përfshijë atë si një aneks të këtij plani. Një përmbledhje e këtij plani përfshihet më poshtë.

Bashkia Lezhë ka stafin e saj që siguron këshillat strategjike për komunikimin, menaxhimin e çështjeve të ndryshme dhe mbështetjen në marrëdhëniet me median, sikurse detyra të tjera të komunikimit, siç kërkohen gjatë gjithë vitit. Bashkia siguron trajnimin e duhur të tyre për të qenë të gatshëm për t'iu përgjigjur siç kërkohet menaxhimit të situatave emergjente, kur kërkohet mbështetje e informacionit publik.

Ekzistojnë dy aspekte kryesore të përfshirjes së medias në emergjencë:

- Nevoja e bashkisë dhe organizatave të tjera për të komunikuar me publikun në mënyrë që të japin këshilla për sigurinë, të ofrojnë informacion mbi emergjencën dhe të reklamojnë disponueshmërinë e përgjigjes ose të shërbimeve mbështetëse. Media, interneti dhe rrjetet e mediave sociale do të jenë të gjitha mjete të vlefshme për një komunikim të tillë;
- Nevojat e mediave për informacion, shpjegime, material vizual, komente dhe analiza. Ndërburimet që ata do të përdorin për këtë janë shërbimet e emergjencës.

Në emergjencë është i rëndësishëm fakti sesi media do të përdoret për të marrë informacion thelbësor për publikun dhe se si bashkia do t'u përgjigjet kërkesave të mediave për informacion, intervista dhe analiza.

Bashkia duhet të ketë sisteme dhe procese për të përfshirë median në mënyrë efektive. Të dyja mediat, si ajo tradicionale dhe ato jo-tradicionale (d.m.th., rrjetet e mediave sociale) luajnë një rol kritik në fazën e përgjigjes. Ato mund të ndihmojnë në mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit dhe në paralajmërimin e publikut/palëve të interesuara për ndryshimin e kushteve dhe veprimeve që duhet të ndërmarrin (p.sh., evakuimi). Ato gjithashtu mund të japin indikacione mbi llojin e informacionit që publiku/palët e interesit duhet dhe presin. Monitorimi i vazhdueshëm i mediave është i nevojshëm për të siguruar që informacioni po shpërndahet saktë për publikun.

Përdorimi efektiv i mediave

Gjatë menaxhimit të emergjencave, informacioni i saktë duhet të shpërndahet në një mënyrë të qëndrueshme, të koordinuar dhe të arritshme dhe në kohë. Në rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, dhënia e informacionit për publikun do të kryhet sipas udhëzimeve që do të merren nga DQO dhe që në bashki do të zbatohen nëpërmjet DOB i cili zbaton vendimet e KMC në bashki.

Në rastet e emergjencave civile vendore, që mund të përballohen me anë të veprimeve të strukturave kompetente të bashkisë, KMC në bashki, koordinon informacionin e emergjencës së dhënë nga institucionet dhe strukturat vendore dhe ato qendrore në nivelin e bashkisë, aktorët e tjerë dhe integrimin e të dhënave në një tërësi kohezive.

Roli i internetit dhe mediave sociale në komunikimin dhe menaxhimin e informacionit gjatë emergjencave/fatkeqësive po zgjerohet shpejt. Ato janë një burim gjithnjë e më i rëndësishëm i informacionit në raste emergjente dhe lejojnë bashkinë të japë informacione të përditësuara direkt tek audienat. Përmes kësaj teknologjie, informacioni në kohë reale mund të merret dhe të ofrohet shumë shpejt për një audiencë të gjerë. Së bashku me këto përfitime të mundshme, ekzistojnë edhe disa sfida. Për shembull, informacioni i pakonfirmuar ose i pasaktë gjithashtu mund të përhapet me shpejtësi përmes mediave sociale. Duke u angazhuar me të gjitha format e mediave, bashkia do të duhet të mbajë parasysh këto udhëzime:

- Të mbajë marrëdhënie të mira pune të përditshme me përfaqësuesit e mediave lokale;
- Të ketë në dispozicion një paketë të përditësuar informacioni mbi bashkinë dhe punën e saj për ta shpërndarë si një përgjigje të parë ndaj mediave. Të jetë vigjilente për saktësinë e informacionit dhe çdo gabim i mundshëm të korrigjohet në mënyrë të qartë dhe të shpejtë;
- Të sigurohet që informacioni i dhënë medias të jetë i koordinuar me organizatat e tjera. Duhet kujdes në lidhje me lëshimin e informacioneve të cilat organizatat e tjera mund të kenë arsye të vlefshme për mos t'i bërë publike;
- Të përdoret media për të përhapur mesazhin e bashkisë, por mos prisni që ato ta pranojnë atë që thoni pa e provuar dhe sfiduar atë;
- Të merret parasysh integriteti i burimit nga i cili merren informacionet;

- Të mblidhen dhe t'i paraqiten medias vetëm fakte. (Kush? Çfarë? Ku? Sa? Kur? Si? Çfarë duhet bërë më tej?);
- T'u jepet përgjigje çështjeve në kohën e duhur, pavarësisht nga madhësia, fushëveprimi ose shkalla;
- Të konsiderohet media sociale si një mjet në një tërësi mjetesh komunikimi. Shko "off line", duke adresuar çështjet përmes rrugëve të tjera, kur është e mundur;
- Të mos spekulohet dhe të mos paraqiten kurrë informacione të pavërteta. Nëse nuk disponohet informacioni i plotë për diçka, thuhet e vërteta dhe premtohet se do të komunikohet përsëri me mediat sa më shpejt që të jetë e mundur. Më pas, do të sigurohet që kjo gjë të kryhet patjetër;
- Bashkia të përpiket që të jetë ajo e para që ta japë lajmin edhe nëse ka vetëm lajme të këqija për të raportuar, duke qenë se mediat, gjithsesi, do të informohen nga një burim tjetër;
- Komunikimi të kryhet shpejt, në mënyrë pozitive dhe me saktësi. Duhet të kuptohet se përfaqësuesit e mediave private kanë përgjegjësi të sigurojnë informacion të besueshëm për ndjekësit e tyre dhe ata do ta marrin këtë informacion edhe nëse bashkia bashkëpunon me ta ose jo. Bashkia duhet të jetë një nga burimet e besueshme të informacionit për mediat gjatë periudhës së menaxhimit të fatkeqësisë;
- Në të kaluarën, urgjenca në sigurimin e materialit për media varej nga afërsia me orët kryesore të buletinit të lajmeve ose oraret e shtypjes së medias së shkruar. Me kanalet aktuale të posaçme të lajmeve dhe mbulimin 24 orë nga ana e tyre, nuk ka më luks të thuash se diçka do të jetë në dispozicion me kohë për buletin e mesditës ose të mbrëmjes. Kjo rrit presionin mbi bashkinë për të gjeneruar një rrjedhë të vazhdueshme informacioni dhe për të monitoruar mediat për ndonjë përgjigje të nevojshme ose për sqarimin e ndonjë keqinterpretimi. Ekziston gjithashtu konkurrencë e rritur midis organizatave mediatike për ndarjen e audiencës, dhe si rrjedhim për informacionin më të fundit, fotografitë dhe intervistat më të mira. Kjo, sërisht, ndikon në rritjen e presionit ndaj zyrtarëve të medias të cilëve u duhet të shfaqen se po merren me drejtësi dhe me paanësi me të gjitha organizatat e medias;
- Nuk i hidhet faji askujt nëse diçka nuk shkon ashtu siç duhet gjatë emergjencës. Më tej, në interes të bashkëpunimit dhe të zgjidhjes së problemit, media duhet të sigurohet duke i thënë: "Me gjithë vështirësitë e mëdha, të gjitha përpjekjet tona po synojnë marrjen nën kontroll të situatës së fatkeqësisë";
- Nuk duhen bërë komente për situata të supozuara, për performanca të dyshimta ose kritike të një organizate tjetër ose të spekulohet mbi shkaqet dhe motivet. Intervistat duhet të kontrollohen dhe të shmangen pyetjet e qëllimshme dhe negative duke iu kthyer paraqitjes së informacionit, fakteve dhe mesazhit që bashkia do të dëshironte të përcillte tek publiku.

Për rolin e medias të shihet edhe seksioni 4.2 "Funksionet dhe Menaxhimi i Qendrës Operacionale të Emergjencës (QOE) në Bashki".

6.1.18. Logjistika (transporti dhe magazinimi etj)

Logjistika integron planifikimin dhe mbështetjen logjistike të gjithë incidenteve të komunitetit në bashki, për shpërndarjen në kohë dhe efikase të furnizimeve, pajisjeve, shërbimeve dhe lehtësive të tjera. Ajo gjithashtu lehtëson planifikimin gjithëpërfshirës të logjistikës, asistencës teknike, trajnimit, edukimit, ushtrimeve, reagimit ndaj incidenteve dhe mbështetjes që shfrytëzon aftësinë dhe burimet e aktorëve publikë dhe privatë në mbështetje të reaguesve dhe të mbijetuarve nga fatkeqësia.

Lehtësirat/pajisjet e transportit të emergjencës përfshijnë transportimin gjatë emergjencës të njerëzve, grupeve të kërkim-shpëtimit, artikujve të ndihmës, depozitave të ujit dhe naftës, evakuimit etj. Operacionet e përballimit të emergjencës kërkojnë transportimin e ndihmës humanitare, të personelit dhe të pajisjeve në vendin ku ka ndodhur fatkeqësia. Kështu, çështjet

e transportit dhe të magazinimit janë të rëndësishme për të përballuar me sukses fatkeqësitë. Kërkesat për transport dhe kapacitetet e disponuara, në rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, bashkërendohen në nivel kombëtar nga DQO.

MM ka rolin drejtues në sigurimin e mjeteve të transportit, qofshin këto në varësi të drejtorive vartëse të saj si DPRMSH, sektorit privat etj. Bashkia mban inventarë të vazhdueshme dhe të përditësuar të kapaciteteve të disponuara nën juridiksionin e saj, duke përfshirë dhe ato të sektorit privat. FA, PSH, MZSH dhe SHU i përballojnë me automjetet e tyre nevojat për transport të efektivave të tyre sikurse sigurojnë shërbime të tjera transporti në mbështetje të përgjigjes emergjente.

Në rastet e emergjencave vendore, nevojat për shërbime transporti dhe magazinimi përballohen përgjithësisht nga kapacitetet e vetë bashkisë. Kur bashkia nuk i disponon kapacitetet e nevojshme, ajo i drejtohet Prefektit të qarkut për koordinimin e vënies në dispozicion të kapaciteteve shtesë nga degët territoriale të institucioneve në qark. Bashkia mund të kërkojë, në koordinim me Prefektin, nëse çmohet e domosdoshme, edhe vënien në dispozicion të kapaciteteve të caktuara të subjekteve private apo OJF-ve sipas deklarimeve të tyre të marra zyrtarisht në periudhën para fatkeqësisë.

Lehtësirat e Transportit Ndërkombëtar për Emergjencat (Ajri dhe Deti)

Në rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, aktivitetet në përgjigje të emergjencës të cilat kërkojnë përdorimin e lehtësirave portuale dhe aeroportuale bashkërendohen nga DQO. Mbështetje gjithashtu sigurohet edhe nga MPJ, MM, MB (PSH), Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave) dhe të kontraktuarit nga sektori privat. DOQ dhe DOB koordinojnë veprimtaritë e nevojshme për transportin dhe magazinimin.

Përtej kapaciteteve të strukturave të Bashkisë, kapacitete të evidentuara për transportin dhe magazinimin sigurohen nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, Drejtoria Rajonale e Autoritetit Rrugor Shqiptar – Shkodër, Baza Ushtarake Detare në Shëngjin, Baza Ushtarake Detare Gjadër, World Vision dhe biznesi privat. Kapacitetet logjistike shtetërore dhe ato joshtetërore gjenden në seksionin 9.2 “Inventari institucional dhe i burimeve njerëzore”. Në rastet e emergjencave vendore dhe rajonale, kapacitetet logjistike (transporti dhe magazinimi) sigurohen në radhë të parë nga burimet e bashkisë. Hap pas hapi, në varësi të shkallës së emergjencës, në koordinim me Prefektin e qarkut, kërkohet edhe mbështetja nga kapacitetet në nivel qarku dhe ato të subjekteve private.

6.1.19. Menaxhimi i të dëmtuarve/viktimave në masë

Në kuptimin e këtij plani, një emergjencë me viktimë në masë do të konsiderohej një incident apo një seri incidentesh që do të shkaktonte qindra ose mijëra viktimë me një sërë dëmtimesh, që është përtej burimeve normale të kapaciteteve të shërbimeve të emergjencës dhe atyre të kujdesit shëndetësor për ti menaxhuar ato sikurse do të kërkojë masa të mëtejshme për të trajtuar në mënyrën e duhur numrat e viktimave. Emergjencia të tilla mund të jenë të papritura dhe me zhvillim të menjëhershëm ose nga sëmundje infektive si gripit pandemik.

Mungesa e trajtimit të duhur të trupave të vdekur mund të rezultojë në rreziqe shëndetësore për komunitetin, si në nivelin fizik ashtu edhe në atë psikologjik. Trupat e vdekur përmbajnë në vetvete rrezik minimal fizik të transmetimit të sëmundjes për të mbijetuarit dhe reaguesit, por ato mund të tërheqin faktorë mbartës dhe biologjikë që mund të shkaktojnë sëmundje veçmas.

Dështimi për të menaxhuar nevojat kulturore vendore për asgjësimin e trupave do të ngadalësonte rimëkëmbjen ndaj fatkeqësisë. Identifikimi i trupit është i rëndësishëm nëse burimet e lejojnë, pasi kjo mund t’ua lehtësonte sadopak dhimbjen e madhe anëtarëve të familjes.

Emergjencat të tilla shoqërohen normalisht me shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore prandaj edhe menaxhimi i tyre kryhet nga KNEC. Menaxhimi i viktimave dhe të dëmtuarve në masë në momentet e para drejtohet nga strukturat e para reaguese (MZSH, SHU, FA, PSH), të cilat janë zakonisht forcat operacionale më të afërta në vendin e ngjarjes. Në varësi të vendit, triazhi (ndihma e shpejtë) dhe ndihma e parë kryhet nga struktura të shërbimit Shëndetësor Parësor të NJ.V.K.SH, të mbështetura nga MM, PSH, MZSH, KKSH, SRL dhe vullnetarë nga sektori privat.

Evakuimi i të dëmtuarve për në shërbimin dytësor dhe tretësor është përgjegjësi e NJ.V.K.SH në bashkëpunim me Strukturat e Policisë, FA në nivel Prefekturë dhe të bashkive. Kapacitetet përforcohen dhe nga forcat speciale të MM, nëpërmjet grupeve të shpëtimit, evakuimit, urgjencës dhe KKSH. Për identifikimin dhe menaxhimin e viktimave në masë, në nivelin e bashkisë do të jenë përgjegjëse strukturat e Bashkisë, PSH dhe NJ.V.K.SH.

6.1.20. Mbrojtja dhe shpëtimi i bimëve dhe produkteve bimore

Ka të bëjë me zbatimin e një përgjigje të integruar vendore dhe qendrore ndaj incidenteve të rënda që kërcënojnë shëndetin e bimëve ose njerëzve të ekspozuar ndaj tyre dhe sigurimin e ekspertizës teknike në mbështetje të menaxhimit të emergjencës bujqësore. Struktura të bashkisë me përgjegjësi specifike në këtë funksion janë Drejtoria e Bujqësisë, Njësia e Administrimit të Pyjeve dhe Drejtoria e Bujqësisë, Njësia e Bujqësisë, Ujit, Kullimit dhe Transportet specifike, Bashki.

Degët territoriale të cilat do të japin kontribut në këtë funksion në nivelin lokal do të jenë:

- Agjencia Rajonale e Mjedisit;
- Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
- Sektori i Ekstensionit Bujqësor Lezhë;
- Drejtoria e Ujit dhe Kullimit;
- Administrata e Zonave të Mbrojtura Qarku Lezhë;
- Sektori Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Lezhë;
- Baza Ushtarake Detare Shëngjin dhe Porti Shëngjin.

6.1.21. Mbrojtja dhe shpëtimi i kafshëve dhe ushqimit të tyre

Ka të bëjë me sigurimin e shëndetit, sigurinë e bagëtive dhe prodhuesve të ushqimit të kafshëve dhe të vetë ushqimit të kafshëve, si dhe sigurinë e prodhimit dhe shpërndarjes së ushqimeve, ilaçeve dhe terapive të dhëna për bagëtitë. Kafshët shtëpiake dhe kafshët e shërbimit: Koordinon dhe siguron shpëtimin, transportin, strehimin, ribashkimin, kujdesin dhe nevojat thelbësore të kafshëve shtëpiake dhe kafshëve të shërbimit gjatë operacioneve të përgjigjes për të siguruar sigurinë dhe mirëqenien e tyre. Kafshët e shërbimit nuk janë kafshë shtëpiake dhe nuk mund të ndahen nga individit me aftësi të kufizuara ose të përdoren për qëllime të tjera; kafshët e shërbimit duhet të lejohen kudo ku shkon publiku.

Struktura të bashkisë me përgjegjësi specifike në këtë funksion janë:

- Drejtoria e Bujqësisë, Njësia e Administrimit të Pyjeve;
- Drejtoria e Bujqësisë, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Njësia e Mirëmbajtjes së Institucioneve;
- Drejtoria e MZSH;
- Njësia e Bujqësisë, Ujit, Kullimit dhe Transportet specifike, Bashki.

Degët territoriale të cilat do të japin kontribut në këtë funksion në nivelin lokal do të jenë:

- Agjencia Rajonale e Mjedisit;
- Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;

- Sektori i Ekstensionit Bujqësor Lezhë;
- Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit;
- Administrata e Zonave të Mbrojtura Qarku Lezhë;
- Sektori Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Lezhë;
- Baza Ushtarake Detare Shëngjin;
- Porti Shëngjin.

6.1.22. Menaxhimi i asistencës ndërkombëtare (procedurat e Mbështetjes së Vendit Pritës/HNS)

Autoriteti përgjegjës për koordinimin e Mbështetjes së Vendit Pritës/HNS, në rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, është Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, ndërsa në rastet e tjera është AKMC-ja¹⁹.

Në rastin e parë, transporti dhe shpërndarja e artikujve të asistencës ndërkombëtare në nivel kombëtar bashkërendohet nga DQO dhe në nivel vendor nga Prefekti i qarkut dhe bashkia, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e MSHMS (për ndihmën në ilaçe), vullnetarët e KKSH në nivel kombëtar dhe vendor dhe kontraktorët.

Rolin kryesor në shpërndarjen e asistencës ndërkombëtare, prej strukturave të bashkisë e luan KMC, ndërsa në nivel qarku është Prefekti i qarkut²⁰. Struktura të tjera bashkiake me rol në këtë funksion janë Drejtoria e Integritimit Evropian, Komunikimit dhe Transparencës, Drejtoria e Emergjencave Civile, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Njësia e Mirëmbajtjes së Institucioneve dhe Drejtoria e MZSH në bashki.

Nga degët territoriale, role në shpërndarjen e asistencës ndërkombëtare kanë Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Shërbimi Doganor Shëngjin - Dega Doganore Lezhë, Komisariati i Policisë Lezhë, Porti Shëngjin dhe Kapitaneria e Portit Shëngjin.

6.4. RIMËKËMBJA²¹

Rimëkëmbja është faza e menaxhimit të emergjencës në të cilën implementohen/ndërmerren hapat dhe proceset për:

- Riparimin e komuniteteve të prekura nga një fatkeqësi;
- Rikthimin e kushteve në një nivel të pranueshëm ose, kur është e mundur, përmirësimi i tyre;
- Rivendosja e vetë-mjaftueshmërisë dhe rritja e aftësisë ripërtëritëse tek individët, familjet, organizatat dhe komunitetet.

19 Sipas pikës 4 të nenit 54 të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"

20 Sipas pikës 2 f të nenit 28 të ligjit 45/2019, "Prefekti koordinon shpërndarjen e asistencës ndërkombëtare në rastet e fatkeqësive në nivel qarku"

21 Sipas nenit 3 të ligjit 45/2019: "Rimëkëmbja" është rivendosja ose përmirësimi i mjeteve të jetesës dhe të shëndetit, asetëve ekonomike, fizike, shoqërore, kulturore dhe mjedisore, sistemeve dhe aktiviteteve të një komuniteti ose shoqërie të prekur nga fatkeqësitë, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe konceptit "rindërto më mirë", për të shmangur ose zvogëluar riskun e fatkeqësive të ardhshme.

TABELA 5. Fazat e rimëkëmbjes dhe karakteristikat

Fazat e rimëkëmbjes	Karakteristikat
Afatshkurtër (p.sh., ditë deri në javë pas emergjencës/fatkeqësisë)	<p>Kjo fazë fillon njëkohësisht me fillimin e veprimtarisë së përgjigjes.</p> <p>Fokusi është në sigurimin e ofritit të vazhdueshëm të nevojave themelore të njeriut dhe shërbimeve kryesore mbështetëse.</p> <p>Ndërsa përparon emergjenca, ndërmerren hapa drejt rimëkëmbjes dhe vendosen objektivat e planifikimit. Rivendosja e funksioneve themelore të shoqërisë varet nga sa shpejt fillojnë aktivitetet dhe planet e rimëkëmbjes.</p> <p>Kalimi nga përgjigja në rimëkëmbje fillon para përfundimit të fazës së përgjigjes. Si rezultat, do të ketë një periudhë aktivitetesh të mbivendosura gjatë së cilës njerëzit dhe grupet më të prekura nga emergjenca përqendrohen në veprimtaritë e përgjigjes ndërsa ata më pak të prekur mund të kalojnë në aktivitete restauruese dhe aktivitete të tjera të rimëkëmbjes. (Kohëzgjatja dhe koha e mbivendosjes varet nga lloji dhe ashpërsia e dëmit të shkaktuar)</p>
Afatmesme (p.sh., javë deri në muaj)	<p>Në këtë fazë, veprimtaritë e përgjigjes ndaj emergjencave kanë përfunduar ose do të përfundojnë së shpejti, dhe ka lëvizje drejt aktiviteteve të drejtuara posaçërisht për rimëkëmbje. Ka një përfshirje më të madhe të organizatave jofitimprurëse, siguruesve, institucioneve financiare dhe grupeve vullnetare.</p> <p>Fokusi është në rivendosjen e lëvizjes së mallrave dhe shërbimeve, rifillimin e funksioneve ekonomike dhe të biznesit, dhe ndërmarrjen e rehabilitimit mjedisor</p>
Afatgjatë (p.sh. muaj deri në vite)	<p>Kjo fazë përfshin përpjekje të vazhdueshme për t'iu përshtatur "normales së re", e cila mund të përfshijë zëvendësimin, rindërtimin ose përmirësimin e asaj që u prek ose humbi në emergjencë. Adresohen çështjet financiare, politike dhe mjedisore dhe përpjekjet drejtohen drejt rehabilitimit ose përmirësimit të jetesës së komuniteteve të prekura nga fatkeqësia.</p> <p>Fokusi është në zvogëlimin e riskut përmes ndryshimeve në kodet e ndërtimit dhe përcaktimet e përdorimit të tokës (kalimi në zbutje/lehtësim), ndërtimi i banesave dhe objekteve të përhershme, rifillimi i biznesit dhe shëndetit mendor afatgjatë dhe shërbimeve mbështetëse sociale për individët.</p> <p>Objektivi është "të ndërtojmë më mirë" dhe të krijojmë komunitete të qëndrueshme</p>

Rimëkëmbja punon drejt minimizimit të dëmit në të ardhmen për komunitetet dhe mjedisin. Masat e rimëkëmbjes fillojnë sa më shpejt që të jetë e mundur, përgjithësisht pasi të jenë adresuar çështjet e sigurisë së jetës. Disa shembuj të masave të tilla janë:

- Strehimi i përkohshëm;
- Monitorimi i nevojave të kujdesit shëndetësor, përfshirë nevojat psikosociale, dhe ofrimi i vazhdueshëm i shërbimeve shëndetësore;
- Vlerësimi i ndikimit në mjedis;
- Rimëkëmbja ekonomike;
- Planifikimi dhe rindërtimi.

Faza e rimëkëmbjes mund të përfshijë, por nuk kufizohet në aktivitetet e mëposhtme:

Informacion dhe angazhim

Qëllimi i informacionit dhe angazhimit në fazën e rimëkëmbjes është të sigurojë që të gjithë sa janë të përfshirë të kenë informacionin e duhur për të kuptuar se çfarë ndodh gjatë kësaj faze dhe që ky informacion të vihet në dispozicion në një mënyrë të qëndrueshme, të saktë dhe transparente;

Menaxhimi financiar

Sigurimi është një mjet financiar që mbulon palën e siguruar për disa risqe në fatkeqësi. Pak individë ose biznese kanë rezervën e fondeve të nevojshme për të marrë përsipër vetë një risk

të tillë. Sigurimi i blerë ndihmon për të mbuluar kostot financiare që lidhen me lloje të caktuara të dëmit dhe rindërtimin pas një fatkeqësie;

Sigurimi i vazhdueshëm i shërbimeve kryesore (p.sh., kujdesi shëndetësor pas fatkeqësisë, akomodimi).

Kujdesi shëndetësor pas fatkeqësisë

Përprjekjet për rimëkëmbjen pas fatkeqësisë theksojnë mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit dhe mirëqenien e qytetarëve të prekur. Sistemi shëndetësor pritet të:

- Vazhdojë të ofrojë shërbime emergjente;
- Rivendosë shërbimet shëndetësore sa më shpejt të jetë e mundur;
- Plotësojë çdo rritje të kërkesës të krijuar nga fatkeqësia;
- Vazhdojë të vlerësojë nevojat psikosociale dhe të zhvillojë dhe zbatojë plane për adresimin e tyre;

Strehimi

Në lidhje me strehimin, qëllimi i rimëkëmbjes është që të sigurojë strehim të mjaftueshëm emergjent sa më afër zonës së prekur. Aftësia për të siguruar strehim gjatë fazës së rimëkëmbjes varet nga disponueshmëria e burimeve përkatëse të strehimit. Për më tepër në lidhje me strehimin, është sqaruar në seksionin 6.5.Strehimi (i përkohshëm)/akomodimi i përkohshëm gjatë emergjencës batanije, tenda, shtroje plastike, rroba).

Rimëkëmbja e biznesit

Biznesi dhe industria sigurojnë burime, ekspertizë dhe shërbime thelbësore (përfshirë infrastrukturën kritike) që u mundësojnë komuniteteve të funksionojnë. Prandaj, ato luajnë një rol themelor në rimëkëmbjen e një komuniteti. Por vetë bizneset kanë nevojat e tyre për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë, megjithatë, dhe qeveritë dhe komunitetet kanë një rol për të luajtur në mbështetjen e vazhdimësisë së biznesit dhe përpjekjeve të rimëkëmbjes. Qëllimi kryesor i këtyre përpjekjeve është të ndihmojnë sektorin privat në zbatimin e planeve të tyre të vazhdimësisë së biznesit në mënyrë që ata të mund të rifillojnë të funksionojnë në një kohë sa më të shpejtë që të jetë e mundur.


Rimëkëmbja e infrastrukturës kritike;

Çdo ndërprerje ose humbje që përfshin infrastrukturën kritike mund të ketë efekte dobësuese në komunitet. Aftësia për t'u rimëkëmbur nga një ndërprerje ose humbje e tillë është thelbësore për rimëkëmbjen e përgjithshme dhe varet nga një përpjekje e koordinuar dhe gjithëpërfshirëse për të vlerësuar ndikimin, për t'i dhënë përparësi restaurimit të infrastrukturës, hapjes së proceseve të fillimit të rindërtimit.

Menaxhimi i mbeturinave të fatkeqësisë.

Shkalla dhe ndikimi i mbeturinave të krijuara nga një fatkeqësi mund të mbingarkojë strukturat dhe burimet ekzistuese të mbetjeve të ngurta. Kur planifikohet për mbeturinat e fatkeqësive, duhet të merret parasysh edhe vazhdimi i shërbimeve të rregullta të mbetjeve të ngurta. Menaxhimi i mbeturinave gjithashtu ndikon në shpejtësinë e rimëkëmbjes fizike, sociale dhe ekonomike. Kur bëhet në mënyrë efektive, ndihmon në sigurimin e zbatimit të aktiviteteve të tjera të rimëkëmbjes, të tilla si rifillimi i shërbimeve (p.sh., shëndetësia, transporti, infrastruktura financiare dhe kritike), rifillimi i biznesit dhe përgjigja ndaj çështjeve psikosociale.

PARALAJMËRIMI I HERSHËM, MONITORIMI DHE ALARMI



Deri në momentin e përfundimit të këtij plani, nuk ekzistonte ndonjë rregullore kombëtare mbi paralajmërimin e hershëm, që do të përfshinte të gjitha fazat dhe procedurat standarde të operimit, për t'u shërbyer të gjitha strukturave dhe institucioneve të përfshira në rastet e emergjencave. Gjithashtu nuk ishte miratuar VKM mbi llojet e sinjaleve të alarmit, numrin dhe mënyrat e përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive²².

Referuar dokumentit “Udhëzuesi për Planifikimin e Emergjencave në nivel prefekturë - Projekti PRO NEWS”, por edhe përvojës italiane, sistemi i Mbrojtjes Civile aktivizohet gradualisht bazuar te Indikatorët e Kontekstit (IK), që rrjedhin nga parashikimet dhe buletinet hidrometeorologjike si edhe Indikatorët e Statusit (IS), që rrjedhin nga rrjeti i automatizuar i monitorimit dhe nga ekipet e vlerësimit që monitorojnë zonat në risk.

Referuar PKEC-së lëshimi i paralajmërimeve të hershme është përgjegjësi e përbashkët e institucioneve qendrore, Prefektit të qarkut dhe bashkisë dhe kanë lidhje drejtpërdrejt me aktivizimin e etapës 1, “Alarmi për rritjen e gatishmërisë” dhe etapës 2 “Gatishmëria”.

7.1. INDIKATORËT E KONTEKSTIT. BULETINI DITOR I IGJEUM

Fazat operacionale në nivel prefekturë aktivizohen në mënyrë sistematike bazuar në kriteret për parashikimet e ardhshme, përmes instrumenteve monitoruese dhe vëzhguese, të mbledhura nga ekipet e vlerësimit të shpërndara në të gjithë terrenin e bashkive. Fazat operacionale janë renditur në shkallë rritjeje, lidhur me impaktet e ngjarjes së parashikuar apo të vëzhguar, megjithatë në zhvillimin e tyre dinamik fazat mund të rezultojnë të parëndësishme.

Indikatorët e Kontekstit (IK) përbëhen kryesisht nga indikatorë të dhënë nga buletini ditor i IGJEUM që siguron vlerësimin e rrezikut hidrometeorologjik. Aktualisht IGJEUM publikon çdo ditë një buletin mbi rreziqet natyrore, i cili bën parashikimin e reshjeve 24-orëshe të shiut si më poshtë:

TABELA 6. Parashikimi i rreziqeve hidrometeorologjike, buletini ditor i IGJEUM

Niveli i Rrezikut	Reshje shiu (mm/24 orë)
S'ka Rrezik	Të dobëta (0 – 15 mm/24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike
I Ulët	Mesatare (15 – 45 mm/24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike
I Moderuar	Intensive (45 – 90 mm/24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike
I Lartë	Shumë intensive (> 90 mm/24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike mjaft intensive

²² Sipas pikës 4 të nenit 50 të ligjit 45/2019 “Llojet e sinjaleve të alarmit, numri dhe mënyra e përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive, miratohen me VKM”.

Buletini bën parashikimin e zjarreve në pyje si më poshtë:

TABELA 7. Parashikimi i rrezikut të zjarreve, buletini ditor i IGJEUM

S'ka Rrezik	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht
I Ulët	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë të mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara
I Moderuar	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme
I Lartë	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë

Duke iu referuar rreziqeve hidrometeorologjike, duke pasur parasysh se pragjet e dhëna janë vetëm për reshjet e shiut dhe se për vlerësimin e pikave kritike nevojiten studime të mëtejshme, ne mund të supozojmë se janë parashikuar 4 nivelet e mëposhtme:

- 0) E gjelbër (gjendja kritike zero)
- 1) E verdhë (gjendja kritike e ulët)
- 2) Portokalli (gjendja kritike mesatare)
- 3) E kuqe (gjendja kritike e lartë)

Në rast se nuk kemi ndonjë fenomen të rëndësishëm të parashikuar, e rendisim tek kuadrati “asgjë kritike” (e gjelbër), përndryshe nëse kushtet janë të tilla për të vendosur kalimin në një nivel më të lartë kritik, ekzistojnë 3 nivele të tilla.

Tabela më poshtë paraqet një skemë të mundshme për klasifikimin e parashikimeve. Kodet më poshtë mund të përdoren për të ofruar një metodologji referencë për aktivizimin e etapave të fazës së përgjigjes sipas PKEC.

TABELA 8. Indikatorët e kontekstit

Indikatorët e kontekstit (IK)	Gjendja kritike e parashikuar (K)
IK₀ Buletini meteorologjik përmban të paktën një nga elementet e mëposhtme: · Intensitetin e reshjeve deri në i moderuar ; · Sasinë e reshjeve deri në të dobëta	Gjendja kritike zero
IK₁ Buletini meteorologjik përmban të paktën një nga elementet e mëposhtme: · Intensitetin e reshjeve deri në i fortë ; · Sasinë e reshjeve deri në mesatare	Gjendja kritike e ulët
IK₂ Buletini meteorologjik përmban të paktën një nga elementet e mëposhtme: · Intensitetin e reshjeve midis i fortë dhe shumë i fortë ; · Sasinë e reshjeve ndërmjet intensive dhe shumë intensive ; · Mundësi e lartë e shtrëngatave të forta	Gjendja kritike mesatare
IK₃ Buletini meteorologjik përmban të paktën një nga elementet e mëposhtme: · Intensitetin e reshjeve shumë i fortë ; · Sasinë e reshjeve shumë intensive	Gjendja kritike e lartë

Ky informacioni iu duhet dërguar të gjitha palëve të interesit pasi ai është jetik për ndërmarrjen e masave parandaluese dhe miratimin e procedurave.

7.2. INDIKATORËT E STATUSIT, VEPRIMTARITË E MONITORIMIT NË KOHË REALE

Për sa u përket parashikimeve, veprimtaritë e monitorimit apo/dhe vëzhgimit përbëjnë një aspekt tjetër themelor të aktivizimit të fazave operacionale në nivel prefekturë/bashkie.

TABELA 9. Tabela e indikatorëve të statusit

Indikator i Statusit (Is)	Informacione nga Rrjeti i Monitorimit ose Vlerësuesve/Monitoruesve në Terren	Gjendja Kritike (K)
IS1	IS1 ₁ Informacioni nga monitorim instrumental Reshje shiu: me intensitet deri në të moderuar, pa shtrëngata, i lëvizshëm (mund të plotësohen vlerat në mm/orë në të ardhmen)	Gjendja kritike e ulët
	IS1 ₂ Informacioni nga monitorim instrumental Nivele hidrometrike: nën pragun që i korrespondon etapës së vëmendjes (të plotësohet me një vlerë në m ose interval vlerash në të ardhmen)	
	IS1 ₃ Informacioni nga prania në territor e monitoruesve Në karrexhiatën e rrugës: pellgje të izoluara, rrjedhje e pamjaftueshme e ujit përmes kuletave të rrugëve Në karrexhiatën e rrugës (nëntokë): rrjedhje e pamjaftueshme përmes kuletave të rrugëve Në shtratin e lumit: shkarkim i prurjeve i pakët Në një lumë të mbuluar: 1/3 e seksionit të hapësirës së dritës së pjesës së mbuluar është e zënë nga uji Rrëshqitje toke: prani e ulët e vërshimeve të ujit	
IS2	IS2 ₁ Informacioni nga monitorim instrumental Reshje shiu: me intensitet nga mesatar deri të lartë, me natyrë stuhie, edhe të qëndrueshme (mund të plotësohen vlerat në mm/orë në të ardhmen)	Gjendja kritike mesatare
	IS2 ₂ Informacioni nga monitorim instrumental Nivele hidrometrike: në rritje, afër pragut të vëmendjes (të plotësohet me një vlerë në m ose interval vlerash në të ardhmen)	
	IS2 ₃ Informacioni nga prania në territor e monitoruesve Në karrexhiatën e rrugës: vërshime uji që arrijnë deri te gomat e automjeteve, kyçet e këmbës së këmbësorëve, ujë shumë i turbullt Në karrexhiatën e rrugës (nëntokë): kanale kullimi të bllokuara Në shtratin e lumit: shkarkime të buta Lum i mbuluar: 1/2 e seksionit të hapësirës së dritës së seksionit të mbuluar, është e zënë nga uji Rrëshqitje të tokës: vërshime uji dhe shenja erozioni ose zhvendosjeje	
IS3	IS3 ₁ Informacioni nga monitorim instrumental Reshje shiu: me intensitet deri shumë të lartë, madje edhe me natyrë stuhie, të vazhdueshëm dhe vetërigjeneruese (mund të plotësohen vlerat në mm/orë në të ardhmen)	Gjendja kritike e lartë
	IS3 ₂ Informacioni nga monitorim instrumental Nivelet hidrometrike: në rritje, midis pragut të vëmendjes dhe pragut të alarmit (të plotësohet me një vlerë në m ose interval vlerash në të ardhmen)	
	IS3 ₃ Informacioni nga prania në territor e monitoruesve Në karrexhiatën e rrugës: ujë deri në lartësinë e shasisë së makinës, vështirë në ecje, pluskim i materialeve të rënda, dalje e kapakëve të pusetave, dalje në sipërfaqe e ujërave nëntokësorë Në karrexhiatën e rrugës (nëntokë): Dalje e kapakëve të pusetave ose lundrim sipërfaqësor i ujërave nëntokësorë Në shtratin e lumit: prurje e plotë Lum i mbuluar: 2/3 e seksionit të hapësirës së dritës së mbuluar është e zënë nga uji Rrëshqitje të tokës: zhvendosje të tokës, shkëputje, bllokim rrugësh	

Ndryshe nga indikatorët e kontekstit që janë të lidhur ngushtë me parashikimin e rrezikut hidrometeorologjik, indikatorët e statusit (IS), rrjedhin nga vëzhgimet në kohë reale ose pothuajse në kohë reale të ngjarjes dhe të ndikimeve të saj në territorin ku ajo ndodh. Kjo kryhet nëpërmjet komunikimit të ekipeve të vlerësimit, vrojtuesve të vendosur në terren. Aktiviteti i prezencës territoriale meteo-hidrogeologjike zhvillohet në mënyrë dinamike, sipas itinerareve të paracaktuara dhe kartave specifike të kontrollit (gjithashtu në pajisjet tabletë), nga stafi i caktuar nga bashkia ose vullnetarët, përmes përdorimit të automjeteve të njohura të pajisura me sisteme komunikimi radio dhe/ose telefonike. Operatorët e prezencës territoriale furnizojnë periodikisht QOE me vëzhgimet e tyre në terren.

Të dhënat nga terreni e monitoruesve janë për gjendjen e:

- Karrexhiatës dhe të nënkalimeve të automjeteve;
- Kunetave dhe pusetave;
- Prurjeve të lumenjve;
- Prurjeve të lumenjve të mbuluar;
- Trupave të rrëshqitjes, nëse rrëshqitjet e tokës ndodhin si rezultat i shirave.

Ato sigurohen gjithashtu nëpërmjet:

- Rrjetit Kombëtar të Stacioneve hidro-meteorologjike;
- Komunikimit nga palët të tjera institucionale të interesit si AKMC, prefektura e bashkitë fqinje, PSH, Drejtoria e Ujitje Kullimit, Baza Ushtarake Ajrore Gjadër. Kapitaneria e Portit Shëngjin etj.;
- Komunikimit nga popullsia përmes numrave të emergjencës.

Siç shihet në tabelën më lart, vlerat e reshjeve të shiut dhe të niveleve hidrometrikë do duhet të plotësohen në të ardhmen për tu ripërcaktuar më vonë në bazë të përvojave të fituara pas ushtrimeve dhe ngjarjeve të regjistruara.

7.3. ETAPAT E FAZËS SË PËRGJIGJES. LIDHJA ME INDIKATORËT E KONTEKSTIT DHE STATUSIT

Aktivizimi i etapave të përgjigjes


Lëshimi i një niveli alarmi do të aktivizojë automatikisht një etapë përgjigjeje siç pasqyrohet në tabelën më poshtë.

TABELA 10. Etapat e përgjigjes referuar vetëm buletinit ditor të IGJEUM

Parashikimi Hidrologjik/Hidraulik (IGJEUM)	Niveli korrespondues i alarmit i adoptuar nga Institucioni i Prefektit	Faza Minimale Operacionale
I GJELBËR	I GJELBËR	Aktivitete të Zakonshme
I VERDHË	I VERDHË	Të paktën faza e alarmit për rritjen e gjendjes së gatishmërisë
PORTOKALLI	PORTOKALLI	Të paktën faza e gatishmërisë
I KUQ	I KUQ	Faza e Aktivizimit

Ngjyra e kuqe në tabelë është e njëjtë me atë të adoptuar nga IGJEUM në buletin ditor. Kur është e mundur të analizohen të dhënat dhe duke kombinuar treguesit e kontekstit dhe treguesit e statusit, do të kemi fazat e mëposhtme operationale në nivel prefekturë²³:

FIGURA 11. Indikatorët e kontekstit, të statusit dhe etapat e përgjigjes



23 Siç mund të shihet në figurën më poshtë, nuk ka një reciprocitet mes fazave operationale të planeve komunale italiane dhe etapave të fazës së përgjigjes sipas PKEC-së. Prandaj u konkludua se etapa II "Vendosja e gjendjes së gatishmërisë" përmbledh tre fazat operative të planeve italiane përkatësisht: Fase operative I = Attenzione (Vëmendje), II Pre allarme (Para alarm) dhe III Allarme (Alarm). Etapa I e PKEC-së "Alarm për rritjen e gjendjes së gatishmërisë" vendoset në çastin e marrjes së njoftimit paraprak ose të informacionit për mundësinë e ndodhjes së një ngjarjeje e cila mund të shoqërohet me dëmtime në njerëz dhe dëme materiale. Si e tillë ajo është para ngjarjes (meteorologjike p.sh.) dhe duhet vendosur kronologjikisht para tre fazave të planeve operative komunale. Etapa III e PKEC-së "Aktivizimi" i korrespondon emergjencës. Përfundimisht është menduar se 3 fazat e sipërcituara të planeve italiane duhen konsideruar si nën etapa të etapës II të PKEC-së "Vendosja e gjendjes së gatishmërisë"

Vlerësuesit, monitoruesit në nivel prefekturë

Veprimtaritë e ekipeve të vlerësimit dhe monitorimit kryhen në mënyrë dinamike. Sipas rrugëve të paracaktuara (për t'u zhvilluar në mënyrë ciklike dhe me një procedurë me pjesëmarrje, duke përfshirë popullsinë dhe të gjitha palët e interesit në përcaktimin e tyre) dhe kartave të kontrollit (shihni figurën më poshtë), stafi nga prefekturat dhe/ose bashkitë, vullnetarët e trajnuar dhe ekspertët e tjerë të caktuar përdorin mjete të dallueshme, mundësisht të pajisura me sisteme komunikimi radiofonike dhe/ose telefonike. Këta operojnë duke pasur kontakte të vazhdueshme me KMC në nivel prefekturë dhe/ose bashkie.

Operatorët e ekipeve të vlerësimit u ofrojnë rregullisht operatorëve të QOE informacion për vëzhgimet e tyre në terren.

FIGURA 12. Ilustrimet e indikatorëve të statusit. Thellësia e ujit në karrexhiatë




FIGURA 13. Gjendja e karrexhiatës




FIGURA 14. Gjendja e prurjeve në shtretërit e lumenjve dhe nënkalime





FIGURA 15. Gjendja e prurjeve në lumenjtë e mbuluar



ETAPAT NË PËRGJIGJEN NDAJ EMERGJENCAVE CIVILE NË BASHKI. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË OPERACIONALE



“Përgjigje” është ofrimi i shërbimeve emergjente dhe të asistencës para dhe gjatë një fatkeqësie ose menjëherë pas saj, për mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, për të garantuar sigurinë publike dhe për të përmbushur nevojat themelore për mbijetesë të njerëzve të prekur²⁴.


Emergjencat civile kategorizohen në²⁵:

- Emergjencia civile vendore, që vijnë si pasojë e fatkeqësive që ndodhin në një bashki dhe mund të përballohen me anë të veprimeve të strukturave kompetente të saj;
- Emergjencia civile rajonale, që vijnë si pasojë e fatkeqësive që ndodhin në më shumë se një bashki që, për shkak të natyrës, shkallës dhe shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrjen e koordinuar të disa bashkive ose qarqeve;
- Emergjencia civile kombëtare, që vijnë si pasojë e fatkeqësive që, për shkak të intensitetit, të shkallës dhe të shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes civile, qendrore e vendore, edhe me masa të jashtëzakonshme, nëse është e nevojshme.

Faza e përgjigjes kalon në këto etapa²⁶:

- **Etapa 1:** “Alarmi për rritjen e gatishmërisë” është tërësia e masave për njoftimin paraprak pas marrjes së informacionit se mund të lindë një situatë emergjence dhe shërben si sinjal për rritjen e gatishmërisë;
- **Etapa 2:** “Gatishmëria” është tërësia e masave për njoftimin paraprak, pasues, pas informacionit që një situatë emergjence është e afërt ose në zhvillim;
- **Etapa 3:** “Aktivizimi” - kur situata emergjente ka ndodhur realisht;
- **Etapa 4:** “Dalja nga situata” - përmbyll fazën e përgjigjes, pavarësisht nga sa faza të mëparshme kanë ndodhur realisht.

FIGURA 16. Etapat e fazës së përgjigjes



24 Neni 3 “Përkufizimet” i Ligjit 45/2019

25 Neni 40 i ligjit 45/2019

26 Seksioni 6.1 i PKEC

8.1. ETAPA I. ALARMI PËR RRIJTJEN E GATISHMËRISË

Menjëherë pas informimit rreth ndonjë situatë emergjente ose ngjarjeje të mundshme të cilat mund të shkaktojnë një emergjencë në nivel qarku apo bashkie, Prefekti i qarkut, Kryetari i bashkisë do të ndër marrin menjëherë veprimet e duhura dhe të koordinuara mes tyre dhe me nivelin qendror.

TABELA 11. Aktivitetet e bashkisë, faza “Alarm për rritjen e gjendjes së gatishmërisë”

Drejtori i Emergjencave Civile në bashki/ KMC në bashki	Koha e realizimit të aktivitetit
Informon Kryetarin e Bashkisë dhe Prefektin, për aktivizimin e etapës “Alarm për rritjen e gatishmërisë”	Urgjent
Informon drejtuesit e Njësive Administrative të bashkisë	Menjëherë
Në koordinim me Institucionin e Prefektit informon strukturat e MZSH, FA, PSH dhe SHU dhe kërkon prej tyre vënien në gatishmëri të strukturave dhe dhënien e informacionit të vazhdueshëm për situatën	Menjëherë
Verifikon gatishmërinë për punë 24 orë të Drejtorisë së Emergjencave Civile dhe QOE në bashki	Menjëherë
Në koordinim me Institucionin e Prefektit komunikon me strukturat monitoruese dhe njoftuese në juridiksionin e bashkisë dhe kërkon prej tyre vrojtimin, dhënien e informacionit të vazhdueshëm dhe parashikimin për zhvillimin situatës	Brenda 1 ore
Në koordinim me Institucionin e Prefektit informon të gjitha institucionet dhe strukturat vepruese aktive, vepruese mbështetëse në territorin e bashkisë dhe kërkon prej tyre konfirmimin e situatës, gjendjen dhe vendndodhjen	Brenda 1 ore
Kontrollon mjetet e komunikimit, përditësimin e listave e kontaktit të planit të emergjencave civile dhe aktivizon sistemin e paralajmërimit me të gjithë anëtarët e KMC në bashki	Brenda 1 ore
Verifikon nëse kapacitetet e deklaruar në planin e emergjencave civile të strukturave të bashkisë janë në gatishmëri, të pajisura me mjetet e nevojshme dhe nëse kanë rezervë të mjaftueshme karburanti	Brenda 1 ore
Kërkon informacion për rezervën cash që disponon çdo strukturë varësie e bashkisë dhe Nj.A për situatat emergjente	Brenda 1 ore
Siguron informacion të saktë për të bërë paralajmërimet dhe këshillimet e duhura për publikun me anë të mjeteve të informimit	Brenda 2 orëve
Përgatit informacion të përmbledhur për Institucionin e Prefektit sikurse dhe AKMC-në (nëse është e nevojshme)	Brenda 2 orëve

8.2. ETAPA II , “VENDOSJA E GJENDJES SË GATISHMËRISË”

Vlerësohet nevoja e fillimit të etapës së dytë “vendosja e gjendjes së gatishmërisë”. Kjo bëhet kur një ngjarje e afërt konsiderohet e pashmangshme dhe që mund të shoqërohet me dëme në njerëz dhe materiale.

TABELA 12. Aktivitetet e bashkisë, faza “Vendosja e gjendjes së gatishmërisë”

Drejtori i Emergjencave Civile në bashki/ KMC në bashki	Koha e realizimit të Aktivitetit
Informojnë Kryetarin e Bashkisë dhe Prefektin, për aktivizimin e etapës 2 “Vendosja e Gjendjes së Gatishmërisë”	Urgjent
Pas miratimit të Titullarit aktivizohet QOE në bashki	Brenda 2 orëve
Pas miratimit të Titullarit mbledhet KMC dhe kërkohet përgatitja për procesin e marrjes së vendimeve takimeve informative për median dhe partnerët	Brenda 2 orëve
Informon drejtuesit e Nj.A të bashkisë	Menjëherë

Drejtori i Emergjencave Civile në bashki/ KMC në bashki	Koha e realizimit të Aktivitetit
Në koordinim me Institucionin e Prefektit, informon strukturat e MZSH, FA, PSH dhe SHU dhe kërkon prej tyre ndjekjen e situatës sipas planit të emergjencave dhe dhënien e informacionit të vazhdueshëm për situatën	Menjëherë
Në koordinim me Institucionin e Prefektit komunikon me strukturat monitoruese dhe njoftuese në juridiksionin e bashkisë dhe kërkon prej tyre vrojtimin, dhënien e informacionit të vazhdueshëm dhe parashikimin për zhvillimin situatës	Brenda 1 ore
Në koordinim me Institucionin e Prefektit informon të gjitha institucionet dhe strukturat vepruese aktive, vepruese mbështetëse në territorin e bashkisë dhe kërkon prej tyre konfirmimin e situatës, gjendjen dhe vendndodhjen	Brenda 1 ore
Harton raportin e parë për situatën dhe informacione periodike të cilat sipas rastit i dërgohen Prefektit dhe AKMC-së	Brenda 2 orëve
Përgatit informacione për Institucionin e Prefektit, AKMC-në, publikun, median, donatorët, KKSH, dhe OJF- të e interesuara	Çdo 4 orë
Përgatit materiale paraprake mbi dëmet, nevojat e pritshme për zonën, natyrën e fatkeqësisë, të dhënat GIS, vlerësimin e risqeve etj.	Brenda 1 ore
Në bashkëpunim me Institucionin e Prefektit, krijon/merr pjesë në grupe të përbashkëta vlerësimi dhe verifikimin e të dhënave për situatën për zonat e rrezikuara nga fatkeqësia	Brenda 4 orëve
Kontrollon dhe siguron që të gjitha masat e mëparshme a janë përbushur. QOE në bashki punon me staf të plotë të pajisur për të punuar në etapë gatishmërie për 24 orë	Në vazhdimësi
Aktivizon Degën Rajonale të KKSH, Caritas dhe World Vision	Brenda 2 orëve
Informon popullatën për skenarin e pritshëm dhe / ose në vazhdim dhe komunikon me popullatën, përfshirë vullnetarët, për nevojën e zbatimit të masave të vetëmbrojtjes. U siguron me urgjencë qytetarëve informacion të mjaftueshëm për shkallën e ekspozimit ndaj riskut me mjetet që konsiderohen më të përshtatshme. Në informimin e popullatës, ajo u jep përparësi banorëve të zonave me risk	Brenda 2 orëve
Siguron parandalimin, mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën për popullatën në zonën me risk	Brenda 2 orëve
Në rastet e riskut të përmbajtjes, urdhëron që të ndërpriten të gjitha aktivitetet në shtretërit e lumenjve dhe sigurinë e automjeteve dhe makinerive në përputhje me masat e sigurisë për operatorët	Brenda 2 orëve
Në rastet e riskut të përmbajtjes monitoron nivelin e ujit dhe gjendjen e punimeve mbrojtëse të argjinaturave përgjatë rrugëve ujore kryesore në bashki	Vazhdimisht
Garanton që vëzhgimet e kodifikuara, instrumentale ose jo, që vijnë nga autoritetet, të vihen në dispozicion të strukturave të bashkisë	Menjëherë
Verifikon disponueshmërinë / funksionalitetin e zonave të emergjencës, lehtësirat e pritjes së popullatës dhe rrugët e evakuimit	Brenda 2 orëve
Në rastet e riskut të përmbajtjes, kryen kontrole territoriale hidrogeologjike përmes zbulimit dhe inspektimit të paktën të zonave të ekspozuara ndaj riskut të lartë dhe shumë të lartë, gjithashtu me monitorimin “me sy” të rrëshqitjeve të mundshme dhe/ose të dukshme; monitoron pikat kritike, përfshirë me mbështetjen e forcave të PSH dhe forcave vullnetare	Brenda 2 orëve

8.3. ETAPA III, “AKTIVIZIMI”

Fillon në rastet kur një ngjarje e papritur ka shkaktuar dëmtime në njerëz dhe materiale ose kur një ngjarje e ngadaltë është në zhvillim e sipër dhe mund të sjellë te njëjtat pasoja të cilat tejkalojnë mundësitë për t'u përballuar nga strukturat e sistemit të mbrojtjes civile në nivel lokal. Në rast se emergjenca është e shkallës dhe e përmasave të mëdha dhe për pasojë shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore, me Vendim të KM, krijohet KNEC-ja dhe në mbledhjen e tij të parë emëron DQO-në që do të marrë drejtimin e përgjithshëm për përgjigjen në nivel kombëtar dhe ndihmën ndërkombëtare, nëse është e nevojshme.

TABELA 13. Aktivitetet e bashkisë, faza “Aktivizimi”

Për emergjenca të shkallës së ulët Drejtori i Emergjencave Civile në bashki/ KMC në bashki	Kontrolli i përfundimit të aktivitetit
1 Sigurohet për aktivizimin e strukturave dhe kapaciteteve të përgjigjes në nivel bashkie si dhe vënien në funksion të KMC dhe funksionimin e plotë 24/7 me të gjitha seksionet të QOE në bashki (nëse ekziston)	Brenda 1 ore
2 Nëse nuk është bërë ende mbledhja e KMC, mbledh urgjentisht atë pjesë të domosdoshme të tij për konsultime sipas llojit të emergjencës për procesin e marrjes së vendimeve	Menjëherë dhe çdo 2-4 orë
3 Së bashku me Institucionin e Prefektit siguron që gjitha strukturat monitoruese dhe njoftuese si edhe strukturat vepruese aktive dhe vepruese mbështetëse të jenë funksionale 24/7 dhe në veprim për situatën.	Në vazhdimësi
4 Nëse është e nevojshme i propozon Kryetarit të bashkisë që t'i kërkojë Prefektit deklarinim e “Gjendjes së fatkeqësisë natyrore” për zonën e prekur	Sipas precipitimit të situatës
5 Nëse nuk është bërë ende, në bashkëpunim me Institucionin e Prefektit, krijon/merr pjesë në grupe të përbashkëta vlerësimi dhe verifikimin e të dhënave për situatën për zonat e rrezikuara nga fatkeqësia	Brenda 4 orëve
6 Kërkon informacion periodik rreth situatës në terren nga grupet e përbashkëta të vlerësimit për situatën	Çdo 4 orë
7 Harton raportin e parë për situatën dhe informacione periodike, të cilat sipas rasti i dërgohen Prefektit dhe AKMC-së	Pas një ore dhe çdo 4 orë
8 Përgatit informacione për Institucionin e Prefektit, AKMC-në, publikun, median, donatorët, KKSH, dhe OJF- të e interesuara.	Çdo 4 orë
Për fatkeqësi të shkallës së lartë: Pas emërimit DOB do të sigurojë këto aktivitete	
9 Verifikon që hapat e sipërshënuar: 1, 2, 3, 4, 6 dhe 8 janë përbushur dhe në zbatim të pikës 1, KMC dhe QOE (nëse ekziston) janë në funksion të plotë	Menjëherë
10 Harton raporte të situatës me shkrim për Prefektin, QOQ ose direkt për QKOE	Çdo 4 orë
11 Bashkërendon strukturat vendore në nivel lokal, si dhe strukturat e tjera qendrore ose ndërkombëtare që vijnë në ndihmë	Sipas planit operacional dhe urdhrave të përditshëm të KMC në Qark
12 Mban lidhje të rregullta dhe kontakte të vazhdueshme me drejtuesit e tjerë të FO në nivel qarku dhe të bashkive fqinje, informon dhe kërkon asistencë nga DOQ në qark dhe DQO	Vazhdimisht
13 Zbaton detyrat dhe urdhrat e marra nga KMC në bashki dhe Prefektin e qarkut si edhe nga DQO	Vazhdimisht

8.4. ETAPA IV “DALJA NGA SITUATA”


Njoftimi për etapën IV “Dalja nga Situata”, bëhet nga i njëjti autoritet që e ka njoftuar fillimin e etapës 1,2,3. Në etapën IV mund të kalohet menjëherë pas etapës I, ose etapës II dhe pa kaluar situatën e fatkeqësisë ose nga etapa III, kur një ngjarje ka ndodhur realisht. Etapa IV “dalja nga situata”, paraqet situatën normale në vend, kur nuk ekziston kërcënimi i drejtpërdrejtë. Në çdo rast dalja nga situata bëhet kur:

- Është bërë vlerësimi i plotë i situatës;
- Kërcënimi i fatkeqësisë është zvogëluar;
- Operacionet e ndihmës kanë dhënë rezultatet e duhura;
- Nevojat më imediate janë plotësuar.

TABELA 14. Aktivitetet e bashkisë, faza “Dalja nga situata”

Drejtori i Emergjencave Civile në bashki/ KMC në bashki	Koha e përfundimit të aktivitetit
I raporton Kryetarit të bashkisë dhe u komunikon të gjithë Kryetarëve të Nj.A në lidhje me etapën “Dalja nga situata”	Menjëherë
Informon të gjitha strukturat e varësisë, institucionet dhe strukturat monitoruese dhe njoftuese, operative vepruese dhe operative mbështetëse rreth etapës “Dalja nga Situata”.	Menjëherë
Verifikon nëse informacioni dhe këshillat e duhura i janë transmetuar publikut nëpërmjet mjeteve të informimit publik.	Çdo 2 orë
Harton raportin përfundimtar të situatës dhe e dërgon tek Institucioni i Prefektit dhe nëse kërkohet edhe tek AKMC.	Pas 4 orëve
Mbledh të gjitha të dhënat duke i vendosur në dosjet përkatëse.	Brenda 4 orëve
Siguron rikthimin e QOE në gjendjen e mëparshme dhe administratës së bashkisë në gjendjen normale	Brenda 4 orëve
Kthen pajisjet e marra hua nga strukturat e tjera	Brenda ditës
Kontrollon që mjetet e transportit që janë aktivizuar në situatë të kthehen në gjendje normale pranë institucioneve dhe firmave private	Brenda ditës
Kërkon inventarin e gjendjes financiare dhe mbledhjen e faturave përkatëse.	Çdo ditë

FIGURA 17. Katër rastet e kalimit tek Etapa IV ‘Dalja nga situata’



SHTOJCAT

9.1. REFERENCAT DOKUMENTARE DHE LIGJORE

Referencat dokumentare

Udhëzuesi për Planifikimin e Emergjencave në nivel Prefekturë në kuadër të nënkomponentit “B2” “Rritja e kapaciteteve të planifikimit të menaxhimit të emergjencave” të Projektit PRONEWS të financuar nga BE. Tiranë 2018.

Manuali “Planifikimi i emergjencave civile”. Drejtorja e Planifikimit dhe Koordinimit të Emergjencave Civile në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit. Maj 2003.

Manuali “Konceptet bazë dhe planifikimi i emergjencave civile”. Drejtorja e Planifikimit dhe Koordinimit të Emergjencave Civile në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit. Maj 2005.

Manuali “Përballimi i emergjencave civile”, Drejtorja e Planifikimit dhe Koordinimit të Emergjencave Civile në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit. Dhjetor 2003.

Manuali “Udhëzues për trajnerët e menaxhimit të fatkeqësive”. Drejtorja e Planifikimit dhe Koordinimit të Emergjencave Civile në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit. Dhjetor 2003.

Manuali “Udhëzues përgatitor për stërvitjet për parapërgatitjen për emergjencat. Drejtorja e Planifikimit dhe Koordinimit të Emergjencave Civile në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit. Maj 2005.

Dokumenti i hartuar në kuadër të Projektit PRO NEWS: “Platforma Strategjike e Komunikimit dhe Rritjes së Ndërgjegjësimit Publik në Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë Natyrore (Risku nga Përmytjet). Tiranë 2018.

Kuadri Sendai për Reduktimin e Riskut të Fatkeqësive 2015-2030 i miratuar në Konferencën e 3-të Botërore të OKB-së për Reduktimin e Riskut të Fatkeqësive, të zhvilluar në 18.03.2015 në Sendai, Japoni dhe të miratuar në 3.06.2015 nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB, A/RES/69/283 në Takimin e 92-të Plenar të saj <https://www.undrr.org/publication/sendai-framework-disaster-risk-reduction-2015-2030>

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, të miratuara në Samitin e Kombeve të Bashkuara, të zhvilluar në NewYork në 25-27.09.2015: http://www.senior-a.al/docs/17SDGs_Shqip.pdf

Agjenda e re Urbane: <http://habitat3.org/wp-content/uploads/NUA-Albanian.pdf>

Deklarata Sendai e qeverisjeve lokale dhe nën kombëtarë: https://www.uclg.org/sites/default/files/sendai_declaration_lr_governments_0.pdf

Dokumenti Vlerësimi i Nevojave pas Fatkeqësisë-Shkurt 2019 (Albania post-disaster needs assessment report, February 2020): <https://www.preventionweb.net/publications/view/70492>
https://www.un.org.al/sites/default/files/albania%20post-disaster%20recovery_volume%20b%20COMP_0.pdf

Fleta e pikëzimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për aftësinë ripërtëritëse ndaj fatkeqësive 2017: <https://www.unisdr.org/campaign/resilientcities/toolkit/article/disaster-resilience-scorecard-for-cities>

British Columbia Emergency Management System https://www2.gov.bc.ca/assets/gov/public-safety-and-emergency-services/emergency-preparedness-response-recovery/embc/bcems/bcems_guide_2016_final_fillable.pdf

Emergency Management Planning Guide for Local Authorities and First Nations. https://www2.gov.bc.ca/assets/gov/public-safety-and-emergency-services/emergency-preparedness-response-recovery/local-government/finalemplanningguideforlocalauthoritiesandfirstnations_1edition_feb2019.pdf

Local Emergency Management Plan Template for Local Authorities and First Nations: <https://www2.gov.bc.ca/gov/content/safety/emergency-preparedness-response-recovery/local-emergency-programs/local-emergency-planning>

Justice Institute of British Columbia. Emergency Management Division. Emergency Operations Centre Operational Guidelines, 2nd Edition

https://www2.gov.bc.ca/assets/gov/public-safety-and-emergency-services/emergency-preparedness-response-recovery/local-government/eoc_operational_guidelines.pdf

Evacuation Operational Guide for First Nations and Local Authorities in British Columbia A guide to managing evacuations during emergency response 2nd edition, 4 July, 2019

https://www2.gov.bc.ca/assets/gov/public-safety-and-emergency-services/emergency-preparedness-response-recovery/local-government/evacuation_operational_guidelines.pdf

Comune di Quiliano, Piano Comunale di Emergenza. <http://www.comune.quiliano.sv.it/index.php/tutti-i-documenti/documenti/documenti-specifici/protezione-civile/documenti-informativi-su-rischio-idrogeologico/241-piano-comunale-di-emergenza-rischio-meteo-idrogeologico>

Protezione Civile. Regione di Lombardia, Manuale da campo. https://www.provincia.pv.it/attachments/article/491/manuale_da_campo.pdf

Comune di Ascoli Pieno. Piano Comunale di Emergenza di Protezione Civile. <https://www.comune.ap.it/flex/cm/pages/ServeBLOB.php/L/IT/IDPagina/7287>

Comune di Genzano di Roma. Piano di Protezione Civile Comunale. <http://www.comune.genzanodiroma.roma.it/home/partecipare/sicurezza/protezione-civile/piano-di-emergenza-comunale/>

Piano Comunale di Protezione Civile di Padova <https://www.padovanet.it/informazione/piano-comunale-di-protezione-civile>

Manuale allestimento tendopoli. <https://docplayer.it/150471296-Manuale-allestimento-tendopoli.html>

Piano di emergenza comunale Verona https://www.comune.verona.it/nqcontent.cfm?a_id=39862&tt=verona_agid

NHS England, Emergency Preparedness, Resilience and Response Concept of Operations for managing mass casualties: <https://www.england.nhs.uk/wp-content/uploads/2018/03/concept-operations-management-mass-casualties.pdf>

Reunification Standards and Procedures. Disaster Cycle Services. 2016 The American National Red Cross: <https://nationalmasscarestrategy.org/wp-content/uploads/2017/02/ReunificationStandardsandProcedures.pdf>

Emergency Support Functions. FEMA. <https://www.fema.gov/emergency-managers/national-preparedness/frameworks/response>

Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave. Prishtinë, Maj 2010. <https://ame.rks-gov.net/Portals/0/Files/SIME%20i%20Miratuar.pdf>

Plani i Reagimit Kombëtar, Prishtinë Dhjetor 2010. https://ame.rks-gov.net/Portals/0/Files/Plani%20Reagimit%20Kombëtar_14_01_11.pdf

Agjencia e Menaxhimit Emergjent të Kosovës. Rregullore për përmbajtjen dhe procedurat e hartimit të planeve të reagimit emergjent: <https://ame.rks-gov.net/Portals/0/Files/Rregullorja%20per%20Permb.dhe%20Proc.e%20hartimit%20te%20planeve%20te%20reagimit%20te%20emergjent.pdf>

A guide to emergency planning arrangements in Northern Ireland https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/85875/aguidetoemergencyplanningarrangements.pdf

Office of the First Minister and Deputy First Minister. A Guide to Plan Preparation. March 2002. North Irland. https://www.executiveoffice-ni.gov.uk/sites/default/files/publications/ofmdfm_dev/a-guide-to-plan-preparation.pdf

A Guide to Evacuation in Northern Ireland: https://www.executiveoffice-ni.gov.uk/sites/default/files/publications/ofmdfm_dev/a-guide-to-evacuation-in-ni.pdf

(EUR-OPA) Guidelines for Assisting People with Disabilities during Emergencies, Crises and Disasters https://www.coe.int/t/dg4/majorhazards/ressources/Apcat2013/APCAT2013_11_Gudelines_Disability_Alexander_Sagramola_17jan2014_en.pdf

Ready 2 Respond. Rapid Diagnostic User Guide Emergency Preparedness and Response Systems. https://www.gfdrr.org/sites/default/files/publication/R2R_RapidDiagnosticUserGuide_2017.pdf

Referencat ligjore

Ligjshmëria shqiptare

Ligji nr. 103/2014 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”

Ligji nr. 75/2016 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Parisit, në kuadër të konventës kuadër të Kombeve të Bashkuara, për ndryshimet klimatike”

VKM nr. 348, datë 11.5.2016 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015-2020”

Ligji 45/2019, datë 18.07.2019, “Për mbrojtjen civile”

VKM nr.747, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”

Urdhri i Kryeministrit nr.27, datë 3.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKMC-së”

Ligji nr. 97/2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”

VKM nr. 754, datë 30.11.2019 “Për mënyrën e organizimit të akomodimit të përkohshëm të të dëmtuarve për shkak të fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, në strukturat akomoduese”

VKM nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”

VKM nr.835, datë 03.12.2004 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile”

VKM nr.965, datë 2.12.2015 “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e emergjencave civile dhe krizave” e shfuqizuar nga VKM nr.923, datë 25.11.2020

VKM nr. 923, datë 25.11.2020 “Për funksionimin e organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile”

VKM nr.533, datë 01.08.2003 “Për pjesëmarrjen e shtetasve në parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile”

VKM nr.655, datë 18.12.2002 “Për ngritjen dhe funksionimin e Strukturës së Sistemit Kombëtar të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile. (Nenet 1, 2 dhe 6 të shfuqizuara)

VKM Nr.664, datë 18.02.2002 “Për kriteret dhe procedurat e shpalljes së gjendjes së emergjencës civile”

VKM Nr.531, datë 1.8.2003 “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit të emergjencave civile”

VKM Nr.148, datë 24.02.2016 “Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të integruar të

informacionit dhe statistikës të Këshillit të Ministrave”.

Ligji nr.152/2015 datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar

Ligji nr.9900, datë 10.4.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, i ndryshuar

Ligji nr.115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”

Ligji nr.107/2016 “Për prefektin e qarkut”

VKM nr.1128, datë 5.8.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore” e ndryshuar

VKM nr.1157, datë 25.11.2009 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të bordeve të kullimit, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ministrisë së bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit”

VKM Nr.1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin, nga ministria e bujqësisë, zhvillimit rural dhe administrimit të ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”

VKM Nr.567, datë 14.7.2010 “Për transferimin e rezervuarëve dhe skemave ujitëse përkatëse nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore dhe për një ndryshim në vendimin nr.1157, datë 25.11.2009 të KM “për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të bordeve të kullimit, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”

VKM nr.147, datë 18.3.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave”

Udhëzimi i përbashkët i gjashtë ministrive nr. 248, datë 28.01.2000 “Për hartimin e planit të alarmit, evakuimit dhe ndihmës për mbrojtjen e popullatës dhe vlerave materiale në rastet e jashtëzakonshme, si pasojë e prishjes së digave dhe dambave”

Udhëzim nr.4, datë 18.7.2003 “Për kërkesat e dokumentacionit ligjor dhe teknik, që duhet të përmbajë dosja e digave dhe e dambave”

Urdhër i Ministrisë të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 116 datë 27.09.2004 “Për: kriteret dhe procedurat e komandës gjatë operimit në raste zjarresh dhe të incidenteve të ndryshme”.

Direktivat e BE-së, udhëzime të tjera ndërkombëtare

Direktiva 2007/60/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23.10.2007, “Për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të përmytjeve”

Direktiva e Këshillit 2008/114/KE, datë 8.12.2008, “Për identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturave kritike evropiane dhe vlerësimin e nevojës për të përmirësuar mbrojtjen e tyre”

Direktiva 2012/18/BE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e datës 4.7.2012, “Mbi kontrollin e rreziqeve të aksidenteve të mëdha që përfshijnë substanca të rrezikshme, që ndryshon dhe më pas shfuqizon direktivën e Këshillit 96/82/KE

Direktiva 2002/22/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 7.3.2002, “Mbi shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve në lidhje me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike” e ndryshuar

Vendimi i Këshillit nr.1313/2013/BE i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit. Datë 17.12.2013, “Mbi mekanizmin e mbrojtjes civile të Bashkimit Evropian, i ndryshuar

Vendimi zbatues i Komisionit 2014/762/BE, datë 16.10.2014, që përcakton rregullat për zbatimin e vendimit nr. 1313/2013/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Mbi mekanizmin e mbrojtjes civile të Bashkimit Evropian” dhe që shfuqizon vendimet e Komisionit 2004.277/KE, Euroatom dhe 2007/606/KE, Euroatom., i ndryshuar

Udhëzime të BE-së për Vlerësimin e Kapaciteteve për Menaxhimin e Riskut (2015/C 261/03)

SEC (2010) 1626. Dokumenti i punës i personelit të Komisionit “Udhëzues për vlerësimin dhe hartëzimin e riskut për menaxhimin e fatkeqësive

9.2. INVENTARI INSTITUCIONAL DHE I BURIMEVE NJERËZORE

Përballimi i një emergjence madhore varet nga përfshirja dhe bashkërendimi i shumë institucioneve dhe strukturave shtetërore në nivelin qendror, qarku dhe bashkie sikurse edhe aktorëve joshtetërorë dhe subjekteve private.

Matrica e përgjithshme e bashkërendimit të aktiviteteve/funksioneve në përgjigje të emergjencave e cila përfshin lidhjen mes funksioneve mbështetëse emergjente dhe institucioneve dhe aktorëve joshtetërorë dhe subjekteve private me rol në kryerjen e tyre gjenden në seksionet 9.5 dhe 9.6.

Institucionet dhe strukturat shtetërore dhe jo shtetërore si edhe subjektet private në territorin e bashkisë dhe qarkut Lezhë me rol kryesor në ZRF dhe MC janë si më poshtë:

- Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Qendra e Mbrojtjes Civile për qarqet Shkodër, Kukës dhe Lezhë me qendër në Shkodër;
- Institucioni i Prefektit të qarkut Lezhë, në veçanti Sektori i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile;
- Këshilli i qarkut Lezhë;
- Strukturat e bashkisë Lezhë:
 - Drejtoria e Emergjencave Civile;
 - Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit;
 - Drejtoria e Planifikimit të Territorit;
 - Drejtoria e Bujqësisë, Njësia e Administrimit të Pyjeve dhe Njësia e Bujqësisë, Ujit, Kullimit dhe Transportet specifike;
 - Drejtoria e Shërbimit Social;
 - Policia Bashkiake;
 - Drejtoria e Integritimit Evropian, Komunikimit dhe Transparencës;
 - Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit;
 - Drejtoria e Financës dhe Buxhetit;
 - Drejtoria e Arsimit dhe Rinisë;
 - Drejtoria e Turizmit dhe Kulturës;
 - Drejtoria e Shërbimeve Publike, Njësia e Mirëmbajtjes së Institucioneve;
 - Drejtoria Juridike;
 - Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
- Sh.A. Ujësjellës Kanalizime, Lezhë;
- Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Lezhë;
- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Lezhë;
- Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM);
- Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
- Sektori i Ekstensionit Bujqësor Lezhë;
- Dega Lezhë e Drejtorisë Rajonale të OSHEE Shkodër;
- Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë;
- Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave Lezhë;
- Shërbimi Doganor Shëngjin, Dega Doganore Lezhë;
- Administrata e Zonave të Mbrojtura Qarku Lezhë;
- Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës;
- Agjencia Kombëtare e Bregdetit për Rajonin e Lezhës;
- Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore;
- Komisariati i Policisë në bashkinë Lezhë;

- Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë;
- Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Lezhë;
- Caritas, Lezhë;
- World Vision;
- Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP), Lezhë;
- Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP);
- Drejtoria Rajonale e Autoritetit Rrugor Shqiptar – Shkodër;
- Kleri;
- Baza Ushtarake Detare, Shëngjin;
- Përfaqësues të biznesit privat në qark apo bashki;
- Spitali Rajonal Lezhë;
- Institucionet shkollore;
- Sektori i Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Lezhë
- Zyra e Mobilizimit Lezhë;
- Baza Ushtarake Ajrore, Gjadër;
- Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bunë dhe Mat;
- Kapitaneria e Portit Shëngjin;
- Media;
- Porti Shëngjin;
- Dega Lezhë e Drejtorisë së OST Shkodër;
- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT);
- Organizata vullnetare, OJQ dhe OSHC.

TABELA 15. Inventari i kapaciteteve të degëve territoriale, Prefektit, Këshillit të Qarkut, arsimit, shëndetësisë

Nr.	Emërtimi institucionit/ndërmarrjes/firmës	Adresa		Kategoria				Automjetet				
		Njësia Administrative e vendi i dislokimit	Administratori, Drejtuesi, tel, adresa e-mail	Burime Njerëzore	Pajisje mjete, makineri	Nr. Pajisjeve, mjeteve, makinerive	Shtretër, ambient strehimi, magazinë, frigoriferike etj.	Lloji i automjetit	Targa e automjetit	Parametrat teknikë/Kapaciteti, gatishmëria etj.	Emri i drejtuesit / përdoruesit të automjetit	Telefoni drejtuesit / përdoruesit të mjetit
1	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor	Lagjja "Besëlidhja", Lezhë	Zoje Zefej Drejtor Tel:0696838401 Email:zoje.zefej@gmail.com	Gjithsej 56 punonjës Mjekë: 8 Infermierë: 11 Sanitarë: 2 Prapavijë: 24 Laborantë të lartë: 2 Laborantë të mesëm: 4 Stomatologë: 5			Dy automjete					
2	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Dega Rajonale Lezhë	Lagjja e Spitalit, Lezhë	Laureta Prendi Drejtor Tel: 0692242866 Email:laureta.prendi@yahoo.com	10 punonjës								
3	Agjencia Rajonale e Mjedisit (Shkodër, Lezhë, Kukës)	Lezhë	Bardhok Frroku, Tel:0682410405, Email:bfrroku10@gmail.com	3 punonjës (vetëm Qarku Lezhë)			Autoveturë	Në gatishmëri	Skënder Prenga	0686370868		
							Fuoristradë	Jo në gatishmëri				
							Fuoristradë	Jo në gatishmëri				
4	AKU, Drejtoria Rajonale Lezhë	Lagjja "Besëlidhja", Lezhë	Blerim Zaja Tel:0692663850 Email:blerim.zaja@aku.gov.al	17 punonjës			Automjet	AA376VX				
							Automjet	AA377VX				
							Autofrigorifer	AA441XI				
5	Spektori i Ekstensionit Bujqësor Lezhë (D.R. Shkodër)	Lagjja Besëlidhja, Lezhë	File Gjoni, Përgjegjëse Tel: 0693931740, 0696010427 Email:filegjoni@yahoo.com									

Nr.	Emërtimi institucionit/ndërmarrjes/firmës	Adresa			Kategoria			Automjetet				
		Njësia Administrative e vendi i dislokimit	Administratori, Drejtuesi, tel, adresa e-mail	Burime Njerëzore	Pajisje mjete, makineri	Nr. Pajisjeve, mjeteve, makinerive	Shtretër, ambient strehimi, magazinë, frigoriferike etj.	Lloji i automjetit	Targa e automjetit	Parametrat teknikë/Kapaciteti, gatishmëria etj.	Emri i drejtuesit / përdoruesit të automjetit	Telefoni drejtuesit / përdoruesit të mjetit
6	Dega Lezhë e Drejtorisë së OSHEE Shkodër	Lezhë, lagjja Besëlidhja	Klodiana Kolici, Tel:0682394187 Email:webmail.oshee.al	82 punonjës	0	0	Mitsubishi	AA 294RV		Klodiana Kolici	0682394187	
							Mitsubishi	AA 541 RX		Edmir Perdreca	0694141580	
							Mitsubishi	AA 683 RX		Gjin Marku	0694147544	
							Skoda	Tr 3495 U		Artur Mardeda	0685573653	
							Piagia			Gjin Pica	0694140510	
7	Drejtoria Ujitjes dhe Kullimit Lezhë	Lezhë	Fran Mataj, Tel:0682078328, Email:fran.mataj@yahoo.com, drejtoriaujitjesdheku-limit@gmail.com	106 punonjës	1		Esk EX-255	S'ka		Agim Kasemi	0693622111	
							Esk EX-255	S'ka		Nikoll Marku	0697021439	
							Esk EX-255	S'ka		Nikoll Çuni	0697021392	
							Esk EX-255			Viktor Berisha	0682689939	
							XCMG XE 260 CLL			Besim Semanaj	0692464311	
							XCMG XE 260 CLL			Paulin Ndoja	0697021438	
							XCMG XE 260 CLL			Agim Hoxhalli	0697201437	
							Kamion Iveko	Le2812A		Llesh Lushi	0697021398	
							Kamion Iveko	AA416HO		Llesh Lushi	0697021398	
							Land Rover	AA946AI		Nikolin Kola	06720661622	
							Ford Everest	AA253AZ		Marash Kola	0697021440	
							Karrofiçine	AA194XM		Lleshi Lushi	0697021398	
							Draga	Ska		Mirash Kalaj, Martin Leka	0686187490	
Ford Ranger	AA749LO		Marash Kola	0697021440								

Nr.	Emërtimi institucionit/ndërmarrjes/firmës	Adresa		Kategoria			Automjetet				
		Njësia Administrative e vendi i dislokimit	Administratori, Drejtuesi, tel, adresa e-mail	Burime Njerëzore	Pajisje mjete, makineri	Nr. Pajisjeve, mjeteve, makinerive	Shtretër, ambient strehimi, magazinë, frigoriferike etj.	Lloji i automjetit	Targa e automjetit	Parametrat teknikë/Kapaciteti, gatishmëria etj.	Emri i drejtuesit / përdoruesit të automjetit
8	Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave	Lagjja Besëlidhja, Lezhë	Florian Shimaj, Drejtor Tel:0672875470 Email:florian.shimaj@tatime.gov.al	19 punonjës							
9	Shërbimi Doganor Shëngjin, Lezhë (Dega Doganore Lezhë)	Shëngjin afër Portit	Ilir Sterkaj, Drejtor Tel:0698985043 Email:Ilir.Sterkaj@dogana.gov.al,	19 punonjës	Peshore	1					Një autoveturë
10	Administrata e Zonave të Mbrojtura Qarku Lezhë	Vain, Lezhë	Pjetër Toni Drejtor Tel:0684059549 Email:pjeter.toni@akzm.gov.al	16 punonjës	Kamera	5					Makinë TATA AA 681 NS Motoçikletë AV 862 motoçikletë AV 863 motoçikletë AV 864 motoçikletë Motobarkë AV 865 tip Yamaha.
11	Rajoni Lezhë i Drejtorisë së Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës	Shëngjin	Sandër Luli, Inspektor peshkimi, Tel:0693995558 Email:sanderluli3@gmail.com	1 punonjës (për Lezhën)							
12	Rajoni Lezhë i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit	Lezhë, L. Besëlidhja	Malvina Murati Përfaqësuese Tel: 0692589840 Email:malvinamurati@gmail.com	1 punonjës (për Lezhën)							
13	Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore	Shkodër	Dedë Margjoni Specialist në Lezhë Tel: 0695387921 Email:drkkShkodër@kultura.gov.al	1 punonjës (për Lezhën)							

Nr.	Emërtimi institucionit/ndërmarrjes/firmës	Adresa		Kategoria			Automjetet				
		Njësia Administrative e vendi i dislokimit	Administratori, Drejtuesi, tel, adresa e-mail	Burime Njerëzore	Pajisje mjete, makineri	Nr. Pajisjeve, mjeteve, makinerive	Shtretër, ambient strehimi, magazinë, frigoriferike etj.	Lloji i automjetit	Targa e automjetit	Parametrat teknikë/Kapaciteti, gatishmëria etj.	Emri i drejtuesit / përdoruesit të automjetit
14	Komisariati i Policisë në bashkinë Lezhë	Lezhë, L. Besëlidhja	Nikë Nikollaj Drejtori Tel:0694100422 Email:nike.nikollaj@asp.gov.al								
15	Dega e Kryqit të Kuq Shqiptar, Lezhë	Lezhë, L. Besëlidhja	Jolanda Gjeçi Sekretare degë e KKSH Lezhë Tel: 0692104892 Email:dega.Lezhë@kksh.org.al	2 punonjës							
16	Caritas Lezha	Lezhë, L. Besëlidhja	Xhovan Bregu Drejtues Tel: 0676027651 Email:xhovanbregu@hotmail.com	4 (dhe 15-20 vullnetar)							
17	World Vision	Lezhë, L. Besëlidhja	Malvina Martini Drejtuese malvina_martini@wvi.org Tel: 0682040430	2 punonjës				Autoveturë			
18	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Lezhë	Lezhë, L. Skënderbeg	Antoneta Suta, Tel:0672941483, Email:z-vaLezhë@arsimi.gov.al	10 punonjës							
	1.Shkolla 9 vjeçare Tale	Tale Shënkoll	Liza Marku, Tal:0692836628, Email:tale_9vj@yahoo.com	13 punonjës							
	2.Shkolla 9 vjeçare G-Lumi	Grykë Lumi Shënkoll	Lazer Lushi, Tel:0682270569, Email:grykelumi_9vjYahoo.com	12 punonjës							
	3.Shkolla e M.B Shënkoll	Shënkoll	Bardhok Çuni, Tel:0686018060, Email:Shënkolli_shmb@yahoo.com	44 punonjës							

Nr.	Emërtimi institucionit/ndërmarrjes/firmës	Adresa		Kategoria			Automjetet				
		Njësia Administrative e vendi i dislokimit	Administratori, Drejtuesi, tel, adresa e-mail	Burime Njerëzore	Pajisje mjete, makineri	Nr. Pajisjeve, mjeteve, makinerive	Shtretër, ambient strehimi, magazinë, frigoriferike etj.	Lloji i automjetit	Targa e automjetit	Parametrat teknikë/ Kapaciteti, gatishmëria etj.	Emri i drejtuesit / përdoruesit të automjetit
18	4.Shkolla 9 vjeçare Rilë	Rilë Shënkoll	Matilda Pepa, Tel:0692508944, Email:Rilë_9vjecare@yahoo.com	31 punonjës							
	5.Shkolla 9 vjeçare Pllanë	Pllanë Zejmen	Martine Trasha, Tel:0696344540, Email:shkolla_Pllanë@yahoo.com	11 punonjës							
	6.Sh. M. B. Zejmen	Zejmen	Zef Therçaj, Tel:0682221560, Email:zejmen_shmb@yahoo.com	33 punonjës							
	7.Shkolla 9 vjeçare Spiten	Spiten Zejmen	Nesti Nika, Tel:0692930755, Email:spiten_9vj@yahoo.com	12 punonjës							
	8.Shkolla 9 vjeçare Tresh	Tresh Zejmen	Vladimir Kamshi, Tel:0684188651, Email:tresh_9vj@yahoo.com	11 punonjës							
	9.Shkolla 9 vjeçare Manati	Manati Kolsh	Brikena Gjini, Tel:0673070506, Email:manati_9vj@yahoo.com	10 punonjës							
	10. Shkolla.9 vjeçare Kolsh	Kolsh	Pjeter Matrizi, Tel:0685772202, Email:kolsh_9vj@yahoo.com	8 punonjës							
	11. Shk.9 vjeçare Barbullojë	Barbullojë Kolsh	Mrike Doda, Tel:0692419300, Email:Barbullojë_9vj@yahoo.com	13 punonjës							
	12. Shkolla M.B Ishull-Lezhë	Ishull Lezhë Shëngjin	Ton Gjekmarkaj, Tel:0692099849, Email:i-shullLezhë@outlook.com	34 punonjës							
	13. Shkolla 9 vjeçare Shëngjin	Shëngjin	Qamil Sokolaj, Tel:0682394080, Email:Shëngjini_9vj@yahoo.com	18 punonjës							

Nr.	Emërtimi institucionit/ndërmarrjes/firmës	Adresa		Kategoria			Automjetet				
		Njësia Administrative e vendi i dislokimit	Administratori, Drejtuesi, tel, adresa e-mail	Burime Njerëzore	Pajisje mjete, makineri	Nr. Pajisjeve, mjeteve, makinerive	Shtretër, ambient strehimi, magazinë, frigoriferike etj.	Lloji i automjetit	Targa e automjetit	Parametrat teknikë/Kapaciteti, gatishmëria etj.	Emri i drejtuesit / përdoruesit të automjetit
18	14. Shkolla 9 vjeçare Ishull-Shëngjin	Ishull Shëngjin, Shëngjin	Dede Luli, Tel:0682553750, Email:shkollaish.Shëngjin@hotmail.com	15 punonjës							
	15. Shkolla M.B. Balldren	Balldren	Tonin Neçaj, Tel:0683808083, Email:shmb_karlgega@yahoo.com	38 punonjës							
	16. Shkolla 9 vjeçare Marlecaj	Marlecaj Balldren	Roland Velaj, Tel:0683430354, Email:-maleca_9vj@yahoo.com	8 punonjës							
	17. Shkolla 9 vjeçare Torovicë	Torovicë Balldren	Kujtim Kolndreu, Tel:0682352178, Email:shkollatorovice@yahoo.com	19 punonjës							
	18. Shkolla 9 vjeçare Kakarriq	Kakarriq Balldren	Aleksandër Haxhia, Tel:0693399133, Email:ka-karriq_9vj@yahoo.com	12 punonjës							
	19. Shkolla M.B Gjadër	Gjadër Dajç	Hasan Muça, Tel:0684677874, Email:gjad-er_shmb@yahoo.com	19 punonjës							
	20. Shkolla 9 vjeçare Mabë	Mabë Dajç	Halit Kavaja, Tel:0692147344, Email:shMabë_9vj@yahoo.it	10 punonjës							
	21. Shkolla.M.B Dajç	Dajç	Elsa Gazulli, Tel:0673427207, Email:el-sagazulli@hotmail.com	19 punonjës							
	22. Shkolla M. B. Blinisht	Blinisht	Viktor Shtjefni, Tel:0673939992, Email:blinisht_shmb@yahoo.com	21 punonjës							
	23. Shkolla 9 vjeçare Troshan	Troshan Blinisht	Lin Shtjefni, Tel:0692175687, Email:tro-shan9vj@yahoo.com	15 punonjës							

Nr.	Emërtimi institucionit/ndërmarrjes/firmës	Adresa		Kategoria			Automjetet				
- Janë rreth 200 ndërtesa me prani uji vetëm në oborret e tyre të cilat kanë shkaktuar dëme në të mbjellat në oborr dhe përreth sikurse një pjesë e tyre kanë banorët të izoluar. Ato janë të shpërndara përkatësisht 49 në Nj.A Zejmen, 114 në Nj.A Shënkoll dhe 37 në Nj.A Kolsh;
- Në qytetin e Lezhës, u përmbyt shkolla 9 vjeçare "Kosova" në lagjen "Besëlidhja", 15 apartamente që ndodhen në lagjen "Besëlidhja", 10 apartamente në lagjen "Skënderbej" dhe 8 banesa në lagjen "Gurra". Janë përmbytur edhe 10 biznese të ndryshme me dëme ndërtimore, mobilje, pajisje dhe të mallrave që tregtojnë;
- 1'500 ha tokë të përmbytura përkatësisht: Njësia Administrative Zejmen 480 ha, Nj.A Shënkoll 970 ha, dhe Nj.A Kolsh 50 ha.
- 1'200 ha sipërfaqe toke me kultura bujqësore si pasojë e të cilës janë dëmtuar kulturat bujqësore dhe që janë si më poshtë; Nj.A Zejmen 380 ha, Nj.A Shënkoll 780 ha, dhe Nj.A Kolsh 40 ha;
- Sipërfaqe toke truall 300 ha si më poshtë; Nj.A Zejmen 95 ha, Nj.A Shënkoll 195 ha, dhe Nj.A Kolsh 10 ha;
- Është përmbytur një stallë me 300 derra dhe një me 130 kokë bagëti nga të cilat kanë ngordhur 80 kokë. Është dëmtuar një pjesë e bazës ushqimore për blegtorinë si rrjedhim kanë ngelur pa ushqim 400 kokë bagëti.

Ndikimi në infrastrukturë e mjedisin në tërësi

- Kolektorët e ujërave Krajen-Lezhë-Tresh-Zejmen, janë bllokuar për shkak të inerteve të sjella nga grykëderdhjet e përrrenjve malorë. Kjo shkaktoi përmbytjen e banesave, bizneseve dhe objekteve sociale;
- Hidrovori Tale dhe Hidrovori Ishull Shëngjin nuk ishin funksional për dy orë;
- Si pasojë e prurjeve shumë të mëdha dhe mosmirëmbajtjes së argjinaturës mbrojtëse të lumit Mat, ajo u ça në afërsi të fshatrave Alk dhe Burimi (duke përmbytur disa sipërfaqe tokash bujqësore në atë zonë);
- Në rezervuarin Kallmet të ndërtuar në vitin 1969, janë dëmtuar veprat e lëshimit të ujit. Rezervuari ka vëllim faktik uji në ujëmbledhës mbi 2'000'000 m³, lartësi të digës 17,5 m, gjatësi të kurorës 1'025 m dhe sipërfaqe të kupës 384'000 m². Si rrjedhojë e reshjeve kishte ngritje të nivelit të ujit me rrezik kapërdërdhjen e tij dhe shkatërrimin e digës. Nga përmbytja poshtë digës rrezikoheshin 65 banesa dhe 4 shërbime, sikurse 303 ha tokë bujqësore;
- Prej stuhive të erës që ka shoqëruar reshjet e shiut, janë dëmtuar linjat elektrike të TM dhe TU dhe si rrjedhim ka ndërprerje energjie elektrike në qytetin e Lezhës, dhe fshatrat e Nj.A Zejmen, Shënkoll, Kolsh. Defektet vijnë si shkak i rrëzimit të disa shtyllave të TM sikurse edhe dëmtimi i 2 transformatorëve;
- Janë bllokuar disa segmente të rrjetit të kanalizimeve në qytetin e Lezhës, kryesisht në lagjet "Skënderbej" dhe "Besëlidhja";
- Qarkullimi rrugor në qytetin e Lezhës është kryer me vështirësi gjatë gjithë ditës për shkak të pemëve të shkulura dhe degëve të thyera në trupin e rrugës por veçanërisht të nivelit të lartë të ujërave në rrugë;
- Për shkak të nivelit të lartë të ujërave, rrëshqitjeve të dherave dhe inerteve të përrrenjve

malorë ka pasur problem qarkullimi në disa segmente të aksit të rrugës së vjetër Milot Lezhë kryesisht midis Treshit e Spitenit, Spitenit e Markatomaj;

- Kishte përmbytyje urbane e prezencë të ujërave të zeza në disa nga bodrumet e ndërtesave në qytetin e Lezhës, sidomos tek ato në jug të rreth rrotullimit në rrugën “Papa Gjon Pali i II” të Lagjes “Besëlidhja”.

Ç) Nevojat humanitare tek popullsia e prekur. Nevojat për përgjigje. Burimet dhe pajisjet që do të nevojiten dhe burimet dhe pajisjet që disponohen aktualisht. Trajtimi i problematikave që dolën.

- **Paralajmërimi i hershëm dhe informacione publike për emergjencën, këshillimi i publikut:** U desh të kryhej gjatë gjithë periudhës së emergjencës;
- **Kërkim shpëtimi:** Nevojitej në tre banesa respektivisht: në Tale, Gajush dhe Barbullojë sikurse një familje e bllokuar në një automjet në një parking në lagjen “Besëlidhja” në Lezhë;
- **Evakuimi:** Nevojitej për 15 familje në qytetin e Lezhës, 6 familje në Nj.A Zejmen, 14 familje në Nj.A Shënkoll dhe 5 familje në Nj.A Kolsh. Nevojitej evakuim dhe për 50 kokë bagëti të imta dhe për 300 derra, stallat e të cilave janë dëmtuar nga përmbytja dhe stuhia;
- **Strehimi:** Përgatitja e ambienteve të palestrës së gjimnazit “Hyddajet Lezha” me qëllim strehimin e 6 familjeve nga qyteti i Lezhës. Nevojitej strehimi i 50 kokë bagëti dhe 300 derrave në ambiente të vendosura në dispozicion nga Nj.A Zejmen. Ndërsa pjesa tjetër e familjeve të evakuara që janë: 9 në qytetin e Lezhës, 6 familje në Nj.A Zejmen, 14 në Nj.A Shënkoll dhe 5 në Kolsh do të strehoheshin tek të afërmit e tyre. Pra në total, nga 40 familje të evakuara, 34 familje do strehoheshin tek të afërmit dhe 6 familje tek ambientet e shkollës;
- **Sigurimi i furnizimit me ndihmën ushqimore, veshmbathjen dhe artikujt e tjerë të jetesës** për 6 familjet e strehuara përkohësisht në ambientet e palestrës së gjimnazit “Hyddajet Lezha”. Do të merrej në konsideratë edhe furnizimi me artikujt e emergjencës edhe e 34 familjeve të strehuara tek të afërmit e tyre;
- **Nevojat shëndetësore:** Nevojitej shtrim në spital për dy persona të lënduar. Kishin nevojë për asistencë mjekësore gjithsej 10 banorë: 2 banorë nga Nj.A Zejmen, 3 nga Nj.A Shënkoll, një nga Nj.A Kolsh dhe 4 nga qyteti i Lezhës. Stafi i Nj.V.K.Sh dhe SRL nevojitej 24/7 në dispozicion të popullsisë sidomos asaj të evakuuar por edhe të forcave operacionale në terren për çdo nevojë shëndetësore që mund të paraqitej.

Rehabilitimi i infrastrukturës si më poshtë:

- Pastrimi urgjent i rrugëve në qytetin e Lezhës dhe të gjithë segmenteve rrugorë të rrugëve kombëtare dhe atyre rurale me probleme nga rrëshqitjet e dherave dhe prania e inerteve në rrugë;
- Pastrimi dhe vënia në funksion të plotë e të gjithë rrjetit të kanalizimeve në qytetin e Lezhës;
- Rregullimi i të gjitha avarive të linjave të TM dhe TU në zonën e Lagjes Varosh të qytetit të Lezhës, në Tresh, në fshatin Ishull Lezhë etj. të dëmtuara nga stuhia;
- Pastrimi i kolektorëve të ujërave Krajen-Lezhë dhe Tresh-Zejmen të bllokuar për shkak të reshjeve intensive që sollën prurje inertesh nga grykëderdhjet e përrrenjve malorë;
- Pastrimi i kanaleve dytësorë të bllokuar në të gjitha zonat informale sidomos tek fshati Barbullojë e Re, Lalm i Ri, Gocaj, në zonat fushore të Treshit e Spitenit;
- Rehabilitimi i argjinaturës së lumit Mat në afërsi të fshatrave Alk dhe Burimi, në zonën midis dy urave mbi lumin Mat, menjëherë pas urës automobilistike të re si edhe argjinaturave të tjera të dëmtuara;
- Ndërhyrje në rezervuarin Kallmet për shkarkimin e detyruar të ujërave nëpërmjet pompave me kapacitet të lartë të FA dhe MZSH Shkodër sikurse riparimin e ujëlëshuesve të tij;
- Vlerësimi i gjendjes së rezervuarëve Fishtë, Troshan, Patalej dhe Kashnjet dhe i gjendjes së

hidrovorëve Tale, Gocajt, Balldrenit, Gryke-Zeze dhe Ishull Shëngjin;

- Ndërhyrje emergjente për pastrimin e ambienteve të përmbytura në shkollën 9 vjeçare “Kosova” në lagjen “Besëlidhja” në qytetin e Lezhës;
- Pastrimi dhe dezinfektimi i kateve përdhe të banesave, bizneseve dhe ndërtesave të tjera të përmbytura nga balta dhe mbeturinat e tjera;
- Ofrimi i ushqimit për gjënë e gjallë tek fermerët të cilëve u janë dëmtuar rezervat nga përmbytja si edhe për gjënë e gjallë që është strehuar në ambiente stallore të reja;
- Kontrolli dhe disiplinimi i trafikut në të gjitha segmentet rrugore, veçanërisht në segmentet e rrugëve të bllokuara ose atyre me thellësi të konsiderueshme të ujit në karrexhatë;
- Masat e ruajtjes dhe të sigurisë për ndërtesat e evakuuara, zbatimi i ligjit, dhe masat për ruajtjen e rendit publik;
- Analiza e vazhdueshme e ujit të pijshëm dhe në rastet e evidentimit të ujërave të ndotura sigurimi i furnizimit të banorëve me ujë të pastër nëpërmjet rrjetit apo ujit të ambalazhuar dhe me autobote;
- Nevoja për mbajtjen nën kontroll të shëndetit publik, sigurimin e shërbimeve të ndihmës sociale, mbështetjen psikosociale/zvogëlimin e panikut;
- Dezinfektimi dhe grposja e gjësë së gjallë dhe bimëve të ndotura nga përmbytja.

Kapacitetet e nevojshme për t’u angazhuar janë:

- E gjithë struktura e MZSH-së së bashkisë Lezhë;
- Kapacitete logjistike dhe njerëzore të strukturave të tjera të bashkisë Lezhë që nevojiten në veçanti në operacionet e ndryshme të përgjigjes ndaj emergjencës janë;
- Njësitë Administrative me gjithë stafin e tyre dhe rrjetin e vullnetarëve;
- Drejtoria e Planifikimit të Territorit;
- Drejtoria e Emergjencave Civile;
- Policia bashkiake;
- Drejtoria e Shërbimeve Publike, Njësia e Mirëmbajtjes së Institucioneve;
- Drejtoria e Bujqësisë, Njësia e Administrimit të Pyjeve dhe Njësia e Bujqësisë, Ujit, Kullimit dhe Transportet specifike;
- Drejtoria e Shërbimit Social;

Nevojat për kapacitete reagoni shtesë përveç atyre të bashkisë janë:

- Strukturat e FA; Batalioni Mbështetës Rajonal i FA, Reparti i Këmbësorisë Malore të

Repartit Ushtarak Nr.1010 në Vau Dejës; Batalioni Komando Zall Herr; DMR Burrel.

- Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor dhe Inspektorati Shtetëror Shëndetësor;
- Spitali Rajonal Lezhë/SRL;
- Inspektorati Kombëtar i Mjedisit dhe Territorit/IKMT;
- Agjencia Rajonale e Mjedisit;
- Komisariati i Policisë në bashkinë Lezhë dhe Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë;
- Administrata e Zonave të Mbrojtura Qarku Lezhë;
- Dega Lezhë e Drejtorisë së OSHEE Shkodër dhe Dega Lezhë e Drejtorisë së OST Shkodër;
- Drejtoria Rajonale e Autoritetit Rrugor Shqiptar – Shkodër;
- Drejtoria Ujit dhe Kullimit Lezhë;
- Sektori i Ekstensionit Bujqësor Lezhë dhe Sektori Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Lezhë;
- Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
- DPRMSH dhe Drejtoria Rajonale e Rezervave të Shtetit Dibër;
- ZVAP dhe DRAP;

- Porti Shëngjin;
- Sh.A. Ujësjetës Kanalizime, Lezhë;
- Caritas Lezhë;
- MZSH bashkia Shkodër, Vau i Dejës, Kurbin dhe Mirditë
- Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Rajonale Lezhë.

D) Funkcionet operacionale për përballimin e emergjencës së përmbytjes

Paralajmërimi i hershëm dhe informacioni publik për emergjencat, këshillimi i publikut;

Paralajmërimi i hershëm i banorëve të zonave që ishin në risk nga përmbytjet dhe erërat e forta u kryen tre ditë më parë. Kjo u bë bazuar në buletin e parashikimit të motit të publikuar nga IGJEUM dhe SHMU. Popullata e mori informacionin përmes njoftimeve derë më derë që u kryen nga stafi i Nj.A Zejmen, Shënkoll, Kolsh dhe Kallmet por edhe përmes medias tradicionale (kombëtare dhe lokale) dhe asaj sociale. Paralajmërimi i hershëm, njoftimi dhe alarmi paraprak u pasua edhe nga dhënia e alarmit në orët e vona të mbrëmjes, kur u pa se po vërtetoheshin saktësisht parashikimi i bërë nga IGJEUM dhe SHMU.

Banorët ishin udhëzuar nga stafi i Njësisë Administrative dhe bashkisë për masat e sigurisë që duhet të merrnin paraprakisht, veprimet që duhet të kryenin gjatë emergjencës dhe menjëherë pas përfundimit të saj.

Organizimi dhe drejtimi, koordinimi qendror / i përgjithshëm i përballimit të emergjencës

Organizimi dhe drejtimi u kryen nga KMC në bashki dhe KMC në qark. Bazuar në shkallën e emergjencës dhe përvojës, Bashkia nuk i kërkoi Prefektit të Qarkut dërgimin e kërkesës për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Stuhia dhe reshjet e mëdha të shiut prekën edhe territorin e bashkive Mirditë dhe Kurbin. Edhe Prefekti i Qarkut, bazuar në një analizë të shkallës së emergjencës civile në gjithë qarkun dhe kapaciteteve shtesë të nevojshme nga niveli qendror për përballimin e saj, vendosi mos dërgimin e një kërkesë për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qark apo bashki. Bazuar shkresës së Prefektit të qarkut Lezhë nr.771/1 prot., datë 7.6.2018, Drejtuesi i Operacionit në rang qarku u caktua Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit dhe Përballimit të Mbrojtjes Civile dhe Krizave në Institucionin e Prefektit i cili u mbështet nga Drejtori i Emergjencave Civile në bashki dhe një staf i kësaj drejtorie. Komandanti i incidentit u caktua Përgjegjësi i Sektorit Operacional të Drejtorisë së MZSH ndërsa në operacionet e zhvilluara në rezervuarin Kallmet u caktua komandant incidenti drejtuesi i modulit “Pompimi me kapacitet të lartë” të MZSH Shkodër. U aktivizuan planet e emergjencave në nivel qarku dhe në nivel bashkie sikurse QOE-të në qark dhe bashki. KMC dhe QOE në bashki dhe në qark ruajtën komunikimin e tyre duke zbatuar hierarkinë institucionale.

Mobilizimi dhe aktivizimi i burimeve

Bashkia mobilizoi të gjitha kapacitetet administrative, teknike dhe financiare që kishte në dispozicion. Nga një analizë që KMC në bashki i bëri gjendjes së burimeve ekzistuese në bashki dhe atyre të nevojshme për përballimin e situatës emergjente të krijuar, u nxorrën kërkesat për burime shtesë të cilat iu drejtuan menjëherë Prefektit të qarkut. Pas analizës që u bë në KMC në qark për burimet ekzistuese në rang qarku dhe nevojave, u kërkuan kapacitete shtesë nga niveli qendror siç ishin ato të FA, MBZHR dhe DPRMSH dhe kapacitete nga niveli lokal siç ishin ato të strukturave të MZSH-ve të bashkive Shkodër, Vau i Dejës, Kurbin dhe Mirditë.

Kërkim-shpëtimi

Banorët e zonave në risk ishin njoftuar paraprakisht tre ditë para sikurse u rinjoftuan 4-5 orë para se të fillonte moti i keq. Edhe pse të njoftuar dhe të udhëzuar nga Njësia Administrative dhe bashkia

për masat para, gjatë dhe pas përmbytjes, kishte banorë që për arsye të ndryshme nuk i zbatuan ato. U nevojitën kryerja e operacioneve të S&R në tre banesa respektivisht: në Tale, Gajush dhe Barbullojë sikurse një familje e bllokuar në një automjet në një parking në lagjen “Besëlidhja” në Lezhë.

Forcat e angazhuara në operacionet e S&R ishin të MZSH Lezhë të mbështetura nga:

- PSH;
- Nj.V.K.Sh dhe SRL;
- MZSH-të e bashkive Shkodër, Vau i Dejës, Kurbin, Mirditë;
- Batalioni Mbështetës Rajonal i FA, Reparti i Këmbësorisë Malore të Repartit Ushtarak Nr.1010 në Vau Dejës; Batalioni Komando Zall Herr; DMR Burrel.

Operacionet S&R u mbështetën nga Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashki dhe Dega Rajonale Lezhë e KKSH.

Evakuimi i popullsisë civile

Vendimi për evakuim u mor nga KMC në qark. Propozimi për evakuim erdhi nga DOQ në bashkëpunim me DOB, Drejtorin e Emergjencave Civile dhe komandantin e incidentit.

Nuk u dha urdhër për evakuimin e 65 familjeve të banesave dhe 4 ndërtesave të shërbimeve poshtë bjefit të poshtëm të digës së rezervuarit Kallmet, që ndodhen në perëndim të fshatit Kallmet i madh, për shkak të ecurisë së mirë të operacionit të zbrazjes së tij por edhe riparimit përfundimtar të ujëlëshuesve.

U evakuuan në total 40 familje: 15 familje në qytetin e Lezhës, 6 familje në Nj.A Zejmen, 14 familje në Nj.A Shënkoll dhe 5 familje në Nj.A Kolsh. U evakuuan gjithashtu 50 kokë bagëti të imta dhe 300 derra, stallat e të cilave u dëmtuan nga stuhia dhe përmbytja.

Për evakuimin e njerëzve, gjësë së gjallë, mobiljeve, pajisjeve dhe orendive, u përdorën automjete të bashkisë, PSH dhe FA. Në segmentet rrugore me thellësi të madhe uji u përdorën 4 automjetet “Iveco” të FA. Në terrene ku thellësia e ujit ishte shumë e madhe u përdorën 2 motobarkat plastike të bashkisë Lezhë dhe 2 varka, me motor me kapacitet transporti prej 18 vetash të FA (reparti Vau i Dejës). Patrullimi dhe ruajtja e ndërtesave të evakuuara u krye nga efektivet e PSH, bazuar planit të masave për këtë skenar fatkeqësie. Operacionet e evakuimit u asistuan edhe nga Policia Bashkiake; Drejtoria e Shërbimeve Publike; Dega Rajonale Lezhë e KKSH dhe Caritas.

Strehimi i përkohshëm i njerëzve dhe gjësë së gjallë

Nga 40 familje të evakuuara gjithsej, vetëm 6 prej tyre në qytetin e Lezhës kërkuan të strehoheshin në strehimore të siguruara nga bashkia Lezhë dhe iu ofruan ambiente të palestrës së gjimnazit “Hyddajet Lezha”.

34 familjet e tjera, 9 në qytetin e Lezhës, 6 në Nj.A Zejmen, 14 në Nj.A Shënkoll dhe 5 në Nj.A Kolsh, preferuan të strehoheshin tek të afërmit e tyre. Për strehimin e 50 kokë bagëti dhe 300 derrave u vendosën ambiente në dispozicion nga Nj.A Zejmen sikurse u furnizuan tenda nga DPRMSH dhe Drejtoria Rajonale e Rezervave të Shtetit Dibër. Strukturat që u angazhuan në strehimin e banorëve ishin Njësitë Administrative; PSH; Policia bashkiake; Drejtoria e Shërbimeve Publike; Drejtoria e Shërbimit Social në bashki; vullnetarët e KKSH dhe Caritas.

Kujdesi mjekësor / ndihma e parë gjatë emergjencës (triazhimi/klasifikimi);

Në dispozicion të përballimit të emergjencës ishin Nj.V.K.Sh, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe Spitali Rajonal Lezhë.

Ambulancat e Nj.V.K.Sh dhe 3 ambulanca nga 5 gjithsej të SRL, ndodheshin të dislokuara në të gjitha fshatrat dhe dhanë ndihmën e parë për njerëzit në nevojë:

Asistuan në këtë funksion edhe vullnetarët e KKSJ, Dega Rajonale Lezhë dhe Caritas.

U dha asistencë e nevojshme shëndetësore për:

- Shtrimin në spital për dy persona të lënduar.
- 2 banorë nga Nj.A Zejmen, 3 nga Nj.A Shënkoll, 1 nga Nj.A Kolsh dhe 4 nga qyteti i Lezhës.

Stafi i Nj.V.K.Sh dhe SRL të mbështetur nga KKSJ dhe Caritas kryenin triazhimin e popullsisë së evakuuar dhe ishin 24/7 në dispozicion të popullsisë sidomos asaj të evakuuar por edhe të FO në terren për çdo nevojë shëndetësore që paraqitej.

Vlerësimi fillestar dhe ai i specializuar i dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura

Grupet e vlerësimit të nevojave dhe dëmeve u ngritën nga Kryetari i Bashkisë dhe kryen urgjentisht vlerësimin me qëllim angazhimin e kapaciteteve të duhura përballuese. Grupet e vlerësimit të nevojave u drejtuan nga Drejtoria e MZSH së bashkisë Lezhë ndërsa ato të vlerësimit të dëmeve nga Drejtoria e Emergjencave Civile. Grupet përbëheshin nga ekspertë të strukturave më poshtë:

- Drejtoria e Emergjencave Civile;
- Drejtoria e Planifikimit të Territorit;
- Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit;
- Kullimit dhe Transportet specifike;

Sipas rastit, në vlerësimin e dëmeve në infrastrukturë, bujqësi dhe biznese grupet angazhuan ekspertë nga:

- Drejtoria Rajonale e Autoritetit Rrugor Shqiptar – Shkodër;
- Dega Lezhë e Drejtorisë së OSHEE Shkodër;
- Sh.A.Ujësjele Kanalizime;
- Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit;
- Sektori i Ekstensionit Bujqësor Lezhë dhe Sektori i Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Lezhë;
- Agjencia Rajonale e Mjedisit;
- ZVAP dhe DRAP;
- Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Rajonale Lezhë.

Bazuar në përcaktimet e VKM nr.329, datë 16.05.2012, komisionet e konstatimit të dëmeve dhe ato të vlerësimit të tyre, të përbërë nga ekspertë dhe punonjës së bashkisë kryen sipas afateve ligjore konstatimin dhe vlerësimin e dëmeve me qëllim dëmshpërblimin e tyre në një kohë sa më të shpejtë të mundshme.

Zbatimi i ligjit, masat e sigurisë dhe masat për ruajtjen e rendit publik, siguria dhe kontrolli i trafikut

Zbatimi i ligjit dhe sigurisë në rastin e emergjencës së përmbytjes lidhej me:

- Disiplinimin e trafikut në rrugët e dëmtuara dhe të përmbytura dhe devijimin e tij sipas zhvillimit të situatës;
- Sigurimin e lëvizjes pa pengesa të automjeteve zjarrfikëse, FA, ambulancave dhe automjeteve të tjera të FO dhe strukturave të tjera në mbështetje të operacioneve për në destinacionet e

- tyre. Për kryerjen e detyrave më lart ishin mobilizuar postbllloqe shtesë të Policisë Rrugore;
- Sigurimin nga plaçkitësit të banesave dhe bizneseve të dëmtuara nga dëmet e shkaktuara nga përmbytja dhe atyre të cilat u evakuuan për arsye sigurie. Kjo u krye nga disa patrulla shtesë të PSH që kryen shërbim 24/7 deri në kthimin e banorëve të evakuuar dhe pronarëve të bizneseve;
 - Sigurimin dhe ruajtjen e ambienteve të palestrës së gjimnazit “Hyddajet Lezha” ku ishin strehuar 6 familje të evakuara nga qyteti i Lezhës.

Në zbatimin e funksioneve të mësipërme, strukturat e PSH u asistuan edhe nga struktura e Policisë Bashkiake dhe FA.

Komunikimi, shkëmbimi i informacionit dhe procedurat e raportimit

Komunikimi operacional u krye midis niveleve të ndryshme, paralele, nga lart poshtë dhe anasjelltas. Komandanti i incidentit raportonte tek Drejtuesi i Operacionit në Bashki/DOB i cili nga ana e tij raportonte tek KMC në bashki. Komandanti i incidentit raportonte edhe tek Drejtuesi i Operacionit në Qark/DOQ i cili raportonte tek KMC i Prefektit. DOB nga ana e tij raporton tek DOQ i cili nga ana e tij raporton tek AKMC. Mjetet e komunikimit të përdorura ishin të ndryshme si me telefon fiks, smartfone, radiokomunikim me mediat lokale (Radio, TV Lezha). Nuk pati ndonjë problem në komunikimin me celular pavarësisht trafikut të thirrjeve për shkak të situatës emergjente. Në kushtet kur nuk ekziston ende një komunikim me radio midis forcave të ndryshme operationale, strukturat e PSH asistuan me radiot e tyre për këtë qëllim.

Shërbimet e Ndhmës Sociale, mbështetja psikosociale

Drejtoria e Shërbimit Social në Bashki e udhëhoqi këtë funksion, së bashku me Nj.V.K.Sh dhe ISHSH. Psikologët e bashkisë, SRL ishin në dispozicion dhe u angazhuan në ndihmë të popullatës së evakuuar por edhe të forcave operationale dhe punonjësve të tjerë të angazhuar në përgjigjen ndaj emergjencës. Asistuan në këtë funksion edhe vullnetarët e KESH-së dhe Caritas. Psikologët e ZVAP dhe DRAP asistuan në mënyrë të veçantë gjatë evakuimit, por jo vetëm, nxënësit e shkollës 9 vjeçare “Besëlidhja”.

Sigurimi dhe rivendosja në funksion e infrastrukturës publike dhe kritike

Impakti i fatkeqësisë në infrastrukturën publike dhe kritike është përmendur më lart në skenar. Ishin një sërë institucioneve, strukturash dhe subjekte joshtetërore të përfshira në këtë funksion si më poshtë:

Drejtoria e MZSH; Sh.A Ujësjellës Kanalizime Lezhë; Drejtoria e Shërbimeve Publike, Njësia e Mirëmbajtjes së Institucioneve; Drejtoria e Bujqësisë, Njësia e Bujqësisë, Ujit, Kullimit dhe Transportet specifike, bashki; Drejtoria e Bujqësisë, Njësia e Administrimit të Pyjeve; Njësitë Administrative; Dega Lezhë e Drejtorisë së OSHEE Shkodër; Drejtoria e Ujit dhe Kullimit Lezhë; ZVAP; DRAP; Drejtoria Rajonale e Autoritetit Rrugor Shqiptar – Shkodër; Caritas; bizneset e ndryshme etj.

Informimi i publikut për situatën/edukimin shëndetësor (marrëdhëniet me publikun dhe mediat)

Institucioni i Prefektit të qarkut dhe bashkia informuan në mënyrë konstante, para, gjatë dhe pas fatkeqësisë, popullatën e zonave në risk por edhe publikun në lidhje me fatkeqësinë, masat e marra nga organet shtetërore dhe udhëzuan qytetarët për veprimet që duhet të ndiqeshin prej tyre. Ata mbajtën një komunikim shumë të ngushtë si me median kombëtare ashtu edhe me median lokale TV Lezha.

Media tradicionale ndihmoi qysh në fazën e paralajmërimit të hershëm të dhënë nga AKMC mbështetur në parashikimin e rreziqeve nga IGJEUM dhe SHMU, në mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit dhe në alarmin përfundimtar për popullatën. Ajo sensibilizoi dhe informoi për veprimet që duhet të ndërmerre popullata (p.sh., rrugët e kalimit, rrugët e sigurta të evakuimit, strehimi etj.).

Në informimin e publikut ndihmoi edhe interneti dhe media sociale, në veçanti faqja e internetit të AKMC-së, faqja në fb e bashkisë Lezhë dhe ajo e AKMC-së. Strukturat e përfshira në informimin e publikut ishin Drejtoria e EC në bashki, Policia bashkiake, PSH dhe Njësitë Administrative.

Logjistika (transporti, magazinimi etj.)

Bazuar në shkallën e emergjencës, nevojat për shërbime transporti u përballuan kryesisht nga kapacitetet e automjeteve të vetë bashkisë. Në raste të veçanta, kur bashkia nuk i dispononte kapacitetet e nevojshme, ishte Prefektit i qarkut që koordinonte vendosjen në dispozicion të kapaciteteve shtesë nga degët territoriale të institucioneve në qark. U angazhuan në transport edhe 4 automjete "Iveco" të FA. Bashkia kërkoi, në koordinim me Prefektin, edhe vënien në dispozicion të kapaciteteve të njërit prej subjekteve private bazuar edhe në deklaratimet e tyre zyrtare për kapacitetet e tyre në dispozicion të përgjigjes ndaj emergjencave të dhëna në periudhën para fatkeqësisë.

FA, PSH, MZSH dhe SHU i përballuan me automjetet e tyre nevojat për transport të efektivave të tyre sikurse siguruan shërbime të tjera transporti në mbështetje të përgjigjes emergjente. Kapacitete magazinimi të nevojshme veçanërisht për sasi të barit të thatë, kashtës dhe koncentratit për gjënë e gjallë, u vendosën në dispozicion nga një subjekt privat. Magazinimi i pakove ushqimore për banorët e evakuuar por edhe të atyre në nevojë si pasojë e dëmtimit të banesave, u siguroa në një nga ambientet e bashkisë.

DH) Institucionet, agjencitë, strukturat dhe organizatat që u përfshinë në përgjigje të emergjencës së përmbytjes. Si u përfshinë dhe çfarë angazhuan ato?

Institucioni i Prefektit të Qarkut dhe KMC në qark

- Prefekti mblodhi urgjentisht KMC në Qark për emergjencën dhe dha detyrat përkatëse për koordinimin e veprimeve.
- Aktivizoi 24/7 KMC-në dhe QOE-në sikurse aktivizoi planin e emergjencave civile;
- Bazuar në kërkesat e bashkisë Lezhë dhe nevojave të evidentuara nga grupi i saj i vlerësimit të nevojave, KMC kreu koordinimin e të gjithë aktorëve në nivel qarku me qëllim plotësimin e të gjitha nevojave me kapacitete shtesë për përgjigjen ndaj emergjencës;
- Pas konkludimit të nevojave të bashkisë për kapacitete shtesë për përballimin e emergjencës, Prefekti koordinoi punën për angazhimin e të gjitha kapaciteteve që disponoheshin nga degët territoriale dhe strukturat në qark, OJQ dhe bizneset;
- Dërgoi menjëherë tek AKMC kërkesën për t'i drejtuar ShPPFA-së për kapacitetet përkatëse shtesë nga FA për S&R, evakuim, transport, asistencë në shpërndarje ndihmesh, asistencë në rehabilitimin e infrastrukturës etj.;
- Dërgoi menjëherë kërkesën për ekspertë rezervuarësh nga MBZHR;
- Përgatiti informacione periodike sipas kërkesës, për AKMC-në si dhe për publikun, median, donatorët, KKSH, dhe OJF- të e interesuara;
- Organizoi grupe pune për të ndjekur, kontrolluar e zbatuar detyra për monitorimin e situatës dhe marrjen e masave të ndryshme sipas problematikave të përgjigjes ndaj emergjencës;
- Nëpërmjet KMC-së mori të gjitha masat koordinuese dhe bashkërenduese për mbrojtjen e jetës së komunitetit, evakuimin, strehimin, furnizimin me artikujt e nevojshëm ushqimor, medikamente mjekësore, etj.

Bashkia Lezhë

- Mblodhi urgjentisht KMC për emergjencën dhe mori në vijimësi vendimet respektive;
- Aktivizoi 24/7 KMC-në dhe QOE-në sikurse aktivizoi planin e emergjencave civile;
- Siguroi 24/7 funksionalitetin dhe vënien në veprim për reagimin ndaj emergjencës të të gjitha strukturave të saj;
- Nën koordinimin e Prefektit, siguroi pjesëmarrjen e ekspertëve të bashkisë në grupe të përbashkëta si ato të vlerësimit, verifikimit dhe përditësimit të vazhdueshëm të të dhënave për situatën në zonat e prekura;
- Hartoi raportin e parë për situatën dhe informacione të mëtejshme periodike, të cilat iu dërguan Prefektit;
- Përgatiti informacione sipas kërkesës për Institucionin e Prefektit.
- Vendosi në funksion të mbështetjes emergjente të gjitha kapacitetet e duhura administrative, teknike dhe financiare;
- Menaxhoi të gjithë punën për vlerësimin e nevojave dhe dëmeve nga përmytja

Njësitë Administrative Zejmen, Shënkoll, Kolsh dhe Kallmet

- U mblodh menjëherë stafi i Njësisë Administrative i cili mobilizoi të gjithë burimet njerëzore mjetet logjistike që kishte në juridiksionin e tij nën drejtimin e KMC në bashki dhe Qark në funksion të operacioneve për përballimin e situatës;
- Kreu paralajmërimin e hershëm, njoftimin dhe alarmin për banorët e zonave në risk si edhe informimin e vazhdueshëm të KMC në bashki;
- Aktivizoi ekspertë nga Nj.A në grupet e punës për vlerësimin fillestar dhe të specializuar të dëmeve dhe të nevojave në zonën e fatkeqësisë;
- Organizoi punën me kapacitetet e Nj.A dhe me rrjetin e vullnetarëve që ka në zonë në ndihmë të operacioneve të evakuimit, strehimit, shpërndarjes së ndihmave etj.,

Strukturat e Forcave të Armatosura

Pas kërkesës së AKMC e cila përcolli shkresën urgjente të Prefektit të qarkut, ShPFA angazhoi në mbështetje të operacioneve emergjente:

- Komandën Mbështetëse, Brigadën e Mbrojtjes Rajonale; Motopompa Gaz 51 (1200 l/minutë për shkarkimin e ujit nga rezervuari Kallmet;
- DMR Burrel; 1 automjet zjarrfikës me 6 personel zjarrfikës për S&R, pastrimin dhe dezinfektimin e ndërtesave;
- Batalionin Mbështetës Rajonal të FA, Repartin e Këmbësorisë Malore të Repartit Ushtarak Nr.1010 në Vau Dejës dhe Batalionin Komando Zall Herr; 60 forca tokësore dhe 4 automjete Iveco me kalueshmëri të lartë për operacione të ndryshme mbështetëse në S&R, evakuim, pastrim dhe dezinfektim, transport, shpërndarje të asistencës etj., 2 varka, me motor me kapacitet transporti prej 18 vetash,

Strukturat e FA morën pjesë në:

- Operacione S&R të njerëzve të rrezikuar nga përmytja;
- Evakuimin e njerëzve, kafshëve dhe të pasurisë aty ku ishte e mundur;
- Kryerjen e punimeve në rezervuarin Kallmet për zbrazjen e ujit me pompën e kapacitetit të lartë dhe riparimin e ujëlëshuesve;
- Shërbimet e transportit me automjetet e FA të nevojshme gjatë operacioneve të ndryshme;
- Shpërndarjen e ndihmave humanitare;
- Kryerjen e punimeve për zhbllokimin e akseve rrugore nga lëndët inerte, pemët rrëshqitjet e dheut etj.
- Kontribuan, kur ishte e nevojshme në masat për zbatimin e ligjit, masat e sigurisë dhe masat për ruajtjen e rendit publik dhe kontrollin e trafikut;

Komisariati i Policisë në bashkinë Lezhë, Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë

- Siguruan paralajmërime të hershme dhe marrjen dhe përpunimin e informacioneve publike për përmbajtjen. Në bashkëpunim me Njësitë Administrative, Policinë bashkiake kryen informimin urgjent të popullatës që ndodhet në zonat me risk pranë zonës së emergjencës;
- Salla operative e Komisarariatit të Policisë në bashkinë Lezhë funksionoi në koordinim të QOE-së në Institucionin e Prefektit dhe QOE-në në bashki;
- Siguroi mbështetjen me mjete dhe forcat sa herë që kërkohej ndihmë nga KMC në Prefekturë dhe bashki duke venë në dispozicion të operacioneve në zonat e dëmtuara, mjetet, materialet dhe burimet njerëzore;
- Nga strukturat e qarkullimit rrugor u morën masat e duhura për garantimin e lëvizjes së mjeteve zjarrfikëse dhe mjeteve të tjera të rënda të gërmimit, të evakuimit, të urgjencës dhe të transportit dhe devijimet e detyruara të trafikut për shkak të situatës së emergjencës;
- Morën pjesë në operacionet e S&R, evakuimit dhe sigurimit të zonës si edhe të strehimit të banorëve të evakuuar;
- Morën pjesë në identifikimin e banorëve të dëmtuar;
- Kryen izolimin dhe ruajtjen e zonës së emergjencës dhe ruajtjen 24/7 të ndërtesave të evakuuara;
- Siguruan ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike si edhe bashkëpunimin në veprimet e mëtejshme hetimore;
- Siguruan ndihmë në informim dhe radiokomunikim gjatë emergjencës;
- Organizuan shërbim të përforcuar në të gjitha objektet e infrastrukturës publike dhe asaj kritike, siç janë porti, dhe në degët territoriale të institucioneve qendrore ose institucioneve të tyre të varësisë;

Nj.V.K.Sh dhe Inspektorati Shtetëror Shëndetësor

Nj.V.K.Sh vendosi në dispozicion ambulancat e Nj.A përkatëse sikurse ambulancat e Nj.A të tjera sipas nevojës.

- Mbajtën në gatishmëri urgjencat, laboratorët e specialistët mjekë e infermierë;
- Siguruan pajisje shëndetësore shtesë dhe gjak rezervë sikurse të gjithë sasinë e barnave të nevojshme në sasi të bollshme;
- Siguruan ndihmën e parë mjekësore dhe të urgjencës për të dëmtuarit;
- Krijuan ekipet shëndetësore të emergjencës dhe siguruan kujdesin mjekësor/ndihmën e parë gjatë emergjencës (triazhimi/klasifikimi);
- Vendosën në dispozicion personelin e domosdoshëm shëndetësor për t'u ardhur në ndihmë komunitetit në zonat e përmbytura;
- Siguruan përkujdesjen shëndetësore në të gjitha nivelet për shtetasit e dëmtuar;
- Mbështetën operacionet e S&R dhe evakuimit të të dëmtuarve nga banesat e dëmtuara dhe atyre në rrezik;
- Siguruan transportin tokësor dhe trajtimin e personave të dëmtuar;
- Siguruan dhënien e asistencës për popullsinë e strehuar tek të afërmit e tyre;
- Kryen kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm dhe të përdorimit familjar si dhe trajtimin etj.
- Siguruan kontrollin dhe ruajtjen e higjienës shëndetësore;
- Siguruan trajtimin e zonave të ndotura;
- Asistuan në shërbimet e ndihmës sociale, mbështetjen psikosociale dhe zvogëlimin e panikut;
- Vendosën ekspertët e kërkuar në dispozicion të grupeve të punës së ngritur nga bashkia për vlerësimin e nevojave dhe të dëmeve;

Spitali Rajonal Lezhë/SRL

SRL vendosi në dispozicion të operacioneve 4 ambulanca.

- Mbështeti operacionet e S&R dhe evakuimit të pacientëve nga banesat e dëmtuara dhe

atyre në rrezik;

- Siguroi kujdesin shëndetësor/ndihmën e parë gjatë emergjencës (triazhimi/klasifikimi);
- Asistoi në shërbimet e ndihmës sociale, mbështetjen psikosociale dhe zvogëlimin e panikut;
- Vendosi ekspertë në dispozicion të grupeve të punës për vlerësimin fillestar dhe atë të specializuar të dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura;

Inspektorati Kombëtar i Mjedisit dhe Territorit / IKMT

- Vendosi në dispozicion të grupeve të punës, ekspertë për vlerësimin fillestar dhe atë të specializuar të dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura;
- Vendosi në dispozicion dhe në funksion të përgjigjes emergjente, veçanërisht për rehabilitimin e infrastrukturës publike dhe kritike, të gjitha kapacitetet logjistike të kërkuara në KMC-në e qarkut.

Agjencia Rajonale e Mjedisit

- Vendosi në dispozicion të grupeve të punës, ekspertë për vlerësimin fillestar dhe atë të specializuar të dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura;
- Monitoroi impaktin mjedisor të fatkeqësisë në mjedis veçanërisht në ndotjen e ujit të pijshëm, të bimësisë dhe gjësë së gjallë;

Administrata e Zonave të Mbrojtura Qarku Lezhë

- Vendosi në dispozicion të grupeve të punës, ekspertë për vlerësimin fillestar dhe atë të specializuar të dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura;
- Angazhoi vullnetarët dhe peshkatarët e lagunave në operacionet S&R dhe evakuimit.
- Monitoroi ndikimin e përmbytjeve në zonat e mbrojtura.

Dega Lezhë e Drejtorisë së OSHEE Shkodër

- Riparoi në kohën më të shpejtë të mundshme defektin e krijuar në linjën e TM që la pa energji elektrike për 2 orë disa fshatra në Nj.A Zejmen, Shënkoll dhe Kolsh;
- Mbajti në gatishmëri rrjetin me qëllim furnizimin e pandërprerë me energji elektrike, veçanërisht në zonat e prekura nga përmbytja;
- Në shërbim të operacioneve të përgjigjes ndaj emergjencës, kreu ndërprerjen e detyruar të furnizimit me energji aty ku nevojitej si edhe njoftimin paraprak të publikut për to;
- Bashkëpunoi me drejtoritë homologe për furnizimin në mënyrë të pandërprerë me energji elektrike të hidrovorëve, pompave të ujit të ujësjesve dhe gjithë infrastrukturës publike dhe kritike;
- Mori masa për sigurimin e vazhdueshëm të furnizimit me energji elektrike të zonave të emergjencës (grumbullimit, zonave të pritjes);
- Vendosi në dispozicion të grupeve të punës, ekspertë për vlerësimin fillestar dhe atë të specializuar të dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura;
- Vendosi në dispozicion dhe në funksion të përgjigjes emergjente, veçanërisht për rehabilitimin e infrastrukturës publike dhe kritike, të gjitha kapacitetet logjistike të kërkuara në KMC-në e qarkut.

Drejtoria Rajonale e Autoritetit Rrugor Shqiptar – Shkodër

- Informoi në kohë për segmentet e bllokuara të rrugëve kombëtare dhe nëpërmjet kompanive kontraktore, garantoi zhblokimin dhe mbajtjen gjithmonë funksionale të tyre;
- Ofroi ekspertizën institucionale në grupet e punës për vlerësimin fillestar dhe atë të specializuar të dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura;
- Nëpërmjet kontraktorëve asistoi në ofrimin e logjistikës për transportin dhe sigurimin dhe rivendosjen në funksion të infrastrukturës publike dhe kritike;
- Nëpërmjet kontraktorëve ofroi kapacitete mbështetëse në riparimin e segmenteve rrugore nën juridiksionin e bashkisë.

Drejtoria Ujitjes dhe Kullimit Lezhë

- Vendosi në dispozicion të grupeve të punës, ekspertë për vlerësimin fillestar dhe atë të specializuar të dëmeve dhe nevojave;
- Asistoi në sigurimin dhe rivendosjen në funksion të infrastrukturës publike dhe kritike veçanërisht për forcimin e argjaturave, hapjen e kanaleve kullues por edhe zhbllokimin e segmenteve rrugorë;
- Asistoi në shërbimet e transportit të kryera gjatë përballimit të emergjencës;
- Organizoi vrojtim të pandërprerë dhe informoi Prefektin dhe bashkinë për situatën e përmblyjes;
- Komunikoi me drejtorin e Hidrocentralit Shkopet për ecurinë e shkarkimit të prurjeve nga portat e shkarkimit;
- Asistoi me mjetet dhe ekspertizën institucionale në shkarkimin e detyruar të rezervuarit Kallmet sikurse riparimin e ujëlëshuesve të tij;
- Monitoroi hidrovorët, rezervuarët, argjinaturat e lumenjve dhe kolektorët e ujërave të larta.

Sektori i Ekstensionit Bujqësor Lezhë dhe Sektori Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Lezhë

- Ofruan ekspertizën institucionale në grupet e punës për vlerësimet fillestare dhe të specializuara të dëmeve dhe të nevojave në bujqësi, blegtori, biznese etj.;
- Ekspertizë në ndikimin e përmblyjes në ndotjen e bimësinë dhe gjësë së gjallë si edhe evidentimin e nevojave për ushqim të gjësë së gjallë;
- Evidentuan sasinë e reshjeve, sipërfaqet e përmblytura dhe probleme të tjera lidhur me kushtet atmosferike;
- Adresuan çështjet e lidhura me 80 bagëti të ngordhura, ato të ngelura pa strehë nga fatkeqësia;
- Rekomanduan dhe zbatuan masat e miratuara nga KMC për mjekimin, asgjësimin apo groposjen e gjësë së gjallë;

Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit

- Ofrroi ekspertizën institucionale në grupet e punës për vlerësimet fillestare dhe të specializuara të dëmeve dhe të nevojave në bujqësi, blegtori, biznese etj.;
- Vlerësoi riskun nga përmblytja dhe bashkërendoi dhe realizoi kontrollin zyrtar të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë dhe të mbrojtjes së bimëve;
- Mori pjesë në këshillimin e publikut për situatën dhe risqet në sektorin e ushqimit;

DPRMSH dhe Drejtoria Rajonale e Rezervave të Shtetit Dibër

- Dërgoi urgjentisht ndihmën ushqimore, veshmbathje dhe artikujt e tjerë të jetesës së kërkuar nga bashkia nëpërmjet Prefektit të qarkut për popullsinë e evakuuar dhe strehuar;
- Vuri në dispozicion tenda për popullsinë e evakuuar si edhe tenda, kashtë, bar të thatë dhe koncentrat për strehimin e gjësë së gjallë;
- Bashkërendoi punën me KMC e Institucionit të Prefektit dhe KMC në bashki për shpërndarjen e ndihmave tek popullsia në nevojë;
- Me automjetet e DPRMSH kreu shpërndarjen e ndihmave të DPRMSH-së nga magazinat e saj në qytetin e Lezhës;

ZVAP dhe DRAP

- Ofrroi ekspertizën institucionale në grupet e punës për vlerësimet fillestare dhe të specializuara të dëmeve dhe të nevojave në arsim etj.;
- Monitoruan nga afër shkallën e rrezikut për secilën nga institucionet arsimore dhe informuan menjëherë Prefektin dhe Kryetarin e bashkisë për ato institucione që duhet të ndërpritej përkohësisht frekuentimi;
- Drejtuan procesin e riparimit të dëmeve të shkollës "Kosova" në lagjen "Besëlidhja" dhe fillimit të procesit mësimor;

- Ofruan shërbimet e ndihmës sociale dhe mbështetjes psikosociale për nxënësit dhe stafin arsimor veçanërisht në shkollën e përmbytur;
- Në bashkëpunim me autoritetet e menaxhimit të emergjencës, bashkëpunoi për organizimin dhe përkujdesjen për nxënësit gjatë operacioneve të transportit;
- Mbajtën në gatishmëri grupet e shpëtimit dhe shoqërimit të nxënësve dhe evakuimit të tyre, me qëllim regjistrimin e nxënësve të evakuuar dhe dërgimin e tyre pranë familjeve në rast nevojë.

Porti Shëngjin

- Vendosi në dispozicion të emergjencës 1 automjet zjarrfikës dhe staf prej 6 zjarrfikësish për pastrimin dhe dezinfektimin e banesave;
- Ofrroi ekspertizën institucionale në grupet e punës për vlerësimet fillestare dhe të specializuara të dëmeve dhe të nevojave në zonat e prekura;
- Mbështeti operacionet e evakuimit të popullsisë civile;

Dega e Kryqit të Kuq Shqiptar Lezhë

- Ofrroi ekspertizën institucionale në grupet e punës për vlerësimet fillestare dhe të specializuara të dëmeve dhe të nevojave në zonat e prekura;
- Mbështeti operacionet e evakuimit të popullsisë civile, strehimit të përkohshëm të njerëzve dhe gjësë së gjallë;
- Mbështeti stafin mjekësor të angazhuar në kujdesin mjekësor/ndihmën e parë gjatë emergjencës (triazhimi/klasifikimi) dhe asistoi në mbështetjen psikosociale/zvogëlimin e panikut.

Caritas Lezhë

- Ofrroi ekspertizën institucionale në grupet e punës për vlerësimet fillestare dhe të specializuara të dëmeve dhe të nevojave në zonat e prekura;
- Mbështeti operacionet e evakuimit të popullsisë civile, strehimit të përkohshëm të njerëzve dhe gjësë së gjallë;
- Mbështeti stafin mjekësor të angazhuar në kujdesin mjekësor/ndihmën e parë gjatë emergjencës (triazhimi/klasifikimi);
- Asistoi në punimet e kryera për rivendosjen në funksion të infrastrukturës publike.

MZSH bashkia Shkodër

Vuri në dispozicion të përgjigjes emergjente:

- 1 automjet zjarrfikës me 6 personel zjarrfikës për S&R, pastrimin dhe dezinfektimin e ndërtesave;
- Modulën kombëtar dhe ndërkombëtar Pompimi me kapacitet të lartë (High Capacity Pumping) për shkarkimin urgjent të ujit nga rezervuari Kallmet.

U angazhua në funksionet emergjente si më poshtë:

- Operacionet e shkarkimit të ujit nëpërmjet pompave nga rezervuarit Kallmet;
- Mbështetje në operacionet e S&R;
- Operacionet e pastrimit nga mbeturinat të banesave të përmbytura.

MZSH e bashkisë Vau i Dejës, Kurbini dhe Mirditë

Secila prej tyre mobilizuan nga 1 automjet zjarrfikës me 3 personel zjarrfikës të cilat morën pjesë në:

- Operacionet e S&R;
- Operacionet e pastrimit nga mbeturinat të banesave të përmbytura;
- Nxjerrjen e ujit nga katet e para të ndërtesave të përmbytura

Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin në bashkinë Lezhë

MZSH e bashkisë Lezhë është struktura kryesore për operacionet e S&R dhe evakuimit e cila siguroi komandën, kontrollin dhe koordinimin e të gjitha burimeve në vendet e incidentit.

- Ajo mobilizoi në funksion të operacioneve të gjitha kapacitetet bazuar planit operacional dhe planit të emergjencave civile dhe pjesëmarrjen e forcave dhe mjeteve të MZSH-së në operacionet e ndryshme të S&R; evakuimit të njerëzve; evakuimit të gjësë së gjallë dhe ushqimit të tyre; nxjerrjen e ujit nga katet e para të ndërtesave të përmbytura dhe më pas pastrimin e tyre nga balta dhe mbeturinat;
- Siguroi lidhjen dhe informimin e vazhdueshëm të QOE-se dhe KMC-së në bashki dhe Institucionin e Prefektit sikurse të Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së në MB;
- Siguroi pajisjen e forcave me pajisjet mbrojtëse personale për të operuar në zonën e operacionit në të cilin ishin caktuar; dhe siguroi që të gjitha forcat e përfshira në operacione të mbështeteshin dhe menaxhoheshin nga një ekip ndër-agjensi i menaxhimit të incidentit;
- Para mobilizimit, kreu një informim specifik për të gjitha incidentet dhe në të u përfshinë përshkrimi i incidentit, kërkesat e misionit dhe rreziqet e njohura. U identifikuan pajisjet mbrojtëse kryesore dhe nevojat shoqëruese për detyrat që punonjësit nuk i ndeshin apo kryejnë në mënyrë rutinë;
- Pas konkludimit mbi pamjaftueshmërinë e kapaciteteve të bashkisë Lezhë për përballimin e emergjencës, iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH në MB për vënien në dispozicion të kapaciteteve shtesë nga bashkitë e tjera;
- Bashkërendoi veprimet me strukturat e FA, PSH, SHU, strukturave të tjera të bashkisë, degëve territoriale dhe vullnetarëve që u përfshinë në operacionet e S&R dhe evakuimit;
- Udhëhoqi punën e grupeve të ngritura nga Kryetari i bashkisë për vlerësimin e nevojave dhe dha kontribut në grupet për vlerësimin e dëmeve;
- Udhëhoqi gjithë procedurat e komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit gjatë operacioneve;
- Mori pjesë krahas strukturave të tjera në operacionet e kryera në rezervuarin Kallmet për zbrazjen e detyruar të ujit me pompa me kapacitet të lartë dhe riparimin e ujëlëshuesve të dëmtuar;
- Mori pjesë në operacionet e rivendosjes në funksion të infrastrukturës publike dhe kritike si dhe për forcimin e argjinaturave dhe hapjen e kanaleve kullues.

Drejtoria e Emergjencave Civile në bashkinë Lezhë

- Drejtoi gjithë procesin e dhënies së paralajmërimit të hershëm, njoftimit dhe alarmit për popullsinë e zonave në rrezik;
- Siguroi funksionimin 24/7 të drejtorisë si Sekretariat i KMC-së së bashkisë Lezhë;
- Siguroi mbarëvajtjen e punës së QOE-së sikurse të KMC-së në bashki;
- Siguroi informimin e vazhdueshëm të Prefektit, publikut, medias, donatorëve, KKSH-së, dhe OJF- të interesuara;
- Vendosi ekspertë në përbërje të grupeve të punës për vlerësimin fillestar të nevojave dhe kryesoi punën e grupeve të vlerësimit të dëmeve;
- Drejtori i Emergjencave Civile në bashki dhe një staf i kësaj drejtorie mbështetën Drejtuesin e Operacionit (Përgjegjës in e Sektorit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në Institucionin e Prefektit);
- Së bashku me komandantët e incidentit paraqiti propozimet në lidhje me evakuimin tek Drejtuesi i Operacionit në bashki.

Policia bashkiake

- Asistoi në operacionet e dhënies së paralajmërimit të hershëm, njoftimit dhe alarmit për popullsinë e zonave në rrezik;

- Asistoi në evakuimin dhe strehimin e popullsisë civile dhe të gjësë së gjallë;
- Asistoi PSH në operacionet e ndryshme siç janë ato të ruajtjes së rendit publik, sigurisë dhe kontrollit të trafikut rrugor, ruajtjes së banesave të evakuuara, këshillimin e banorëve të zonave me risk etj.

Drejtoria e Bujqësisë, Njësia e Administrimit të Pyjeve

- Mori pjesë në grupet e punës për vlerësimin paraprak dhe të specializuar të dëmeve dhe nevojave;
- Nëpërmjet vrojtuesve të saj, dha informacionet dhe ekspertizën e saj në lidhje me problematikat e ndryshme që u shfaqën me infrastrukturën mbrojtëse nga përmbytjet, sipërfaqet e përmbytura të tokave bujqësore, ndotjet e tokave nga përmbytjet etj.;
- Kontribuoi në punimet emergjente që u kryen në funksion të rehabilitimit të infrastrukturës publike veçanërisht asaj të mbrojtjes nga përmbytjet;
- Asistoi me mjetet dhe ekspertizën institucionale në shkarkimin e detyruar të rezervuarit Kallmet sikurse riparimin e ujëlëshuesve të tij;
- Rekomanduan dhe zbatuan masat e miratuara nga KMC për mjekimin, asgjësimin apo groposjen e gjësë së gjallë.

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Njësia e Mirëmbajtjes së Institucioneve

- Asistoi në operacionet e evakuimit dhe strehimit të popullsisë;
- Kontribuoi në punimet emergjente që u kryen në funksion të rehabilitimit të infrastrukturës publike dhe kritike;
- Me forcat dhe mjetet që disponon, sikurse nëpërmjet kontraktorëve, siguroi mbajtjen funksionale të segmenteve të rrugëve nën juridiksionin e bashkisë;
- Koordinoi punën me Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Rrugor Shqiptar – Shkodër për veprimtari të përbashkëta në mbajtjen funksionale të segmenteve rrugore nacionalë;
- Asistoi me mjetet dhe ekspertizën institucionale në shkarkimin e detyruar të rezervuarit Kallmet sikurse riparimin e ujëlëshuesve të tij;
- Ofroi lehtësira logjistike (transporti, magazinimi etj.).

Drejtoria e Bujqësisë, Njësia e Bujqësisë, Ujit, Kullimit dhe Transportet specifike, Bashki

- Mori pjesë në grupet e punës për vlerësimin paraprak dhe të specializuar të dëmeve dhe nevojave;
- Ofroi lehtësira logjistike (transporti, magazinimi etj.);
- Komunikoi me drejtorët e Hidrocentraleve Ulëz dhe Shkopet për ecurinë e shkarkimit të prurjeve nga portat e shkarkimit;
- Asistoi me mjetet dhe ekspertizën institucionale në shkarkimin e detyruar të rezervuarit Kallmet sikurse riparimin e ujëlëshuesve të tij;
- Asistoi në sigurimin dhe rivendosjen në funksion të infrastrukturës publike dhe kritike veçanërisht për forcimin e argjinaturave, hapjen e kanaleve kullues por edhe zhbllokimin e segmenteve rrugorë;
- Monitoroi hidrovorët, rezervuarët, argjinaturat e lumenjve dhe kolektorët e ujërave të larta.

Sh.A Ujësjiellës Kanalizime

- Mori pjesë në grupet e punës për vlerësimin paraprak dhe të specializuar të dëmeve dhe nevojave;
- Mbajtë në gatishmëri linjat e furnizimit me ujë të pijshëm të popullatës së prekur nga përmbytja;
- Garantoi sistem të sigurt të largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në përputhje me standardet kombëtare të ruajtjes së shëndetit dhe mjedisit;
- Monitoroi pandërprerë dhe informoi urgjentisht Kryetarin e bashkisë dhe Prefektin e qarkut

për çdo problematikë të shfaqur në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve si pasojë e situatës së krijuar nga përmytja;

- Bashkëpunoi me Drejtorinë e Higjienës për kryerjen e analizave periodike dhe klorifikimin e ujit të pijshëm;
- Bashkëpunoi me Degën Lezhë të Drejtorisë së OSHEE Shkodër për sigurimin në vazhdimësi të punës së elektropompave që furnizojnë depot e ujit;
- Siguroi furnizimin e nevojshëm me ujë të ambienteve të shkollës “Hyddajet Lezha” ku ishin familjet e strehuara;
- Kontribuoi në punimet emergjente që u kryen në funksion të rehabilitimit të infrastrukturës publike veçanërisht asaj të rrjetit të ujësjellës kanalizimeve;
- Asistoi me mjetet dhe ekspertizën institucionale në shkarkimin e detyruar të rezervuarit Kallmet sikurse riparimin e ujëlëshuesve të tij;
- Ofroi lehtësira logjistike (transporti, magazinimi etj.)

FIGURA 21 Sipërfaqet e përmytura sipas skenarit (google earth)





FIGURA 22 Sipërfaqet e përmytura historikisht (ArcMap)



dëmshpërblimi është detyrim i bashkisë. Koha në të cilën pronarët e banesave të dëmtuar do t'i përfitojnë këto dëmshpërblime do të varet nga shpejtësia me të cilën bashkia do të përgatisë dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës por edhe nga disponibiliteti i fondit të nevojshëm;

- Impakti i fatkeqësisë shtrihet edhe në infrastrukturë si linjat elektrike, argjinaturat, kanalet kulluese e kolektorët, pritave malore, rrugët dhe veprat e artit etj. Ka një pritshmëri të madhe për rehabilitimin afatshkurtër të një pjese të dëmeve të infrastrukturës, si asaj që është nën juridiksionin e institucioneve qendrore ashtu edhe dhe asaj nën juridiksionin e bashkisë. Problematike mbetet rehabilitimi i pritave malore të dëmtuara sikurse i segmenteve të ndryshëm të rrugëve rurale.

Më poshtë do të gjeni disa nga masat kryesore strukturore dhe jostrukturore që sugjerohen të ndërmerren nga bashkia me qëllim përgatitjen e saj për përballimin e përmbytjeve në të ardhmen.

- Përfshirja nga ana e bashkisë së masave të ZRF dhe MC në politikat e saj zhvillimore dhe zbatimi i tyre;
- Planifikimi i detajimit të buxhetit bashkiak prej të paktën 4 % për ZRF dhe MC bazuar në dokumentin e vlerësimit të Riskut të Fatkeqësive dhe prioritetet strategjike për integrimin e politikave të ZRF në politikat e zhvillimit të bashkisë;
- Trajnime të vazhdueshme të stafit të Drejtorisë së Emergjencave Civile, Drejtorisë së MZSH, të KMC-së dhe banorëve për gatishmërinë dhe përgjigjen ndaj fatkeqësive nëpërmjet të cilave të sigurohet edhe rishikimi i vazhdueshëm i dokumentit të vlerësimit të Riskut të fatkeqësive dhe i planit vendor të emergjencave civile;
- Bazuar në dokumentin e vlerësimit të riskut të fatkeqësive, të kryhet informimi i vazhdueshëm i komuniteteve të zonave me risk për cenueshmërinë e tyre ndaj përmbytjes;
- Rritja e ndërgjegjësimit publik të komunitetit, trajnimi dhe përgatitja e tij për të qenë në gjendje për t'u vetëmbrojtur, për ndihmën reciproke dhe për t'u përgjigjur si duhet si komunitet i tërë ndaj fatkeqësive;
- Rritja e kapaciteteve logjistike të gatishmërisë dhe atyre reaguese të bashkisë ndaj përmbytjeve. Një pjesë e buxhetit prej 4% për ZRF dhe MC, duhet të shpenzohet për blerjen e mjeteve dhe pajisjeve si zjarrfikëse, automjete shpëtimi, automjete gërmimi, automjete transporti me kalueshmëri të lartë, autoshtetë, varka, gjeneratorë, tenda, soba, thasë rëre, sharra, pompa etj. sikurse edhe artikuj të ndihmës së parë për popullsinë e strehuar (krevate portativë, batanije, çarçafë, jastëkë, dyshekë, shtroje plastike). Kjo do ta bëjë bashkinë më të aftë, më të pavarur, fleksibël dhe të shpejtë në reagimin e saj të parë ndaj emergjencave në përgjithësi dhe përmbytjes në veçanti;
- Bazuar në dokumentin e vlerësimit të riskut të fatkeqësive të kryhet mirëmbajtja e infrastrukturës mbrojtëse ndaj përmbytjeve që ka bashkia nën juridiksionin e saj si kanalet e dyta dhe të treta dhe kolektorët, pritave malore dhe rezervuarët. Në veçanti për këta të fundit bashkia duhet të fillojë realisht një proces të shpejtë të evidentimit të problematikave të secilit prej tyre për të filluar edhe me marrjen e masave strukturore për rehabilitimin sa më të shpejtë të tyre sipas një radhe prioritare;
- Rritja e shkallës së informimit dhe ndërgjegjësimit të banorëve për sigurimin privat ndaj fatkeqësive në përgjithësi dhe përmbytjes në veçanti. Rritja e ndërgjegjësimit të fermerëve për domosdoshmërinë e sigurimit privat të aktiviteteve të tyre bujqësore dhe blegtorale ndaj fatkeqësive.
- Në zbatim të VKM nr.147, datë 18.3.2004 dhe Udhëzimit të përbashkët të gjashtë ministrive nr. 248, datë 28.01.2000, Bashkia në bashkëpunim me Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit të zbatojë të gjitha detyrimet e saj institucionale, në veçanti të hartojë planin e alarmit, evakuimit dhe ndihmës për mbrojtjen e popullatës dhe vlerave materiale në rastet e jashtëzakonshme, si pasojë e prishjes së digës.

9.11. SKENARI I ZJARRIT NË PYLL NË MALIN E SHËNGJINIT, BASHKIA LEZHË

Muaji Gusht, ditë pune, ora 13.00

FIGURA 25. Foto nga zjarret në Shëngjin në verën e vitit 2016



A) Vlerësimi periodik i realitetit në bashkinë Lezhë.


Historikisht pyjet janë mjaft të rrezikuara nga rënia e zjarreve si nga shkaqe natyrore ashtu dhe humane. Pothuajse çdo vit, në periudhën e nxehtë të verës, në territorin e bashkisë Lezhë ndodhin zjarre që përfshijnë sipërfaqe të mëdha pyjesh e kullotash. Më tepër informacion mbi zjarret në pyje gjendet në seksionin 9.12.4 të këtij plani.

B) Çfarë e shkaktoi emergjencën e zjarrit?

Arsyet e rënies së zjarreve në bashkinë Lezhë janë nga më të ndryshmet. Në bazë të përvojave dhe njohurive të deritanishme, në 99 % të rasteve të shfaqjes së këtyre zjarreve si shkak paraqitet njeriu, në mënyrë direkte ose indirekte. Shkaktarët e zjarreve në pyje mund të jetë thatësira gjatë gjithë verës, era e fortë, temperaturat e larta, lagështia e ulët të cilat shkaktojnë kushte të jashtëzakonshme thatësire në pyll. Rrufeja apo vetëndezja e pyjeve kap vetëm 1% të rasteve.

Rënia e zjarreve në pyje/kullota ku shkaktar është njeriu, ndodh nga pakujdesia, padituria, piromania si sëmundje apo qëllim i pastër. Zjarret e shkaktuara nga pakujdesia apo padituria, përfshijnë kryesisht zjarret e shkaktuara nga njerëzit që punojnë në pyje apo kullota të cilët kryejnë punime operacionale në këto zona. Këto zjarre ndodhin zakonisht në pranverën e hershme kur vegjetacioni barishtor nga viti i kaluar është i thatë dhe vegjetacioni i ri nuk ka filluar akoma. Këtu si shkaktarë të zjarreve janë mbledhësit e frutave pyjore, bimëve medicinale, gjahtarët, fermerët apo edhe turistët. Zjarret e qëllimshme bëhen me synim që të zgjerojnë tokën e punueshme apo kullotat, ku njeriu ndez zjarrin pa llogaritur pasojat. Motivet e këtyre zjarreve janë nga më të ndryshmet, ato mund të jenë edhe për përfitim ekonomik, për përfitim dru të lirë për dru zjarri apo ndërtim, për të mbuluar prerjet ilegale. Konkretisht zjarri i skenarit, vlerësohet se është shkaktuar nga persona të cilët kryenin veprimtari në pyll.

FIGURA 26. Skema e aktorëve qeveritarë dhe joqeveritarë të angazhuar në përballimin e emergjencës sipas skenarit të zjarrit në Shëngjin



C) Ndikimet e emergjencës së zjarrit mbi njerëzit, pasurinë, infrastrukturën, gjënë e gjallë, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin? Popullsia e prekur, ajo e zhvendosur, karakteristikat e tyre.

Zjarri u shua në orën 7.00 të ditës së pestë të tij, pra kohëzgjatja e tij ishte 114 orë. Qyteti Shëngjin ka një popullsi rreth 4'000 banorë. Nga ky zjarr kërcënohen rreth 200 banesave që janë me një popullsi rreth 1000 banorë;

- Nga zjarri kishim këto dëmtime në njerëz:
 - 1 efektivi i MZSH-së Shkodër me djegie të vogla që u dërgua në spital;
 - 2 efektivë të FA me shqetësime të aparatit frymëmarrës dhe 4 banorë që iu dha ndihma e parë e nevojshme në vend nga ambulancat e Nj.V.K.SH Lezhë dhe e SRL që ndodheshin të dislokuara në afërsi të aksit rrugor Lezhë-Shëngjin;
- Ndikimet më të mëdha të zjarrit të rënë janë në masivin pyjor me pisha dhe shkurre të malit të Shëngjinit nga i cili u dogjën nga zjarri 68 ha, dhe u përshkuan 52 ha;
- U dëmtuan pjesërisht nga flakët, 5 ndërtesa banimi 2 katëshe dhe 2 ndërtesa 1 katëshe në

- të cilat banonin 30 banorë;
- Pësuan dëmtime në muret rrethuese dhe muret e jashtme 5 biznese: tre hotele dhe dy restorante;
 - Djegia e këtij masivi pyjor ndikon negativisht në cilësinë e ajrit gjatë kësaj periudhe, në zonë;
 - Sipërfaqet e djegura, ndër të tjera, do të rrisin dukurinë e erozionit sikurse mundësinë e rrëshqitjeve të dherave dhe të masivëve shkëmbore dhe gurëve. Këto të fundit do të rrisin shumë edhe riskun nga rrokullisjet e shkëmbinjve dhe gurëve çka, duke marrë parasysh terrenin shumë të pjerrët të masivit pyjor, do të shoqërohet me një impakt të madh negativ në sigurinë e popullsisë së qytetit në përgjithësi dhe të lagjes mbi zonën e Portit në veçanti;
 - Zjarri ndikoi në bllokimin e trafikut rrugor në aksin rrugor Shëngjin-Lezhë në vendin e quajtur Sakë, duke e devijuar vetëm nga Kenalla në drejtim të Kunes e duke sjellë kështu shqetësime për qarkullimin e banorëve por edhe të turistëve dhe pushuesve që po kalojnë pushimet verore në Shëngjin. Po kështu është ndaluar trafiku për në Rërën e Hedhur, në degëzimin në afërsi të portit të Shëngjinit.
 - Kohëzgjatja e zjarrit ishte e madhe dhe shkaktoi panik në zonë. Për shkak edhe të reve të tymit në qytet, e në plazhin në drejtim të Rërës së Hedhur, një pjesë e pushuesve dhe turistëve në Shëngjin i ndërpreu pushimet dhe u larguan nga qyteti. Retë e mëdha të tymit që shtyheshin nga erërat e fuqizuara për shkak të flakëve të zjarrit shkakton një ndotje dhe shqetësim për popullsinë e qytetit por edhe zonave përreth vatrave të zjarrit;
 - U dëmtua nga zjarri në dy pika linja e TM (10Kv) e cila furnizon kabinat elektrike në zonën e Portit dhe katër kabinat tek Rëra e Hedhur. Po ashtu u dëmtua në 3 vende në konturin nga ana e zjarrit edhe rrjeti i TU që furnizon zonën në anën e malit.

Ç) Nevojat humanitare tek popullsia e prekur. Nevojat për përgjigje. Burimet dhe pajisjet që do të nevojiten dhe burimet dhe pajisjet që disponohen aktualisht. Trajtimi i problematikave që dolën.

Nevojat e evidentuar për shkak të zjarrit janë:

- Njoftimi i gjithë banorëve të zonave të banuara përreth për t'u larguar nga banesat në risk nga zjarret;
- Izolimi dhe shuarja sa më shpejt e vatrave të zjarrit;
- Kërkim shpëtimi në disa prej ndërtesave që dyshohet për banorë të bllokuar;
- Evakuimi dhe strehimi tek të afërmit/spitalin Rajonal Lezhë i banorëve të evakuuar;
- Evakuimi dhe strehimi në hotele të tjera të sigurta i turistëve dhe pushuesve në 3 hotelet e evakuuara;
- Triazhimi dhe mjekimi i efektivëve, vullnetarëve, banorëve të dëmtuar gjatë operacioneve dhe e banorëve të evakuuar; Dërgimi në Spitalin Rajonal Lezhë i të plagosurve;
- Riparimi i infrastrukturës së dëmtuar nga zjarri (linja elektrike e TM dhe TU)

Kapacitetet e nevojshme për t'u angazhuar janë:

- E gjithë struktura e MZSH-së së bashkisë Lezhë;
- Kapacitete logjistike dhe njerëzore të strukturave të tjera të bashkisë Lezhë që nevojiten në operacionet e ndryshme të përgjigjes ndaj emergjencës dhe që janë:
 - Drejtoria e Emergjencave Civile;
 - Policia bashkiake;
 - Drejtoria e Bujqësisë, Njësia e Administrimit të Pyjeve;
 - Drejtoria e Shërbimeve Publike, Njësia e Mirëmbajtjes së Institucioneve;
 - Drejtoria e Bujqësisë, Njësia e Bujqësisë, Ujit e Kullimit dhe Transportet specifike në bashki;
 - Drejtoria e Shërbimit Social

Nevojat për kapacitete reagimi shtesë përveç atyre të bashkisë janë:

- Agjencia Rajonale e Mjedisit;
- Komisariati i Policisë në bashkinë Lezhë dhe Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë;
- Inspektorati Kombëtar i Mjedisit dhe Territorit / IKMT;
- Administrata e Zonave të Mbrojtura Qarku Lezhë;
- Dega Lezhë e Drejtorisë së OSHEE Shkodër;
- Dega Lezhë e Drejtorisë së OST Shkodër;
- Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor;
- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor;
- Spitali Rajonal Lezhë/SRL;
- Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Rajonale Lezhë.

TABELA 28. Institucionet e angazhuara dhe kapacitetet e vëna në dispozicion

Nr.	Institucioni/struktura	Kapacitetet e angazhuara
1	Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit/ MZSH i bashkisë Lezhë	2 automjete zjarrfikëse dhe 12 personel zjarrfikës
		Drejtorja e Emergjencave Civile - 2 punonjës në ndihmë të Drejtuesit të Operacioneve
2	Forca të tjera nga bashkia Lezhë	Drejtorja e Shërbimeve. 2 automjete dhe 4 punonjës
		Njësia Administrative Shëngjin - 6 punonjës
		Drejtorja e Bujqësisë, Njësia e Administrimit të Pyjeve në bashki, me 5 inspektorë pjesh
3	MZSH bashkia Shkodër	1 automjet zjarrfikës me 6 personel zjarrfikës
4	MZSH i bashkisë Vau i Dejës	1 automjet zjarrfikës me 3 personel zjarrfikës
5	MZSH i bashkisë Kurbin	1 automjet zjarrfikës me 3 personel zjarrfikës
6	MZSH i bashkisë Mirditë	1 automjet zjarrfikës me 3 personel zjarrfikës
7	Porti Shëngjin	1 automjet zjarrfikës me 3 personel zjarrfikës
8	Forcat e Armatosura	1 Helikopter
9	Batalioni Mbështetës Rajonal i Forcave të Armatosura, Repartit të Këmbësorisë Malore të Repartit Ushtarak Nr.1010 në Vau Dejës dhe Batalioni Komando Zall Herr	100 forca tokësore
10	DMR Burrel	1 automjet zjarrfikës me 3 personel zjarrfikës
11	Njësia Administrative Shëngjin	10 vullnetarë nga Nj.A Shëngjin
12	Vullnetarë nga KKSH, Dega Rajonale Lezhë	5 vetë
13	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor. Qendra Shëndetësore Shëngjin	1 ambulancë dhe stafi mjekësor përkatës pranë reaguesve dhe banorëve
14	Spitali Rajonal Lezhë	1 ambulancë dhe stafi mjekësor përkatës pranë reaguesve dhe banorëve
15	Komisariati i Policisë në bashkinë Lezhë dhe Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë	2 patrulla të policisë rrugore në akset rrugore SH 32, Lezhë-Shëngjin me qëllim devijimin e trafikut nga kjo rrugë dhe drejtimin e tij vetëm në drejtim të zonës së Kunes, si dhe ndalimin e qarkullimit në drejtim të Rërës së Hedhur. Efektiva shtesë të PSH për ruajtjen e banesave të evakuuara
16	Dega Lezhë e Drejtorisë së OSHEE Shkodër	Një skuadër e riparimit të avarive nga ana e OSHEE për riparimin e defektit të shkaktuar në linjat elektrike
17	Drejtorja e Shërbimit Social në Bashki. Nj.V.K.SH dhe ISHS	Punonjës socialë dhe psikologë për asistimin e reaguesve, popullsisë, turistëve dhe pushuesve të evakuuar

D) Funkcionet operationale për përballimin e fatkeqësisë së zjarrit

Paralajmërimi i hershëm dhe informacioni publike për emergjencat, këshillimi i publikut

Për vetë natyrën e emergjencës, nuk ishte e mundur paralajmërimi i hershëm i banorëve të zonave përreth vatrave të zjarrit. Gjithsesi një informacion urgjent për zjarrin e rënë popullata e mori përmes medias tradicionale e sociale, por edhe njoftimeve derë më derë që kreu stafi i Njësisë Administrative Shëngjin i mbështetur nga ai i bashkisë Lezhë. Gjithashtu banorët u njoftuan nëpërmjet sirenave të vetë automjeteve zjarrfikëse që mbërritën menjëherë në vijën e zjarrit. Dhënia e alarmit për popullsinë e zonave në rrezik u drejtua nga Drejtoria e Emergjencave Civile në bashki dhe u mbështet nga PSH dhe Policia Bashkiake.

Operacionet e shuarjes së zjarreve

Operacionet e shuarjes së zjarreve me automjete zjarrfikëse u kryen nga MZSH Lezhë së bashku me strukturat e MZSH-ve të bashkive Shkodër, Vau i Dejës, Mirditë, Kurbin dhe Porti Shëngjin. Operacionet e izolimit dhe shuarjes së zjarreve me pompa shpine, kazma, lopata dhe me mjete të tjera rrethanore u kryen nga 100 trupat e batalioneve Vau i Dejës dhe Zall Herr të dërguara nga ShPFA të mbështetura edhe nga 10 vullnetarë të Njësisë Administrative Shëngjin dhe 10 vullnetarë të AZM. Struktura mbështetëse të operacioneve, me detyra specifike, ishin strukturat e PSH, Nj.V.K.SH, KKSH, SRL dhe ISHSH.

Organizimi dhe drejtimi, koordinimi qendror / i përgjithshëm i përballimit të emergjencës

Organizimi dhe drejtimi u kryen nga KMC në qark dhe KMC në bashki. Bazuar në shkallën e emergjencës dhe përvojës, Bashkia nuk i kërkoi Prefektit të Qarkut dërgimin e kërkesës për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore sikurse edhe nga Prefekti i Qarkut nuk u pa e udhës dërgimi i një kërkesë të tillë. Bazuar shkresës së Prefektit të qarkut Lezhë nr.771/1 prot., datë 7.6.2018, Drejtuesi i Operacionit u caktua Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në Institucionin e Prefektit i cili u mbështet nga Drejtori i Emergjencave Civile në bashki dhe një staf i kësaj drejtorie.

Kërkim-shpëtimi

U krye në një prej banesave në të cilën ndodhej një çift të moshuarish dhe që për shkak të tymit të dendur nuk mundeshin të lëviznin.

Forcat e angazhuara në operacionet e S&R ishin ato të MZSH Lezhë të mbështetura nga PSH. Forca mbështetëse ishin edhe personeli i Nj.V.K.SH dhe SRL.

Evakuimi i popullsisë civile

Vendimi për evakuim u mor nga Prefekti i Qarkut në mbledhjen e KMC-së në qark. Propozimi për evakuim erdhi nga Drejtuesi i Operacionit në bashkëpunim me Drejtorin e Emergjencave Civile. U evakuuan 120 banorët e banesave të dëmtuara dhe atyre të rrezikuara, 95 turistët dhe pushuesit nga 3 hotelet sikurse stafi i bizneseve të dëmtuara dhe atyre në rrezik. Për evakuimin e njerëzve, gjëse së gjallë, u përdorën automjete të bashkisë, PSH dhe FA por edhe automjetet e tyre private.

Operacionet u asistuan edhe nga Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, Njësia e Mirëmbajtjes së Institucioneve, Dega Rajonale Lezhë e KKSH, Nj.V.K.Sh dhe SRL;

Strehimi i përkohshëm

Popullsia prej 120 banorësh e evakuuar nga banesat, u strehuan tek të afërmit e tyre.

95 turistët dhe pushuesit e evakuuar nga 3 hotelet u akomoduan nga NjA Shëngjin në disa hotele të tjerë në zonën Kune në Shëngjin.

Strukturat që u angazhuan në strehimin e banorëve, turistëve dhe pushuesve ishin Njësia Administrative Shëngjin, PSH, Policia bashkiake, Drejtoria e Shërbimit Social në bashki dhe Dega Rajonale Lezhë e KSSH.

Kujdesi mjekësor/ndihma e parë gjatë emergjencës (triazhimi/klasifikimi)

Në dispozicion të përballimit të emergjencës ishin Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe Spitali Rajonal Lezhë.

Ambulanca e SRL (pas miratimit të vendosjes në dispozicion të operacioneve nga Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore) që ndodhej e dislokuar në afërsi të aksit rrugor Lezhë-Shëngjin dhe ambulanca tjetër e Nj.V.K.SH dhanë ndihmën e parë për:

- 1 efektiv të MZSH-së së lënduar gjatë operacioneve që i dhanë asistencën shëndetësore sikurse e dërguan me ambulancë në spital;
- 2 efektiva të FA të angazhuar në shuarjen e zjarrit nga toka, dhe 4 banorë, të cilët paraqitën problem të aparatit të frymëmarrjes, që u dhanë në vend asistencën e nevojshme. Nuk ishte e nevojshme dërgimi i tyre për trajtim të mëtejshëm shëndetësor.

Asistuan në këtë funksion edhe vullnetarët e KSSH, Dega Rajonale Lezhë.

Vlerësimi fillestar dhe ai i specializuar i dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura

MZSH Lezhë kreu vlerësimin e situatës fillestare të zjarrit dhe të dëmit dhe përcaktoi mënyrën e përshtatshme të reagimit për të përmbushur kërkesën për ndihmë. Vlerësimi i nevojave dhe dëmeve të shkaktuara u krye nga grupi i punës së ngritur nga bashkia Lezhë. Grupi u drejtua nga MZSH e bashkisë Lezhë i përbërë nga:

- Njësia Administrative Shëngjin;
- Drejtoria e Emergjencave Civile në bashki;
- Drejtoria e Planifikimit të Territorit;
- Drejtoria e Bujqësisë, Njësia e Administrimit të Pyjeve;
- Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit;
- Kontribuan në vlerësimin e nevojave dhe dëmeve:
- Sektori i Ekstensionit Bujqësor Lezhë;
- Agjencia Rajonale e Mjedisit;
- Administrata e Zonave të Mbrojtura;

Zbatimi i ligjit, masat e sigurisë dhe masat për ruajtjen e rendit publik, siguria dhe kontrolli i trafikut

Zbatimi i ligjit dhe sigurisë në këtë rast lidhej me:

- Disiplinimin e trafikut në rrugët rreth zonës së zjarreve dhe devijimin e tij sipas zhvillimit të situatës së zjarreve;
- Sigurimin e lëvizjes së automjeteve zjarrfikëse, ambulancave dhe automjeteve të tjera në mbështetje të operacioneve për në destinacionet e tyre.
- Sigurimin dhe ruajtjen nga plaçkitësit të banesave dhe bizneseve të dëmtuara dhe atyre të cilat u evakuuan për arsye sigurie. Kjo u krye nga 2 patrulla të PSH që kryen shërbim 24/7 deri në kthimin e banorëve të evakuuar në banesat e tyre dhe të stafit në bizneset e evakuuara.

Për kryerjen e detyrave më lart ishin mobilizuar 2 postbllloqe shtesë të Policisë Rrugore.

Në zbatimin e funksioneve të mësipërme, strukturat e PSH u asistuan edhe nga struktura e Policisë Bashkiake.

Komunikimi, shkëmbimi i informacionit dhe procedurat e raportimit

Komunikimi u krye midis niveleve të ndryshme, paralele, nga lart poshtë dhe anasjelltas. Mjetet e komunikimit të përdorura janë të ndryshme si me telefon, celular, radiokomunikim me mediat lokale (Radio, TV). Në kushtet kur nuk ka ende një komunikim me radio midis forcave të ndryshme operacionale, strukturat e PSH asistuan me radiot e tyre për këtë qëllim.

Shërbimet e Ndhmës Sociale, mbështetja psikosociale

Drejtoria e Shërbimit Social në Bashki e udhëhoqi këtë funksion, së bashku me Nj.V.K.SH dhe ISHSH. Psikologët ishin në dispozicion dhe u angazhuan në ndihmë të popullatës së evakuuar por edhe të forcave operacionale dhe punonjësve të tjerë të angazhuar në përgjigjen ndaj emergjencës. Asistuan në këtë funksion edhe vullnetarët e KKSH-së.

Sigurimi dhe rivendosja në funksion e infrastrukturës publike dhe kritike

Ditën e parë të emergjencës, nga zjarri u dëmtua linja elektrike e tensionit të mesëm e të ulët; OSHEE mori masa për eliminimin e menjëhershëm të avarive të krijuara nga zjarret dhe ndërprerjen e detyruar të furnizimit me energji aty ku nevojitej. Një skuadër e riparimit të avarive nga ana e OSHEE e riparoj defektin e shkaktuar në linjën elektrike.

Asistencë në sigurimin dhe rivendosjen në funksion të infrastrukturës publike dhe kritike u dha edhe nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Njësia e Mirëmbajtjes së Institucioneve.

DH) Institucionet, agjencitë, strukturat dhe organizatat që u përfshinë në përgjigje të këtij skenari? Si u përfshinë dhe çfarë angazhuan ato?

Institucioni i Prefektit të Qarkut dhe KMC në qark

- Prefekti mblodhi urgjentisht KMC në Qark dhe aktivizoi QOE (nëse është operacionale);
- Bazuar në kërkesat e bashkisë Lezhë dhe nevojave të evidentuara nga grupi i vlerësimit të nevojave të ngritur me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë, KMC kreu koordinimin e të gjithë aktorëve në nivel qarku me qëllim plotësimin e të gjitha nevojave me kapacitete shtesë për përgjigjen ndaj emergjencës së zjarrit;
- Pas konkludimit të nevojës për helikopterë dhe kapacitete shtesë të FA për shuarjen e zjarrit, Prefekti dërgoi menjëherë tek AKMC kërkesën për t'iu drejtuar menjëherë ShPFA-së;
- Përgatiti informacione periodike sipas kërkesës për AKMC-në si dhe për publikun, median, donatorët, KKSH, dhe OJF- të e interesuara;
- Organizoi grupe pune për të ndjekur, kontrolluar e zbatuar detyra për monitorimin e situatës dhe marrjen e masave të ndryshme sipas problematikave që kanë të bëjnë përgjigjen ndaj emergjencës;
- Nëpërmjet KMC-së koordinoi të gjitha masat koordinuese dhe bashkërenduese për mbrojtjen e jetës së komunitetit, evakuimin, strehimin, furnizimin me artikujt e nevojshëm ushqimor, medikamente mjekësore, etj.

Bashkia Lezhë

- Mblodhi urgjentisht KMC për konsultime për zjarrin dhe mori vendimet respektive;
- Aktivizoi 24/7 Qendrën Operacionale të Emergjencave Civile (nëse është operacionale);
- Siguroi 24/7 funksionalitetin dhe vënien në veprim për reagimin ndaj zjarrit të të gjitha strukturave të saj;
- Nën koordinimin e MZSH, siguroi pjesëmarrjen e ekspertëve të bashkisë në grupe të përbashkëta të vlerësimit dhe verifikimit të dëmeve dhe të nevojave për përbalimin e situatës së zjarreve;
- Siguroi informacion të vazhdueshëm dhe të përditësuar rreth situatës në terren nga grupet e përbashkëta të vlerësimit për situatën;
- Hartoi raportin e parë për situatën dhe informacione të mëtejshme periodike, të cilat u

- dërguan Prefektit;
- Përgatiti informacione sipas kërkesës për Institucionin e Prefektit.

Njësia Administrative Shëngjin

- Mobilizoi të gjithë burimet njerëzore mjetet logjistike që ka në juridiksionin e tij nën drejtimin e KMC në bashki dhe Qark në funksion të operacioneve për shuarjen e zjarrit;
- Kreu njoftimin dhe alarmin për gjithë popullsinë në rrezik si edhe informimin e KMC në bashki;
- Aktivizoi ekspertë nga Nj.A në grupet e punës për vlerësimin fillestar dhe të specializuar të dëmeve dhe të nevojave në zonën prekur nga zjarri;
- Organizoi punën me kapacitetet e Nj.A dhe me rrjetin e vullnetarëve që ka në zonë për operacionet e evakuimit, strehimit etj.,

Forcat e Armatosura

2 orë pas marrjes së kërkesës së drejtuar nga Prefekti i qarkut dhe të miratuar dhe përcjellë nga AKMC, ShPFA angazhoi në mbështetje të përgjigjes emergjente:

- 1 helikopter që kreu gjithsej 40 orë fluturime mbi vatrat e zjarrit dhe hodhi rreth 100 kova uji;
- 100 forca tokësore nga Batalioni Mbështetës Rajonal i Forcave të Armatosura, Repartit të Këmbëorisë Malore të Repartit Ushtarak Nr.1010 në Vau Dejës dhe Batalioni Komando Zall Herr që u angazhuan së bashku me forcat e MZSH-ve dhe vullnetarët në operacionet e shuarjes së zjarrit;
- 1 automjet zjarrfikës me personelin përkatës nga DRM Burrel që operoi në shuarjen e zjarreve bashkë me automjetet e MZSH-ve dhe Portit Shëngjin.

Agjencia Rajonale e Mjedisit

Vendosi në dispozicion të grupeve të punës, ekspertë për vlerësimin fillestar dhe atë të specializuar të dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura.

Komisariati i Policisë në bashkinë Lezhë, Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë

- Salla operative e Komisarariatit të Policisë në bashkinë Lezhë funksionoi në koordinim të QOE në Institucionin e Prefektit dhe QOE në bashki;
- Nëpërmjet grupeve të ekspertëve të strukturave të specializuara morën masat e duhura për evidentimin dhe vënien para përgjegjësisë të autorëve të zjarrvënies;
- Siguroi mbështetjen me mjete dhe forcat sa herë që kërkohej ndihmë nga KMC në Prefekturë dhe bashki;
- Nga strukturat e qarkullimit rrugor u morën masat e duhura për garantimin e lëvizjes së mjeteve zjarrfikëse në vatrat e zjarrit apo në objekte me risk zjarri dhe devijimet e detyruara të trafikut për shkak të situatave të krijuara nga zjarret;
- Morën pjesë në operacionet e kërkim shpëtimit, evakuimit dhe sigurimit të zonës si edhe të strehimit të banorëve të evakuuar;
- Morën pjesë në identifikimin e banorëve të dëmtuar;
- Kryen izolimin dhe ruajtjen e zonës së emergjencës;
- Siguruan ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike;
- Në bashkëpunim me Policinë bashkiake kryen informimin urgjent të popullatës që ndodhej në zonat me risk pranë zonës së emergjencës;
- Siguruan ndihmë në informim dhe radiokomunikim;

Inspektorati Kombëtar i Mjedisit dhe Territorit/IKMT

- Vendosi në dispozicion të grupeve të punës, ekspertë për vlerësimin fillestar dhe atë të specializuar të dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura;
- Vendosi në dispozicion dhe në funksion të shuarjes së zjarreve të gjitha kapacitetet.

Administrata e Zonave të Mbrojtura Qarku Lezhë

- Vendosi në dispozicion të grupeve të punës, ekspertë për vlerësimin fillestar dhe atë të specializuar të dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura;
- Vendosi në dispozicion dhe në funksion të shuarjes së zjarreve 10 vullnetarë.

Dega Lezhë e Drejtorisë së OSHEE Shkodër

- Garantoi furnizimin e pandërprerë të energjisë elektrike, veçanërisht në qytetin e Shëngjinit si dhe informimin e publikut për ndërprerjet e planifikuara për shkak të zjarreve;
- Mori masa për ndërprerjen e detyruar të furnizimit me energji aty ku nevojitej dhe njoftimin e banorëve për këtë. Një skuadër e riparimit të avarive riparoj defektin e shkaktuar në linjën elektrike.

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor dhe Inspektorati Shtetëror Shëndetësor

- Mbajtën në dispozicion dhe në shërbim të situatës 1 automjet ambulancë të Qendrës Shëndetësore Shëngjin;
- Mbajtën në gatishmëri të emergjencës, laboratorët e specialistëve mjekë e infermierë;
- Siguruan pajisje shëndetësore shtesë dhe gjak rezervë sikurse të gjithë sasinë e barnave të nevojshme në sasi të bollshme;
- Krijuan ekipet shëndetësore të emergjencës për të siguruar kujdesin mjekësor në dhënien e ndihmës së parë gjatë emergjencës, triazhimi/klasifikimi;
- Mbështetën operacionet e evakuimit të pacientëve nga banesat e dëmtuara nga flakët dhe atyre në rrezik si edhe ato të kërkim shpëtimit;
- Siguruan transportin tokësor të personave të dëmtuar;
- Siguruan dhënien e asistencës për popullsinë e strehuar tek të afërmit e tyre;
- Asistuan në shërbimet e ndihmës sociale, mbështetjen psikosociale/zvogëlimin e panikut.

Spitali Rajonal Lezhë/SRL

- Mbështeti operacionet e S&R dhe evakuimit të pacientëve nga banesat e dëmtuara nga flakët dhe atyre në rrezik;
- Siguroi kujdesin shëndetësor/ndihmën e parë gjatë emergjencës (triazhimi/klasifikimi);
- Asistoi në shërbimet e ndihmës sociale, mbështetjen psikosociale/zvogëlimin e panikut.

Drejtorja e MZSH-së së bashkisë Lezhë

- MZSH e bashkisë Lezhë është struktura kryesore për zbulimin dhe shuarjen e zjarreve në ambient të hapur, rural dhe urban e cila siguron komandën, kontrollin dhe koordinimin e të gjitha burimeve;
- Ajo mobilizoi në funksion të operacioneve të shuarjes së zjarreve të gjitha kapacitetet bazuar planit operacional dhe planit të emergjencave civile;
- Siguroi lidhjen dhe informimin e vazhdueshëm të QOE-se dhe KMC-së në bashki dhe Institucionin e Prefektit sikurse të Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së në MB;
- Kreu vlerësimin e situatës fillestare të zjarrit dhe të dëmit dhe përcaktoi mënyrën e përshtatshme të reagimit ndaj zjarrit;
- Analizoi secilën kërkesë para angazhimit të forcave dhe burimeve të tjera;
- Siguroi pajisjen e forcave me pajisjet mbrojtëse personale për të operuar në zonën e operacionit në të cilin ishin caktuar; dhe siguroi që të gjitha forcat e përfshira në përgjigjen ndaj zjarrit të mbështeteshin dhe menaxhoheshin nga një ekip ndër-agjensi i menaxhimit të incidentit;
- Para mobilizimit, kreu një informim specifik për të gjitha incidentet dhe në të u përfshinë përshkrimi i incidentit, kërkesat e misionit dhe rreziqet e njohura. U identifikuan pajisjet mbrojtëse kryesore dhe nevojat shoqëruese për detyrat që punonjësit nuk i ndeshin apo kryejnë në mënyrë rutinë;

- Pas konkludimit mbi pamjaftueshmërinë e kapaciteteve të bashkisë Lezhë për fikjen e zjarrit iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit në MB për vënien në dispozicion të kapaciteteve luftuese shtesë nga bashkitë e tjera;
- Iu argumentua Kryetarit të Bashkisë domosdoshmëria e përfshirjes në operacionet e shuarjes së zjarrit edhe të helikopterëve të FA dhe forcave tokësore për luftimin e zjarrit;
- Bashkërendoi veprimet me strukturat e FA, PSH, SHU, strukturave të tjera të bashkisë, degëve territoriale dhe vullnetarëve që u përfshinë në operacionin e shuarjes së zjarreve;
- Udhëhoqi punën e grupeve për vlerësimin fillestar dhe atë të specializuar të dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura;
- Angazhoi forca në operacionet e kërkim-shpëtimit që u kryen në një banesë për një çift të moshuarish;
- Udhëhoqi gjithë procedurat e komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit gjatë operacioneve.

Drejtoria e Emergjencave Civile në bashkinë Lezhë

- Drejtoi gjithë procesin e dhënies së alarmit për popullsinë e zonave në rrezik nga zjarri;
- Siguroi funksionimin 24/7 të drejtorisë si Sekretariat i KMC-së së bashkisë Lezhë;
- Siguroi mbarëvajtjen e punës së QOE-së sikurse të KMC-së në bashki;
- Siguroi informimin e vazhdueshëm të Prefektit, AKMC-së, publikut, medias, donatorëve, KKS-së, dhe OJF të interesuara;
- Vendosi ekspertë në përbërje të grupeve të punës për vlerësimin fillestar dhe atë të specializuar të dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura;
- Drejtori i Emergjencave Civile në bashki dhe një staf i kësaj drejtorie mbështetën Drejtuesin e Operacionit (Përgjegjës të Sektorit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në Institucionin e Prefektit);
- Së bashku me Drejtorinë e MZSH paraqiti propozimin për evakuim tek Drejtuesi i Operacionit.

Policia bashkiake

- Asistoi në operacionet e dhënies së alarmit për popullsinë e zonave në rrezik nga zjarri;
- Asistoi në evakuimin dhe strehimit të popullsisë civile;
- Asistoi PSH në operacionet e ndryshme siç janë ato të ruajtjes së rendit, disiplinimit të qarkullimit, ruajtjes së banesave të evakuuara, këshillimin e banorëve të zonës me risk etj.

Drejtoria e Bujqësisë, Njësia e Administrimit të Pyjeve

- Njëpërmjet vrojtuesve të saj siguron paralajmërimet e hershme në lidhje me zjarret ekzistues dhe vatrat e reja të zjarreve;
- Mori pjesë në grupet e punës për vlerësimin paraprak dhe të specializuar të dëmeve dhe nevojave për shuarjen e zjarrit.

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Njësia e Mirëmbajtjes së Institucioneve

- Asistoi në operacionet e evakuimit të popullsisë nga zona e prekur nga zjarri;
- Kontribuoi në punimet emergjente që u kryen në funksion të përgjigjes ndaj emergjencës së zjarrit, sikurse janë hapjet e rrugëve në pyll, pastrimit të brezave të izolimit nga zjarri, punime të ndryshme në funksion të rehabilitimit të infrastrukturës zonën urbane etj.;

Drejtoria e Bujqësisë, Njësia e Bujqësisë, Ujit, Kullimit dhe Transportet specifike, Bashki

- Mori pjesë në grupet e punës për vlerësimin paraprak dhe të specializuar të dëmeve dhe nevojave për shuarjen e zjarrit;
- Kontribuoi në punimet emergjente që u kryen në funksion të përgjigjes ndaj emergjencës së zjarrit, sikurse janë hapjet e rrugëve në pyll, pastrimit të brezave të izolimit nga zjarri, punime të ndryshme në funksion të rehabilitimit të infrastrukturës zonën urbane etj.;

Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Rajonale Lezhë

- Asistoi në operacionet e evakuimit dhe strehimit të popullsisë nga zona e prekur nga zjarri;
- Asistoi në operacionet e dhënies së alarmit për popullsinë e zonave në rrezik nga zjarri;
- Asistuan në shërbimet e ndihmës sociale, mbështetjen psikosociale / zvogëlimin e panikut.
- Asistuan në triazhimin dhe mjekimin e efektivëve, vullnetarëve, banorëve të dëmtuar gjatë operacioneve dhe të banorëve të evakuuar;

E) Sfidat ose vështirësitë që mund të sjellë kjo fatkeqësi për Njësinë Administrative, bashkinë? Si mund të parapërgatiten Njësia Administrative, bashkia për përballimin e këtyre sfidave?

Të gjitha masat që merren për parandalimin e zjarreve sipas kohës kur ndërmerren dhe qëllimit të tyre, ndahen në :

Masat preventive. Janë masa mbrojtjeje kundër zjarreve që merren vazhdimisht gjatë gjithë vitit. Për shkak se njeriu është shkaktar i tyre në 99% të rasteve, edhe këto masa janë të përqendruara plotësisht ndaj njeriut. Qëllimi final është të parandalohet shkaktimi i zjarreve dhe të zvogëlohet numri i këtyre zjarreve. Në këtë kuadër këto masa janë:

Masa ligjore, mbrojtja e pyjeve/kullotave rregullohet me ligje dhe akte nënligjore ku mbrojtja e tyre është përgjegjësi e të gjithëve por edhe e pronarëve (bashkisë apo subjekteve private) si edhe subjekteve që i menaxhojnë ato.

Masat edukative janë masa të cilat në vetvete përfshijnë edukimin e njerëzve dhe përdoren për të gjithë grupmoshat, megjithëse më të përdorurat janë për të rinjtë deri në 18 vjet. Mënyrat janë nga më të ndryshmet që nga mësimet në librat shkollorë, leksione të hapura për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret, përdorimi i revistave, fletëpalosjeve, internetit, TV etj.

Masa informative - propagandistike, qëllimi i tyre është për të paralajmëruar dhe informuar njerëzit për rreziqet nga paraqitja e zjarreve në pyje si edhe për të informuar se si duhet të sillemi gjatë qëndrimit në pyll. Kjo masë kombinohet edhe me atë edukative.

Masa strukturore. Hapja e rrugëve në sipërfaqet pyjore me qëllimin mundësimin e aksesit të forcave ndërhyrëse në rastet e zjarreve.

Masa përgatitore. Duke pasur parasysh që masat preventive nuk e zgjidhin plotësisht problemin e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret, është e domosdoshme marrja e masave përgatitore. Këto masa kanë një natyrë të përhershme gjatë gjithë vitit dhe në to përfshihen:

- Zbulimi në kohë i zjarrit;
- Transferimi i informacionit mbi zjarrin;
- Organizimi i zjarrfikëseve dhe vullnetarëve;
- Ndërtimi i hendeqeve kundra zjarrit;
- Përgatitja e planit operativ vjetor për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret.

Pavarësisht nga masat më të mira preventive të marra, zjarret përsëri ndodhin. Për këtë arsye nevojiten masat direkte. Këto janë masa të cilat ndërmerren gjatë kohëzgjatjes së zjarrit dhe synojnë lokalizimin dhe shuarjen e tij.

FIGURA 27. Sipërfaqja e zjarrit Shëngjin sipas skenarit (google earth)



9.12. HISTORI FATKEQËSISH NATYRORE DHE FATKEQËSISH TË TJERA NË TERRITORIN E BASHKISË LEZHË

Shqipëria është goditur mesatarisht nga një fatkeqësi natyrore madhore në vit gjatë dekadave të shkuara. Vetëm në tre dekada, përkatësisht nga viti 1980 deri në vitin 2010, kanë ndodhur 23 fatkeqësi të tilla, prej të cilave nëntë fatkeqësi kanë qenë përmbytjet, katër tërmete si dhe 3 goditje nga temperaturat ekstreme. Për shkak të këtyre fatkeqësive, gjatë kësaj periudhe humbën jetën 163 njerëz, ndërsa rreth 4 milion banorë u ndikuan në një masë të caktuar²⁹.

Bashkia Lezhë, është ndër territoret e ekspozuara ndjeshëm në Shqipëri nga një numër i konsiderueshëm fatkeqësish natyrore dhe fatkeqësish të tjera. Rreziku më i madh nga fatkeqësitë natyrore të ndodhura janë tërmetet por veç tyre, sidomos në dekadat e fundit kanë qenë mjaft të shpeshta përmbytjet, zjarret, rrëshqitjet e tokës, rënia e gurëve etj.

(Të dhënat në vijim mbi historikun e fatkeqësive natyrore janë mbledhur nga ato zyrtaret të paraqitura në raportet e planet për emergjencat e ndodhura në nivel Bashkie, takimet me Institucionet e konsultat me komunitetin, publikimet e mediave etj.).

9.12.1. Tërmetet (Gjeorreziket)

Tërmetet e fuqishme për nga pasojat, lenë më shumë gjurmë në historinë ngjarjeve të fatkeqësive natyrore të ndodhura. Territori i Bashkisë së Lezhës zë vend në shtrirje përgjatë bregdetit të brezit tërmetor Adriatiko-Jonik, tërmetet e fuqishme të cilat kanë kushtëzuar potencialin sizmik të saj. Ky territor që bën pjesë në zonën sizmoaktive Joniko-Adriatike, vlerësohet me potencial sizmik me magnitudë 6.0-7.0 shkalla Rihter dhe intensitet epiqendrore 8-9 ballë MSK-64 dhe është prekur disa herë nga lëkundjet sizmike. Në vijim po përshkruajmë shkurt disa nga tërmetet më të fortë që kanë goditur Shqipërinë nga rajoni i Durrësit deri në Shkodër e nga deti Adriatik në kufirin lindor ku përfshihet dhe territori i Bashkisë së Lezhës.

Tërmetet e vitit 1905 (Tërmetet e Shkodrës)

Goditja më e fortë ka ndodhur në 1 qershor 1905. Magnituda e këtij tërmeti është përcaktuar MS=6.6; dhe intensitet mbi 9 ballë. Ky tërmet shkaktoi dëmtime të rënda në njerëz dhe pasuri në Shkodër dhe fshatrat përreth (veçanërisht në fshatrat në jug - perëndim të Shkodrës). Janë shkatërruar plotësisht rreth 1500 shtëpi banimi vetëm në qytetin e Shkodrës; të gjitha shtëpitë e tjera të këtij qyteti u dëmtuan rëndë; u dëmtua edhe kalaja e Rozafës. Ky tërmet shkaktoi rreth 200 të vdekur dhe 500 të plagosur. Lëkundjet e këtij tërmeti në zonën e Bashkisë të Lezhës janë vlerësuar me intensitet 8 ballë.

Tërmeti i 18 Dhjetorit 1926

Në dhjetor të vitit 1926 Durrësi dhe rajonet rreth tij u goditën nga një seri tërmetesh shumë të fortë. Goditja e parë e fortë ndodhi më 16 Dhjetor; ajo u pasua nga goditje të tjera të forta më 17 Dhjetor. Në këtë datë, ndodhi një goditje e fortë, e cila u pasua nga një goditje më e fuqishme që dëmtoi Durrësin, Shijakun e Ishmin. U shkatërruan dhe u dëmtuan shumë shtëpi. Kjo goditje kishte magnitudë Ms=5.8. Ajo u shoqërua me shumë goditje të tjera. Në 18 Dhjetor u regjistrua një goditje tjetër me magnitudë Ms=6.2. Kjo goditje shkatërroi e dëmtoi shumë ndërtesa në Durrës, Kavajë e Shijak dhe në fshatrat rreth tyre. Në shkallën e dëmtimit padyshim kanë influencuar dhe goditjet e forta që paraprinë atë. Në Kavajë u dëmtuan rëndë të gjitha shtëpitë dhe u këputën minaret e xhamive. Midis Durrësit e Shijakut pati dukuri të lëngëzimit të truallit të shfaqura me shatërvanë më

29 "Dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në Shqipëri", Shtator 2018, botim i REC.

ujë të nxehtë e sulfur dhe pseudovullkane balte, rëre e ujë. Tërmeti u ndje shumë fort në Tiranë në Shkodër, Berat, Lushnjë, Elbasan. Në Itali u ndje 5 ballë në Pulje ndërsa në Greqi 4 ballë në Janinë e Korfuz. Intensiteti i tërmetit është vlerësuar 9 ballë të shkallës MSK-1964, Ky tërmet është shoqëruar nga shumë pasgoditje të cilat vazhduan edhe gjatë vitit 1927. Intensiteti i këtij tërmeti në zonën e Bashkisë të Lezhës ka qenë deri 7 ballë të shkallës MSK-1964.

Tërmeti i 30 Nëntorit 1967

Tërmeti i 30 Nëntorit 1967 pati një magnitudë $MS=6.6$ dhe intensitet 9 ballë dhe dëmtoi rëndë rrethet e Dibrës dhe të Librazhdit si dhe një pjesë të territorit të Maqedonisë perëndimore. Në rrethet e Dibrës dhe të Librazhdit nga ky tërmet u prekën 13 lokalitete me 177 fshatra, vdiqën 12 veta dhe u plagosën 174 të tjerë. Viktima në njerëz pati edhe në territorin e Maqedonisë Perëndimore. Ky tërmet është shoqëruar nga më shumë se 1200 pasgoditje dhe është ndjerë në zonën e Bashkisë së Lezhës si një lëkundje 5-6 ballësh.

Tërmeti i 15 Prillit 1979

Ky tërmet (tërmeti i zonës kufitare Shqipëri-Mali i Zi), është një nga më të fortët që ka goditur gadishullin e Ballkanit gjatë shekullit të XX-të dhe që ka lenë më shumë gjurmë të dallueshme deri sot si fatkeqësi natyrore. Magnituda e tij është llogaritur $Ms=7.2$ dhe intensiteti në epiqendër është vlerësuar 9-10 ballë të shkallës MSK-1964. Epiqendra e këtij tërmeti është në bregdetin Adriatik, pranë Petrovacit, në Mal të Zi.

Shumë paragoditje e kanë paraprirë këtë tërmet rreth dy javë para goditjes kryesore të 15 Prillit, kurse pasgoditjet vazhduan për rreth 9 muaj. Pasgoditja më e fortë është ajo e 24 Majit 1979, me magnitudë $MS=6.3$. Intensiteti i këtij tërmeti në epiqendër është 8 ballë (MSK-64). Goditja kryesore e 15 Prillit shkaktoi 35 të vdekur dhe 382 të plagosur në Shqipëri. Më shumë se 100.000 banorë (shumica në rajonet e Shkodrës dhe Lezhës) mbetën pa shtëpi.

FIGURA 28. Pamje nga puna për eliminimin e pasojave të tërmetit të 15 Prillit 1979



U shkatërruan pothuajse plotësisht 17'122 shtëpi banimi dhe objekte social-kulturore. Dëmet më të mëdha në njerëz dhe të mira materiale u shkaktuan në bregdetin Malazet. Tërmeti i 15 Prillit 1979 u ndje fort në të gjithë territorin e Shqipërisë. Lëkundjet e këtij tërmeti shkaktuan dëmtime edhe në rrethin e Krujës; intensiteti i lëkundjeve në Bashkinë e Lezhës ka arritur 8 ballë.

Tërmeti i 26 Nëntor 2019

Më shumë se dyzet vjet pas tërmetit të vitit 1979, me 26 Nëntor 2019, Shqipëria u godit nga një tërmet me magnitudë 6.4 Rihter. Tërmeti kishte si epiqendër detin Adriatik, në afërsi të qytetit

të Durrësit, dhe një thellësi rreth 27 km. Si pasojë, dëme të shumta janë shkaktuar në ndërtesa në Qarkun Durrës, Tiranë e Lezhë. Në total 51 njerëz mbetën të vdekur nga tërmeti dhe mbi 3,000 vetë u plagosën, 5200 banorë mbetën të pastrehë. Në bashkinë e Lezhës nuk u raportuan humbje në jetë njerëzore por dëme në të gjithë territorin e bashkisë në ndërtesa. Si rezultat, në këtë bashki 76 familje, ose 288 banorë mbetën të pastrehë dhe u sistemuan në tenda. Tabela e mëposhtme ofron një pasqyrë të familjeve dhe shpërndarjes së tyre sipas njësive administrative:

TABELA 29. Të dhëna nga mbështetja e dhënë familjeve në nevojë

Bashkia	Njësia Administrative	Nr. tendave	Nr. Familjeve	Nr. Banorëve
Lezhë	Ungrej	2	2	3
	Shënkoll	14	14	57
	Kallmet	7	7	27
	Blinisht	2	2	10
	Dajç	1	1	4
	Zejmen	9	9	39
	Shëngjin	16	16	46
	Kolsh	16	16	66
	Ballëdren	9	9	36
	Total Lezhë	76	76	288

Burimi: Prefektura Lezhë 2020, intervista të zhvilluara nga grupi i punës

Përtej kësaj, në bashkinë Lezhë janë dy shkolla të cilat kanë dalë jashtë funksioni, përkatësisht shkolla “Gjergj Kastrioti” në Lezhë dhe shkolla “Llesh Nik Daka” në Shënkoll. Përveç kësaj, në bashkinë Lezhë ka pasur dëme të shumta në ndërtesa. Në situatën e fatkeqësisë natyrore të shpallur nga Këshilli i Ministrave u përfshi edhe Lezha. Operacionet e kërkim shpëtimit të forcave shqiptare, të mbështetura fuqimisht dhe nga ato të vendeve të huaja, u konsideruan të përfunduar më 30 Nëntor 2019. Qeveria Shqiptare filloi menjëherë zbatimin e programit të rindërtimit dhe të rimëkëmbjes ekonomike i cili është në proces.

Rrëzimi i gurëve, rrëshqitjet. (Gjeorrezique)

FIGURA 29. Shembje në bregun e lumit Mat



Sipas studimeve dhe ngjarjeve të ndodhura, rezulton së në territorin e Bashkisë Lezhë janë disa zona të banuara që rrezikohen nga fenomenet gjeodinamike të rrëzimit të gurëve, rrëshqitjeve dhe shembjeve në shpate. Ndër rastet më tronditëse të rënies së gurëve me pasoja fatale, është ai ndodhur në Torovicë të Nj.A. Balldren, më 7 Tetor 2017. Dy vëllezër dhe nusja shtatzënë e njërit prej tyre humbën jetën, pasi makina tip Land Rover me të cilën po udhëtonin, u godit nga një gur që ra nga mali në afërsi të fshatit Torovicë. Shkëmbi u shkëput nga një lartësi e konsiderueshme dhe pasi goditi mësipërmes makinën, përfundoi në një parcelë aty pranë. Shenjat që ka lënë nga maja e malit, nga ku u shkëput dhe deri ku është ndaluar, tregojnë forcën që ka pasur masivi shkëmbor. Histori të tjera të frikshme tregohen për raste deri të ngjashme por pa humbje jetësh njerëzore. Episode të tjera të rrëzimit të gurëve janë të njohura edhe për rëniet e gurëve nga mali për gjatë aksit të rrugës Lezhë - Shëngjin - Rëra e Hedhur sidomos në afërsi të fshatrave Sakë e Skutaj, Madhësia e blloqeve të rëna është 0.3 – 0.5 – 1m³ (Bashkia Lezhë, 2018).

FIGURA 30. Guri i rënë, që shkaktoi humbjen e jetëve njerëzore në Torovicë (majtas), Gurë në rrezik rënie në shpatin e malit të Torovicës (djathtas, burimi Nj.A. Balldren)



Rrëshqitjet e terrenit

Në territorin e Bashkisë së Lezhës, rrëshqitjet të tokës të përmasave mesatare e të mëdha janë prezentë.

Në zonat që kanë më shumë histori me rrëshqitje njihet shpati i kodrës së Kalasë Lezhë, e në vijim ajo e Grykë - Zezës, ku janë evidentuar raste të rrezikimit të ndërtesave të cilat kanë një risk të lartë dëmtimi.

Po kështu histori të rrezikut nga rrëshqitjet janë të njohura edhe për pjerrësinë e kodrave në Spiten, Pllanë, Troshan etj si dhe në segmentet rrugore Fishtë - Troshan.

9.12.2. Stuhi bore, erë e fortë, breshër etj (meteorologjike)

Reshjet e dëborës, ngricat dhe stuhitë

Rënia e reshjeve të dëborës me stuhi me ndikim potencial, në dekadat e fundit janë bërë të rralla. Vetëm Nj.A. Ungrej dhe Kolsh, mund të përballen në pak ditë me keto reshje. Edhe në malin e Velës me lartësi 1172 m mbi nivelin e detit, më i larti në territorin e B. së Lezhës, fare pak herë në vit vërehet dëborë. Kur këto reshje bien në zona të ulëta, më të dukshme bëhen ato në zonat malore të Molungut (Nj. Administrative Kolsh e Zejmen) si dhe më rrallë në Malin e Rrencit (Nj.A. Shëngjin).

FIGURA 31. Borë në qytetin e Lezhës, 2.09.2009 (Foto J. Gjini)



Periudhat e rënies së borës që mbulojnë të gjithë territorin, zakonisht shoqërohen me temperatura të ulëta që arrijnë në -5 dhe rrallë deri -20°C e që për periudhën e tanishme për Lezhën konsiderohen si ekstreme. Kur trashësia e borës arrin 10 cm lartësi dhe bëhet më e qëndrueshme, ajo ngrin dhe formon shtresë akulli deri në 5 mm, trashësi e cila është e mjaftueshme për ndërprerjen e trafikut normal dhe bëhet pengesë për zhvillimin e operacioneve të emergjencave civile. Ndërsa rritja e trashësisë në $25-30$ cm bllokun tërësisht qarkullimin rrugor të automjeteve në zonat malore.

Reshjet e borës, ngricat, dhe stuhitë, kanë sjellë në mjaft raste bllokimin e rrjetit të infrastrukturës rrugore, ngrirje të ujësjellësve, dëmtime të linjave të energjisë elektrike, etj. Situata të tilla më ndikim më të madh kanë ndodhur në dimrin e vitit 2010-2011 dhe në Janar të vitit 2016. Ndërsa ngricat në datat 5-10 Janar 2017, bllokuan akset rrugore Troshan-Kashnjet, Lezhë qendër-Spital, Lezhë-L.Gurra, Lezhë-Kala, dhe të gjithë territorin e Bashkisë. Po ashtu këto reshje shkaktuan dëmtime të tubacioneve të ujësjellësve, pompave të ujit dhe pajisjeve të instaluar në to. Ky rast u shoqërua edhe më dëme të mëdha në kulturat e mbjella, pemëtari e blegtori dhe si rezultat i kohës së keqe u ndërpre procesi mësimor për dy javë. Në Nj.A Ungrej u vështirësua furnizimi i qarkullimit të banorëve të asaj zone.

Reagimi në rastet e reshjeve bllokuese me dëborë e stuhi nga strukturat e Bashkisë Lezhë ka qenë i pakët për mungesë të forcave e mjeteve të specializuara. Në raste të veçanta, bashkia është detyruar që t'i kërkojë bashkëpunim Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë për Institucionet qendrore, për angazhimin e FA si dhe subjekteve private.

Erërat e fuqishme

Erërat e fuqishme janë tipike për territorin e Bashkisë së Lezhës dhe godasin herë pas here në drejtime të ndryshme në të gjithë territorin e saj. Rrezikshmërinë më të madhe, kanë paraqitur erërat me origjinë kontinentale të drejtimit Jug - Lindje, veçanërisht ato që vijnë nga lugina e Lumit Mat. Nga erërat e fuqishme, veç dëmeve në konstruksione të ndryshme, banesa e bujqësi, kanë shkaktuar deri ndërprerjen e qarkullimit rrugor në një pjesë të segmentit të autostradës Lezhë - Ura e Matit. Më 23.02.2019, si rezultat i erërave të forta, dolën nga rruga disa automjete transporti duke krijuar aksidente në aksin Lezhë Milot, në zonën e fshatrave Rilë Gajush.

Më 5 Shtator 2010, në orën 6 të mëngjesit, një lagje në jug të fshatit Rrilë të Komunës Shënkoll, zona u godit nga një erë e fuqishme ku brenda pak sekondave, dëmtoi çatitë e 10 shtëpive, pati dëme gjithashtu në kasolle, etj. Dëmin më të madh e pësoi një shtëpi e re dy katëshe në të cilën u rrëzua totalisht çatia më të gjithë elementët drusor mbajtës. Koha kur ndodhi ngjarja, favorizoi që të mos ketë lëndime në njerëz. Fenomeni u zhvillu sipas një segmenti perëndim lindje, rreth 1 km gjatësi.

FIGURA 32. Era e fuqishme e 5 Shtatorit 2010, heq çatinë e shtëpisë së Zef Smakut, Rrilë. (Foto nga J. Gjini)



FIGURA 33. Aksidente nga erërat e fuqishme të datës 23.02.2019 në aksin Lezhë-Milot. (Foto J.Gjini)



Stuhi me breshër

Stuhi të papritura më breshër jo të zakonshëm po bëhen më shpesh prezent në territorin e bashkisë së Lezhës. Më shumë mbahet mend ajo e 8 Majit 2013, ku në 40 minuta, në Tale, kishte një stuhë breshëri që nga fshataret e kësaj zone nuk mbahej mend të kishte ndodhur më parë. Sipërfaqe të tëra me të mbjella u rrafshuan, u dëmtuan vreshta, qershi, sera, perime etj.

Kapriçot e motit

Ndryshimeve klimatike dhe efektet e tyre po shfaqen edhe me “kapriçot” e motit të cilat po paraqesin një trend në rritje. Një shprehje e tillë ishte edhe rënia e reshjeve të dëborës në datën 1 Prill 2020 në të gjithë vendin tonë, përfshi territorin e Bashkisë Lezhë, në një kohë kur në Lezhë, reshje të tilla bore nuk kishte pasur në asnjë ditë të të gjithë periudhës dimërore të po këtij viti.

9.12.3. Përmbytje, përmbytje të shpejta dhe valë e madhe deti (hidrologjike)

Veçanërisht në gjysmën e dytë të shekullit të 20 (deri rreth viteve 1970 kur u bë drenazhimi për të përfutur tokë bujqësore), e gjithë zona fushore e deltave të lumenjve Drin e Mat, i është nënshtruar një ekspansioni të egër të aktivitetit njerëzor. Në tokat e përfutura nga kullimi e që janë jashtë zonave të rikonfiguruar si zona të mbrojtura, vërehet një rritje e popullsisë banuese dhe të presionit të saj i cili u bë veçanërisht i ndjeshëm pas viteve 90. Ky territor ka sipërfaqe të konsiderueshme që janë nën nivelin e detit dhe të cilat mbahen nën regjim bonifikimi përmes rritjes të kanaleve kulluese dhe stacioneve të pompimit.

E gjithë zona fushore e territorit të Bashkisë Lezhë, si ajo e Zadrimës po ashtu edhe ajo në jug të qytetit të Lezhës deri në bregun e lumit Mat është mjaft e ekspozuar dhe ka një risk të lartë të përmbytjes. Nga vlerësimet e kryera të përmbytjeve të mëparshme, rezultojnë se sistemi lumor përbën rrezikun më të madh për përmbytjen masive ku riskun kryesor e kanë tokat bujqësore informale e në kuota nën nivelin e detit, (ish kënetat) si në Mabë, Zojz, Gocaj, Torovicë, Ishull-Shëngjin, Barbullojë, Lalm i Ri, Tresh, Zejmen etj. Për t'u veçuar, janë përmbytjet e viteve 1962-1963; 1995-1996; 2002-2004; 2009-2010; Nëntor 2014, Janar 2016 (Bashkia Lezhë, 2018; Qarku Lezhë, 2018). Gjatë vitit 2017 e më pas, me masat e marra për pastrimin e thellimin e shtratit të lumenjve, kanaleve kryesore, kanaleve të dyta e të treta, ky risk është ulur dhe nuk ka pasur përmbytje të banesave, por vetëm raste të pranishme së ujit mbi tokë.

Përmbytjet, historikisht janë favorizuar nga një sërë faktorësh natyrorë e humanë nga ku përmendim:

- Dobësimi e humbja e funksioneve përcjellëse natyrore të prurjeve dhe e aftësisë vetëpastruese të lumit Drin nga ndërprerja e devijimi i tyre për në lumin Buna. Kjo ndërprerje, është bërë me anë të ndërtimit të digës së Spatharës në Mjedë të Bashkisë së Shkodrës si pjesë e projektit të sistemimit hidrik të fushës së Zadrimës që e ka zanafillën në vitin 1950. Po ashtu është bërë dhe ndërprerja e ujërave të Lumit Gjadër, të cilat janë dërguar edhe ato në digën e Spatharës. Por me kalimin e viteve, u vu re edhe impakti negativ i kësaj ndërhyrjeje e cila çon në mbushjen e shtratit të lumit Drin, e bllokimin e kanaleve kulluese nga sedimentet e sjella prej përrenjve malorë;
- Në mënyrë të veçantë në tre dekadat e fundit, u rrit frekuenca e reshjeve intensive, ku reshjet e rëna arrijnë në 300 ml në një hark kohor prej dy ditësh, sistemi hidrik nuk ka kapacitete për t'i përcjellë këto prurje, e për pasojë shoqërohet me daljen e ujërave të lumenjve nga shtrati i tyre duke shkaktuar përmbytje;
- Nga mungesa e mirëmbajtjes së shtretërve të përrenjve malorë, sidomos nga amortizimi e dëmtimi i pritave mbrojtëse, rritja e erozionit nga prerja pa kriter e pyjeve, rënia e reshjeve intensive në fraksione kohe të shkurtra, kanë ndikuar në rritjen e prurjeve të ngurta duke bllokuar shtretërit e tyre, mbushjen e shpejtë të kanaleve kulluese, dëmtuar infrastrukturën rrugore, paralizim të përkohshëm (ose dalje përkohësisht jashtë funksionit) të infrastrukturës urbane në qytete etj.. Kjo situatë ka ndikuar së tepërmi në përmbytjet në zonën fushore;
- Lëvizja e lirë e popullatës bëri që zonat fushore të dominohen nga ndërtimet jashtë konturit të fshatrave të kësaj zone duke shtuar një sërë zonash informale e deri në krijimin e fshatit të ri si Barbulloja e Re e Lalmi i Ri. Këto ndërtime ndikuan në prishjen e sistemit kullues të zonës, duke bërë që uji të mbetet në parcela për një kohë të gjatë e duke e ndikuar në shkallën e përmbytjes;
- Ndërtimi i infrastrukturës së rrugore si dhe i mjaft objekteve industriale, sociale e të shërbimeve në këto zona, duke mos marrë parasysh ruajtjen e kapacitetit përcjellës të ujërave sidomos në rastet e ndërtimit të urave, vendosjes së tombinove, ndërtime mbi ose buzë sistemit kullues, ka rritur në mënyrë të ndjeshme presionin ndaj kësaj zone duke favorizuar përmbytjet;
- Para investimeve të fundit, rastet e mosfunksionimeve të hidrovorëve nga amortizimi i tyre,

mungesa e energjisë elektrike si dhe e kapacitetit të ulët përballë reshjeve intensive, ka ndikuar në shumë raste në shkaktimin e përmbytjeve në ato zona të cilat mbahen të kulluara nga funksionimi i tyre;

- Në mjaft raste, rritja e baticës detare të shoqëruar nga stuhi që godasin zonën bregdetare, duke e eroduar e përmbytur atë me kapërderdhjen e ujërave nga deti, kanë penguar dhe shkarkimin e ujërave të lumenjve në deltat e tyre, duke ndikuar në përmbytjet e zonës fushore;
- Mosmirëmbajtja e për pasojë dëmtimi ose amortizimi i argjinaturave, rritja e nivelit të rrymave lumore mbi normat e parashikuara si rezultat i reshjeve intensive, e kanë vënë zonën fushore mjaft në rrezik ndaj përmbytjeve;
- Mospastrimi i rezervuarëve dhe mbushja e tyre (me 2 % të volumit të tyre çdo vit), moskujdesi ndaj digave të tyre, mund të kthehet në precedent për përmbytje në të gjitha banesat e asetet e tjera që janë nën nivelin e këtyre digave;
- Dëmtimi ose mungesa në sistemin e brishtë të sinjalizimit e paralajmërimit për përmbytjet, mungesa ose dëmtimi i hidrometrave të nivelit të ujërave në trupin e urave e bankinave të lumenjve e përrenjve, në hidrovore etj., dhe mungesa e monitorimit, ka ndikuar që komuniteti e subjektet që ushtrojnë aktivitetet në këto zona të gjenden të papërgatitur për t'u përballur në rastet e përmbytjeve.

Nga historiku i përmbytjeve po paraqesim ato me kryesoret të dy dekadat e fundit, me dëmet që kanë janë shkaktuar prej tyre.

Përmbytje në datat 22-25.09.2002

Në mënyrë të përmbledhur nga situata e përmbytjeve e krijuar nga reshjet e datave 22 deri 25.09.2002 evidentohet:

- Ka dalje nga shtrati të lumit Drin në vendet: Ishull Lezhë, Ishull Shëngjin, Gjadër, Kakarriq, Mapë. Lumi Mat ka dalje nga shtrati në Fushë Kuqe;
- Janë thyer në 3 vende argjinaturat e kanaleve të ujërave të larta të Zejmenit;
- Janë thyer në 3 vende argjinaturat e kanaleve të ujërave të larta të Zadrimës;
- Ka vërshime të përrenjve të Trashanit, Fishtës, Grykë Manatisë.

Situata me hidrovoret:

- Hidrovori i Tales punon, ka pasur pak ndërprerje (merr energji në dy drejtime nga Lezha e Laçi)
- Hidrovori në Ishull Shëngjin nuk ka punuar (pa energji);
- Hidrovori ne Balldren ka funksionuar me kapacitet të ulët, niveli i ujërave të Drinit ku shkarkon ujërat është shumë i lartë;
- Hidrovori në Grykë Zezë nuk ka punuar (ishte i dëmtuar).

Nga situata e shkaktuar nga përmbytjet veçohet:

Si rezultat i rënies së mbi 200 mm reshje brenda një periudhe kohore të shkurtër janë shkaktuar përmbytje në 15000 ha tokë. Janë shkaktuar dëme në rrjetin elektrik, në infrastrukturën rrugore, argjinaturat e kanaleve vaditës, ujëmbledhës, ujësjellës e rrjet shpërndarës, objekte social kulturore, dhe 160 shtëpi banimi.

Përmbytje në datat 26-29.02.2004

Pasojat e përmbytjeve përshkruhen sipas njësive administrative. _

Qyteti Lezhë:

- Në Lagjen "Besëlidhja", janë përmbytur plotësisht 3 shtëpi banimi;
- Në Lagjen "Gurra", janë përmbytur 12 shtëpi banimi;
- Është bllokuar rruga që lidh Lagjen "Shehër" në afërsi të Kalasë me qendrën e qytetit, nga shembja masive e dherave.

- Në rrugën nacionale Lezhë - Shkodër, pranë ish fabrika e letrës është bllokuar kanali kryesor i shkarkimit të ujërave si rezultat i prurjeve të inerteve nga mali.
- Problem për qytetin e Lezhës, është pastrimi i lumit Drin, që përmyt Lagjen "Besëlidhja" e Komisarlatin e Policisë, si dhe Përroi i Grykës i cili përmyt territoret e shkollave të qytetit Lezhë.

Nj.A. Kolsh:

- Në fshatin Manati janë përmytur plotësisht 2 shtëpi banimi;
- Në fshatin Barbullojë janë përmytur plotësisht 80 shtëpi banimi;
- Në zonën Barbullojë e Re janë përmytur 50 ha tokë bujqësore;
- Në Manati janë përmytur 5 ha tokë bujqësore;
- Në lagjen Lalm i Ri janë përmytur 5 ha tokë bujqësore;
- Ka filluar gërryerja që rrezikon shembjen e digës së rezervuarit në qendër të fshatit Kolsh, me kapacitet ujëmbajtës 110'000 m³ dhe paraqet rrezik për zonën poshtë saj dhe kërkohet ndërhyrje e menjëhershme;
- Prishja e pritave malore dhe e argjinaturave të përrenjve, ku si pasojë gjatë reshjeve, sjellin inerte të cilat ndikojnë në bllokime rrugësh, gërryerje të tokave bujqësore dhe përmytje;
- Problem për eliminimin e përmytjeve në zonën Barbullojë e Re dhe Manati, është pastrimi i kanaleve kulluese.

Nj.A. Balldren:

Përmytje e 900 ha tokash të mbjella, të ndara:

- 800 ha në ish kënetën e Kakarriqit dhe 100 ha në fushën e Gocajve;
- Gërryerjet e dherave në zonën e Torovicës sollën probleme serioze për disa shtëpi banimi, bllokim të sistemit të ujërave të zeza, bllokim të hyrjeve në katet e para të pallateve, bllokim pjesor të rrugës nacionale Lezhë – Shkodër.

Nj.A. Shënkoll:

- Është dëmtuar argjinatura e lumit Mat në zonën Shënkoll në afërsi të Kampit të burgut dhe Tale 1;
- Janë përmytur në rreth 155 shtëpi banimi në fshatrat Grykë Lumi 1-2, Rrilë, Barbullojë, Tale-2 dhe Shënkoll;
- Është përmytur 150 ha tokë bujqësore;
- Problem për komunitetin është rritja e fuqisë shpërndarëse të nënstacionit elektrik me një transformator më të madh, sepse mungesa e tij shkakton ndërprerje të shpeshta të energjisë elektrike, çfarë do të thotë mos furnizim të vazhdueshëm të Hidrovorit të Tales me energji e për pasojë, krijohen përmytje të tokave nga mos thithja e ujërave që sjellin reshjet.

Nj.A. Ungrej:

- Bllokim të akseve rrugore Kallmet-Ungrej-Rreshën, dhe Kalivaç-Vau-Dejës, në disa pika për shkak të rrëshqitjeve të dherave dhe gurëve;
- Dëmtim i linjave elektrike, shtylla të tensionit të lartë dhe drurit;
- Dëmtim i 15 urave në mes 9 fshatrave të Komunës;
- Dëmtim i 1.4 ha tokë bujqësore në të gjitha fshatrat e Komunës;
- Dëmtime të kanaleve vaditëse në masën 760 ml;
- Shembje muresh mbajtëse të kanaleve vaditëse në masën 230 m³.

Nj.A. Dajç:

- Në fshatin Gjadër janë përmytur 2 shtëpi banimi dhe 365 ha tokë bujqësore;
- Në fshatin Mabë janë përmytur 3 shtëpi banimi dhe 60 ha tokë bujqësore;
- Në fshatin Zojz janë përmytur 40 ha tokë bujqësore;
- Në fshatin Grash, janë përmytur 40 ha tokë bujqësore;
- Në fshatin Dragush, janë përmytur 30 ha tokë bujqësore;

- Në fshatin Dajç janë përmbytur 40 ha tokë bujqësore;
- Në fshatin Kotërr, janë përmbytur 30 ha tokë bujqësore;
- Është dëmtuar pjesërisht baza ushqimore e thatë për bagëtitë.

Nj. A. Zejmen:

- Janë përmbytur 129 shtëpi banimi;
- Janë përmbytur 1950 ha tokë bujqësore;
- Janë dëmtuar pritrat malore në të gjithë faqen e malit Pllanë - Manati.

FIGURA 34. Dalje e ujërave të lumit Drin nga shtrati në zonën e Balldrenit



Përmbytje, 10.11.2009

Përmbytje të tokave bujqësore dhe trojeve në fshatin Barbullojë të Nj.A.Kolsh kanë ndodhur nga reshje intensive shirash, erëra të shoqëruara nga dallgëzime të fuqishme në bregdet;

Reshje intensive të shirave afro një javore me ndërprerje, arritën të përmbytin pothuajse të gjithë fshatin Barbullojë, si zonën e truallit ashtu dhe 2300 ha tokë bujqësore. Përveç reshjeve intensive, situata e rëndë u favorizua nga pamundësia e thithjes së ujërave nga Hidrovori i Tales, punonin vetëm 4 pompa me 2.5 m³, ndërsa pompa me kapacitet 10m³, ishte me defekt.

Nga përmbytjet u shkaktuan gjithashtu këto dëme:

- Shtëpi të përmbytura në Barbullojë;
- Përmbytje e 2300 ha tokë bujqësore, disa prej tyre me kultura në proces;
- Ndërprerje të furnizimit me energji elektrike;
- Vështirësi në shpëtimin e ushqimit e të krerëve të blegtorisë;
- Rrëzime të reja pishash në bregdetin e Kunës;

FIGURA 35. Pamje nga përmbytjet në fshatin Barbullojë të Nj.A. Kolsh



Përmbytje datë 18.11.2014 në qytetin e Lezhës:

- 2 banesa tek kryqëzimi i kanaleve përroi Manatisë, ai Grykës, e Lagjes së Gurrave;
- 1 banesë tek Lagjja "Frutore";
- 11 banesa tek Lagjja "Besëlidhja";
- 16 banesa tek Lagjja "Skënderbeg";
- 1 banesë tek Lagjja e Fiqve.

Në këto banesa u dëmtuan mjaft mobilje, pajisje dhe orendi shtëpiake sikurse kishte dëme ndërtimore në suvatime etj.

Përmbytjet datë 6 Janar 2016

Në zonën e Bashkisë së Lezhës kanë rënë 90 mm shi gjatë 24 orëve dhe po brenda kësaj periudhe kanë rënë 60 mm shi në zonën Manati - Milot në një hark kohor prej vetëm 3 orëve. Ndërsa në 48 orë kanë rënë gjithsej 120 mm.

Si rezultat i këtyre reshjeve intensive që kulmuan në datën 6 Janar 2016, rezultojnë përmbytje pothuajse në të gjithë zonën fushore të Bashkisë së Lezhës, në një sipërfaqe totale toke bujqësore prej 1500 ha, përkatësisht:

- Njësia Administrative Shënkoll 220 ha;
- Njësia Administrative Zejmen 550ha;
- Njësia Administrative Balldren 450 ha;
- Njësia Administrative Blinisht 180ha;
- Njësia Administrative Dajç 100 ha.

Si rezultat i përmbytjes pati dëme të konsiderueshme në kulturat bujqësore të mbjella si grurë e jonxhë, por dhe degradim të cilësisë së tokës nga erozioni dhe futje të ujërave të kripura në zonën Tale 2. Dëme pati dhe në blegtori në zonën e Zejmenit e të Tales. U përmbytën gjithsej 7 banesa në Nj.A Zejmen dhe 1 banesë në Nj.A Shënkoll, ku përveç dëmeve në pajisje e orendi, dy prej tyre patën edhe dëme në anën ndërtimore.

Po ashtu, nga reshjet intensive të rëna në datën 6 Janar 2016 e për pasojë të daljes nga shtrati të përroit të Zejmenit e të Pllanës, në fshatin Zejmen e Pllanë në Nj.A Zejmen, u përmbytën:

- 1 banesë u përmyt totalisht dhe doli jashtë funksionimit;
- 6 banesa në fshatin Pllanë, në të cilat pati dëmtime në mobilje, pajisje e orendi si dhe suvatime.

Në territorin e Bashkisë së Lezhës, pasojat e përmbytjes i ka ndjerë më shumë fusha e Torovicës, Zadrimes e Bregu i Matës. Në riskun e përmbytjes ndikim të madh kanë mënyra si funksionojnë sistemi i kanaleve kryesore (kolektorët) të largimit të ujërave, të kanaleve të dyta e të treta, prandaj e rëndësishme është të mbahet nën kontroll funksionimi i tyre.

Ndërsa në zonën urbane pasojat janë më të ndjeshme në qytetin e Lezhës në lagjen "Besëlidhja", "Skënderbeg" si dhe në qytetin e Shëngjinit, zona e portit në rrëzë të malit të Shëngjinit. Pavarësisht nga ulja e riskut të prekjes nga përmbytjet, si rezultat i investimeve të viteve të fundit rezulton se përsëri janë me risk rreth 20 fshatra dhe 500 shtëpi banimi me rreth 25000 banorë.

Siç vërehet nga të gjitha rastet, përmbytjet nga rritja e prurjeve në lumenj, përrenj e kanale si rezultat i reshjeve intensive kanë shkaktuar:

- Dëmtime të mobiljeve, pajisjeve e orendive në banesa ose humbje e plotë e funksionit të tyre;

- Dëmtim të kulturave bujqësore, e humbje të cilësisë së tokës, dëmtim të gjësë së gjallë e në bazën ushqimore të saj;
- Paralizimi i përkohshëm i infrastrukturës urbane të qyteteve Lezhë e Shëngjin, dëmtimi i aseteve të mjaft subjekteve që ofrojnë shërbime etj.;
- Dëmtim i infrastrukturës rrugore në shumë segmente të territorit të Bashkisë së Lezhës nga mbushjet me inerte si rezultat i prurjeve të ngurta ose rrëshqitjeve të dherave;
- Dëmtime të urave mbi sistemin ujqor deri në rrezik për shkatërrim të tyre;
- Dëmtime të shtyllave të rrjetit elektrik;
- Bllokime të rrjetit të ujërave të zeza në zonat urbane;
- Mbushje e nxjerrje jashtë funksionit të sistemit kullues e vaditës në mjaft segmente të këtyre rrjeteve.

Në të gjitha përmbytjet, reagimi i komunitetit lokal e i strukturave lokale ka qenë në përputhje me natyrën e dëmeve të çdo rasti, e vlerësimit të rrezikshmërisë së dëmit, si dhe në vartësi të fondeve e mjeteve të vëna në dispozicion. Pushteti vendor ka angazhuar rast pas rasti mjetet e veta të shërbimit publik si fadroma, kamionë, tenda, si dhe fondet financiare për dëmshpërblimet për dëmet në banesa, në përputhje me bazën ligjore për emergjencat civile. Në rastet e dëmeve të mëdha sidomos në rastet e dëmtimeve të argjinaturat lumore, janë aktivizuar rast pas rasti edhe FA me mjetet e tyre por edhe subjektet private. Përballimi i përmbytjeve është organizuar e mbështetur nga komisionet e emergjencave civile në Prefekturë e Bashki, sikurse është bashkëpunuar me subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Lezhë, forcat e mjetet e ushtrisë, forcat e MZSH, banorët që u janë dëmtuara pronat, shoqatat jo fitimprurëse etj.

Përmbytjet nga deti, stuhitë detare të shoqëruara me baticë të lartë

Nga ngjarjet më të mëdha ekstreme klimatike që lidhen me mësymjen e detit në drejtim të tokës, shënohet:

A. Përmbytje të pazakonshme në Tale të Komunës Shënkoll (sot Nj .A.) Lezhë e datës 28.12.2009 -1.01.2010.

Kjo ngjarje e shtrirë në një interval kohor prej rreth 6 orësh karakterizohet nga baticë me një ngritje vertikale të detit në një lartësi jo të zakonshme, deri në 1.8 m, ndërkohë që batica normale mesatare sipas literaturës për këtë bregdet është 30 - 40 cm. Kjo baticë u shoqërua me erëra të forta me drejtim jugperëndim - verilindje ose shirok. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, janë shtuar ujërat e lumit Mat, si rezultat i shkarkimeve të Hidrocentraleve të Ulzës e Shkopetit. Për pasojë, ballafaqimi i ujërave të fryra të lumit Mat në grykëderdhje me ujqrat e baticës detare të fuqishme, favorizuan zhvillimin e përmbytjeve në zonat më të ulta e të pambrojtura mirë për këto raste.

Ujqrat e detit, të ngritura në nivel baticë të përziera me ato të lumit Mat që vinin nga ana jugore e vendngjarjes, mbuluan plazhin e Tales si dhe kënetën pas tij. Ky nivel i ngritur i ujërave, shkaktoi rrjedhjen e tyre në zonën e banuar, duke përmbytur një territor të gjerë dhe duke rrezikuar rreth 20 banesa. Territori i përfshirë është zona bregdetare që përfshin plazhin, dunat, ligatinat dhe më pas përmbyti të gjithë territorin në drejtimin nga Posta e Policisë Tale, deri në Hidrovor, e zonën e banuar në lindje të saj. Po kështu, pasi ujërat detare shkaktuan çarjen e bankinës së Hidrovorit të Tales, ato bllokuan dhe shtuan ujërat në magjistralet kulluese të Barbullojes, Rrilës, Treshit, Spitenit, që sjellin ujë në këtë hidrovor.

Si rezultat i kësaj ngjarje të jashtëzakonshme, u shkaktuan:

- Përmbytje të mjediseve të jashtme të rreth 20 banesave, dhe rrezik për dëmtimin e tyre;

- Dëmtohet bankina e Hidrovorit të Tales (çarje në pjesën perëndimore të saj) e për pasojë ujërat depërtuan në kolektorin kullues Tresh – Hidrovor;
- Si rezultat i ngjarjes, përmbytet e gjitha ultësira në Tale, Barbullojë, Rrilë e Tresh. Kjo ultësirë është 50-150 cm nën nivelin e detit. Kjo përmbytje u bë nga uji i kripur dhe ndikoi negativisht në cilësinë e tokës dhe në kulturat e mbjella në këto toka, si rezultat i rritjes së kripshmërisë;
- Dëmtime të argjinaturës mbrojtëse në ato segmente që doli uji në drejtim të banesave;
- U rrezikuan dy banesa pasi gjendeshin në afërsi të hidrovorit, në anën e tokës së gërryer; Po në afërsi u dëmtua edhe bankina e sipërpërmendur;
- U dëmtua rëndë rrjeti elektrik. Si rezultat i marrjes së dherave u rrëzuan 5 shtylla të linjës elektrike si dhe u dëmtua kabli i furnizimit me energji elektrike të hidrovorit;

Në përgjigje të kësaj situatë, u reaguua menjëherë si vijon:

- Strukturat e emergjencave civile filluan punën për evakuimin e familjeve që rrezikoheshin nga ujërat, por situata u normalizua brenda ditës;
- Bordi i Kullimit ndërhyri për hapjen e kanalit të mbyllur të shkarkimit që u realizua nga firma "Pacani". Gjithashtu kjo firmë, mbylli çarjen e hapur me gurë e materiale inerte, në digën e hidrovorit nga ku ishin rrezikuar dhe dy banesa në afërsi nga rrëmbimi i dherave. Në këtë proces u aktivizuan edhe mjetet e Bordit të Kullimit dhe ato të FA;
- Specialistët e elektrikut, lidhen hidrovorin me linjën ajrore elektrike por kjo nuk mundësoi hidrovorin që të punojë me kapacitet të plotë.

Kjo situatë u ndoq në vend nga Prefekti i Qarkut të Lezhës me Komisionin e Emergjencave të këtij Qarkut, Drejtori i Përgjithshëm i Emergjencave Civile, përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Bujqësisë, Drejtues të Policisë e të FA dhe drejtues të Njësive të Qeverisjes Vendore.

FIGURA 36. Përmbytje nga deti në zonën e Hidrovorit të Tales



B. Përmbytje të pazakonshme nga deti në Ishull Shëngjin të Nj. A. Shëngjin, Lezhë.

Edhe kjo ngjarje u zhvillua në të njëjtën kohë me atë të Tales, e me të njëjtat karakteristika, si kohëzgjatja prej rreth 6 orësh, batica me një ngritje vertikale të detit në një lartësi deri në 1.8 m. Kjo baticë cilësohet si rast që nuk mbahet mend nga më të moshuarit.

Në datën 1.01.2010, pas orës 3.00, batica arriti nivelin më të lartë, duke kaluar ujërat e lagunës së Merxhanit tashmë së bashku më ato të detit në baticë të hyra në jug të lagunës (në vendin ku është eliminuar krejtësisht litorali që ndante lagunën me detin, në një gjatësi 750 m) mbi argjinaturë e duke përmbytur lagjen Stom të fshatit Ishull Shëngjin. Kjo argjinaturë ishte krejt e amortizuar dhe e dëmtuar dhe ndante këtë lagje me ujërat e lagunës së Merxhanit. E gjithë vija bregdetare e Kunës deri në qytetin Shëngjin u godit nga kjo baticë e shoqëruar me dallgë e erë të fortë, duke kaluar e qarkulluar ujërat në drejtim të territorit të zonës së mbrojtur Kunë dhe pjesës hyrëse të saj deri në afërsi të qytetit. Në portin e Shëngjinit anijet e varkat e ankoruara pothuajse dolën në pjesën e sterës, mbi bankinë.

Si rezultat i kësaj ngjarje të jashtëzakonshme, u shkaktuan:

- Përmbytje të mjediseve të jashtme të rreth 40 banesave, ndërsa në 6 prej tyre uji hyri në brendësi duke dëmtuar orendi e ushqime të këtyre familjeve;
- U rrëzuan një numër i madh pishash (me moshë rreth 50 vjeçare) në pyllin artificial mbrojtës të bregdetit në zonën e mbrojtur të Kunës dhe në hyrje të saj;
- Shtresa të reja rëre u futën në disa vatra të territorit të tokës si dhe u vërejtën sasira planktoni të nxjerra nga deti ne pjesën e bregut;
- Uji i kripur i detit ka qarkulluar dhe ka mbetur për pak kohë në vatra me nivel të ulët pothuajse në të gjithë territorin e Kunës e të hyrjes së saj. Kjo rrezikoi tharjen e bimëve drunore dhe një pjese të vegjetacionit më të ulët të zonës. Ndërsa uji i kripur i detit ka qarkulluar në një sipërfaqe të konsiderueshme toke bujqësore duke përkeqësuar seriozisht cilësitë prodhuese të saj;
- Ndërprerje të furnizimit me ujë të pijshëm pasi pompat thithëse ishin në puset e përmbytura, në kufi të lagunës;
- Vështirësi në shpëtimin e krerëve të blegtorisë e ushqimin e tyre.

FIGURA 37. Pasoja të stuhive detare në bregdetin e Kunës



Për këtë situatë të krijuar u reaguua menjëherë nga:

- Strukturat e emergjencave civile që kryen evakuimin e familjeve që rrezikoheshin nga ujërat;
- Bordi i Kullimit, fadroma e Komunës Shëngjin dhe dy kamionë të FA, realizuan menjëherë ngritjen e argjinaturës në zonat më të ulëta. Në ditët në vijim puna vazhdoi me përfundimin e argjinaturës mbrojtëse nga FA të repartit të MCR.
- Në datën 4.01.2010, përfaqësues të Emergjencës Civile të Prefekturës, specialistë të D.SH. Pyjor kryen inspektime në Kune, për të vlerësuar rrezikshmërinë e bashkimit të detit me lagunën e Merxhanit në zonën më të eroduar.

9.12.4. Zjarret

Pyjet historikisht janë mjaft të rrezikuara nga rënia e zjarreve si nga shkaqe natyrore ashtu dhe njerëzore. Pothuajse çdo vit, në periudhën e nxehtë të verës ndodhin zjarre që përfshijnë sipërfaqe të mëdha pyjesh e kullotash. Bashkia Lezhë ka një sipërfaqe prej 18'200 ha me pyje dhe 4'250 ha me kullota (Bashkia Lezhë, 2018), sipërfaqe kjo e konsiderueshme në raport me sipërfaqen e territorit në tërësi. Temperaturat e larta, mungesa e reshjeve dhe thatësira e tejzgatur, karakteristika këto për periudhën e verës, të cilat në dekadat e fundit kanë pasur një trend në rritje, i kanë ekspozuar ndjeshëm pyjet ndaj zjarreve. Veç kushteve natyrore, shkaqet kryesore të rënies së zjarreve janë pakujdesia e njerëzve sidomos në rastet e mosvënies nën kontroll të zjarreve gjatë djegies së territoreve për përfitim të kullotave. Po kështu rëniet e zjarreve në pyje kanë ndodhur dhe nga djegiet e bimësisë gjatë hapjes së shesheve për ndërtime ose djegies së barishteve të këqija gjatë aktivitetit bujqësor. Rastet e zjarreve në pyje kanë ardhur në rritje në mënyrë të veçantë pas viteve 1991. Rënie të shumta të zjarreve kanë ndodhur në ekonominë pyjore të malit të Shëngjinit, në malin e Velës si dhe shpatet në afërsi të fshatrave Gjash, Kaçinar

e Lalm të Nj.A. Kolsh, në afërsi të fshatrave Torovicë, Malecaj, Kakarriq të Nj.A. Balldren, si dhe në disa vatra të tjera si në Bërzanë të Nj.A. Zejmen. Nga historiku i rënies së zjarreve ato më të shënuara në dekadën e fundit për sa i përket sipërfaqes pyjore të djegur e të përshkuar dhe dëmit të bërë³⁰, evidentojmë:

- Në vitin 2010, pati rënie zjarri në zonën pyjore të Malit të Velës e në Gjash të Nj.A. Kolsh, i cili u shtri në një sipërfaqe të konsiderueshme prej të cilit u bë edhe evakuimi i banorëve të fshatrave të kësaj zone, për në zona më të sigurta;
- Në verën e vitit 2016, në malin e Shëngjinit, u dogjën sipërfaqe të konsiderueshme në pyje, livadhe e kullota, duke rrezikuar një numër të madh banesash dhe jetën e qytetarëve. Për ndalimin e shuarjen e zjarrit e shpëtimin e jetës së njerëzve, u angazhuan forcat e mjetet e bashkisë Lezhë si dhe ato të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile në MPB;
- Gjatë verës së vitit 2017 janë djegur sipërfaqe të konsiderueshme pyjore nga rënia e zjarrit në disa vatra si në Bërzanë të Nj.A. Zejmen, dhe në afërsi të fshatrave Torovicë, Malecaj, Kakarriq të Nj.A. Balldren në të cilat është ndërhyrë menjëherë për evitimin e zgjerimit të përhapjes së zjarrit deri në shuarjen e plotë të tij;
- Gjatë vitit 2018 raportohen³¹ rënie zjarri në pyjet me pishë e shkurre tek Rëra e Hedhur në datën 24.06.2018, në pyll pisha e shkurre në ekonominë pyjore në Kolsh në 12.07.2018, pyllin me pisha e shkurre në Kodër Marlekaj në 15.07.2018, në pyllin me pisha në Shëngjin me 17.11.2018, si dhe në pyllin me pisha në Lagjen "Nënë Tereza" në datën 19.11.2018 ku zjarri përshkoi një sipërfaqe prej 3 dynim.
- Në 25.02.2019 janë djegur 3 ha me pyje e shkurre, në fshatin Gocaj të Nj. A. Balldren, 1 ha me pyje e shkurre në Torovicë si dhe në pyllin me pisha të Malit të Shëngjinit në Sakë. Po në këtë zonë u dogjën 2 dynim nga rënia e zjarrit me datën 28.03.2019. Gjatë muajit Gusht 2019 janë raportuar 5 raste zjarri të rëna në ekonominë pyjore të Bashkisë Lezhë. Në datën 18-19 Gusht 2020 u shënuan rënie zjarri në ekonominë pyjore në Pllanë, ndërsa në datën 22.08.2020 u dogjën 50 ha me pyje në malin e Shëngjinit. Në po këtë ekonomi pyjore, zjarri ra edhe në datën 26.8.2019. Në të gjitha rastet nuk janë identifikuar shkaktarët e zjarrit. Në 16 Shtator 2020, zjarri ra në shpatin e malit të Manatisë të Nj. A. Kolsh, në afërsi të fshatit më të njëjtin emër. Zjarri përshkoi një sipërfaqe pyjore me pishë e shkurre prej 20 ha, ndërsa sipërfaqja e djegur u raportua 5 ha, duke arritur në afërsi të banesave të fshatit. Gjatë gjithë ngjarjes nuk pati humbje jete apo lëndime në njerëz. Zjarri u izolua në orën 9.20. Për fikjen e tij u angazhuan 12 forca zjarrfikëse të bashkisë Lezhë, me 2 mjete zjarrfikëse si dhe 40 efektivë të FA, (20 nga Vau i Dejës, Shkodër dhe 20 nga Tirana), 4 forca policore, 5 forca vullnetare, 6 forca bashkiake të Nj. A. Kolsh, 5 inspektorë të shërbimit pyjor, dhe nuk pati urgjenca mjekësore. Pas izolimit të plotë të vatrës së zjarrit, ajo u mbajt në monitorim nga Njësia e Administrimit të Pyjeve të Drejtorisë së Bujqësisë, Bashkia Lezhë, pasi në brendësi të saj mbetën trugje që vetëdigjeshin.

9.12.5. Biologjike

Pandemia Covid-19

Shqipëria u prek për herë të parë nga shpërndarja e pandemisë COVID-19 në 9 Mars 2020. Pas kësaj date, qeveria qendrore mori një sërë masash për parandalimin e pandemisë duke përfshirë dhe mbylljen e aktiviteteve ekonomike, aktiviteteve social kulturore etj. Aktualisht (8 Nëntor 2020)³² në territorin e qarkut Lezhë janë identifikuar 985 persona të cilët janë prekur nga virusi, të shëruar 503, të vdekur 26, aktualisht pozitiv 456.

30 Burimi, arshiva e MZSH, Bashkia Lezhë.

31 Sipas MZSH, Bashkia Lezhë

32 <https://shqiptarja.com/statistics>

Nisur nga qasja centralizuese për përballimin e pandemisë, ku vendimet dhe masat për përballimin kryheshin nga qeverisja qendrore, roli i qeverisjes vendore ishte shumë i reduktuar. Të gjithë pacientët e identifikuar që kishin nevojë për hospitalizim sillleshin në Tiranë, në spitalet e përcaktuar për COVID, ndërkohë që pacientët e tjerë ishin të detyruar të vetëkarantinoheshin në banesat e tyre. Masat e marra nga qeveria qendrore, protokollet e sigurisë dhe nevoja për distancim social ka shtyrë dhe Bashkinë Lezhë për të ridimensionuar një pjesë të punës. Përtej masave të marra për mbarrëvajtjen e punës brenda institucionit, Bashkia Lezhë është angazhuar dhe në një sërë iniciativash të tjera të cilat kanë ndihmuar komunitetin për përballimin e pandemisë dhe respektimin e protokolleve për parandalimin e shpërndarjes së saj.

Gjatë periudhës së karantinës, nëpërmjet një Urdhri të Kryetarit të bashkisë është ngritur një grup pune i cili ka bërë identifikimin e grupeve në nevojë të cilët kishin vështirësi në përballimin e situatës si për shembull persona të moshuar, familjet që marrin ndihmë ekonomike, të papunët, familjet me persona me aftësi të kufizuara etj. Identifikimi i grupeve në nevojë ishte prioritet në mënyrë që më pas të ofrohej mbështetja e nevojshme kryesisht nëpërmjet ndihmave ushqimore apo produkteve higjieno-sanitare. Në periudhën Mars-Maj 2020, janë shpërndarë rreth 700 pako nga bashkia të cilat janë plotësuar nga donacione, rezervat e shtetit dhe blerje të drejtpërdrejta nga bashkia.

Bashkia ka arritur që të shpërndajë ndihma jo vetëm në qytetin e Lezhës por në të gjitha njësitë administrative. Në këtë kuadër ka ndihmuar dhe reagimi i shpejtë për ngritjen e një grupi vullnetarësh. Në bashkinë Lezhë kanë qenë të angazhuar rreth 90 vullnetarë të moshës 30-50 vjeç të cilët kanë ndihmuar bashkinë në kohën e karantinës e më gjerë të pandemisë duke ofruar asistencë familjeve dhe personave në pamundësi për të dalë, nëpërmjet kryerjes së blerjes së ushqimeve, pagesës së dritave, uji, tërheqjes së kempit apo pensionit, blerje ilaçesh etj. Vullnetarët gjithashtu kanë ndihmuar bashkinë në shpërndarjen e ndihmave. Grupi vullnetar ka qenë i atashuar pranë bashkisë nga e hëna në të premtë. Vlen të përmendet se përtej grupit të vullnetarëve të angazhuar pranë bashkisë, në procesin e mbështetjes së familjeve dhe personave në nevojë janë përfshirë dhe një sërë organizatash humanitare dhe fetare të tilla si Kryqi i Kuq, Caritas, World Vision etj të cilat kanë ofruar ndihmën e tyre nëpërmjet pakove ushqimore, veshmbathjeve apo dhe duke ofruar shërbime psikologu për përballimin e situatës. Bashkia Lezhë gjithashtu ka luajtur një rol të rëndësishëm edhe në dezinfektimin e hapësirave të ndryshme të territorit. Kështu, janë dezinfektuar rrugët dhe trotualet kryesore, tregjet publike, spitali dhe territori përreth tij, ndërtesat ku janë identifikuar persona të infektuar me COVID, parqe e lulishte, muze, zyrat e bashkisë etj. Gjithashtu, përtej kësaj, nëpërmjet policisë bashkiake, janë kryer kontrolle të shpeshta për të garantuar respektimin e protokolleve të sigurisë në tregjet lokale, subjekte dhe në hapësira të tjera publike. Bashkia, për të përballuar situatën, ka bërë dhe ndryshimet përkatëse në planin buxhetor, duke rialokuar fonde në shërbim të situatës, dhe në paketën fiskale. Në këtë rast janë ulur me 20% tarifa e shërbimeve publike (ndriçim, pastrim, gjelbërim) si dhe është shtuar numri i familjeve të cilat janë pjesë e ndihmës ekonomike.

Nisur nga situata e krijuar dhe paqartësia për evoluimin e shpërndarjes së COVID-19, bashkia Lezhë parashikon që do të ketë një rënie në të ardhurat dhe vështirësi në mbledhjen e tyre. Sfidë parashikohet veçanërisht mbledhja e taksave të ndërtesës, truallit, tokës bujqësore dhe të tabelave. Gjithashtu, një tjetër sfidë që parashikohet nga bashkia në përballimin e situatës është dhe gjenerimi i fondeve të mjaftueshme për të mbështetur familjet në nevojë nëse shpërndarja e virusit dhe protokollet e sigurisë apo ri-mbyllja e vendit do të vijojnë. Në terma afatgjatë, bashkia identifikon se rritja e numrit të të papunëve dhe mbyllja e bizneseve mund të jetë një sfidë për komunitetin lokal. Në aspektin e zhvillimit ekonomik, rreziku për rënien e të ardhurave nga sektori i turizmit, i cili është një ndër më kryesorët në periudhën Maj-Tetor, është shumë i madh. Në lidhje me shërbimet të cilat ofrohen nga bashkia, ajo e shikon si sfiduese sektorin e arsimit para-universitar si dhe transportin publik.

9.12.6. Teknologjike, shpërthim zjarri

Në 17 Nëntor 2006, zjarri ra (në mënyrë aksidentale) në depozitat e karburantit të Kompanisë TAÇI OIL, ku veç dëmit ekonomik pati përhapje të madhe të naftës me ndikim ndotës në mjedisin ligatinor të Knallës. Rënia e këtij zjarri në formë shpërthimi, rrezikoi shumë jetën e forcave zjarrfikëse të vendit tonë dhe nga Greqia të angazhuara në ndalimin e zjarrit. Zbatimi i masave në këtë rast parandaloi përhapjen e zjarrit në ekonominë pyjore të Shëngjinit e të gjithë zonës së banuar në afërsi. Nga zjarri janë djegur 1 depozitë me 300 ton benzol, dy depozita me 500 e 900 ton me naftë. Kanë shpëtuar pa u djegur 2 depozita me naftë me 2000 ton e 3000 ton secila. Zona ligatinore përreth pësoi ndotje nga djegia e derdhja e naftës në të, në një sipërfaqe prej 60 ha. Ndikimi nga djegia e përhapja e naftës arriti në një gjatësi prej 480 m në drejtim jugperëndimor të parkut të depozitave si dhe në gjerësi që arrin deri në 120 m. Nga zjarri janë djegur e dëmtuar mbulesa shkurre e kryesisht me kallamishte e marine.

FIGURA 38. Pamje nga aksidenti i ndodhur (majtas) dhe zona e djegur dhe e ndotur e Knallës (në të djathtë)



9.13. URDHRI I KRYETARIT TË BASHKISË “PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË MBROJTJES CIVILE” DHE RREGULLORJA



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA LEZHË

Adresa : Lagja "Skenderbeg", Sheshi "Gjergj Kastriotii", Lezhe - ALBANIA tel/fax:00355215 22270/22219 email: info@lezha.gov.al

URDHËR

Nr. _____, dt. ____/____/2020

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË MBROJTJES CIVILE

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 29 të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; pikës 2 dhe 5 të nenit 9; nenit 11; pikave 2 dhe 6 të nenit 14; shkronjës "b" të nenit 27; pikave 2 dhe 3 të nenit 29; nenit 30; pikës 2 të nenit 63, të ligjit nr.45/2019, datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen civile"; Planit Kombëtar për Emergjencat Civile të miratuar me VKM nr.835, datë 3.12.2004;

URDHËROJ

1. Ngritjen e Komisionit të Mbrojtjes Civile në Bashkinë Lezhë me përbërjen si më poshtë:

Nr.	Emri, mbiemri	Pozicioni i punës	Funksioni
1	Pjerin Ndreu	Kryetar i Bashkisë	Kryetar i Komisionit
2	Ermal Pacaj	Nënkryetari i Bashkisë	N/kryetar i Komisionit
3	Nikë Nikollaj	Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë	Anëtar
4	Bardhyl Kaçorri	Drejtor i Emergjencave Civile (drejtor).	Anëtar
5	Nik Leka	Drejtor i Planifikimit të Territorit (drejtor).	Anëtar
6	Dodë Jaku	Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve (drejtor).	Anëtar
7	Vinçens Tuku	Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit (Kryeinspektor)	Anëtar
8	Nard Palaj	Policia Bashkiake (Kryeinspektor)	Anëtar
9	Marte Fetaj	Drejtoria e Shërbimit Social (drejtor).	Anëtar
10	Mimoza Shtjefni	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve (drejtor).	Anëtar
11	Renaldo Xhanej	Drejtoria e Turizmit dhe Kulturës, (drejtor).	Anëtar
12	Brikena Vuksani	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit (Drejtor)	Anëtar
13	Arjan Barbullushi	Drejtoria e të Ardhurave Vendore	Anëtar
14	Gent Malotaj	Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve Publike (Drejtor)	Anëtar
15	Elton Zefi	Drejtoria e Shërbimeve Publike, (drejtor)	Anëtar
16	Gjok Gjoka	Drejtoria për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin (MZSH) (drejtor)	Anëtar
17	Eelson Frroku	Drejtoria e Integritimit Evropian, Komunikimit dhe Transparencës, (drejtor)	Anëtar
18	Flori Gjini	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	Anëtar
19	Zef Maçi	Sh.A. Ujësjetës Kanalizime, Lezhë, (drejtor)	Anëtar
20	Bjordi Malaj	Administrator i Njesisë Administrative Shëngjin	Anëtar
21	Sandër Marashi	Administrator i Njesisë Administrative Ballëdren	Anëtar
22	Luiza Marku	Administrator i Njesisë Administrative Blinisht	Anëtar
23	Lina Guri	Administrator i Njesisë Administrative Shënkoll	Anëtar
24	Gjergj Malshi	Administrator i Njesisë Administrative Zejmen	Anëtar
25	Fatjon Zefi	Administrator i Njesisë Administrative Kolsh	Anëtar
26	Besnik Simoni	Administrator i Njesisë Administrative Kallmet	Anëtar
27	Majlinda Miloti	Administrator i Njesisë Administrative Dajç	Anëtar
28	Gëzim Kola	Administrator i Njesisë Administrative Ungrej	Anëtar
29	Zoje Zefej	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, (drejtor)	Anëtar
30	Jolanda Gjeçi	Përfaqësuesi i Kryqit të Kuq Shqiptar, Dega Lezhë	Anëtar

2. Detyrat e Komisionit të Mbrojtjes Civile janë si më poshtë vijon:

- a. Të shërbejë si organ këshillues për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin në nivelin vendor nga Kuadri Sendai për Zbatimin e Riskut të Fatkeqësive, Axxhenda e Re Urbane, Axxhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Marrëveshja e Parisit për Ndryshimet Klimatike.
- b. Të shërbejë si organ këshillues për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, Planit i qarkut për emergjencat si edhe Planit vendor për emergjencat civile.

- c. Të shërbejë si organ këshillues për të siguruar që të gjitha politikat dhe dokumentet strategjike të bashkisë të jenë të informuara rreth riskut nga fatkeqësitë dhe të jenë të pajisura me masa për ta reduktuar atë, me qëllim garantimin e sigurisë së komunitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij.
 - d. Të shërbejë si organ këshillues për të siguruar që planifikimi dhe zhvillimi i territorit në nivel vendor të përgatiten në përputhje me dokumentet e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë dhe me strategjitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.
 - e. Të planifikojë, organizojë, koordinojë dhe kontrollojë të gjithë masat për parandalimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë në territorin e bashkisë dhe të sigurojë bashkërendimin e të gjitha aktiviteteve të strukturave shtetërore dhe joshtetërore në bashki për këtë qëllim.
 - f. Në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe degët territoriale, Prefektin e qarkut, organizatat e ndryshme ndërkombëtare, subjektet private, shoqatat dhe organizatat e shoqërisë civile si dhe ekspertët privatë, të kryejë.
 - Deri në muajin gusht 2021, vlerësimin e risqeve nga fatkeqësitë në territorin e bashkisë Lezhë, ta rishikojë atë jo më pak se një herë në çdo tre vjet dhe dokumentin e hartuar ta dërgojë për miratim në Këshillin Bashkiak.
 - strategjinë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe ta rishikojë atë jo më pak se një herë në çdo pesë vjet dhe dokumentin e hartuar ta dërgojë për miratim në Këshillin Bashkiak.
 - planin vendor për emergjencat civile dhe ta rishikojë atë jo më pak se një herë në çdo tre vjet dhe dokumentin e hartuar ta dërgojë për miratim në Këshillin Bashkiak.
 - g. Të bashkëpunojë me Komisionin e Mbrojtjes Civile në nivel Qarku dhe komisionet përkatëse të bashkive fqinje, për kryerjen e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë në territorin e bashkisë si edhe vlerësimin e nevojave.
 - h. Të vëzhgojë në mënyrë të vazhdueshme funksionimin e sistemit të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në territorin e bashkisë dhe të punojë për të informuar në kohë në lidhje me risqet dhe fatkeqësitë, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Prefektin e Qarkut dhe komunitetet e rrezikuara.
 - i. Të bashkërendojë veprimtaritë për organizimin dhe pajisjen e forcave të ndërhyrjes në rastet e emergjencave.
 - j. Të ndjekë dhe të zbatojë të gjitha detyrat e tjera në rastet e emergjencave, si në rastet
 - k. e shpalljes dhe ato të mosshpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore.
 - l. Sekretari i komisionit përgatit të gjitha materialet e mbledhjeve të radhës së komisionit, mban procesverbalet e takimeve dhe i ndan ato me anëtarët e komisionit.
3. Funksionimi i Komisionit të Mbrojtjes Civile përcaktohet sipas rregullores për këtë qëllim të miratuar në këtë Komision.
 4. Urdhri i Kryetarit të Bashkisë Lezhë me nr 514, datë 26.11.2019 “Për ngritjen e Komisionit të Mbrojtjes Civile në Bashkinë Lezhë” shfuqizohet.
 5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I BASHKISË
PJERIN NDREU



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA LEZHË

Adresa : Lagja "Skenderbeg", Sheshi "Gjergj Kastriotii", Lezhe - ALBANIA tel/fax:00355215 22270/22219 email: info@lezha.gov.al

**RREGULLORE
PËR FUNKSIONIMIN E BRENDSHËM TË KOMISIONIT TË MBROJTJES CIVILE**

Në mbështetje të pikës 2 dhe 3 të nenit 29 dhe nenit 30, të ligjit nr.45/2019, datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen civile", Komisioni i Mbrojtjes Civile, vendosi të aprovojë rregulloren për funksionimin e brendshëm të tij si më poshtë vijon:

- a. Komisioni i Mbrojtjes Civile (KMC) funksionon sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" si edhe bazuar Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Lezhë Nr. ____, datë _____.2020 ku saktësohen përgjegjësitë dhe detyrat e këtij komisioni.
- b. Rregullorja ka si qëllim funksionimin e brendshëm të KMC-së, të sekretarisë teknike, si edhe të marrëdhënieve ndërmjet anëtarëve të Komisionit.
- c. KMC funksionon në mënyrë të vazhdueshme, si në situata normale ashtu edhe në situata emergjente.
- d. KMC mblidhet me kërkesën e Kryetarit të tij, i cili përcakton rendin e ditës së mbledhjes dhe drejton mbledhjen. Mbledhja mund të zhvillohet edhe/ose me kërkesë të 30 % të anëtarëve të tij. Me miratimin e Kryetarit, çdo anëtar ka të drejtë të propozojë edhe çështje të tjera, të cilat nuk janë të përfshira në rendin e ditës.
- e. KMC e ushtron veprimtarinë e tij nëpërmjet mbledhjeve të zakonshme, të cilat janë të vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se 50 %+1 e anëtarëve, dhe janë të hapura. Në rastet kur pjesëmarrja nuk sigurohet, mbledhja e Komisionit do të zhvillohet jo më vonë se dy javë nga data e njoftimit të ri. Në rastet e situatave emergjente mbledhja zhvillohet menjëherë pavarësisht nga numri i pjesëmarrësve.
- f. KMC mblidhet jo më pak se një herë në tre muaj në situata normale, ose rast pas rasti sipas nevojës, si dhe qëndron i mbledhur në situata të emergjencave civile.
- g. Njoftimi për mbledhjen bëhet të paktën 10 (dhjetë) ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes në situata normale ndërsa njoftimi bëhet për mbledhje të paparashikuar apo urgjente në situata gatishmërie apo të emergjencës së ndodhur.
- h. Në rastet kur mbledhja është e domosdoshme të zhvillohet ditën e caktuar dhe kryetari e ka të pamundur drejtimin e mbledhjes, ai cakton Nënkryetarin ose një nga anëtarët e Komisionit, për kryesimin e mbledhjes si kryetar provizor.
- i. KMC vendos me shumicë votash ndërsa në rastet kur numri i votave është ndarë në mënyrë të barabartë, vendos vota e Kryetarit të Komisionit.

SHTOJCA 1

- a. Sipas nevojës, mund të krijohen grupe tematike me anëtarë nga: prefekti i qarkut, institucionet qendrore dhe degët e tyre rajonale, organizatat e ndryshme ndërkombëtare, përfaqësues të Klerit, subjektet private, shoqatat dhe organizatat e shoqërisë civile, studiues, shkencëtarë si dhe ekspertët privatë, sipas shtojcës 1 të kësaj rregulloreje. Këta anëtarë ftohen në raste specifike, ose edhe në mbledhjet e radhës, varësisht çështjeve dhe problematikave të trajtuara.
- b. Drejtoria e Emergjencave Civile në bashki luan rolin e Sekretarisë Teknike të Komisionit të Mbrojtjes Civile
- c. Sekretaria Teknike e Komisionit të Mbrojtjes civile merr të gjitha masat për organizimin e mbledhjeve të programuara, kryen njoftimin, përgatit dhe shpërndan materialet përkatëse të mbledhjes në kohë, për secilin anëtar.
- d. Në mbledhjet e Komisionit të Mbrojtjes civile mbahet procesverbali/minutat e takimit, nga sekretari i sekretarisë teknike, ku shënohen data, vendi i mbledhjes, anëtarët e pranishëm, çështjet që u diskutuan, diskutimet e pjesëmarrësve dhe rezultatet e arritura. Procesverbali u shpërndahet me e-mail anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes Civile, jo më vonë se një javë pas përfundimit të mbledhjes. Ai nënshkruhet nga sekretari i sekretarisë teknike të Komisionit të Mbrojtjes Civile.
- e. Komisioni i Mbrojtjes Civile, nëpërmjet sekretarisë, kontrollon dhe verifikon zbatimin e vendimeve apo dhe të detyrave të marra/caktuara në mbledhjet e tij si nga anëtarët e komisionit, të institucioneve të tjera shtetërore e kërkimore-shkencore, nga subjektet fizike e juridike, private e publike, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike, shoqërore, kulturore e argëtuese, në territoret e Bashkisë së Lezhës.
- f. Drejtoria e Emergjencave Civile dhe çdo anëtar i Komisionit të Mbrojtjes Civile informojnë rregullisht për zbatimin e vendimeve e të detyrave në mbledhjen e ardhshme të Komisionit të Mbrojtjes Civile.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
I KOMISIONIT TË MBROJTJES CIVILE**

PJERIN NDREU

Qarku Lezhë

Nr	Institucioni
1	Sektori i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në Prefekturë
2	Inspektorati Kombëtar i Mjedisit dhe Territorit (dega për Veriun, IKMT)
3	Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit
4	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit – Lezhë
5	Sektori i Ekstensionit Bujqësor Lezhë
6	Sektori Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Lezhë
7	Agjencia Rajonale e Mjedisit (DRM)
8	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë (DRAP)
9	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Lezhë (ZVAP)
10	Drejtoria Rajonale e Autoritetit Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër
11	Administrata e Zonave të Mbrojtura Qarku Lezhë
12	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
13	Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës
14	Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore
15	Dega Lezhë e Drejtorisë së OSSHE Shkodër
16	Dega Doganore Lezhë
17	Përfaqësuesi i Caritas
18	Përfaqësuesi i World Vision
19	Ekspert nga kompani private
20	Ekspert privat për emergjencat civile, mjedisin etj.
21	Ekspert nga OJF
22	Përfaqësuesi i Klerit Katolik
23	Përfaqësuesi i Klerit Mysliman
24	Përfaqësues nga subjekt privat
25	Studiues, shkencëtar

Institucionet Qendrore

1	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
2	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
3	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
4	Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit
5	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
6	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
7	Agjencia Kombëtare e Turizmit
8	Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
9	Agjencia e Zhvillimit Bujqësor Rural
10	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
11	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit

